VENDIM

Nr. 621, datë 10.10.2024

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS "AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE 2024–2027", NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN "FACILITETI PËR REFORMA DHE RRITJE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrit të Drejtësisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Mekanizmi për mbarëvajtjen e zbatimit të dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" miratohet me urdhër të Kryeministrit.
3. Ngarkohen struktura përgjegjëse për negociatat, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në dokumentin e politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DOKUMENTI I POLITIKËS
"AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE 2024–2027" NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN "FACILITETI PËR REFORMA DHE RRITJE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR"

PJESA E PARË

Komisioni Evropian, më 8 nëntor 2023, në kuadër të Paketës së Zgjerimit 2023, lancoi nismën për propozimin e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, pjesë e të cilit është dhe mbështetja përmes Instrumentit "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor".

Instrumenti "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor" mbështet shtyllën e tretë[1] dhe të katërt[2] të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Kjo iniciativë e re zhvillimore do të ofrojë mbështetje financiare deri në 6 miliardë euro për periudhën 2024–2027, për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

[1] Shtylla 3 e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor: Përshpejtimi i reformave themelore, duke përfshirë grupimin themelor, duke mbështetur rrugëtimin e Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke përmirësuar rritjen e qëndrueshme ekonomike, duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal.

[2] Shtylla 4 e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perendimor: Rritja e asistencës financiare për të mbështetur reformat nëpërmjet një Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (RGF): një instrument i ri me vlerë 6 miliardë euro me mbështetje të pakthyeshme (grant) dhe kredie, ku pagesa kushtëzohet me përmbushjen e reformave themelore.

Synimi është përshpejtimi i konvergjencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor krahasimisht me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ndikuar sidomos nga pasojat që erdhën nga kriza ekonomike si pasojë e pandemisë COVID-19, si dhe kriza energjetike globale, si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, përmes nxitjes, me objektiv dyfishimin, e rritjes ekonomike.

Ky instrument është miratuar më 14 maj 2024, përmes Rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian "Për miratimin e Facilitetit të Reformave dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor".

Dokumenti i politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" (AKR 2024–2027) konsiderohet si një instrument i rëndësishëm që do të nxisë përgatitjet ekonomike të orientuara nga tregu për përshpejtimin e integrimit të ekonomisë shqiptare në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, drejt progresit në konvergjencë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vjen si kërkesë e kreut III të Rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian.

Prioritetet e reformave të përcaktuara në AKR 2024–2027 janë në përputhje me drejtimet prioritare që përcakton Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, me qëllim përshpejtimin e integrimit të ekonomisë shqiptare në Tregun Unik të Bashkimit Evropian, përshpejtimin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe thellimin e integrimit ekonomik rajonal, me objektiv kryesor mbështetjen për dyfishimin e rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Faza aktuale e procesit të negociatave dhe integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian e bën të qartë nevojën e ngushtimit të hendekut të konvergjencës ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, në drejtim të zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKR 2024–2027 adreson sfidën e rritjes së shkallës së integrimit të ekonomisë kombëtare dhe asaj rajonale në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, rritjes së produktivitetit të ekonomisë shqiptare, rritjes së aftësive të bizneseve dhe fuqisë punëtore etj.

Prandaj, fokusi kryesor i AKR 2024–2027 është përmirësimi i klimës së favorshme ndaj biznesit dhe nxitja për rritjen ekonomike, nëpërmjet reformave për shtetin e së drejtës dhe të transformimit dhe ristrukturimit të ekonomisë, me burime kryesore të rritjes në kapitalin human, produktivitetin përmes specializimit dhe modernizimit, investimet dhe pjesëmarrjen në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian (përmes eksporteve, internacionalizimit dhe integrimit të tregjeve sektoriale).

Dokumenti i politikës AKR 2024–2027 përcakton reforma/politika sipas qasjes, si më poshtë:

a) Politika me në qendër biznesin: masa në adresim të sfidave për tregun, forcimin e biznesit dhe ekonomisë, me synimin rritjen e aftësisë konkuruese në tregjet rajonale dhe përshpejtimin e integrimit në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, të sipërmarrjes vendase.

b) Qasje "Treg me treg": duke i shërbyer integrimit të tregut shqiptar në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, që përbën burim të rëndësishëm për rritje ekonomike, për të lehtësuar aksesin e sipërmarrjes në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, si dhe bashkëpunimit në tregun rajonal, si bazë më e gjerë konsumatore dhe e partneritetit të zinxhirit të vlerës.

c) Transformim ekonomik: masa dhe hapa që nxisin, gjenerojnë dhe kanë ndikim në inovacion, specializim të zgjuar, transformimi tregu, aftësish dhe tranzicion energjitik/ digjital për një rritje ekonomike të qëndrueshme.

d) Realizueshmëri dhe masa realiste: masa që gjenerojnë rezultat dhe ndikim, si dhe janë transformuese e sfiduese, por të arritshme me përpjekje të shtuara.

AKR 2024–2027 është një dokument politike reformash thelbësore të nxitjes së rritjes dhe transformimit ekonomik dhe konsolidimit të vlerave të shtetit të së drejtës. Dokumenti i politikës AKR 2024–2027 ofron një përmbledhje masash të përzgjedhura nga dialogu institucional Shqipëri – Bashkim Evropian, dhe hapash për krijimin e mjedisit të favorshëm për konsolidimin e transformimin ekonomik të vendit, i cili është i domosdoshëm për të rritur ritmin e rritjes dhe konvergjencës socio-ekonomike me vendet anëtare në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

AKR 2024–2027 përfshin masa që lidhen me prioritete në fushat/shtyllat e politikave si më poshtë vijon:

1. Klima e biznesit;
2. Kapitali njerëzor;
3. Energjia/tranzicioni i gjelbër;
4. Tranzicioni digjital;
5. Shteti i së drejtës/themeloret.

Qëllimi kryesor i dokumentit të politikës AKR 2024–2027 është të ndikojë dhe stimulojë më tej çlirimin e potencialit ekonomik të vendit, përmes mbështetjes së transformimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe agjendës së gjelbër (tranzicionit energjitik) dhe digjitale, për të hyrë gradualisht dhe i përgatitur në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, në themele solide dhe përmes forcimit të shtetit të së drejtës, me progres të vazhdueshëm në integrimin e përshpejtuar, pakthyershmërinë, konsolidimin dhe efikasitetin e reformave themelore të ndërmarra, dhe ecjes së qëndrueshme përpara, në përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, deri më 2030-n.

Synimi kryesor i dokumentit të politikës AKR 2024–2027, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor", është të kontribuojë dhe mbështetë objektivin e Planit të Rritjes për dyfishimin e rritjes ekonomike në Shqipëri, nëpërmjet potencialit dhe konsolidimit të ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj, përmes avancimit të teknologjisë dhe digjitalizimit, me burim të çmuar kapitalin human, dhe në bazat e qëndrueshme të reformave për shtetin e së drejtës.

Objektivat kryesorë të dokumentit të politikës AKR 2024–2027 janë të shumëfishta, duke përfshirë aspekte të ndryshme të qeverisjes, zhvillimit ekonomik dhe progresit shoqëror, si më poshtë vijon:

Objektivi 1: Rritja e konkurrueshmërisë dhe qeverisjes ekonomike

Objektivi i parë është konsolidimi i reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisje ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me *acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Ky objektiv përfshin disa iniciativa kryesore, të parashikuara si masa në dokumentin e politikës AKR 2024–2027, që nxisin një klimë biznesi edhe më konkurruese dhe tërheqëse, përmes një kornize kohezive dhe mbështetëse për zhvillimin ekonomik, përmes reformave dhe masave, si: i) mobilizimi i të ardhurave të brendshme dhe përmirësimi i sistemit tatimor; ii) sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve shtetërore të kadastrës, për investitorët, bizneset dhe qytetarët dhe një politike publike gjithëpërfshirëse për përdorimin e tokës dhe pronës; iii) rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve dhe përmirësimi i qeverisjes së shoqërive me pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore; iv) përmirësimi i kornizës së tërheqjes së investimeve, në veçanti për IHD-të, dhe i klimës së biznesit, nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit; v) vendosja e Sistemeve Inteligjente të Transportit dhe E-mallrave; vi) promovimi i eksportit të produktit vendas drejt Bashkimit Evropian dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e tregtisë dhe transportit, me synim Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, si një bazë e gjerë konsumatorë; vii) partneritetin për zinxhirin e vlerës dhe rritjen, specializimin e zgjuar dhe formimin profesional, sipërmarrjen inovative etj.

Objektivi 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i kapitalit njerëzor – reformimi më tej i arsimit, për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur digjitalisht

Objektivi i dytë fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke krijuar një sistem arsimor dinamik që pajis studentët dhe punonjësit me aftësitë përkatëse dhe kompetencën digjitale të nevojshme në ekonominë globale, duke nxitur inovacionin dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare, zhvillimin e produktivitetit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të këtij objektivi, përvijohen iniciativa të ndryshme të parashikuara si masa në dokumentin e politikës AKR 2024–2027, për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor profesional, përafrimin e tij me kërkesat në përgjigje të zhvillimeve dinamike të tregut të punës dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe më gjerë, me zhvillimin e ekonomisë.

Reformat kryesore për arritjen e këtij objektivi konsistojnë në: i) përmirësimin e sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës; ii) përditësimin i kurrikulave në arsimin parauniversitar për kompetencat e të mësuarit në përmbushje të Rekomandimit të Bashkimit Evropian dhe Strategjisë Kombëtare të Arsimit,

2021–2026; iii) përmirësimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, në përputhje me atë të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG[3]), si një nga angazhimet kryesore të Procesit të Bolonjës; iv) përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe infrastrukturën TIK për shkollat dhe universitetet publike; v) forcimin e efikasitetit të skemave mbështetëse të politikës së punësimit; vi) forcimi i mjedisit dhe ekosistemit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit etj.

Objektivi 3: Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme

Objektivi i tretë përqendrohet në transformimin digjital, duke krijuar një shoqëri digjitale udhëheqëse të zhvillimit dhe rritjes, ku infrastrukturat digjitale të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike dhe transformimin ekonomik, e sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Për të arritur këtë objektiv, parashikohen në AKR 2024–2027 disa iniciativa kryesore, që konsistojnë në: i) përafrimin me rregulloren e Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital dhe zbatimi i E-Portofolit Digjital për shërbimet publike; ii) përafrimin e kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike, me standartet e Bashkimit Evropian dhe kërkesat e Direktivës NIS2[4] të Bashkimit Europan; iii) përmirësimin e kuadrit rregullator për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme; iv) përmirësimin e mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe mbështetja e inicitivave të bizneseve me potencial për tranzicionin e gjelbër dhe digjital, si dhe nxitjen dhe rritjen e e ekosistemit të sipërmarrjes inovative etj.

Objektivi 4: Konsolidimi i qëndrueshmërisë energjitike dhe integrimi i tregut shqiptar në atë të BE-së

Objektivi i katërt fokusohet në energjinë dhe tranzicionin e gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në një lider rajonal të energjisë, nëpërmjet adoptimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur një treg konkurrues dhe transparent të energjisë, duke adresuar risqet nga varfëria energjetike dhe aspektet mjedisore, si dhe duke rritur përpjekjet e mëtejshme në tranzicionin e gjelbër.

Masat që përfshihen nën këtë objektiv konsistojnë në: i) rregullimin gradual të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e risqeve nga varfëria energjetike; ii) nxitje e prodhimit të energjisë së rinovueshme përmes zhvillimit të një plani transparent dhe konkurrues për energjinë e rinovueshme; iii) zbatimi i Direktivës së Energjisë së Rinovueshme; iv) mekanizmat lidhur me vendosjen e sistemit të tregtisë dhe emetimit të karbonit të Bashkimit Evropian; v) kuadri strategjik për eficiencën e energjisë dhe skema e eficiencës së energjisë për godinat publike etj.

Objektivi 5: Konsolidimi i shtetit të së drejtës

Objektivi i pestë synon të kontribuojë në garantimin e pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi dhe të konsolidojë më tej punën për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet masave që luftojnë krimin e organizuar, parandalojnë dhe ulin incidencën e korrupsionit, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe promovojnë transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane.

Masat që përfshihen nën këtë objektiv konsistojnë në: i) fuqizimin e punës për parandalimin e korrupsionit dhe luftën ndaj krimit të organizuar; ii) forcimin e kapacitetit institucional dhe kuadrit strategjik në fushën e parandalimit dhe luftës kundër drogave; iii) konsolidimin e një kornize strategjike dhe veprimi të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave; iv) konsolidimin i pavarësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë, nëpërmjet transparencës; v) rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në të gjitha nivelet; vi) konsolidimin e progresit për lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane; vii) përafrimin e politikës së vizave me standardet/politikat e BE-së.

[3] ESG – *European Stardards Guidelines.*
[4] NIS – *Network and Information Security Directive,* EU.

AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE 2024–2027			
Fusha e politikës	**Komponenti (sektori)**	**Reforma indikative**	**Hapat cilësorë ose sasiorë**
1. Klima e biznesit	1.1. Klima e biznesit	1.1.1 Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe e sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA)	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) e përditësuar dhe e miratuar **(Dhjetor 2024)**, duke përfshirë (ndër të tjera) një masë për një vlerësim të të gjitha përjashtimeve tatimore, me synim vendimmarrjen për heqjen graduale të përjashtimeve, si edhe për mundësimin e përdorimit të të dhënave nga palë të treta për hetimin e pasurive të pajustifikuara (**qershor 2025**). Përfshirja në SAA dhe zbatimi i masave për përmirësimin e administrimit tatimor, si përdorimi i të dhënave nga palët e treta (energjia elektrike, uji, regjistrimi i automjeteve), për të mundësuar programin e administratës tatimore mbi hetime të pasurive të pajustifikuara të aseteve të tatimpaguesve **(dhjetor 2026);** plotësimi i regjistrit të pasurive të tatimpaguesve me 10% të tatimpaguesve të regjistruar **(dhjetor 2026);** rritja e plotësimit paraprak të deklaratave të TVSH-së dhe deklaratave të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga fiskalizimi) (**dhjetor 2026**); forcimi i performancës së hetimeve kundër mashtrimit tatimor (**qershor 2027).**
		1.1.2 Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët, dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës	Regjistrimi fillestar është kryer në 95% të të gjitha zonave kadastrale **(qershor 2026).** Digjitalizimi i të gjithë kartelave manuale të pasurive të paluajtshme ka përfunduar dhe digjitalizimi përparon, në përputhje me Udhërrëfyesin gjithëpërfshirës, për të arritur rezultate të prekshme me përfundimin e proceseve të digjitalizimit, të miratuar deri në qershor 2025 **(qershor 2026).** Miratimi i një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të arritur rezultate të prekshme për përfundimin e proceseve të digjitalizimit, me qëllim që titujt e mëparshëm të pronësisë, të administruara fizikisht në zyrë, për pasuritë e paluajtshme dhe hartat kadastrale në të gjitha zonat kadastrale të digjitalizohen, duke i dhënë përparësi zonave me rëndësi ekonomike, dhe që regjistrimi fillestar të përfundojë plotësisht (**qershor 2025).** Miratimi i një politike mbi tokën dhe masat e nevojshme administrative, buxhetore dhe koordinuese për fillimin e zbatimit të saj, në vitin 2028 **(qershor 2027**). Miratimi i një plani integriteti **(dhjetor 2025)**, duke përfshirë masa të efektshme antikorrupsion që reflektojnë mendimin e palëve të interesuara (përfaqësues të shoqërisë civile, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, shoqatave përfaqësuese të sistemit bankar dhe shoqatave të biznesit etj.), me synimin për të përmirësuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve dhe treguar rezultate në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve, për shërbimet si regjistrimi i titujve të pronësisë, regjistrimi i të drejtave reale mbi pronën apo regjistrimi i detyrimeve, lëshimi i vërtetimeve të ndryshme, të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës **(dhjetor 2027).**
		1.1.3 Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikat e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe Ndihmës Shtetërore	Miratimi i ligjit mbi PPP[5]/koncesionet në përputhje me *Acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian **(qershor 2025)** dhe PPP/koncesionet fillojnë të integrohen plotësisht në Listën Unike Kombëtare të Projekteve (**dhjetor 2025**). Miratimi i kuadrit ligjor për të siguruar një Autoritet, me pavarësi operacionale, të Ndihmës Shtetërore dhe i masave operacionale përkatëse (buxheti) **(dhjetor 2025).** Të sigurohet që të gjithë anëtarët e rinj të bordeve të SHPSH[6]-ve emërohen përmes procedurave transparente dhe të bazuara në merita **(dhjetor 2024)** dhe ndryshimi i rregullimeve përkatëse për të përfshirë rregulla për emërimin e anëtarëve të bordeve të SHPSH-ve, përmes proceseve të rekrutimit të hapura dhe të bazuara në

[5] Partneriteti publik privat.
[6] SHPSH – shoqëri në pronësi shtetërore.

			merita (**qershor 2025**). Zgjerimi i kritereve për anëtarë të pavarur të bordeve të SHPSH-ve, përmes procedurave të hapura dhe të bazuara në merita, aplikohet "kudo ku është e mundur" (d.m.th., për të gjithë ato SHPSH, të cilat nuk klasifikohen me "performancë të ulët" etj., pas një analize fizibiliteti) **(dhjetor 2026).**
		1.1.4 Përmirësimi i kornizës së tërheqjes së investimeve dhe në veçanti i kuadrit të IHD-ve dhe i mjedisit të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit	Miratimi i ligjit (eve) të unifikuar të investimeve dhe akteve kryesore nënligjore për zbatimin e ligjit, në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian (**dhjetor 2026).** Miratimi i ndryshimeve ligjore për të lehtësuar procedurat administrative për bizneset **(dhjetor 2024).** Miratimi i ndryshimeve ligjore për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e inspektimit për bizneset **(dhjetor 2025).** Përgatitja e Udhërrëfyesit për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e raportimit të biznesit **(dhjetor 2025).** Miratimi i një plani veprimi për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për Politikat e SME-ve (**dhjetor 2025**).
		1.1.5 Vendosja e Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT) dhe E-transporti	Miratimi i legjislacionit përkatës për t'u harmonizuar me Rregulloren e BE-së 2020/1056 mbi Informacionin Elektronik të Transportit të Mallrave (eFTI[7]) **(Qershor 2025).** Ratifikimi i Protokollit shtesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave mbi "fletëshoqërimin elektronik" (eCMR[8]) për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave, të nevojshme për ta vendosur në zbatim eFTI **(dhjetor 2025).** Miratimi i legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit për transportin rrugor, në përputhje me Acquis të Bashkimit Evropian (**dhjetor 2026)** dhe zbatimi i fazës së parë të sistemeve të mbledhjes së të dhënave të trafikut dhe sistemeve të informacionit të përdoruesve të transportit rrugor **(qershor 2027).** Miratimi i legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit [9] për transportin hekurudhor, në përputhje me Acquis të Bashkimit Evropian (**qershor 2027).**
		1.1.6. Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje	Miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (**dhjetor 2025).** Miratimi i ligjeve për Kontrollet Zyrtare **(qershor 2026)** për Shëndetin e Kafshëve dhe për Shëndetin e Bimëve, në përputhje të plotë me Acquis të Bashkimit Evropian (**qershor 2025)** dhe përgatitja e akteve nënligjore **(dhjetor 2026).** Progres i arritur në iniciativat rregullatore **(dhjetor 2025 / qershor 2026)** dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian **(Dhjetor 2027).** Progres i vazhdueshëm në zbatimin e iniciativave të Korridoreve të Gjelbra (*Green Lanes*) për lehtësimin e tregtisë, duke miratuar një program për lehtësimin e tregtisë dhe transportit **(dhjetor 2025)**[10]**.**

[7] Electronic Freight Transport Information (e-FTI).
[8] e-CRM (Electronic Consignment Note).
[9] ITS - Intelligent Transport Systems / Sistemet Inteligjente të Transportit (SIT).
[10] *Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.*

			Rritja e peshës së eksporteve (shërbime dhe mallra) ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së është në vlerë neto 40% **(qershor 2027).**
-2. Kapitali njerëzor	1.2. Arsimi	2.1.1. Rishikim i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës - - - -	Dy (2) Komitete shtesë të Aftësive Sektoriale (Bujqësia; (Energjia) Aftësitë e Gjelbërta) janë krijuar dhe funksionojnë, duke kontribuar në përshtatjen e përmbajtjes së AFP-së dhe programeve të trajnimit, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave të AFP-së **(qershor 2026).** Pesë (5) Kurrikula të Arsimit dhe Formimit Profesional[11] (përfshirë standardet e profesioneve përkatëse), në fushat e përcaktuara në Strategjinë e Specializimit Inteligjent[12] (S3), janë rishikuar nga Agjencia Kombëtare e AFP-së dhe Kualifikimeve dhe janë miratuar nga ministria përgjegjëse për AFP-në (**qershor 2026).** 85% e mësuesve përkatës të AFP-së janë trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP-së (**dhjetor 2026).** 50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së janë punësuar në sektorin përkatës të studimeve të tyre (3 muaj/6 muaj) pas diplomimit (të ndarë sipas gjinisë dhe llojit (të punësuar/të vetëpunësuar/vazhdojnë studimet e larta dhe punojnë në të njëjtën kohë); e monitoruar për çdo vit **(qershor 2027).**
		2.1.2. Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar	Miratimi dhe zbatimi i një sistemi të ri të vlerësimit të performancës (një metodologji dhe instrumente për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale) për mësuesit e arsimit parauniversitar, veçanërisht për kompetencat TIK (**qershor 2027).** Përditësimi i kurrikulës bazë në arsimin parauniversitar, me qëllim për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës, përkatësisht në lëndët "Shkencat e natyrës, Artet, Teknologjia dhe TIK, dhe Gjuhët dhe Komunikimi" (**dhjetor 2026**). 95% e mësuesve janë trajnuar (**qershor 2027**) për kurrikulat e reja (Programet e zhvillimit profesional për 50% të programeve lëndore) (**Dhjetor 2025).** Fillimi i zbatimit të kurrikulës së re **(qershor 2027).** Zgjerimi i programit "Art dhe Zeje" në 65% të shkollave të arsimit parauniversitar **(qershor 2027).**
		2.1.3. Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke vendosur një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve	Rregullimi dhe miratimi i kuadrit për njohjen/vlefshmërinë e përvojës së mëparshme të të mësuarit joformal dhe informal dhe përfshirja e kualifikimeve të "të mësuarit përgjatë të gjithë jetës", përfshirë mikrokredencialet, në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (**qershor 2026**). 90% e ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së hyjnë në procesin e akreditimit (**qershor 2027**). Zbatimi i pjesshëm i ESG[13]-ve (përkatësisht ESG 2.7 dhe ESG 3.3) dhe futja e referencave të qarta në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të Kornizës Shqiptare, si kritere për akreditim **(dhjetor 2025).**
		2.1.4Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike	95% të shkollave publike me lidhje broadband me shpejtësi të lartë (të paktën 30 Mbit) (**dhjetor 2025).**

[11] AFP – Arsimi dhe formimi profesional.
[12] S3 – *Smart Specialisation Strategy* – Strategjia e Specializimit Inteligjent (SSI).
[13] ESG – *European Standards and Guidelines*.

			Krijimi i Smart Labs[14], shoqëruar secili me infrastrukturën përkatëse digjitale, në 75% të shkollave publike **(qershor 2027)[15].** Futja e lëndës TIK në të gjitha klasat e arsimit bazë dhe trajnimi i 500 mësuesve të arsimit parauniversitar për të dhënë mësim këtë lëndë (**dhjetor 2026).** Përmirësimi i kapaciteteve TIK në IAL[16], duke zhvilluar dhe konsoliduar një platformë të menaxhimit të informacionit për arsimin e lartë (**dhjetor 2026).** Certifikimi sistematik për programet e aftësive digjitale të arrijë në certifikimin e 6000 individëve (**dhjetor 2026**).
	2.2. Tregu i Punës	2.2.1. Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Punësimit	Ofrim i Programeve Aktive të Tregut të Punës të reja dhe të diversifikuara, që synojnë mbështetjen për punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, punëkërkuesit e papunë afatgjatë dhe punëkërkuesit e papunë afatgjatë me arsim bazë/pa arsim paraprak (**qershor 2025**). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në Programet Aktive të Tregut të Punës në 8% (**qershor 2026**). Rritja e numrit të regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve (**qershor 2026**). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë në Formimin Profesional në 20% të totalit të punëkërkuesve të papunë (**dhjetor 2026**). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes Programeve të Promovimit të Punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në 5000 (të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe grupeve vulnerabël) (**dhjetor 2027**).
	2.3. Kërkim & Zhvillim	2.3.1. Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit, duke miratuar kornizën strategjike aftësuese	Miratimi i Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) (**dhjetor 2024**). Miratimi i ligjit dhe zbatimi i legjislacionit për shkencën dhe kërkimin, në përputhje me politikën e Zonës Evropiane të Kërkimit (**dhjetor 2025).** Krijimi nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor i një platforme për promovimin e Shkencës së Hapur, duke u dhënë studiuesve shqiptarë akses në botimet kërkimore të mundësuara nga institucionet e tyre (**qershor 2027**). Miratimi i një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (*European Inovation Scoreboard*), me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI (**dhjetor 2025**).
3.Digjitale	3.1. Digjitale	3.1.1. Përputhshmëria me rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i E-Portofolit Digjital për	Miratimi i legjislacionit përkatës për t'u harmonizuar me rregulloren e re të Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital (eIDAS 2 Regulation 2024/1183) **(qershor 2026**).

[14] Program i Qeverisë Shqiptare që përfshin pajisjen e shkollave me laboratorë teknologjikë (laboratorë smart) të përshtatshëm për mësimdhënien e lëndës së TiK në kushtet më optimale.
[15] Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.
[16] IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë.

		shërbimet publike -	Përfshirja në listën e besuar të Vendeve të Treta të Bashkimit Evropian për validimin e nënshkrimeve elektronike, si nënshkrim elektronik i avancuar për të arritur efektin ligjor të nënshkrimit fizik në BE, si hap i parë drejt njohjes reciproke të shërbimeve të kualifikuara të besuara **(dhjetor 2025).** Zbatimi i identiteteve elektronike të verifikuara nëpërmjet NFC[17] (**qershor 2026**) që lejojnë lidhjen me shërbimet digjitale të administratës publike (duke përfshirë të paktën 22 shërbime elektronike aktuale në E-Albania në fushën e taksave, shërbimeve sociale dhe arsimore) **(dhjetor 2026)** dhe pjesëmarrje të plotë në Portofolin e Identitetit Elektronik të Bashkimit Evropian **(dhjetor 2027).** Zbatimi i një Portofoli Digjital për shërbimet elektronike publike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke e pilotuar si pjesë të Portofolit të Identitetit Digjital të E-shërbimeve publike, për të paktën 10 E-shërbime publike **(dhjetor 2026).** Kërkesat e marrëveshjeve të njohjes reciproke janë të përgatitura dhe gati për nënshkrim me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor (**qershor 2027).**
	-	3.1.2. Përafrimi i kuadrit rregullator për qëndrueshmërinë kibernetike, duke përfshirë kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse	Përditësimi i listës së infrastrukturës kritike në fushëveprimin e ligjit të zbatueshëm të vendit në përputhje me Direktivën NIS2[18] **(qershor 2025).** CERT[19]-et kombëtare dhe qeveritare janë plotësisht funksionale, në përputhje me kërkesat e NIS2 **(dhjetor 2025)** dhe arrijnë të paktën statusin e 'të akreditуarit' në TF CSIRT[20] Trusted Introducer [21] **(dhjetor 2026).** Zbatimi dhe bërja plotësisht funksionale e kornizave (korniza CVD[22], kuadri i menaxhimit të krizave) të vendosura sipas përafrimit të NIS2 (**dhjetor 2025).** AKSK[23] vepron si autoritet kompetent (siç përcaktohet në Direktivën NIS2) dhe është funksional: me staf të mjaftueshëm, të pajisur me kompetenca mbikëqyrëse e që kryen kontrolle mbikëqyrëse (**dhjetor 2026).**
	-	3.1.3. Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme	Miratimi i legjislacionit përkatës për Broadband për ta përafruar me Acquis të Bashkimit Evropian dhe Aktin e Infrastrukturës Gigabit, me hyrjen në fuqi në Bashkimin Evropian **(qershor 2026).** Zbatimi i masave rregullatore dhe të kapaciteteve institucionale për të siguruar futjen e infrastrukturave 5G, në përputhje me instrumentet 5G të sigurisë kibernetike të BE-së (**qershor 2025**).

[17] NFC *Users Identity Verification* – procesi i përdorimit të teknologjisë së komunikimit në terren të afërt (*Near Field Communication* – NFC) për të verifikuar identitetin e një përdoruesi. NFC është një teknologji komunikimi wireless/me valë që lejon pajisjet të shkëmbejnë të dhëna në distanca të shkurtra, zakonisht disa centimetra.
[18] NIS – *Network and Information Security* (NIS) *Directive of EU*.
[19] CERT - *Computer Emergency Response Team*.
[20] TF CSIRT – *Task Force on Computer Security Incident Response Teams*
[21] *Trusted Introducer* – Prezantuesi i besuar: Shërbimi i Prezantuesit të Besuar është një kornizë brenda TF-CSIRT e ngritur për të krijuar besim dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis CSIRT-ve. Prezantuesi i besuar vlerëson dhe akrediton CSIRT bazuar në respektimin e tyre ndaj standardeve specifike dhe praktikave më të mira.
[22] Korniza CDV (*Coordinated Vulnerability Disclosure Framework*) – Korniza e koordinuar e zbulimit të cenueshmërisë krijon procedura për identifikimin, raportimin dhe adresimin e dobësive të sigurisë në sistemet e informacionit. Ka si funksion, që dobësitë të zbulohen në mënyrë të koordinuar, duke i lejuar organizatat të zbusin rreziqet përpara se ato të shfrytëzohen.
[23] AKSK – Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

	3.2. Përvetësimi nga biznesi i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale	3.2.1. Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare	Miratimi i Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative (**dhjetor 2024**). Miratimi i akteve nënligjore për instrumente të mbështetjes së inovacionit, duke përmirësuar praktikën aktuale, në përputhje me praktikat e BE-së (**dhjetor 2025**). Përgatitja **(dhjetor 2025)** dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus në inkubatorët/përshpejtuesit, duke synuar zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale **(dhjetor 2026).** Përgatitja **(dhjetor 2024)** dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus tek SME-të dhe/ose startup-et, ku 30% e grantit përcaktohet për SME-të dhe/ose startup-et, që synojnë zgjidhje të gjelbra dhe/ose digjitale **(dhjetor 2025).**
4.Energjia / tranzicioni i gjelbër	4.1. Reformat e tregut	4.1.1. Përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike, për të mundësuar integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës (intra day), operacionalizimin e paketës në përputhje me planin e integrimit të operatorëve për bashkim të tregjeve deri në vitin 2025	Miratimi i ndryshimeve ligjore për t'u përafruar me paketën e integrimit të energjisë elektrike[24], në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe fillimi i zbatimit të tyre (**qershor 2025).** Vazhdimi i zbatimit të Paketës së Integrimit të Energjisë elektrike, duke vënë në funksion tregun e energjisë elektrike brenda ditës (*intra day*)[25], në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë **(dhjetor 2024).** Vazhdimi i zbatimit të Paketës së Integrimit të Energjisë Elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST[26]) dhe Operatori i emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (*NEMO-Nominated Electricity Market Operator*), duke ndërmarrë veprimet e nevojshme kombëtare për t'u integruar (*market coupling)*[27] me tregun e ditës në avancë (day ahead market)[28] të Bashkimit Evropian, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë (**Dhjetor 2025**).
		4.1.2. Rregullimet graduale të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e varfërisë energjetike	Tërheqja graduale nga ndërhyrja publike në përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike, nëpërmjet derregullimit të tensionit të mesëm dhe të lartë (**Plani i Veprimit/dhjetor 2024**), në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë (**dhjetor 2025**). Zhvillimi i metodologjisë për të përcaktuar grupet e prekura nga varfëria energjetike dhe mjetet e monitorimit, si dhe masat e eficiencës së energjisë që synojnë konsumatorin në nevojë, duke miratuar planin e veprimit për adresimin e varfërisë energjetike **(qershor 2026).**
	4.2. Energjitë e rinovueshme	4.2.1. Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme: Planifikimi trevjeçar i miratuar.	Miratimi i një plani ankandi, me bazë sasiore, për të paktën 600 MW instalime të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme për tre vjetët e ardhshëm (300 MW në proces konsiderohen si pjesë e planit trevjeçar të ankandit) (**dhjetor 2024**).
		4.2.2. Zbatimi i Direktivës së Energjisë së Rinovueshme: miratimi i legjislacionit RES[29], riorganizimi i lejeve, krijimi i komuniteteve të energjisë	Miratimi i ligjit të harmonizuar me Direktivën e Energjisë së Rinovueshme të vitit 2018 për biomasën/biokarburantet, përfshirë qëndrueshmëri dhe kriteret e uljes të emetimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet (**qershor 2025**).

[24] Afatet janë pa paragjykim të afatit ligjor të përcaktuar në Paketën e Integrimit të Energjisë Elektrike.
[25] *Intra-day market* – Tregu i energjisë elektrike "brenda ditës".
[26] Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
[27] *Market coupling* – Integrimi/lidhja e tregut: Është një metodë e përdorur në tregun e energjisë për të integruar/lidhur tregje të ndryshme të energjisë elektrike, duke lejuar shpërndarjen efikase të energjisë elektrike përtej kufijve. Synon të optimizojë përdorimin e kapacitetit të transmetimit dhe të përmirësojë efikasitetin e tregut duke përshtatur ofertën dhe kërkesën në të gjithë rajonet.
[28] *Day ahead market* – Tregu i "ditës në avancë" për energjinë elektrike.
[29] RES – *Renewable Energy Sources*.

		së rinovueshme, funksionalizimi i garancive të origjinës.	Sistem funksional për lëshimin e garancive të origjinës për energjinë e rinovueshme (**dhjetor 2024**). Miratimi i ndryshimeve në rregullat në fuqi për dhënien e lejeve, për të thjeshtuar procedurat e lejeve për burimet e rinovueshme (njësi familjare dhe instalime të mëdha) (**qershor 2025**). Miratimi i kornizës ligjore për krijimin e komuniteteve të energjisë (**qershor 2026**). Të paktën 600 MW kapacitete të reja të energjisë së rinovueshme të instaluara (**qershor 2027**). Pjesa që zë energjia nga burimet e rinovueshme në totalin bruto të energjisë, arrihet sipas Planit Kombëtar në fuqi për Energjinë dhe Klimën (**qershor 2027**).
	4.3. Miratimi i ETS	4.3.1. Puna për çmimin e karbonit me synimin për të pasur një ETS[30] në fuqi deri në vitin 2030: fokusimi në paketën MRVA.	Zbatimi i MRVA-së (Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi) duke miratuar ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për tu përafruar plotësisht me Acquis të Bashkimit Evropian për MRVA-në [31]dhe duke përgatitur institucionet dhe tregun për të zbatuar Monitorimin, Raportimin, Verifikimin dhe Akreditimin (MRVA) (**dhjetor 2025**).
	4.4. Efikasiteti i Energjisë dhe ndotja e ajrit	4.4.1. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë.	Miratimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave dhe parashikimi i financimit të nevojshëm të përcaktuar për 2025 dhe 2026, për të përmbushur objektivin vjetor të rinovimit prej 3% për ndërtesat publike qeveritare ekzistuese (**dhjetor 2024**). Miratimi i legjislacionit kombëtar për t'u përafruar me rregulloret e etiketimit **(dhjetor 2024)** dhe rregulloret e ekodizajnit për ngrohësit lokalë të hapësirës me lëndë djegëse të ngurta dhe ngritja respektivisht e infrastrukturës dhe kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen e tregut (**dhjetor 2025).** Skema e detyrimit të eficiencës së energjisë miratohet në ligjin për eficiencën e energjisë (**dhjetor 2025;** aktet nënligjore **/dhjetor 2026),** miratohen masa në përputhje me Direktivën e Eficiencës së Energjisë (EED[32]), dhe vendosen sisteme të matjes, kontrollit dhe verifikimit në përputhje me kërkesat e Direktivës së Eficiencës së Energjisë (**qershor 2027).** Zbatimi i objektivave vjetorë për rinovimin e ndërtesave në përputhje me treguesit indikativë (numri i ndërtesave publike të rinovuara), të përfshira në strategjinë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave (Ndryshimet ligjore në ligjin përkatës / **qershor 2025;** 2% e ndërtesave publike të rinovuara si objektiv/**qershor 2027).**

-5.	Sundimi i ligjit / Themeloret	5.1. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	5.1.1. Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonale/ndërkombëtare, për të kontribuar në përmirësimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve	Zyra e Rikuperimit të Aseteve është krijuar dhe është funksionale (**Qershor 2025**). Paraqitja e aplikimit për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve ose në platformat rajonale/ndërkombëtare të rikuperimit **(Dhjetor 2025).** Të paktën 50% e numrit dhe vlerës së pasurive të konfiskuara ripërdoren (përfshi ripërdorimin social) brenda 6 muajve nga konfiskimi **(Dhjetor 2026**).
			5.1.2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë	Përgatitja e vlerësimit të rreziqeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda dhe rishikimi respektivisht i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda **(Qershor 2026).** gjerimi i aksesit dhe ndërveprimit të bazave të të dhënave dhe përdorimi i mjeteve të IT-së/metodave hetimore në luftën kundër krimit të organizuar (**Dhjetor 2026**). Progres i vazhdueshëm me cilësinë e procedimeve, në pajtueshmëri të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, dhe përmirësimi i historikut te të dhënave (*track records*), që burojnë nga hetime, ndjekje penale, vendime të formës së prerë , sekuestrime dhe konfiskime përfundimtare efektive dhe efikase në rastet e korrupsionit, përfshirë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë **(Qershor 2026),** përsëritje në **(Qershor 2027).** Progres i vazhdueshëm me rezultatet në hetimet, ndjekjet penale, dënimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive në rastet e lidhura me krimin e organizuar **(Qershor 2027).**
		5.2.Bashkëpunimi në fushën e drogës	5.2.1. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme	Vlerësimi i zbatimit të Planit të rishikuar të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e dëmtimeve të lidhura me drogën 2023-2026 (**Qershor 2027**). Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm është funksional (**Dhjetor 2025**). Observatori Kombëtar i Drogës është funksional (**Dhjetor 2026).**
		5.3. Pastrimi parave	5.3.1. Sigurimi i një kornize të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave	Zbatimi efektiv dhe në kohë i Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA) kundër Pastrimit të Parave 2024-2027 **(Qershor 2027).** Miratimi i Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Kundër Financimit të Terrorizmit, dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2030 **(Dhjetor 2024).**
			5.4.1. Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës	Rastet e vetting-ut me dyshime për elementë kriminalë, të përfunduara në shkallë të parë (KPK) [me vendim pushimi] i referohen prokurorisë (**Dhjetor 2024)** dhe ndjekja efektive gjyqësore për rastet e veting-ut që rezultojnë me dyshime për elementë kriminalë, që vazhdojnë t'i referohen prokurorisë **(Qershor 2025).** Ndryshimi i dispozitave që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për t'iu përshtatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, të zbatueshme për magjistratët, dhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në merita për renditjen e pavarur **(Dhjetor 2027).** Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë sigurojnë transparencë të lartë, ndajnë publikisht të gjithë informacionin në lidhje me emërimet [vlerësimet periodike të karrierës],

			Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS)[31], i cili siguron ndërveprim ndërmjet gjykatave dhe prokurorive dhe Portalit ndërqeveritar (Government Gateway) - në respekt të plotë të garancive ligjore për bazat e të dhënave shtetërore, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorisë, si dhe gjenerimin automatik të statistikave bazuar në metodologjinë e CEPEJ dhe legjislacionin kombëtar, është gati për t'u përdorur **(Dhjetor 2027).** Të paktën 70% e vendeve vakante për magjistratë në Gjykatat e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të paktën 80% për Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 90% e personelit jomagjistrat në të gjitha nivelet e gjykatave, janë plotësuar (**Dhjetor 2027**). Rritja e kapaciteteve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) duke siguruar që vendet vakante e inspektorëve pranë ILD-së të plotësohen gradualisht, me masa që synojnë të sigurojnë atraktivitetin e pozicionit. ILD miraton dhe zbaton Planin Vjetor të inspektimeve tematike për çështjet më problematike, në konsultim me Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës (**Dhjetor 2026**).
	5.5. Lufta kundër korrupsionit	5.5.1. Parandalimi efektiv i korrupsionit, zvogëlimi i incidencës së korrupsionit	Rritja e transparencës, duke ngritur një platformë të hapur të të dhënave për buxhetin dhe shpenzimet publike, qendrore dhe vendore, në partneritet me shoqërinë civile, dhe publikimin e të gjitha deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale (**Dhjetor 2024**). Miratimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), me qëllim rritjen e efikasitetit dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit **(Dhjetor 2026).** Kuadri ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, si dhe për konfliktin e interesit dhe financimin e partive politike, është ndryshuar në përputhje me standardet evropiane dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias /GRECO dhe OSBE/ODHIR (**Qershor 2027).**
	5.6. Demokracia, të Drejtat	5.6.1. Forcimi i lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane	Rritja e kapaciteteve të organeve ligjzbatuese për të trajtuar rastet e dhunës, duke përfshirë incidente "të izoluara" të protestave, dhe çështje të tjera penale që përfshijnë gazetarët,

[31] ICMS (Integrated Case Management System)

	Themelore dhe Shoqëria Civile		veçanërisht duke siguruar nivel të lartë për respektimin e të drejtave të njeriut në trajtimin e incidenteve që përfshijnë gazetarë, përmes udhëzimeve të detyrueshme, mbledhjes së të dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve (**Qershor 2025**). Aspektet penale dhe civile të shpifjes janë përafruar me standardet evropiane **(Dhjetor 2026).** Kryerja e vlerësimit të ndikimit të politikës dhe analizë së hendekut ligjor në lidhje me Rregulloren e Aktit të Shërbimit Digjital të Bashkimit Evropian, me synimin për ta përafruar në legjislacionin kombëtar, për të rritur mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve dhe përmbajtjen e sigurt **(Qershor 2025)** dhe miratimin e ndryshimeve ligjore për të përafruar gjerësisht Rregulloren e Aktit të Shërbimit Digjital **(Qershor 2026).** Miratimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor për transparencën e pronësisë së medias **(Dhjetor 2024),** shtrirjen e audiencës, forcimin e transparencës së financimit të medias, pluralitetin e medias dhe pavarësinë dhe autonominë editoriale të rregullatorit të medias, mbi bazën e një dialogu të strukturuar dhe gjithëpërfshirës me aktorët e medias **(Dhjetor 2026)**. Miratimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor për anti-SLAPP[32], në përputhje me standardet e Këshillit të Europës/Komisionit të Venecias dhe në përputhje me acquis të BE-së, mbi bazën e një dialogu të strukturuar dhe gjithëpërfshirës me aktorët e medias dhe shoqërisë civile (**Qershor 2027**).
	5.7. Përafrimi me politikën e vizave	5.7.1. Përafrimi i kërkesave për lëshimin e vizave me standardet evropiane	Përfundimi i regjimeve pa viza me të paktën dy vende në 2025, dhe me të paktën nga një vend në secilin nga vitet, 2026 dhe 2027, nga lista e vendeve për të cilat kërkohen viza për në Bashkimin Evropian (e matur në fund të çdo viti, në **Dhjetor 2025**, **Dhjetor 2026** dhe **Dhjetor 2027**)

[32] SLAPP - Strategic lawsuits against public participation - Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut (të njohura edhe si paditë SLAPP ose paditë e frikësimit), ose proceset gjyqësore strategjike kundër pjesëmarrjes publike, janë padi që synojnë të censurojnë, frikësojnë dhe heshtin kritikët duke i ngarkuar ata me koston e një mbrojtjeje ligjore. derisa të braktisin kritikat apo kundërshtimet e tyre.

PJESA E DYTË

Përmbajtja

PJESA 1: OBJEKTIVAT DHE KOHERENCA E AGJENDËS SË REFORMAVE
1. SFIDAT KRYESORE (ANALIZA E PROBLEMIT)
2. OBJEKTIVAT E AGJENDËS SË REFORMAVE
3. PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN E PËRGJITHSHËM TË POLITIKAVE
4. PRIORITETET KRYESORE TË POLITIKAVE
4.1 SEKTORËT THEMELORË
4.2 TRANSFORMIMI DIGJITAL DHE ÇËSHTJET E SIGURISË DIGJITALE
4.3 ARSIMI, FORMIMI, PUNËSIMI DHE OBJEKTIVAT SOCIALË
4.4 PARIMI "NUK BËN DËM TË KONSIDERUESHËM"
5. INTEGRIMI GJINOR
5.1 INTEGRIMI GJINOR DHE MUNDËSITË E BARABARTA NË SHTYLLËN E KAPITALIT NJERËZOR
5.2 INTEGRIMI GJINOR DHE MUNDËSITË E BARABARTA NË SHTYLLËN E KLIMËS SË BIZNESIT
5.3 INTEGRIMI GJINOR DHE MUNDËSITË E BARABARTA NË SHTYLLËN E TRANZICIONIT DIGJITAL DHE TË GJELBËR
5.4 INTEGRIMI GJINOR DHE MUNDËSITË E BARABARTA NË SHTYLLËN E PARIMEVE THEMELORE DHE SHTETIT TË SË DREJTËS
5.5 INTEGRIMI GJINOR DHE MUNDËSITË E BARABARTA GJATË ZBATIMIT TË AGJENDËS SË REFORMAVE
5. 6 PËRSHPEJTIMI DHE KONTRIBUTI NË AGJENDËN E GJELBËR
PJESA 2: PËRSHKRIMI I FUSHAVE TË POLITIKËS DHE REFORMAVE PËRKATËSE
6. FUSHA E POLITIKËS 1: PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT
1.1 KLIMA E BIZNESIT
R – 1.1.1 RRITJA E MOBILIZIMIT TË TË ARDHURAVE TË BRENDSHME DHE E SISTEMIT TATIMOR, VEÇANËRISHT NËPËRMJET MIRATIMIT DHE ZBATIMIT TË STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE (SAA)
R – 1.1.2 SIGURIMI I TRANSPARENCËS DHE EFIKASITETIT TË SHËRBIMEVE TË KADASTRËS SHTETËRORE, PËR INVESTITORËT DHE QYTETARËT DHE OFRIMI I NJË POLITIKE TË QARTË PËR PËRDORIMIN E TOKËS
R – 1.1.3. RRITJA E TËRHEQJES DHE TRANSPARENCËS SË INVESTIMEVE, NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT E BE-së, PËRMIRËSIMI I QEVERISJES SË SHOQËRIVE NË PRONËSI SHTETËRORE DHE NDIHMËS SHTETËRORE
R – 1.1.4. PËRMIRËSIMI I KUADRIT TË TËRHEQJES SË INVESTIMEVE DHE NË VEÇANTI I KUADRIT TË IHD-ve DHE I MJEDISIT TË BIZNESIT NËPËRMJET DERREGULLIMIT DHE MODERNIZIMIT TË SHËRBIMEVE TË BIZNESIT
R – 1.1.5. VENDOSJA E SISTEMEVE INTELIGJENTE TË TRANSPORTIT (SIT) DHE E-TRANSPORTI
R – 1.1.6. PROMOVIMI I EKSPORTIT DHE NDËRKOMBËTARIZIMI I NDËRMARRJEVE, DUKE PËRFSHIRË LEHTËSIMIN E EKSPORTEVE DHE TREGTISË, DHE MBËSHTETJEN E ZINXHIRIT TË VLERËS PËR INDUSTRI TË PËRZGJEDHURA ME POTENCIAL RRITJEJE
7. FUSHA E POLITIKËS 2: KAPITALI NJERËZOR 88
2.1 ARSIMI
R – 2.1.1 RISHIKIM I SISTEMIT TË AFP-së PËR TA PËRSHTATUR MË MIRË ME KËRKESËN PËR AFTËSI TË TREGUT TË PUNËS
R – 2.1.2 PËRDITËSIMI I KURRIKULAVE NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM
R – 2.1.3 PËRDITËSIMI I KORNIZËS KOMBËTARE TË KUALIFIKIMEVE, DUKE VENDOSUR NJË MARRËDHËNIE TË QARTË DHE TRANSPARENTE NDËRMJET NIVELEVE KOMBËTARE TË KUALIFIKIMEVE DHE NIVELEVE PËRKATËSE TË KORNIZËS EVROPIANE TË KUALIFIKIMEVE
R – 2.1.4 PËRPARIMI NË AFTËSITË DHE ARSIMIN DIGJITAL PËR TË RINJTË DHE SIGURIMI I PAJISJEVE TË MJAFTUESHME TIK PËR SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET PUBLIKE
2.2 TREGU I PUNËS
R – 2.2.1 FORCIMI I EFIKASITETIT TË SKEMËS SË POLITIKËS SË PUNËSIMIT
2.3 KËRKIMI DHE ZHVILLIMI
R – 2.3.1 FORCIMI I MJEDISIT KOMBËTAR TË KËRKIMIT DHE INOVACIONIT, DUKE MIRATUAR KORNIZËN STRATEGJIKE AFTËSUESE
8. FUSHA E POLITIKËS 3: DIGJITALE
3.1 DIGJITALE
R – 3.1.1 PËRPUTHSHMËRIA ME RREGULLOREN E IDENTITETIT DIGJITAL DHE ZBATIMI I E-PORTOFOLIT DIGJITAL PËR SHËRBIMET PUBLIKE
R – 3.1.2 PËRAFRIMI I KUADRIT RREGULLATOR PËR QËNDRUESHMËRINË KIBERNETIKE, DUKE PËRFSHIRË KËRKESAT E DIREKTIVËS NIS2 DHE DUKE FORCUAR INSTITUCIONET PËRKATËSE
R – 3.1.3 PËRDITËSIMI I KORNIZËS PËR NJË INFRASTRUKTURË DIGJITALE TË SIGURT DHE TË QËNDRUESHME
3.2. RRITJA E PËRFSHIRJES SË BIZNESIT NË POTENCIALIN E AGJENDËS SË GJELBËR DHE DIGJITALE
R – 3.2.1 PËRMIRËSIMI I MJEDISIT MUNDËSUES PËR BIZNESET INOVATIVE DHE SHFRYTËZIMI NGA ANA E TYRE I POTENCIALIT TË AGJENDËS SË GJELBËR DHE DIGJITALE, PËRFSHIRË MUNDËSITË RESPEKTIVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE
9. FUSHA E POLITIKËS 4: ENERGJIA / TRANZICIONI I GJELBËR
4.1 REFORMAT E TREGUT
R – 4.1.1 PËRAFRIMI ME PAKETËN E INTEGRIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR TË MUNDËSUAR INTEGRIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË BE-së DHE SHQIPËRISË, KRIJIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE BRENDA DITËS (*INTRA DAY*), OPERACIONALIZIMIN E PAKETËS NË PËRPUTHJE ME PLANIN E INTEGRIMIT TË OPERATORËVE PËR BASHKIM TË TREGJEVE DERI NË VITIN 2025
R – 4.1.2 RREGULLIMET GRADUALE TË TARIFAVE NDAJ ÇMIMEVE TË TREGUT, TË SHOQËRUARA ME MASA PËR ADRESIMIN E VARFËRISË ENERGJETIKE

4.2 ENERGJITË E RINOVUESHME
R – 4.2.1 ZHVILLIMI I NJË PLANI ANKANDI ME BAZË SASIORE, TRANSPARENT DHE KONKURRUES, PËR ENERGJINË E RINOVUESHME: PLANIFIKIMI TREVJEÇAR I MIRATUAR
R – 4.2.2 ZBATIMI I DIREKTIVËS SË ENERGJISË TË RINOVUESHME: MIRATIMI I LEGJISLACIONIT RES, RIORGANIZIMI I LEJEVE, KRIJIMI I KOMUNITETEVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME, FUNKSIONALIZIMI I GARANCIVE TË ORIGJINËS.
4.3 MIRATIMI ETS
R – 4.3.1 PUNA PËR ÇMIMIN E KARBONIT ME SYNIMIN PËR TË PASUR NJË ETS NË FUQI DERI NË VITIN 2030: FOKUSIMI NË PAKETËN MRVA
4.4 EFICIENCA E ENERGJISË DHE NDOTJA E AJRIT
R – 4.4.1 MIRATIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË AFATGJATË TË RINOVIMIT TË NDËRTESAVE, DHE SKEMËS SË EFICIENCËS SË ENERGJISË
10 FUSHA E POLITIKËS 5: SHTETI I SË DREJTËS / THEMELORET
5.1 LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
R – 5.1.1 KRIJIMI I NJË ZYRE PËR RIKUPERIMIN E ASETEVE, SI NJËSI KOMBËTARE KOORDINUESE DHE PIKË KONTAKTI RAJONALE/NDËRKOMBËTARE, PËR TË KONTRIBUAR NË PËRMIRËSIMIN E SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE
R – 5.1.2 FORCIMI I LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, DUKE PËRFSHIRË EDHE RASTET E NIVELIT TË LARTË
5.2 BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E DROGËS
R – 5.2.1 FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE DHE KUADRIT STRATEGJIK ME SYNIMIN PËR ZVOGËLIMIN E OFERTËS DHE KËRKESËS PËR DROGA TË PALIGJSHME 165
5.3 PASTRIMI I PARAVE
R – 5.3.1 SIGURIMI I NJË KORNIZE TË BESUESHME DHE TË QËNDRUESHME PËR TË PARANDALUAR DHE LUFTUAR PASTRIMIN E PARAVE 168
5.4 GJYQËSORI
R – 5.4.1 KONSOLIDIMI I PAVARËSISË DHE LLOGARIDHËNIES SË GJYQËSORIT NËPËRMJET TRANSPARENCËS
R – 5.4.2 RRITJA E EFIKASITETIT TË GJYQËSORIT NË TË GJITHA NIVELET 177
5.5 LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT
R – 5.5.1 PARANDALIMI EFEKTIV I KORRUPSIONIT, ZVOGËLIMI I INCIDENCËS SË KORRUPSIONIT
5.6 DEMOKRACIA, TË DREJTAT THEMELORE DHE SHOQËRIA CIVILE
R – 5.6.1 FORCIMI I LIRISË SË SHPREHJES, NË PËRPUTHJE ME STANDARDET EVROPIANE
5.7 PËRAFRIMI I VIZAVE
R – 5.7.1 PËRAFRIMI I KËRKESAVE PËR LËSHIMIN E VIZAVE ME STANDARDET EVROPIANE
11. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PAGESA (NË TË GJITHA FUSHAT E POLITIKAVE)
PJESA 3: KOMPLEMENTARITETI DHE ZBATIMI I AGJENDËS SË REFORMAVE
12. KOMPLEMENTARITETI ME IPA III
13. INVESTIMET SIPAS KORNIZËS SË INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR (KIBP/WBIF)
14. KONSULTIMI
15. MONITORIM, RAPORTIM, VLERËSIM
16. KONTROLLI DHE AUDITIMI
17. KOMUNIKIMI
18. SHTOJCA 1: HAPAT DHE KUSHTET E PAGESËS SIPAS FUSHËS SË POLITIKËS

PJESA 1: OBJEKTIVAT DHE KOHERENCA E AGJENDËS SË REFORMAVE

1. SFIDAT KRYESORE (ANALIZA E PROBLEMIT)

Komisioni Evropian, më 8 nëntor 2023, propozoi Instrumentin e Reformave dhe Rritjes 2024–2027 (*Reform and Growth Facility*) që ofron mbështetje kyçe për zbatimin e Planit të ri të Rritjes për Vendet e Ballkanit Perëndimor. Instrumenti shërben si mjet për ofrimin e huave dhe granteve me synim trajtimin e konvergjencës së pamjaftueshme socio-ekonomike midis Ballkanit Perëndimor (BB) dhe BE-së, që është përkeqësuar nga ndikimi ekonomik i pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, dhe kriza energjetike, si pasojë e luftës së agresionit rus ndaj Ukrainës.

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 (AKR 2024–2027) për Shqipërinë është përgjigja në kuadër të Instrumentit të ri të Reformave dhe Rritjes së BE-së, që konsiderohet si platformë thelbësore për përshpejtimin e mëtejshëm të veprimeve ekonomike të orientuara nga tregu për hyrjen e ekonomisë shqiptare në Tregun e Vetëm të BE-së dhe drejt arritjes së konvergjencës me vendet anëtare të BE-së. Përparësitë e Planit të Ri të Rritjes janë të orientuara drejt përshpejtimit të integrimit të ekonomisë shqiptare në Tregun e Vetëm dhe drejt reformave të mëtejshme themelore për integrimin në BE, si dhe drejt thellimit të integrimit ekonomik rajonal.

Shqipëria po punon për përshpejtimin e ritmit të konvergjencës me 27 vendet e BE-së, duke marrë parasysh kohën e gjatë të nevojshme për të arritur nivelin aktual të Bashkimit Evropian, si vend i rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ritmi i konvergjencës është më i ngadaltë se ç'duhet dhe praktikisht ka ngecur për rajonin e Ballkanit Perëndimor, ndërkohë që vendet po përpiqen të përballojnë dhe të sigurojnë aftësi ripërtëritëse nga kriza në krizë, që prej krizave financiare të periudhës 2008–2009, pasojave të tërmetit të vitit 2019, pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, luftës në Ukrainë dhe krizës energjetike.

Në Shqipëri, ishte e theksuar rritja më e ngadaltë e prodhimtarisë si pasojë e krizës financiare botërore. Ngadalësimi në produktivitetin e punës erdhi kryesisht nga ulja e rritjes së faktorit të përgjithshëm të prodhimtarisë, si dhe investimet e pakësuara. Në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit dhe ndërlidhjes digjitale ka një hendek të konsiderueshëm financimi, çka vë në dukje nevojën për investime me qëllim arritjen e "skenarit të konvergjencës së lartë", që do të shtynte rritjen e PBB-së me 6% dhe periudhën e konvergjencës në 20 vjet.

Veprimtaritë me vlerë të shtuar të lartë, që kanë rreth 1/3 e të punësuarve (me përjashtim të bujqësisë dhe administratës), kanë shënuar rritjen më të lartë të punësimit gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Krahas rritjes së prodhimtarisë në nivel kombëtar, ka rëndësi dallimi i theksuar në nivelet e prodhimtarisë sipas sektorëve të ndryshëm të veprimtarisë ekonomike. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit (2011–2020), sektorët jobujqësorë me rritjen më të lartë të prodhimtarisë në Shqipëri janë shëndetësia, shërbimet e ndryshme, botimet dhe programet kompjuterike etj., në të cilët niveli i prodhimtarisë është rritur më shumë se dy herë krahasuar me dhjetë vjet më parë. Forcimi i mëtejshëm i këtyre sektorëve dhe sektorëve të tjerë të mundshëm përmes politikave mbështetëse për zgjerimin e punësimit, që shoqërojnë diversifikimin dhe orientimin e mëtejshëm të ekonomisë drejt veprimtarive me produktivitet, krijon mundësi të mëtejshme për përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe jep kontribut thelbësor në rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Sfidat përfshijnë qasjen në financim, mungesën ose shtrenjtimin e teknologjisë dhe nevojën për më shumë aftësi. Ndërkohë që, gjithnjë është raportuar, se qasja në financim ka qenë sfidë e rëndësishme në Shqipëri, kufizimet e tjera të rritjes janë bërë veçanërisht të mprehta në fazën e rimëkëmbjes, në sajë të mungesës së kontributeve kyçe, si teknologjia dhe aftësitë, dhe të pengesave ende të konsiderueshme ligjore lidhur me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive.

Struktura e veprimtarisë ekonomike në vend mbizotërohet nga NVM-të, që përbëjnë më shumë se 90% të bizneseve të regjistruara dhe që funksionojnë kryesisht në veprimtari të bazuara në fuqi punëtore me vlerë të shtuar të ulët. Rritja e konkurrueshmërisë së shoqërive shqiptare është element shumë i rëndësishëm për zgjerimin e veprimtarisë së tyre brenda vendit, por edhe përtej kufirit, në tregun e integruar rajonal dhe atë të BE-së. Nga ana tjetër, hapja e plotë e ekonomisë së vendit, integrimi në BE dhe mbështetja që BE-ja u jep vendeve të Ballkanit Perëndimor, janë faktorë të rëndësishëm që do të ushtrojnë trysni pozitive gjithnjë e më të madhe tek kompanitë vendase me qëllim përmirësimin e ndjeshëm të konkurrueshmërisë së tyre në treg dhe që të konkurrojnë brenda vendit dhe të kërkojnë aktivisht mundësi për zgjerimin e veprimtarisë jashtë vendit.

Në kuadër të përmirësimit të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, ka vend për rritje falë efikasitetit të shtuar në sajë të përmirësimit të produktivitetit në sektorë kyçë, si bujqësia dhe industria, si dhe përmes zhvendosjes së fuqisë punëtore, investimeve dhe mbështetjes nga sektori i ndërtimit, drejt veprimtarive më produktive dhe me vlerë të shtuar të lartë, si turizmi i qëndrueshëm, shërbimet, TIK-u, NVM-të e bazuara në inovacion dhe teknologji, financimi dhe veprimtaritë e gjelbra etj.

Aktualisht, Shqipëria po përballet me vështirësi lidhur me kapitalin njerëzor, veçanërisht sa i përket punësimit dhe aftësive, të cilat pengojnë rritjen e shpejtë dhe rritjen e prodhimtarisë. Vështirësia e parë është niveli i ulët i aftësive të popullsisë në moshë pune. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2021, 41.6 për qind e fuqisë punëtore dhe 48.3 për qind e popullsisë në moshë pune në Shqipëri kanë nivel arsimor bazë (8–9-vjeçar) ose më të ulët.

Vështirësia e dytë lidhet me zotërimin nga fuqia punëtore të aftësive të kërkuara në tregun e punës, mungesa e të cilave mund të pengojë hapjen e më shumë vendeve të punës apo të vendeve të punës të një cilësie më të mirë. Disa nga treguesit kryesorë të mospërputhjes së mundshme të aftësive mund të konsiderohen shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë dhe shkalla e lartë e papunësisë së të diplomuarve me arsim të lartë. Shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë në punësim, në arsim apo formim (NEET), është një tjetër tregues që vë në pah mospërputhjen e aftësive. Vështirësitë e mungesës ose mospërputhjes së aftësive janë rezultat i sasisë, cilësisë ose relevancës së pamjaftueshme të ofrimit të arsimit dhe formimit. Nevoja për trajtimin e këtyre problemeve lidhur me tregun dhe aftësitë e fuqisë punëtore është urgjente.

Në kuadër të transformimit digjital, përdorimi i teknologjisë së informacionit në ofrimin e shërbimeve publike qeveritare ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë efekt transformues në mënyrën e funksionimit të qeverisjes, llojet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve, si dhe do të ndikojë veprimtarinë dhe zhvillimin e sektorëve të ekonomisë. Së bashku me format e tjera të ndryshimeve dhe inovacionit teknologjik, qeveria shqiptare dhe subjektet e sektorit privat, jo vetëm që duhet të reagojnë më mirë ndaj këtyre shtysave për ndryshim, por edhe të hulumtojnë aktivisht mundësi më të mira për ndryshim, konkurrueshmëri më të madhe dhe rritje ekonomike. Transformimi digjital, që i paraprin këtyre proceseve, do të kërkojë përvetësimin dhe fuqizimin e aftësive digjitale më aktuale, veçanërisht sa i përket brezit të ri që po përgatitet të hyjë në tregun e punës dhe të hapë biznese të reja, duke përfshirë këtu organizimin dhe funksionimin e bizneseve shqiptare.

Energjia është faktor kyç për rritjen e Shqipërisë, me ndikim në zhvillimin ekonomik, investime, punësim dhe cilësinë e jetës. Politikat efektive të energjisë, që nxisin energjinë e rinovueshme, përmirësojnë eficiencën e energjisë, investojnë në infrastrukturë dhe përcaktojnë kuadër të qëndrueshëm ligjor, mund të ndikojnë ndjeshëm në trajektoren e rritjes dhe zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Shqipëria mund të nxisë prosperitet dhe qëndrueshmëri ekonomike afatgjatë, duke shfrytëzuar potencialin e saj të energjisë së rinovueshme dhe duke siguruar furnizim të besueshëm dhe të qëndrueshëm me energji.

Sektori i energjisë po përballet me disa sfida në kuadër të ndikimit që ka mbi rritjen dhe hyrjen në Tregun e Vetëm të BE-së. Gjithashtu, ajo mbetet e ekspozuar ndaj risqeve domethënëse nga ndryshimet klimatike. Për shkak të peshës madhore të hidrocentraleve në prodhimin e energjisë elektrike, Shqipëria është tejet e varur nga sasia e reshjeve vjetore ose shpërndarja e tyre gjatë vitit dhe në mbarë vendin.

Nga ana tjetër, ndryshimi i konsumit të energjisë gjatë periudhave të veçanta, e bën sistemin energjetik të varur në mënyrë të pashmangshme nga importi e energjisë. Sipas të dhënave të INSTAT-it[33], prodhimi i brendshëm neto i energjisë elektrike arriti vlerën 8.796 GWh në vitin 2023 krahasuar me 7.003 GWh energji të prodhuar në vitin 2022, duke shënuar rritje të prodhimit me 25.6%. Ky prodhim vjen nga hidrocentralet publike në masën 58.2%, nga hidrocentralet private dhe marrëveshjet koncesionare në masën 40.8% dhe nga prodhues të tjerë (fotovoltaikët) në masën 1.0% të prodhimit neto të energjisë elektrike vendase. Importi bruto i prodhimit të energjisë elektrike (energji në hyrje) arriti vlerën 1.922 GWh në vitin 2023, nga 3.044 GWh që ishte në vitin 2022, duke shënuar një rënie prej 36.9%. Eksporti bruto i energjisë elektrike për vitin 2023 (energji në dalje) rezulton në vlerën 2.842 GWh nga 2.12 GWh në vitin 2022, duke shënuar një rritje prej 33%. Për këto arsye, krahas zhvillimit të investimeve në këtë sektor, diversifikimi i prodhimit të energjisë paraqet sfidë dhe mundësi domethënëse që duhet trajtuar në të ardhmen drejt forcimit të pavarësisë energjetike.

[33] https://www.instat.gov.al/media/13065/bilanci-i-energjis%C3%AB-elektrike-2023.pdf

Arritja e integrimit të tregut të sektorit të energjisë në Tregun e Vetëm të BE-së mbetet sfidë që duhet adresuar. Përfitimet në sektorin e energjisë janë të larta, përfshirë përfitime ekonomike nëpërmjet rritjes së investimeve dhe tregtisë, përmirësimit të sigurisë dhe infrastrukturës së energjisë, përparimeve teknologjike, qëndrueshmërisë mjedisore dhe rritjes së konkurrencës në treg. Sfidat lidhen së pari me përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar për energjinë dhe energjinë e rinovueshme me *acquis*-të e BE-së, mundësimin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës, sigurimin e përafrimit gradual të tarifave me çmimet e tregut shoqëruar me masa për trajtimin e varfërisë energjetike, masat për energjinë e rinovueshme, forcimin e politikës së eficiencës së energjisë dhe zbatimin e skemave mbështetëse të eficiencës së energjisë.

Themeloret sigurojnë bazën e demokracisë të konsoliduar që hap rrugën drejt shtimit të konvergjencës ekonomike dhe integrimit në Tregun e Vetëm. Që Shqipëria të integrohet me sukses në Tregun e Vetëm të BE-së, është e domosdoshme të forcohet sundimi i ligjit dhe reformat themelore. Kjo përfshin intensifikimin e përpjekjeve kundër krimit të organizuar, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe operacional për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe garantimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë në mënyrë efikase dhe transparente. Për më tepër, mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe përafrimi për këto fusha me standardet evropiane do të jenë thelbësore për përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në BE dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në vend.

Reforma në drejtësi konsiderohet si një prej reformave më rrënjësore ligjore dhe institucionale që ka përfshirë sistemin e drejtësisë në vend gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Qëllimi i saj ishte krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, efektiv, të pavarur dhe profesional të bazuar në parimet e shtetit të së drejtës dhe në përputhje me standardet evropiane. Reforma gjyqësore e vitit 2016 rezultoi në reformimin rrënjësor të kuadrit ligjor dhe institucional të gjyqësorit dhe prokurorisë, dhe përcaktoi garanci ligjore për përforcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe prokurorisë, përfshirë zhbllokimin e mekanizmave për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, mjetet për shmangien e ndikimit politik në institucionet e drejtësisë, mekanizmat e llogaridhënies, si dhe vlerësimin kalimtar (*vetting*) të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Reforma në drejtësi solli ristrukturim të plotë institucional të gjyqësorit dhe prokurorisë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe ngritjen e organeve të reja për vetëqeverisjen e gjyqësorit.

Kjo strukturë e re institucionale ka dhënë rezultate në disa drejtime, përfshirë trajtimin e sfidave themelore të reformës në drejtësi për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësinë dhe funksionimin e përshtatshëm të sistemit. Reforma duhet të konsolidojë më tej kuadrin institucional, veçanërisht në drejtim të efikasitetit të gjyqësorit, si dhe të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë në të gjitha shkallët. Sfida e rritjes së efikasitetit në të gjitha shkallët e gjyqësorit kërkon hartimin e proceseve të integruara, me qëllim uljen e vonesave dhe përmirësimin e reagimit të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë, si dhe përmirësimin e digjitalizimit. Efikasiteti i sistemit gjyqësor duhet të forcohet ndjeshëm, duke trajtuar veçanërisht kohëzgjatjen e proceseve, shkallën e ulët të evadimit të çështjeve dhe numrin e madh të çështjeve të prapambetura përmes qasjeve strategjike që synojnë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Emërimet në sistemin e drejtësisë duhet të përparojnë në të gjitha shkallët. Gjithashtu, ka nevojë për masa të mëtejshme për konsolidimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit përmes rritjes së transparencës dhe përmirësimit të integritetit.

Shqipëria ka tashmë politika dhe kuadër ligjor të shëndoshë kundër korrupsionit, që është fushë ndërsektoriale dhe kyçe në kuadër të grup-kapitujve themelorë. Vendi ka strategji ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe planin përkatës të veprimit për periudhën 2020–2023, ndërkohë që strategjia e re dhe plani i veprimi për periudhën 2023–2030 janë në përfundim e sipër.

Shqipëria ka legjislacion të gjerë në fushën e parandalimit të korrupsionit, që mbulon administratën publike, deklarimin e pasurisë, konfliktin e interesave dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Legjislacioni është i përafruar pjesërisht me Direktivën 2017/1371 (BE), të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Bashkimit përmes legjislacionit penal. Kodi Penal parashikon kriminalizimin e korrupsionit si krim të rëndë, duke përfshirë edhe dimensionin e tij ndërkufitar. Legjislacioni është përafruar pjesërisht me vendimin kuadër të Këshillit 2003/568/JHA për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat.

Në kuadër të mbrojtjes dhe përpunimit ligjor të të dhënave personale, Shqipëria është duke përafruar aktualisht projektligjin e vet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Acquis-të e BE-së, pra Rregulloren 2016/679 (BE) dhe Direktivën 2016/680 (BE). Legjislacioni shqiptar është në përputhje me Rregulloren e Këshillit 2017/1939 (BE) për zbatimin e bashkëpunimit të zgjeruar për ngritjen e Zyrës së Prokurorit Publik Evropian. Baza ligjore për hetimin e pasurisë përbëhet nga neni 36 i Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 (ligji antimafia) dhe akti normativ nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda, dhe për konsolidimit të rendit e sigurisë publike".

Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" rregullon edhe çështjen e lëvizjes së nëpunësve publikë drejt sektorit privat (e ashtuquajtura "dera rrotulluese"), me qëllim shmangien e konfliktit të interesit. Ky ligj përcakton konfliktin e interesit dhe së bashku me ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, përgjegjësinë financiare të personave të zgjedhur dhe zyrtarëve të emëruar publikë (9049/2003), i ndryshuar, dhe gjithashtu normon deklarimin e pasurisë së personave të zgjedhur dhe zyrtarëve publik të emëruar, si dhe përcakton tagrin përkatës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Mosdorëzimi i deklaratës rezulton në sanksione administrative, ndërsa fshehja ose deklarimi i informacionit të rremë përbën vepër penale (neni 257/a i Kodit Penal). Edhe ligji për partitë politike ka dispozita përkatëse, të cilat janë harmonizuar me Kodin Zgjedhor në nëntor të vitit 2020. Procedura për ushtrimin e të drejtës së qasjes në informacion përshkruhet në ligjin për të drejtën e informimit, i cili parashikon llogaridhënien administrative për mospërmbushjen e detyrimeve, që kufizohet vetëm tek koordinatori i informacionit, dhe mundësinë që Komisioneri për Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave të lëshojë gjoba. Sa i përket ndëshkimit, Kodi Penal parashikon veprat penale të korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv.

Shqipëria duhet të përmirësojë koherencën e kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit dhe integritetin e zyrtarëve publikë, kuadër që është gjithëpërfshirës, por tepër i ndërlikuar, veçanërisht për sa u përket zyrtarëve të lartë. Kuadri ligjor për konfliktin e interesit duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe *Acquis*-të e BE-së.

Në përgjithësi, masat kundër korrupsionit duhet të kenë ndikim më të mirë në sektorët veçanërisht të cenueshëm (infrastruktura publike, kadastra dhe të drejtat pronësore, doganat, administrata tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat PPP etj.). Këta sektorë kërkojnë vlerësime të posaçme të riskut, udhërrëfyes kundër korrupsionit dhe veprime të dedikuara.

Vlerësimi kalimtar i anëtarëve të gjyqësorit vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit. Është thelbësore të rivendoset besimi i publikut te gjyqësori dhe organet ligjzbatuese të shtetit. Ka nevojë për përpjekje shtesë, veçanërisht për hapjen sistematikisht të proceseve penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të dyshuar për sjellje kriminale gjatë vlerësimit kalimtar.

Është e nevojshme të arrihet më shumë transparencë lidhur me financimin e partive politike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Duke qenë se fushatat zgjedhore po zhvillohen gjithnjë e më shumë përmes internetit, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë zhvillimit të fushatave në internet dhe nga palë të treta. Zbatimi i kuadrit ligjor për dhurimet dhe sponsorizimet duhet të vlerësohet plotësisht në kuadër të standardeve evropiane.

Ka nevojë për përparim të mëtejshëm për krijimin e një historiku cilësie dhe rezultatesh më të mira të hetimeve, procedimeve penale dhe dënimeve të formës së prerë për çështjet e korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë. Gjithashtu, duhet të përmirësohen sekuestrimi dhe konfiskimi/rikuperimi i pasurive, produkt i veprave penale të lidhura me korrupsionin.

Sa i përket lirisë së shprehjes si një prej aspekteve themelore kryesore, neni 22 i Kushtetutës garanton lirinë e shprehjes, ndërsa neni 17 përcakton kufizimet e kësaj të drejte. Neni 23 parashikon të drejtën e informimit. Kuadri ligjor i Shqipërisë përfshin veçanërisht ligjin për Mediat Audiovizive, i ndryshuar në maj të vitit 2017, dhe së fundmi në prill të vitit 2023, me qëllim përafrimin me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audiovizive 2010/13/BE. Duhet të përcaktohen kërkesa ligjore për trajtimin e përqendrimit të lartë të tregut të mediave, duke forcuar transparencën dhe duke vendosur kufizime për pronësinë e medias dhe për mbulimin e audiencës. Gjithashtu, është e nevojshme të përforcohen rregullat për transparencën e financimit dhe pronësisë së medias, duke përfshirë interesat e pronarëve në sektorin e medias dhe në sektorë të tjerë. Ka gjithashtu nevojë të merren masa për mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve

dhe punonjësve të medias kundër frikësimit, kërcënimeve dhe sulmeve, si dhe të ndërmerret hetim i plotë dhe i efektshëm i rasteve të dhunës në të shkuarën. Kuadri ligjor për luftën kundër krimit të organizuar bazohet kryesisht në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe në akte të tjera të legjislacionit penal, përfshirë ligjin antimafia. Shqipëria zbaton Strategjinë e saj kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda për periudhën 2021–2022 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2023–2025.

Reagimi i autoriteteve ligjzbatuese ndaj krimit të organizuar, sidomos hetimi i rrjeteve të mëdha kriminale, duhet të jetë më proaktiv dhe sistematik. Përdorimi i teknikave të posaçme të hetimit ka nevojë të shtohet. Gjithashtu, sfidë mbetet zgjerimi i bazave të të dhënave me shkëmbim informacioni, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit për shtimin e bashkëpunimit, operacionet e përbashkëta me vendet e BE-së dhe më gjerë.

Kuadri ligjor në fuqi është kryesisht në përputhje me Direktivën 2015/849 (BE) për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Është ngritur një grup ndërinstitucional për zbatimin e grupit të rishikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar (ICRG) i Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Sigurimi i kuadrit të besueshëm dhe të qëndrueshëm për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave është gjithashtu i nevojshëm.

Shqipëria ka kuadër ligjor të fuqishëm për konfiskimin e produkteve të krimit, i cili parashikon tri lloje konfiskimi: konfiskim penal, konfiskim pavarësisht pranisë së një vendimi dënimi dhe konfiskim administrativ. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është ngritur, megjithatë mbetet sfidë ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 do të trajtojë sfidën e rritjes së produktivitetit në ekonomi në përgjithësi, integrimit të ulët në Tregun e Vetëm të BE-së, aftësive të pakta të bizneseve dhe fuqisë punëtore etj. Për këto arsye, fokusi kryesor i Agjendës së Reformave Kombëtare do të jetë krijimi i mjedisit për klimën e biznesit, nëpërmjet reformave lidhur me sundimin e ligjit, dhe transformimit dhe strukturimit të ekonomisë.

Faza aktuale e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian e bën të qartë nevojën e ngushtimit së hendekut të konvergjencës ndërmjet Shqipërisë me Bashkimin Evropian, sa i përket zhvillimit social-ekonomik.

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 për Shqipërinë konsiderohet si instrument për sigurimin e qasjes në Tregun e Vetëm të BE-së, për reformat e mëtejshme rrënjësore për integrimin në BE, si dhe për thellimin e integrimit ekonomik rajonal. Shtysat e Agjendës Kombëtare të Reformave janë përcaktuar:

a) Politika me në qendër biznesin, duke u përqendruar në trajtimin e sfidave të tregut kombëtar, forcimin e aktorëve të biznesit dhe atyre ekonomikë, me synimin kryesor të rritjes së ritmit për konvergjencën ekonomike dhe sociale, dhe të konkurrueshmërisë në kuadër të përshpejtimit të integrimit në Tregun e Vetëm të BE-së;

b) Qasje treg me treg, duke i shërbyer integrimit të tregut shqiptar në Tregun e Vetëm të BE-së, që përbën thelbin e rritjes, me qëllim lehtësimin e qasjes së bizneseve kombëtare në Tregun e Vetëm të BE-së;

c) Transformim ekonomik, si shtylla kryesore që gjeneron dhe përmbledh të gjitha masat dhe veprimet në kuadër të Agjendës;

d) Masa të realizueshme dhe realiste, që rezultojnë në veprime të mëtejshme detajuese.

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 është përmbledhje masash dhe veprimesh për krijimin e mjedisit të faojshëm për transformimin ekonomik të vendit, që është i nevojshëm për të përshpejtuar ritmin e konvergjencës socio-ekonomike me vendet anëtare të BE-së. Prandaj, fokusi kryesor duhet të jetë çlirimi i potencialit ekonomik të vendit, përmes stimulimit të transformimit ekonomik dhe mjedisit më të mirë që i lejon biznesit të futet në Tregun e Vetëm të BE-së, përmes forcimit të elementeve themelore duke përparuar vazhdimisht drejt konsolidimit dhe efikasitetit të reformave, dhe përparimit të vazhdueshëm drejt përmbushjes së kritereve të anëtarësimit. Synimi kryesor është dyfishimi i rritjes nëpërmjet ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj në drejtim të avancimit të teknologjisë dhe digjitalizimit.

2. OBJEKTIVAT E AGJENDËS SË REFORMAVE

Agjenda e Reformave për Shqipërinë shërben si platformë thelbësore për shtimin e veprimeve ekonomike të Shqipërisë të orientuara nga tregu dhe për të lehtësuar qasjen e saj në Tregun e Vetëm të

BE-së, duke synuar si përfundim konvergjencën me vendet anëtare të BE-së, ndërkohë që përmbushet parakushti për të përfituar nga Instrumenti i Reformave të Reja dhe Rritjes i BE-së.

Kur merret në konsideratë faza aktuale të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, eliminimi i hendekut të zhvillimit socio-ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së është element kritik. Agjenda e Reformave Kombëtare për Shqipërinë është hartuar me qëllim sigurimin e qasjes në Tregun e Vetëm të BE-së, për të çuar përpara reformat themelore të nevojshme për integrimin në BE dhe për të thelluar integrimin ekonomik rajonal.

Agjenda e Reformave Kombëtare përfshin një sërë masash dhe veprimesh që synojnë krijimin e mjedisit mundësues për transformimin ekonomik të Shqipërisë, që është kritik për përshpejtimin e konvergjencës socio-ekonomike me vendet anëtare të BE-së. Përparësitë e Planit të Ri të Reformave dhe Rritjes përqendrohen në përshpejtimin e integrimit të ekonomisë së Shqipërisë në Tregun e Vetëm, avancimin e reformave themelore të integrimit në BE dhe rritjen e integrimit ekonomik rajonal.

Kështu, fokusi kryesor është çlirimi i potencialit ekonomik të vendit përmes nxitjes së transformimit ekonomik dhe përmirësimit të mjedisit të biznesit me qëllim lehtësimin e hyrjes në Tregun e Vetëm të BE-së.

Objektivi kryesor i Agjendës së Reformave Kombëtare lidhet me përshpejtimin e konvergjencës socio-ekonomike të Shqipërisë me Bashkimin dhe integrimin e saj në Tregun e Vetëm të Bashkimit, duke forcuar sundimin e ligjit dhe duke përparuar në mënyrë të qëndrueshme me përmbushjen e standardeve dhe kritereve të anëtarësimit në BE.

Synimi kryesor është dyfishimi i rritjes, përmes ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj në drejtim të avancimit të teknologjisë dhe digjitalizimit.

Agjenda e Reformave shërben si kornizë gjithëpërfshirëse që synon avancimin e fushave kyçe të politikave në vendet përfituese të Ballkanit Perëndimor, në përputhje me objektivat e përshkruar në Instrumentin e Reformave dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Objektivat kryesorë të Agjendës së Reformave janë të shumanshme, dhe përfshijnë aspekte të ndryshme të qeverisjes, zhvillimit ekonomik dhe përparimit shoqëror. Agjenda e Reformave synon të nxisë rritjen e qëndrueshme, të rrisë konkurrencën dhe të promovojë shoqëri gjithëpërfshirëse dhe elastike në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes reformave të synuara dhe nismave strategjike.

Objektivi 1: Rritja e konkurrueshmërisë dhe qeverisjes ekonomike

Objektivi i parë i agjendës së reformave përqendrohet në transformimin e Shqipërisë në ekonomi të zhvilluar dhe konkurruese, e shtyrë përpara nga drejtimi transparent, infrastruktura efikase dhe kuadër i fuqishëm ligjor që përputhet me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Ky objektiv përfshin disa nisma kyçe që synojnë përmirësimin e kushteve që bizneset të funksionojnë në mënyrë efikase dhe transparente në vend, si dhe të kenë mundësi lidhur me Tregun e Vetëm të BE-së dhe tregun rajonal nëse e kërkojnë diçka të tillë.

Objektivi 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i kapitalit njerëzor – reformimi më tej i arsimit, për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur digjitalisht

Objektivi i dytë i Agjendës së Reformave përqendrohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor përmes ngritjes së një sistemi arsimor dinamik, që pajis kapitalin njerëzor me aftësitë dhe kompetencat digjitale përkatëse, të nevojshme për të përparuar në ekonominë botërore, duke forcuar inovacionin dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë kombëtare, si dhe zhvillimin e prodhimtarisë dhe të fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të këtij objektivi, përvijohen nisma të ndryshme për rritjen e efektshmërisë së sistemit arsimor dhe linjëzimin e tij me kërkesat në rritje të tregut të punës, për rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe për zhvillimin e ekonomisë.

Objektivi 3: Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe të aksesueshme

Objektivi i tretë i Agjendës së Reformave përqendrohet në transformimin digjital, përmes krijimit të një shoqërie digjitale pararojë, ku infrastruktura digjitale të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbime publike të bashkërenduara mirë dhe sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. Për arritjen e këtij objektivi, janë parashikuar një sërë nismash kyçe.

Objektivi 4: Konsolidimi i qëndrueshmërisë energjetike dhe integrimi i tregut shqiptar në atë të BE-së

Objektivi i katërt i Agjendës së Reformave përqendrohet tek energjia dhe tranzicioni i gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në lider të qëndrueshëm të energjisë, përmes zbatimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur konkurrencën dhe transparencën në tregun e energjisë, njëkohësisht duke trajtuar varfërinë energjetike dhe çështjet mjedisore dhe duke mbështetur më tej përpjekjet e tranzicionit të gjelbër.

Objektivi 5: Konsolidimi i shtetit të së drejtës, si baza kryesore për sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës në qeverisje

Objektivi i pestë i Agjendës së Reformave synon të përforcojë themeloret dhe sundimin e ligjit përmes reformave rrënjësore që luftojnë krimin e organizuar, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe nxisin transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane. Objektivi kontribuon në sigurimin e konsolidimit të reformës në drejtësi dhe pakthyeshmërinë e saj, progresit të vazhdueshëm me efikasitetin në fushën e drejtësisë dhe ecjen përpara drejt përmbushjes së standardeve të BE-së dhe kritereve të anëtarësimit.

Duke marrë në konsideratë qëllimin dhe objektivat e përgjithshëm dhe të qartë të Agjendës së Reformave, ky instrument konsiderohet si përforcues për harmonizimin me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian.

Që prej 20 vjetësh, Shqipëria ndjek një politikë njëqindpërqind të harmonizuar me **Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (PPJS)**. Shqipëria është e angazhuar të përafrohet në mënyrë progresive me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë në MSA dhe në Kuadrin e Negocimit për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Përafrimi i vazhdueshëm dhe i plotë i Shqipërisë me PPJS-në është pranuar dhe vijon të pranohet nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i BE-së si zgjedhje strategjike e Shqipërisë në momente pasigurie të madhe gjeopolitike, veçanërisht pas agresionit të paligjshëm rus ndaj Ukrainës. Për Shqipërinë, përafrimi me PPJS-në nuk përbën kusht, por është faktor *sine qua non* për t'u angazhuar me BE-në dhe vendet e tjera anëtare në nivel të barabartë në marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe për t'i hapur rrugën besueshmërisë së Shqipërisë në forume ndërkombëtare si partner i angazhuar dhe parimor, në përputhje me parimet e multilateralizmit dhe respektimit të shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare.

Kjo besueshmëri në marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të sjellë edhe besueshmërinë për t'u angazhuar më tej me BE-në në procesin e Integrimit Evropian të Shqipërisë, si dhe për t'u angazhuar më tej në marrëdhëniet ekonomike me BE-në dhe vendet anëtare të BE-së.

Nga ana tjetër, sa më shumë rritet besueshmëria e Shqipërisë nga reformat e vazhdueshme dhe të qëndrueshme lidhur me shtetin e së drejtës dhe më tej, veçanërisht në marrëdhëniet ekonomike, stabilitetin makroekonomik dhe perspektivën ekonomike, në kuadrin e gjerë të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe strategjisë sonë kombëtare për zhvillim, aq më e lartë është besueshmëria e Shqipërisë në forumet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Agjenda e Reformave, e paraqitur nga Shqipëria, përfshin masa që lidhen me shtetin e së drejtës si dhe me fusha me ndikim në tranzicionin e gjelbër, të drejtë dhe digjital, të cilat nga ana e tyre kontribuojnë në thellimin dhe forcimin e sigurisë në BE, në konceptin e vet gjithëpërfshirës.

Arritja e standardeve në fusha të ndryshme, siç parashikohet në Agjendën Kombëtare të Reformave, do ta lidhë përfundimisht dhe vendosmërisht Shqipërinë në standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare dhe evropiane, duke bashkëngjitur qartë standardet dhe praktikat e BE-së dhe parimet e angazhimit me partnerë të ndryshëm.

Nga ana tjetër, arritja e standardeve të BE-së në aspekte të ndryshme të marrëdhënieve ekonomike do të japë kontribut në praktikën e realizimit të marrëdhënieve ndërkombëtare me vendet gjeografike ose për çështje të ndryshme tematike, përfshirë sanksionet, duke eliminuar hapësirat e mundshme për shkelje ose moszbatim të politikës së sanksioneve të BE-së, dhe duke dhënë kështu kontribut në zbatimin e plotë të PPJS-së së BE-së në territorin e Shqipërisë.

Është e qartë se integrimi ekonomik nuk mund të konsiderohet i "shkëputur" nga çështja e përkushtimit ndaj vlerave politike si demokracia, të drejtat themelore, sundimi i ligjit apo përafrimi me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së (PPJS). Shqipëria angazhohet plotësisht ndaj konceptit politik të institucioneve të BE-së, se çdo hap thelbësor drejt integrimit të mëtejshëm në Tregun

e Vetëm, përfshirë nëpërmjet Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe Instrumentit për Rritje dhe Reforma, do t'i nënshtrohet të njëjtave kushte politike si vetë anëtarësimi. Nga ana tjetër, përparimi dhe pjesëmarrja e plotë aktuale dhe në të ardhmen e afërt në këtë integrim ekonomik, përmes Planit të Rritjes dhe Agjendës së Reformave, qartësisht krijon kushte më të mira për të ruajtur plotësisht politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

3. PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN E PËRGJITHSHËM TË POLITIKAVE

Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 është e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHI 2030), që është dokumenti kryesor gjithëpërfshirës kombëtar i planifikimit strategjik për vendin, i cili shtrihet në harkun kohor dhjetëvjeçar 2021–2030 në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë, duke u përqendruar në aspiratën kryesore të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. SKZHI 2030 është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit në rrugën e integrimit të tij në Bashkimin Evropian, përfshirë lidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me qëllim përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030. Strategjia përcakton vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2021–2030. Për pasojë, lidhja me shtyllat e Agjendës së Reformave sipas SKZHI 2030 qëndron në objektivin kryesor gjithëpërfshirës të anëtarësimit në BE dhe integrimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, AKR-ja është në linjë me shtyllat kryesore të SKZHI 2030, si më poshtë:

1. Demokracia dhe forcimi i institucioneve dhe qeverisja e mirë.
2. Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, lidhje dhe rritje të gjelbër.
3. Kohezioni social.

Këto shtylla, të ndërlidhura në funksion të vizionit afatgjatë dhe integrimit të vendit në BE, dhe të mbështetura në përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030, përbëhen nga një sërë sektorësh të ndërlidhur dhe të ndërthurur që u përgjigjen përparësive të politikave përkatëse sektoriale ose më gjerë, me të cilën është në përputhje AKR-ja 2027.

Agjenda e Reformave të Shqipërisë për periudhën 2024–2027 është në përputhje me Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë (ERP) për periudhën 2024–2026. Agjenda e propozuar e Reformave paraqet një udhërrëfyes të hollësishëm dhe ambicioz për përparimin e përparësive të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Agjenda përfshin një gamë të gjerë reformash strukturore në gjashtë fusha kryesore të politikave: (1) Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe lufta kundër ekonomisë informale; (2) Zhvillimi i kapitalit njerëzor; (3) Qëndrueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse; (4) Transformimi dhe infrastruktura digjitale; (5) Kërkimi shkencor dhe inovacioni, integrimi ekonomik dhe shërbimet; dhe (6) Themeloret dhe sundimi i ligjit. Këto reforma të propozuara paraqesin shkallë të lartë vijueshmërie dhe komplementariteti me sfidat, objektivat dhe kuadrin e politikave të shprehura në Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë (PRE) për periudhën 2024–2026.

PRE-ja bën një vlerësim gjithëpërfshirës të situatës aktuale ekonomike të Shqipërisë dhe përshkruan strategjinë afatmesme makroekonomike dhe fiskale të qeverisë. Programi vlerëson rimëkëmbjen e qëndrueshme ekonomike të Shqipërisë nga goditjet e fundit, por thekson nevojën për reforma të qëndrueshme strukturore për të nxitur konkurrencën, nxitur rritjen gjithëpërfshirëse dhe siguruar stabilitetin makro-fiskal të vendit, ndërkohë që vendi në rrugën e anëtarësimit në BE. Përparësitë kryesore të PRE-së përfshijnë forcimin e qeverisjes fiskale, përmirësimin e klimës së biznesit, zhvillimin e kapitalit njerëzor, përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër dhe digjital dhe përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me standardet e BE-së.

Agjenda e Reformave i trajton këto përparësi drejtpërsëdrejti përmes një sërë veprimesh konkrete politikash dhe objektivash të matshëm. Në fushën e parë të politikave "Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe lufta kundër ekonomisë informale", Agjenda përshkruan disa masa për fuqizimin e menaxhimit të financave publike dhe administrimin e të ardhurave, në përputhje me Udhëzimin e Politikave 1 të PRE-së. Këto përfshijnë miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave deri në dhjetor 2024, integrimin e të dhënave të palëve të treta për vlerësimin e përmirësuar të tatimpaguesit deri në dhjetor 2026 etj. Agjenda synon gjithashtu përmirësime në garancitë ligjore dhe transparencën e të drejtave pronësore, si dhe ndihmën shtetërore, që është kyçe për tërheqjen e IHD-ve dhe mbështetjen e rritjes së NVM-ve, siç theksohet në PRE.

Reformimi i administratës tatimore dhe i kuadrit të menaxhimit të financave publike është thelbësor për Shqipërinë për të krijuar hapësirë fiskale për investime që nxisin rritjet, duke garantuar qëndrueshmërinë e borxhit. Kjo përputhet mirë me linjën e konsolidimit fiskal të përshkruar në PRE.

Një shtyllë kryesore e Agjendës së Reformave është përforcimi i kapitalit njerëzor për t'i dhënë shtysë transformimit ekonomik të Shqipërisë (PRE, Seksioni 5.I). Masat e propozuara synojnë të modernizojnë sistemin arsimor, të përmirësojnë përkatësinë e aftësive me tregun e punës dhe të nxisin përfshirjen. Në fushën e AFP-së, ngritja e katër Komiteteve Sektoriale deri në vitin 2027, akreditimi i 90% të ofruesve të AFP-së deri në qershor 2026; arritja e shkallës së punësimit prej 50% të të diplomuarve nga shkollat e AFP-së (të cilët punësohen në sektorin përkatës të studimeve të tyre), tregojnë përafrim të mirë me Udhëzuesin e Politikave 5.3 për shfrytëzimin e të dhënave të tregut të punës për të informuar formimin.

Tranzicioni i gjelbër shfaqet dukshëm në Agjendën e Reformave së Shqipërisë, duke pasqyruar përqendrimin e PRE-së tek qëndrueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse (seksioni 5.II). Në fushën e politikave të energjisë dhe klimës, Agjenda angazhohet për përafrim me direktivat kryesore të BE-së për burimet e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe tregun e energjisë elektrike deri në periudhën 2024–2025. Objektivat e matshëm përfshijnë pjesën e energjive të rinovueshme në përzierjen bruto të energjisë sipas Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe rritjen e masës vjetore të rinovimit të godinave në përputhje me etapat kryesore të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Këto masa përparojnë drejtpërsëdrejti synimet e dekarbonizimit të Shqipërisë dhe angazhimet e saj në kuadër të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor.

Sektori i transportit është tjetër fokus kyç i strategjisë së tranzicionit të gjelbër të Shqipërisë. Agjenda e Reformave i jep përparësi zhvillimit të Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT), përafrimit me rregulloren e e-FTI-së së BE-së dhe zbatimin e fazës së parë të sistemeve të mbledhjes së të dhënave të qarkullimit dhe sistemeve të informacionit të përdoruesve të rrugës. Këto nisma jo vetëm që do të ulin kostot e transportit dhe nxisin tregtinë, por gjithashtu japin kontribut për synimet e pakësimit të shkarkimeve.

Në sektorin digjital (PRE, seksioni 5.III), Agjenda e Reformave pranon rolin kritik të TIK-ut në nxitjen e konkurrencës dhe konvergjencës së Shqipërisë me standardet e BE-së. Masat për sigurimin e brezit të gjerë me shpejtësi të lartë në 95% të shkollave deri në dhjetor të vitit 2025, trajnimin e mësuesve për kompetencat digjitale dhe pajisjen e 75% të shkollave me pajisje TIK-u deri në qershor të vitit 2027 do të ndihmojnë në zhvillimin e fuqisë punëtore të gatshme për të ardhmen. Ngritja e kornizës së certifikimit për programet e aftësive digjitale për të mbështetur rritjen e sektorit të TI-së dhe promovimi i zgjidhjeve digjitale për NVM-të, demonstrojnë më tej përafrimin dhe theksin e PRE-së në përshpejtimin e transformimit digjital.

Nxitja e inovacionit dhe lehtësimi i transferimit të teknologjisë është një tjetër përparësi ndërsektoriale. Agjenda e Reformave synon vënien në funksion të Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorit të Drogave deri në dhjetor 2026 (Udhëzuesi i Politikës 5.1). Krijimi dhe zbatimi i skemave të granteve për të mbështetur inkubatorët/përshpejtuesit dhe inkubimin e *start-up*-eve (duke synuar zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale), do të ndihmojë në eliminimin e hendekut ndërmjet akademisë dhe sektorit privat, si dhe në nxitjen e inovacionit të gjelbër dhe digjital.

Masat për thellimin e integrimit ekonomik të Shqipërisë dhe zhvillimin e mbështetjes për NVM-të, kuadri i Politikave për Kërkim dhe Zhvillim, dhe ecuria për masat e buta të zinxhirit të vlerës, janë të harmonizuara mirë me objektivat e konkurrueshmërisë së ERP-së (seksioni 5. III). Zbatimi i ndërhyrjeve të linjës së gjelbër dhe zhvillimi i kornizave cilësore infrastrukturore do të lehtësojë tregtinë dhe do të ndihmojë shoqëritë shqiptare të integrohen në zinxhirët e vlerave rajonale dhe globale. Kombinuar me Programin e parashikuar të Nxitjes së Eksportit për periudhën 2024–2027, kuadri paraqet qasje të përqendruar në diversifikimin e ekonomisë dhe shfrytëzimin e avantazheve krahasuese të Shqipërisë.

Së fundi, Agjenda e Reformave thekson fuqimisht përforcimin e themeloreve të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Në fushën e antikorrupsionit dhe reformës së gjyqësorit, objektiva të tillë si ulja e numrit të çështjeve të mbartura (*backlog*), miratimi dhe zbatimi i një udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për rritjen e efikasitetit dhe uljen e numrit të çështjeve të mbartura nga ana e KLGJ-së, garantojnë një kuadër të besueshëm dhe të qëndrueshëm për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, forcimin e sistemit të deklarimit të pasurive, uljen e numrit të përgjithshëm të çështjeve të prapambetura dhe shkurtimin e

kohës së disponimit në çështjet civile dhe tregtare nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit, si dhe përafrimi i legjislacionit për financimin e partive politike me standardet e BE-së, synojnë forcimin e themeleve të demokracisë dhe ekonomisë së tregut në Shqipëri.

Si përfundim, Agjenda e Reformave së Shqipërisë për periudhën 2024–2027 paraqet një program gjithëpërfshirës dhe ambicioz të bazuar mirë në sfidat, përparësitë dhe kuadrin e përgjithshëm të politikave të përcaktuara në Programin e Reformës Ekonomike 2024–2026. Shtrirja dhe gjithëpërfshirja e Agjendës, me hapa cilësorë të përcaktuar qartë dhe objektiva me afate të përcaktuara në të gjithë sektorët kyçë, tregon pronësi dhe përkushtim të fortë të vendit për të mbështetur ritmin e reformave. Bashkërendimi i efektshëm dhe monitorimi i rregullt i ecurisë së zbatimit do të jenë vendimtarë, pasi shumë nga reformat e parashikuara kërkojnë përpjekje të ndërlikuara ndërsektoriale dhe vullnet të qëndrueshëm politik.

Duke konsideruar përputhshmërinë e Agjendës së Reformave me strategjinë ekonomike afatmesme të Shqipërisë dhe reagimin e saj ndaj udhëzimeve të politikave të BE-së, realizimi i suksesshëm i saj ka mundësi të ndryshojë tërësisht situatën lidhur me përshpejtimin e zhvillimit socio-ekonomik të Shqipërisë dhe nxitjen e procesit të integrimit të vendit në BE. Përmes përforcimit të sundimit të ligjit, përparimit, drejtimit ekonomik, zhvillimit të kapitalit njerëzor, dhe duke shfrytëzuar tranzicionin e gjelbër dhe digjital, Agjenda premton të përmirësojë konkurrueshmërinë e Shqipërisë, integrimin rajonal dhe konvergjencën me standardet e BE-së. Partneriteti i vazhduar i ngushtë me BE-në dhe partnerët ndërkombëtarë, si në aspektin e mbështetjes financiare ashtu edhe të ekspertizës teknike, do të jene elemente kyçe për të ndihmuar Shqipërinë ta përkthejë këtë vizion ambicioz në realitet. Ndërsa vendi përtërihet nga goditjet e viteve të fundit, si tërmeti, pandemia e shkaktuar nga COVID-19 dhe krizat energjetike, dhe synon të ardhme më të begatë dhe të qëndrueshme, Agjenda e Reformave siguron një udhërrëfyes bindës për realizimin e potencialit të jashtëzakonshëm të pashfrytëzuar të Shqipërisë në rrugëtimin e vet evropian.

Dialogu ekonomik dhe financiar jep kontribut për qëllimet më të përgjithshme të qeverisjes së mirë, përfshirë sundimin e ligjit dhe prosperitetin ekonomik. Me qëllim përforcimin e aftësisë ripërtëritëse ekonomike në periudhën më afatgjatë, Shqipëria si vend negociator miraton dhe pranon angazhimin e BE-së për përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër dhe digjital në përputhje me angazhimet që lidhen me objektivat për reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë, eficiencën e energjisë dhe energjinë e rinovueshme për vitin 2030. Për më tepër, përforcimi i zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe përfshirjes sociale, veçanërisht e të rinjve, është me rëndësi të madhe. Këto janë pjesë e Përfundimeve të Përbashkëta nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar i majit të vitit 2023.

Reformat e synuara të propozuara në Agjendën e Reformave synojnë të trajtojnë zbatimin e Udhëzuesit të Politikave për fushat e politikave të përmirësimit të mjedisit të biznesit dhe luftës kundër ekonomisë informale, kapitalit njerëzor, energjisë dhe tranzicionit të gjelbër, transformimit digjital dhe nënkomponentëve të tyre përkatës. Këto fusha politikash dhe komponentë janë të lidhur fort me fushat tematike dhe nënfushat e ERP-së 2024–2026, duke lejuar kështu një sinergji më të madhe të reformave të propozuara në të dyja dokumentet.

Agjenda e Reformave është në përputhje me Udhërrëfyesin për Sundimin e ligjit dhe themeloret, që janë përpiluar dhe miratuar pas procesit të shqyrtimit analitik dhe si piketa për hapjen e bisedimeve të negociatave të anëtarësimit me BE-në, në kuadër të anëtarësimit në BE, që Shqipëria synon të arrijë brenda vitit 2030. Në veçanti, politikat dhe reformat në kuadër të Themeloreve/Shtetit të së Drejtës të Agjendës së Reformave janë plotësisht të përafruara me angazhimet e Qeverisë Shqiptare sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës dhe Themeloret. **Agjenda e Reformave për Shqipërinë është hartuar në mënyrë strategjike për të qenë në përputhje me kuadrin më të fundit makroekonomik dhe të politikave dorëzuar Komisionit**. Ky përafrim siguron që plani ynë i rritjes të përdorë parimet themelore të përvijuara në Dialogun Ekonomik dhe Financiar, duke theksuar stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe rritjen. Duke iu përmbajtur këtij kuadri, synojmë të arrijmë disa objektiva kyçe:

1. Stabilitet makroekonomik: Agjenda jonë e Reformave i jep përparësi disiplinës fiskale dhe politikave monetare që nxisin stabilitetin dhe aftësinë ripërtëritëse të ekonomisë shqiptare.

2. Reforma Strukturore: Jemi të përkushtuar të zbatojmë reformat strukturore gjithëpërfshirëse që nxisin konkurrencën, tregun e punës dhe zhvillimin e sektorit privat. Kjo përfshin masa për përmirësimin

e mjedisit të biznesit, përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e tregut të punës dhe lehtësimin e tregtisë.

3. Sundimi i ligjit/Themeloret: përpjekjet për të konsoliduar dhe siguruar një sundim të fortë të ligjit, qeverisje transparente dhe mekanizma të efektshëm kundër korrupsionit janë thelbësore dhe bazohen në angazhimin e Shqipërisë për të përparuar më tej për zhvillimin e vendit dhe aspiratat e integrimit në BE.

4. Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor: Investimi në arsim, kujdes shëndetësor dhe përfshirje sociale janë kritike për të nxitur një fuqi punëtore të kualifikuar dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme.

5. Integrimi në BE: Agjenda jonë është e përafruar ngushtë me kriteret dhe kuadrin e anëtarësimit në BE, duke hapur rrugën për integrim më të ngushtë ekonomik dhe përafrim me politikat dhe standardet e BE-së, veçanërisht duke përparuar me përafrimin me *acquis-ve* të BE-së.

Qëllimi kryesor i Agjendës sonë të Reformave për Planin e Rritjes është krijimi i mjedisit të favorshëm për tërheqjen e investimeve, nxitjen e hapjes së vendeve të punës dhe promovimin e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në të mbarë Ballkanin Perëndimor.

Agjenda e Reformave së Shqipërisë 2024–2027 është në përputhje me Planin Ekonomik dhe të Investimeve (EIP) për Ballkanin Perëndimor, që pasqyron angazhimin strategjik për përforcimin e integrimit ekonomik brenda peisazhit evropian. Ndërkohë që Agjenda e Reformave synon të përshpejtojë integrimin në Tregun e Vetëm të BE-së me reforma kritike që lidhen me mjedisin e biznesit, tranzicionin e gjelbër dhe të energjisë, transformimin digjital, kapitalin njerëzor dhe sundimin e ligjit, nga ana tjetër vendi synon "përmes EIP-së" të nxisë investime të rëndësishme në sektorë kyçë si lidhjet, energjia, tranzicioni i gjelbër dhe digjital dhe kapitali njerëzor. Ky përafrim është kritik për rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Ai tregon gjithashtu përkushtimin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve dhe praktikave evropiane, duke i hapur rrugën lidhjeve më të forta ekonomike dhe anëtarësimit të mundshëm në Bashkimin Evropian. Më poshtë jepen disa ngjashmëri dhe elemente konvergjence ndërmjet Agjendës së Reformave dhe Planit të Rritjes, si dhe Planit Ekonomik dhe Investimeve për Ballkanin Perëndimor:

1. Përmirësimi i qeverisjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë fiskale

Si Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, ashtu edhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve, i japin përparësi masave për forcimin e qeverisjes ekonomike, përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar publik. Këto nisma synojnë të promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e shpenzimeve publike, duke forcuar kështu stabilitetin makroekonomik dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

2. Nxitja e sundimit të ligjit dhe reformës në drejtësi

Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, së bashku me Planin Ekonomik dhe të Investimeve, theksojnë rëndësinë e promovimit të sundimit të ligjit, forcimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe forcimit të kuadrit ligjor për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe për të siguruar zbatimin e efektshëm të ligjit.

3. Përparimi i reformës së administratës publike

Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, si dhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve, pranojnë rolin kritik të reformës së administratës publike në përmirësimin e qeverisjes, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe promovimin e efikasitetit dhe efektshmërisë në sektorin publik. Duke modernizuar strukturat administrative, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe duke promovuar meritokracinë dhe profesionalizmin, këto nisma synojnë të përmirësojnë performancën e sektorit publik, të thjeshtojnë proceset rregullatore dhe të tërheqin investime dhe zhvillimin e biznesit në Ballkanin Perëndimor.

4. Nxitja e konkurrueshmërisë ekonomike dhe inovacionit

Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, si dhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve, u japin përparësi nismave për të nxitur konkurrueshmërinë ekonomike, për të promovuar inovacionin dhe për të nxitur zhvillimin e sektorit privat. Duke mbështetur sipërmarrjen, ekosistemet e inovacionit dhe qasjen në financim për NVM-të, këto nisma synojnë të çlirojnë potencialin ekonomik të rajonit, të hapin vende pune dhe të nxisin rritje dhe prosperitet të qëndrueshëm.

5. Promovimi i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor

Të dyja planet pranojnë rëndësinë e promovimit të përfshirjes sociale, reduktimit të pabarazive dhe investimit në zhvillimin e kapitalit njerëzor për të siguruar zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm në

Ballkanin Perëndimor. Duke investuar në arsim, zhvillimin e aftësive dhe sistemet e mbrojtjes sociale, këto nisma synojnë të fuqizojnë individët, të përmirësojnë kohezionin social dhe të krijojnë mundësi që të gjithë qytetarët të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga rritja dhe zhvillimi ekonomik.

6. Trajtimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe veprimit klimatik

Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, së bashku me Planin Ekonomik dhe të Investimeve, pranojnë nevojën urgjente të trajtimit të sfidave mjedisore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. Duke promovuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe duke investuar në teknologjitë dhe infrastrukturën e gjelbër, këto nisma synojnë të promovojnë praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm në mbarë rajonin.

Në përgjithësi, Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes, si dhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, ndajnë një vizion të përbashkët për përparimin e zhvillimit ekonomik, nxitjen e qeverisjes së mirë, promovimin e përfshirjes sociale dhe trajtimin e sfidave mjedisore për një të ardhme të begatë dhe me aftësi ripërtëritëse në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përmes përpjekjeve të bashkërenduara dhe investimeve strategjike, këto nisma rreken të çlirojnë potencialin e plotë të rajonit dhe të përshpejtojnë integrimin e tij në Bashkimin Evropian.

Agjenda e Reformave është në përputhje si me Planin Kombëtar Shqiptar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) ashtu edhe me Kontributin Kombëtar të Pikësynuar të rishikuar (KKP) të miratuar përkatësisht në dhjetor të vitit 2021 dhe tetor të vitit 2021.

Në lidhje me PKEK-në, reformat kryesore që janë në përputhje me politikat dhe masat (PaM) jepen më poshtë sipas sektorëve:

- Në lidhje me sektorin e mjedisit të biznesit: vënia në funksion e sistemeve e-mallra dhe të transportit inteligjent është në përputhje me dekarbonizimin e sektorit të transportit, veçanërisht me politikën dhe masën G-T2 "Menaxhimi i integruar i mallrave";

- Në lidhje me sektorin e reformave të tregut: (i) përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike për mundësimin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë është në përputhje me masat e kërkuara në PKEK lidhur me tregjet e Energjisë veçanërisht me EM-I1 dhe EM-I2 për ndërlidhësit e energjisë elektrike dhe reformën e sektorit të energjisë elektrike; (ii) korrigjimi gradual i tarifave për t'u përputhur me çmimet e tregut, shoqëruar me masat për trajtimin e varfërisë energjetike, janë në përputhje me PaM-et në lidhje me varfërinë energjetike (EM-P1) ndërsa korrigjimet tarifore lidhen gjithashtu me reformën e sektorit të energjisë elektrike (EM-I2).

- Në lidhje me sektorin e burimeve të rinovueshme: (i) hartimi i planit të veprimit transparent dhe konkurrues bazuar në sasi për energjinë e rinovueshme është në përputhje me kërkesat e PaM-ve (R-E2) të PKEK-së në lidhje me ankandet për kapacitete të reja të rinovueshme (erë dhe diellore) dhe kontratat-për-diferencë; (ii) zbatimi i Direktivës së Energjisë së Rinovueshme lidhet me disa masa të pranishme në PKEK si R-T2 Biokarburantet e Qëndrueshme/të Avancuara, R-E1 etj.

- Në lidhje me sektorin e miratimit të ETS: puna për vënien në zbatim të MRVA-së (Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi) do të përmirësojë cilësinë e të dhënave për GS (gazet serrë), të të mbledhura nga infrastruktura e instaluar, dhe kjo do t'i shërbejë synimit afatgjatë për vënien në funksion të një ETS-je (Sistemi i Tregtimit të Shkarkimeve) në vitin 2030, në përputhje me dekarbonizimin e sektorit industrial me PaM G-I1[34] "Zbatimi i ETS-së në Shqipëri". – Në lidhje me sektorin e eficiencës së energjisë dhe ndotjes së ajrit: puna për miratimin dhe zbatimin e strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë është në përputhje me disa politika të PaM-ve që lidhen me dimensionet e eficiencës së energjisë në PKEK si EE-L1 "Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në godina", EE-L2 "Strategjia afatgjatë e rinovimit (për godinat publike dhe private)", EE-L3 "Rikonstruksioni i godinave ekzistuese të qeverisjes qendrore (me përjashtim të godinave të tjera publike në pronësi të bashkive etj.)", EE-L4 "Rikonstruksioni i stokut të godinave publike (të gjitha godinat publike përveç atyre të qeverisjes qendrore)".

Gjithashtu, si ndikim i përgjithshëm, komponenti i arsimit do të kontribuojë në dimensionin e kërkimit, inovacionit dhe konkurrueshmërisë së PKEK-së.

[34] PAM G-I1- do të thotë *"politika dhe masa" me kodin G-I1,*në kuadër të dimensionit "Dekarbonizimi / shkarkimet dhe largimet e GS-ve" të Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2021–2030.

Në lidhje me Kontributin Kombëtar të Pikësynuar të rishikuar të përmendur më sipër, ai është në përputhje me veprimet kryesore zbutëse për sektorin e energjisë siç paraqitet më poshtë:

- Në lidhje me sektorin e mjedisit të biznesit: vënia në funksion e sistemit të e-mallrave dhe transportit inteligjent është në përputhje me veprimin e sistemit të transportit efikas.
- Në lidhje me Sektorin e Eficiencës së Energjisë dhe ndotjes së ajrit: puna për miratimin dhe zbatimin e strategjisë afatgjatë të rinovimit të godinave dhe skemës së eficiencës së energjisë është në përputhje me veprimin e përmirësimit të performancës së energjisë në godina.
- Në lidhje me sektorin e miratimit të ETS-së: puna për përcaktimin e çmimit të karbonit me synimin vënien në funksion të një ETS-je deri në vitin 2030 është në përputhje me veprimin e reduktimit të shkarkimeve nga industritë.
- Në lidhje me sektorin e burimeve të rinovueshme: (i) hartimi i planit të veprimit transparent dhe konkurrues të bazuar në sasi për energjinë e rinovueshme është në përputhje me procesin e tranzicionit nga hidrocentralet drejt diversifikimit dhe promovimit të veprimit për burimet alternative të energjisë së rinovueshme.

Duhet përmendur se si PKEK-ja shqiptare ashtu edhe KKP-ja e rishikuar synojnë ambicien për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.

4. PRIORITETET KRYESORE TË POLITIKAVE

4.1 Sektorët themelorë

Shteti i së drejtës dhe reformat themelore janë thelbësore për integrimin e Shqipërisë në Tregun e Përbashkët të BE-së, sepse ofrojnë bazat ligjore, ekonomike dhe sociale të nevojshme për një mjedis tregu të qëndrueshëm, transparent dhe konkurrues. Këto reforma sigurojnë siguri ligjore, konkurrencë të ndershme, besim të investitorëve dhe përafrim me standardet e BE-së, të cilat të gjitha janë kyç për integrimin e pandërprerë ekonomik. Duke adresuar krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave, efikasitetin dhe forcimin e drejtësisë, si dhe duke konsoliduar lirinë e shprehjes, Shqipëria mund të ndërtojë një kuadër të besueshëm dhe të shëndoshë që mbështet aspiratat e saj për anëtarësim në BE dhe pjesëmarrje në Tregun e Përbashkët.

Prioritet i Agjendës së Reformave mbetet mbështetja e themeloreve dhe shtetit të së drejtës, duke forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke forcuar pushtetin gjyqësor, si dhe duke promovuar parimet demokratike. Shqipëria ka planifikuar nisma të ndryshme në Agjendën e Reformave, për arritjen e këtyre objektivave.

Së pari, përpjekjet janë orientuar drejt luftës kundër krimit të organizuar nëpërmjet krijimit të një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, dhe forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë rastet e nivelit të lartë. Krahas kësaj, janë marrë masa për të forcuar kapacitetet institucionale dhe kuadrin strategjik për të reduktuar furnizimin e paligjshëm me drogë, duke krijuar një sistem të paralajmërimit të hershëm për drogën dhe një Observator Kombëtar të Drogës. Këto konsiderohen me një ndikim transformues në uljen e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme. Këto masa rrisin aftësinë për të zbuluar dhe për t'iu përgjigjur prirjeve të reja të drogës, mbështesin zbatimin e ligjit dhe përpjekjet e shëndetit publik, informojnë politikëbërjen dhe promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Sigurimi i kuadrit të besueshëm për të parandaluar dhe për të luftuar pastrimin e parave mbetet një fokus i rëndësishëm i reformave, për të promovuar transparencë më të madhe në transaksionet financiare, çka është thelbësore për integrimin në Tregun e Përbashkët të BE-së dhe pjesëmarrjen në sistemin më të gjerë financiar evropian.

Do të ndërmerren masa për të siguruar përditësime të rregullta të një platforme për mbledhjen e të dhënave rreth krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, akses të zgjeruar dhe ndërveprim në bazat e të dhënave, përdorimin e mjeteve të TI-së dhe metodave hetimore në luftën kundër krimit të organizuar dhe progres të vazhdueshëm në hetime, dënime dhe sekuestrime/konfiskime të pasurive të fituara nga korrupsion dhe krimi i organizuar. Këto masa konsiderohen se kanë një ndikim të gjerë dhe transformues në sistemin e drejtësisë penale dhe qeverisjen e përgjithshme. Zbatimi i këtyre masave ka një ndikim të thellë në aftësinë e Shqipërisë për të luftuar krimin e organizuar dhe krimet e rënda, si dhe korrupsionin. Platformat e mbledhjes së të dhënave, të përditësuara rregullisht, zgjerojnë aksesin dhe ndërveprimin midis bazave të të dhënave, si dhe përdorimi i mjeteve të TI-së dhe metodave hetimore çojnë në monitorim, zbulim dhe ndërprerje më të efektshme të aktiviteteve kriminale. Progresi i vazhdueshëm në

hetime, ndjekje penale, dënime, dhe sekuestrime të aseteve, siguron që drejtësia të vihet në vend, frenon sjelljen kriminale dhe rikuperon pasuritë për përfitim publik. Këto masa forcojnë kolektivisht shtetin e së drejtës, rrisin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe përmirësojnë përafrimin e Shqipërisë me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur kështu qëllimet e saj më të gjera për integrim dhe zhvillim ekonomik.

Për sa i përket gjyqësorit, Shqipëria synon të konsolidojë pavarësinë dhe llogaridhënien, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e gjyqësorit në të gjitha nivelet. Kjo përfshin miratimin e një udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të ulur çështjet e mbartura (*backlog*), për të përmirësuar statistikat gjyqësore dhe për të plotësuar vendet vakante për gjyqtarë dhe personelin jogjyqësor.

Parandalimi i korrupsionit dhe ulja e rasteve të korrupsionit konsiderohen si aspekte të rëndësishme të parimeve themelore të Agjendës së Reformave. Shqipëria do të fokusohet në parandalimin e korrupsionit dhe uljen e rasteve të korrupsionit, nëpërmjet miratimit të instrumenteve që adresojnë korrupsionin dhe rritin transparencën, duke krijuar një platformë të hapur të të dhënave për buxhetin kombëtar dhe vendor dhe shpenzimet publike.

Legjislacion i rëndësishëm do të miratohet dhe do të përafrohet me *acquis* të BE-së. Do të miratohen ndryshime në ligjin për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), për donacionet dhe sponsorizimet, për konfliktin e interesit, për financimin e partive politike dhe për mediat audiovizive.

Përmirësimi i kapaciteteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit adreson sfidat me efikasitetin e auditimit dhe parandalimin e korrupsionit. Ndryshimi i kuadrit për donacionet, sponsorizimet dhe financimin e partive politike, trajton nevojën për rritjen e transparencës, për reduktimin e konfliktit të interesit, si masë parandaluese kundër korrupsionit, dhe mangësitë përkatëse rregullatore. Këto masa synojnë të forcojnë qeverisjen, të rrisin besimin e publikut, të përafrohen me normat ndërkombëtare dhe të sigurojnë mbikëqyrje dhe mbrojtje më të efektshme ligjore në Shqipëri.

Veç kësaj, në Agjendën e Reformave do të merren masa për rritjen e lirisë së shprehjes, duke ngritur kapacitetet e organeve ligjzbatuese për të trajtuar rastet e dhunës ku përfshihen gazetarët, e cila ndikon në rritjen e sigurisë së gazetarëve, promovimin e lirisë së shprehjes, forcimin e shtetit të së drejtës, duke mbështetur lirinë dhe pavarësinë e medias, duke përmirësuar reputacionin ndërkombëtar, duke nxitur praktikat efektive të zbatimit të ligjit dhe duke rritur qeverisjen demokratike, duke përafruar aspektet penale dhe civile të shpifjes me standardet e BE-së. Dispozitat e të drejtës civile për publikimet e rreme ose të pasakta do të përafrohen me standardet dhe rekomandimet evropiane. Rishikimi i kuadrit ligjor për mediat audiovizive do të trajtojë sfidat e transparencës për pronësinë dhe financimin e medias, do të promovojë pluralitetin e medias, do të mbrojë pavarësinë editoriale dhe do të forcojë autonominë e organit rregullator të medias.

Përpjekjet e ardhshme do të fokusohen në rritjen e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese për të menaxhuar me efektshmëri rastet e dhunës, veçanërisht ato që ndodhin në periferi të protestave, si dhe çështje të tjera penale që përfshijnë gazetarë. Kjo do të arrihet duke zbatuar udhëzime detyruese, duke përmirësuar proceset e mbledhjes së të dhënave dhe duke miratuar masa për ndërtimin e kapaciteteve, për të siguruar zbatimin e plotë të standardeve të të drejtave të njeriut, kur kemi të bëjmë me incidente që përfshijnë gazetarë.

Do të ndërmerren nisma ligjore për transpozimin e ligjeve të fundit të BE-së, të tilla si Rregullorja e Aktit të Shërbimeve Digjitale dhe nisma Anti-SLAPP, e përbërë nga një direktivë dhe një rekomandim. Transpozimi i Direktivës Anti-SLAPP në legjislacionin kombëtar do të trajtojë çështjen e mbrojtjes së personave që përfshihen në pjesëmarrje publike mbi pretendime haptazi të pabazuara ose mbi procedura gjyqësore abuzive, dhe do të promovojë të drejtën për lirinë e shprehjes. Rekomandimi Anti-SLAPP plotëson Direktivën duke nxitur masat për ndërgjegjësim, trajnim, mekanizmat mbështetës dhe mbledhjen e të dhënave. Paraqet gjithashtu një shtrirjeje më të gjerë, duke përfshirë edhe procedurat penale dhe administrative.

Duhet të theksohet se Shqipëria ka tashmë një bazë të konsoliduar në lidhje me fushat e tjera të parimeve themelore, si: zbatimi i reformës së administratës publike (në veçanti strategjia e menaxhimit të financave publike, kontrolli i brendshëm financiar publik, kontrolli dhe auditimi) dhe çështjet e lidhura me kapitullin 32 (detajet e përfshira në kapitullin 16 të këtij dokumenti). Përmbledhtazi, Shqipëria ka siguruar progres në lidhje me fushat e reformës së administratës publike sipas Raportit Vjetor SIGMA

2021. Sipas Raportit të Monitorimit SIGMA 2021, Shqipëria ka treguar performancën më të mirë dhe të shëndoshë në krahasim me fqinjët e saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke shënuar vlera më të larta se mesatarja rajonale për gjashtë fushat kyçe të administratës publike të BE-së. Vlerësimi i vitit 2021, u bazua në 48 parimet e 6 fushave të administratës publike, të përbërë nga 52 tregues/340 nëntregues. Shqipëria shënoi rezultate më të larta se mesatarja rajonale e Ballkanit Perëndimor në fushat e ofrimit të shërbimeve, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve publike, zhvillimit dhe koordinimit të politikave, kuadrit strategjik për reformën në administratën publike (RAP) dhe menaxhimin e financave publike (MFP), si dhe pati një performancë të konsoliduar në fushën e llogaridhënies.

Bazuar në arritjet e raportuara nga raportet aktuale të monitorimit të strategjive për MFP dhe RAP, nga Raporti i fundit i Monitorimit SIGMA të vitit 2021 dhe Progres Raportet e BE-së për 2022 dhe 2023, si dhe sfidat e identifikuara për administratën publike në lidhje me procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, janë përcaktuar disa fusha prioritare për përmirësim të mëtejshëm si shtylla të kuadrit të ri të politikave për RAP-in dhe MFP-në.

Strategjia e re e MFP-së u miratua me VKM-në nr. 390, datë 12.6.2024 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare, më 26.6.2024[35]. Strategjia e miratuar është publikuar edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave[36].

Ky dokument do të përcaktojë drejtimet dhe prioritetet për të garantuar një sistem të financave publike që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale, si dhe efikasitetin dhe barazinë në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik, duke siguruar një integrim pa pengesa në Bashkimin Evropian. Shtyllat kryesore të Strategjisë së MFP-së 2023–2030 dhe Planit të saj të veprimit janë si më poshtë:

a)Programimi makroekonomik dhe monitorimi i riskut: Sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e një politike të shëndoshë fiskale të bazuar në rregulla fiskale, parashikime të avancuara makroekonomike dhe praktika solide të menaxhimit të riskut fiskal mirëmbahen dhe përmirësohen më tej. Krijohet Këshilli Fiskal.

b) Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent: Ekziston një sistem i avancuar për planifikimin strategjik të integruar dhe planifikimin buxhetor afatmesëm në të gjitha nivelet e qeverisjes. Praktikat për planifikimin e investimeve publike janë të profesionalizuara. Sigurohet monitorim dhe raportim transparent dhe pjesëmarrja e publikut në proceset buxhetore, në përputhje me standardet përkatëse.

c) Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave: Mobilizimi i të ardhurave vendase është rritur përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave të avancuara tatimore; sistemet për menaxhimin e taksave dhe doganave përmirësohen më tej dhe aty ku është e aplikueshme, në përputhje me kërkesat ligjore të BE-së. Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) zbatohet, përditësohet rregullisht dhe reformat tatimore menaxhohen në mënyrë adekuate.

d) Kontabiliteti dhe menaxhimi i zbatimit të buxhetit: Praktikat e menaxhimit të zbatimit të buxhetit forcohen, duke përfshirë përmirësimin dhe rritjen e përdorimit të Sistemit Informativ Financiar Qeveritar (SIFQ), zbatimin e reformave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik, duke lehtësuar kalimin në kontabilitetin "*accrual*". Sistemet e prokurimit përmirësohen dhe në veçanti sigurohet pajtueshmëria me legjislacionin e prokurimit. Praktikat e menaxhimit të borxhit dhe parasë përmirësohen më tej. Përmirësohen sistemet e menaxhimit të aseteve.

e) Kontrolli i brendshëm financiar publik sistemet për kontrollin e brendshëm financiar publik përmirësohet më tej, në përputhje me praktikat e pranuara nga BE-ja për menaxhim të shëndoshë financiar. Koncepti i përgjegjshmërisë menaxheriale dhe delegimit të autoriteteve forcohet dhe adresohen të gjitha mangësitë e menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet publike. Auditimet e brendshme me vlerë të shtuar zbatohen në të gjitha institucionet publike në përputhje me standardet në fuqi. Rastet e mashtrimit dhe parregullsive trajtohen në mënyrë efektive nga inspektimi financiar publik dhe rrjeti i shërbimit të koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS) zbaton strategjinë kundër mashtrimit. Krijohen

[35] https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/105/d896de92-1aea-4d73-991e-7a99cfeb934f
[36] https://financa.gov.al/en/menaxhimi-i-financave-publike/

sisteme adekuate të menaxhimit financiar për të përthithur IPAIII dhe mbështetjen e ardhshme financiare të BE-së.

h) Mbikëqyrja e jashtme: funksioni i pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit profesionalizohet më tej në përputhje me parimet e INTOSAI-t dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Forcohet funksioni mbështetës për Parlamentin, për t'i mundësuar Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të zbatojë në mënyrë rigoroze rolin e tij mbikëqyrës.

Krahas kësaj, aktualisht është në proces projektstrategjia e RAP 2023–2030 dhe bazohet në vizionin: fuqizimi i një administrate publike profesionale, transparente, novatore, dhe i llogaridhënies, qëndrueshmërisë dhe drejtimit etik, për të promovuar në mënyrë efikase dhe për të përshpejtuar procesin e integrimit evropian. Projektdokumenti përfshin rreth 15 objektiva në 5 shtylla, të cilat organizohen sipas fushave të monitorimit të SIGMAs: i) Zhvillimi dhe koordinimi i politikave; ii) Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; iii) Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi; iv) Llogaridhënia dhe organizimi i administratës; v) Administrata e gjelbër. Projektstrategjia e RAP-së dhe Plani i Veprimit 2023–2030 nuk përfshijnë shtyllën për MFP-së, njësoj si strategjia dhe plani i mëparshëm i veprimit për 2019–2023.

Reforma të rëndësishme të Parimeve Themelore/Shtetit të së Drejtës përfshihen edhe në dy dokumente thelbësore, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyesi i RAP-it, miratuar me VKM[37], si vazhdim i fazës së shqyrtimit analitik për negociatat (përfunduar në nëntor 2023) dhe raportit përkatës (*screening*) të Komisionit Evropian.

Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës është një dokument politik që përfshin kapitullin 23, "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe kapitullin 24, "Drejtësia, liria dhe siguria". Ky udhërrëfyes përshkruan masat ligjore, administrative dhe institucionale, si dhe angazhimet që Shqipëria merr në kuadër të procesit të saj të integrimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Synon të adresojë boshllëqet e identifikuara gjatë shqyrtimit analitik të *acquis* së BE-së, dhe të prioritizojë masat për të siguruar përputhjen me standardet e BE-së, duke çuar përpara procesin e negociatave dhe integrimit. Masat prioritare në këtë udhërrëfyes mbulojnë fusha të tilla, si gjyqësori, antikorrupsioni, të drejtat themelore, mbrojtja e të drejtave të qytetarëve të BE-së, lufta kundër krimit të organizuar, bashkëpunimi në luftën kundër drogës, përpjekjet kundër terrorizmit, bashkëpunimi juridik në çështjet penale dhe civile, migracioni (i rregullt dhe i parregullt), azili, politika e vizave, kufijtë e zonës Shengen dhe lufta kundër falsifikimit të euros.

Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike është një dokument politik i hartuar për të mbështetur reformën e administratës publike me një plan masash prioritare për periudhën 2023–2030. Hartimi i tij synon të adresojë sfidat e identifikuara gjatë shqyrtimit analitik të *acquis* së BE-së, duke përmbushur kriteret për anëtarësimin në RAP dhe duke prioritizuar masat për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe progresin në procesin e negociatave dhe integrimit në Bashkimin Evropian. Masat prioritare janë organizuar në pesë shtylla, bazuar në parimet e BE-së për administratën publike: i) Zhvillimi dhe koordinimi i politikave; ii) Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore iii) Organizimi i administratës publike, llogaridhënia dhe transparenca; iv) Ofrimi i shërbimeve publike; v) Menaxhimi i financave publike.

Shqipëria angazhohet të prezantojë masa shtesë sigurie për të kontrolluar më mirë mbërritjet pa viza (qershor 2027) dhe të përmbyllë gradualisht regjimet pa viza me vendet që nuk janë në listën e BE-së të regjimit pa viza (veçanërisht ndaj atyre që paraqesin migracion të parregullt ose rrezik sigurie për BE-në). Shqipëria do të përmbyllë të paktën dy regjime pa viza në dhjetor 2025, të paktën një regjim pa viza në dhjetor 2026 dhe të paktën një regjim pa viza në dhjetor 2027, me vendet e treta, të matura në fund të çdo viti (dhjetor) gjatë kohëzgjatjes së Instrumentit/Facilitetit 2024–2027.

4.2 Transformimi digjital dhe çështjet e sigurisë digjitale

Transformimi digjital është një nga prioritetet e Agjendës së Reformave, i fokusuar në krijimin e një shoqërie pararojë digjitale, ku infrastruktura digjitale të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike pa probleme dhe sigurojnë siguri kibernetike, në përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. Për ta arritur këtë prioritet, janë përshkruar disa nisma kyç. Së pari, Shqipëria

[37] VKM nr. 736, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës".
VKM nr. 737, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike".

synon të zbatojë rregulloren e BE-së për Identitetin Digjital duke miratuar legjislacionin përkatës dhe duke vënë në zbatim një portofol elektronik digjital për shërbimet publike, si dhe duke lehtësuar identifikimin elektronik të sigurt dhe aksesin në shërbimet digjitale të qeverisë.

Veç kësaj, do të bëhen përpjekje për të përditësuar kuadrin për sigurinë kibernetike, duke u përafruar me kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse si CERT-et kombëtare dhe qeveritare.

Shqipëria gjithashtu planifikon të përditësojë kuadrin e saj për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme, duke miratuar legjislacionin për *broadband*-in dhe duke zbatuar masa për të siguruar shtrirjen e infrastrukturës 5G në përputhje me standardet e BE-së. Agjenda thekson nxitjen e përdorimit të potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale nga ana e bizneseve, duke përfshirë përmirësimin e mjedisit të favorshëm për bizneset novatore dhe ofrimin e mbështetjes financiare përkatëse. Nëpërmjet këtyre nismave, Shqipëria synon të përshpejtojë transformimin e saj digjital, të rrisë sigurinë kibernetike dhe të stimulojë novacionin dhe rritjen në ekonominë digjitale.

Ligji shqiptar për *broadband*-in bazohet në direktivën BCRD dhe ligjin nr. 120/2016, që është në fuqi që nga viti 2016, duke qenë të vetëdijshëm se direktiva BCRD së shpejti do të zëvendësohet me Aktin e Infrastrukturës Gigabit, dhe nga ana tjetër direktiva EECC është një pjesë e rëndësishme e masave reformuese për rrjetet me *broadband* dhe me kapacitet shumë të lartë.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale të qëndrueshme dhe të sigurt do të arrihet përmes zbatimit të masave të mëposhtme në harmoni, duke marrë parasysh paketën e instrumenteve të sigurisë kibernetike 5G. Me miratimin dhe zbatimin e ligjit të ri, bazuar në direktivën NIS2 dhe zbatimin e paketës së instrumenteve 5G, do të garantohet siguria dhe qëndrueshmëria e rrjetit dhe lidhjes digjitale.

4.3 Arsimi, formimi, punësimi dhe objektivat socialë

Zhvillimi i kapitalit njerëzor është një nga prioritetet në Agjendën e Reformave. Reformat që do të ndërmerren do të rrisin cilësinë e arsimit, aftësive digjitale, aktualitetin e formimit profesional, kapacitetin e kërkimit dhe novacionit, si dhe efikasitetin e tregut të punës. Këto elemente do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, barazinë sociale dhe integrimin e Shqipërisë në kuadrin evropian.

Reformat do të trajtojnë sfidën e përafrimit më të mirë të arsimit dhe formimit profesional (AFP) me nevojat e tregut të punës për të rritur punësueshmërinë e të diplomuarve, duke u ofruar atyre aftësitë që kërkohen. Gjithashtu, do të sigurojë nevojën për fuqi punëtore të kualifikuar që do t'i përgjigjet nevojave të ekonomisë për produktivitet më të lartë dhe rritje ekonomike. Për më tepër, do të trajtojë reduktimin e mospërputhjes së aftësive, duke mundësuar që të diplomuarit të kenë kualifikimet që kërkohen nga punëdhënësit, duke zvogëluar hendekun midis arsimit dhe punësimit.

Këto reforma do të përfshijnë krijimin e një sistemi arsimor dinamik që pajis nxënësit me aftësitë përkatëse dhe kompetencat e nevojshme digjitale për të lulëzuar në ekonominë globale, për të nxitur inovacionin dhe për të rritur konkurrencën kombëtare. Në kuadër të këtij prioriteti përvijohen iniciativa të ndryshme për të rritur efektivitetin e sistemit arsimor dhe për ta harmonizuar me kërkesat në zhvillim të tregut të punës. Së pari, sistemi i arsimit dhe formimit profesional (AFP) synohet të rishikohet për të përmbushur më mirë kërkesën për aftësitë e punës, me krijimin e Komiteteve shtesë Sektoriale të Aftësive, që kontribuojnë në përshtatjen e përmbajtjes së AFP-së dhe programeve të formimit.

Një tjetër reformë e rëndësishme do të konsistojë në përditësimin e kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm për të kapërcyer sfidat që lidhen me rezultatet e të nxënit, për t'u përshtatur më mirë me nevojat e tregut, për të promovuar të menduarit kritik dhe novacionin, si dhe për të siguruar përshtatshmëri më të mirë, duke i pajisur studentët me aftësi që përshtaten me ndryshimet e ardhshme në tregun e punës dhe shoqëri. Përditësimi i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm, do të përfshijë edhe futjen e sistemeve të reja të vlerësimit të performancës për mësuesit dhe zgjerimin e programeve të tilla si "Arti dhe zeje" në shkolla.

Një reformë tjetër e rëndësishme do të konsistojë në përditësimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për të krijuar një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të KK-së evropiane, duke lehtësuar njohjen e përvojave të mëparshme joformale dhe informale të të mësuarit. Kjo reformë do të trajtojë një sistem transparent dhe koherent për punëdhënësit dhe institucionet arsimore për të kuptuar kualifikimet e individëve, duke siguruar standarde të qëndrueshme. Ndërkaq do të harmonizojë sistemet kombëtare të arsimit dhe

formimit me standardet evropiane, duke mbështetur integrimin e Shqipërisë në BE. Për më tepër, do të adresojë një lëvizshmëri më të madhe brenda tregut evropian të punës, duke garantuar që kualifikimet të kuptohen dhe vlerësohen përtej kufijve.

Zhvillimi i aftësive dhe shprehive digjitale te të rinjtë është prioritet, me nisma që synojnë sigurimin e pajisjeve të TIK-ut për shkollat, prezantimin e lëndëve të TIK-ut në të gjitha klasat dhe rritjen e kapaciteteve të TIK-ut në institucionet e arsimit të lartë. Nëpërmjet këtyre masave, Shqipëria kërkon të rrisë bazën e saj të kapitalit njerëzor, të nxisë mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe t'i pajisë individët me aftësitë e nevojshme për sukses në ekonominë moderne.

Një reformë kyç lidhet me forcimin e efikasitetit të Skemës së Politikës së Papunësisë, e cila do të trajtojë papunësinë, duke rritur shërbimet mbështetëse për të përmirësuar efektivitetin e përputhjes së punës, trajnimit dhe shërbimeve mbështetëse, duke ndihmuar punëkërkuesit të fitojnë aftësitë e nevojshme për punët e disponueshme. Njëkohësisht, do të sigurojë që politikat e papunësisë të jenë më efikase, të cilat do t'i ndihmojnë individët të gjejnë punë më shpejt, duke ulur normat e përgjithshme të papunësisë. Në të njëjtën kohë, do të zvogëlojë ndikimin ekonomik të papunësisë duke siguruar riintegrim më të shpejtë të individëve të papunë në tregun e punës dhe do të ofrojë mbështetje më të shënjestruar për grupet e cenueshme, siç janë të papunët afatgjatë dhe individët me aftësi të ulëta.

Agjenda e Reformave do të përfshijë reforma për forcimin e mjedisit kombëtar të Kërkimit dhe Inovacionit (K&I) duke miratuar një kuadër strategjik aftësues, i cili do të rrisë kapacitetin për inovacion, duke sjellë produkte, shërbime dhe teknologji të reja. Do të adresojë sfidën e konkurrencës, duke e bërë vendin më konkurrues në shkallë globale dhe duke tërhequr investime dhe talent. Në të njëjtën kohë, do të adresojë mungesën e mbështetjes në lidhje me zhvillimin e sektorëve dhe industrive të reja, duke reduktuar varësinë nga aktivitetet ekonomike tradicionale dhe duke nxitur diversifikimin ekonomik. Gjithashtu, do të trajtojë nevojën për infrastrukturë më të shëndoshë kërkimore, duke inkurajuar përparimet shkencore dhe zhvillimin e njohurive e reja.

4.4 Parimi "nuk bën dëm të konsiderueshëm"

Rregullorja e Taksonomisë së BE-së është një kornizë që klasifikon aktivitetet ekonomike të shteteve anëtare, që janë të qëndrueshme nga ana mjedisore. Megjithëse Shqipëria nuk është një vend anëtar, dhe për rrjedhojë nuk e ka miratuar Rregulloren e Taksonomisë së BE-së, qeveria shqiptare po punon në mënyrë aktive për harmonizimin e politikave të saj me standardet e BE-së, veçanërisht në kuadrin e integrimit të saj më të gjerë evropian. Shqipëria po bën hapa përpara drejt përafrimit me politikat e BE-së për klimën dhe energjinë, përfshirë ato të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në kuadër të Agjendës së Reformave, Shqipëria do të përpiqet të mbrojë mjedisin veçanërisht nëpërmjet dekarbonizimit të sektorit të industrisë duke përmirësuar skemën MRVA dhe duke promovuar industritë me ndotje të ulët. Kjo do të mbrojë në mënyrë të tërthortë biodiversitetin pranë zonave industriale ose ku ndotja e tyre mund të ndikojë në biodiversitet. Ekziston një fushë e tërë politikash (nr. 4) për Energjinë/Tranzicionin e Gjelbër, që përfshin masa të cilat do të përshpejtojnë zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët, veçanërisht në lidhje me energjinë e rinovueshme, eficiencën energjetike dhe zbatimin e skemës ETS. Në përgjithësi, Agjenda e Reformave për Shqipërinë përputhet me objektivat më të gjerë të agjendës së gjelbër dhe mund të kontribuojë ndjeshëm në përshpejtimin e tranzicionit të vendit drejt një ekonomie më të qëndrueshme, më elastike dhe me karbon të ulët.

5. INTEGRIMI GJINOR

Agjenda Kombëtare e Reformave Shqiptare do të zbatohet sipas politikave të shëndosha dhe kuadrit ligjor, si dhe mekanizmave dhe instrumenteve që sigurojnë integrimin gjinor dhe mundësitë e barabarta.

Ekziston një kuadër i konsoliduar ligjor dhe i politikave për barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" parashikon bazat e nevojshme ligjore për të siguruar barazi gjinore. Aktualisht po fillon procesi i rishikimit të tij, për t'iu përgjigjur sfidave aktuale të barazisë gjinore në Shqipëri. Barazia gjinore është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE) dhe ndërhyrjet specifike kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), si dhe në Agjendën e OKB-së 2030. Në SKZHIE, vizioni i barazisë gjinore synon "një shoqëri që vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe politik të vendit, fuqizon të gjithë individët të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon askënd të lihet pas, si dhe

mbështetet në parimin e tolerancës zero ndaj praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ndëshkimit të autorëve dhe mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dhunuar". Për të ecur më tej, Qeveria e Shqipërisë ka miratuar "Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 (SKBGJ 2021–2030) dhe Planin e saj të Veprimit". Të gjitha ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë masa dhe planifikojnë vazhdimisht ndërhyrje për përmbushjen e objektivave të këtyre dy strategjive të rëndësishme, në bashkëpunim dhe me partnerë, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"[38] është i përafruar me aktet e BE-së nga aspekti juridik dhe i bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Miratimi i ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", i cili mundësoi krijimin e rrjetit të institucioneve përgjegjëse dhe të angazhuara në ofrimin dhe garantimin e shërbimeve juridike. Ligji u mundëson personave të cilëve u janë cenuar të drejtat nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, përfshirë diskriminimin me bazë gjinore, të përfitojnë ndihmë juridike falas nga shteti, pavarësisht nga gjendja e tyre financiare. Eliminimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave ka qenë në fokusin e nismave legjislative të miratuara nga shteti shqiptar duke i dhënë përparësi zbatimit të rekomandimeve të GREVIO ose të Komitetit CEDAW, të cilat kanë mundësuar miratimin e një sërë masave gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara për të luftuar dhunën në familje dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Rekomandimet në lidhje me përmirësimin e legjislacionit janë përmbushur nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në ligjin ekzistues kundër dhunës në familje, plotësimit të kuadrit nënligjor dhe ndryshimeve në Kodin Penal.

Qeveria shqiptare ka bërë progres të dukshëm në pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Indeksi i Barazisë Gjinore në vend, i publikuar për herë të parë në vitin 2020 sipas metodologjisë evropiane, e rendit Shqipërinë më mirë se mesatarja e anëtarëve të BE-së në fushën e pushtetit, ku zbatimi i kuotave gjinore ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të përfaqësimit të grave dhe vajzave në jetën politike dhe në vendimmarrje.

Numri i grave deputete në Kuvendin e Shqipërisë është rritur, nga 36 (29.5%) më 2019-n, në 50 (35.7%) më 2024-n. Në zgjedhjet parlamentare më 25 prill 2021 janë regjistruar 1841 kandidatë/kandidate (732 gra dhe 1109 burra) dhe janë zgjedhur 140 deputetë/deputete (50 gra dhe 90 burra). Kryetarja e Kuvendit është grua, e cila ka një nënkryetar dhe një nënkryetare; nga tetë komisione të përhershme gjithsej, katër ose 50% drejtohen nga gra; qeveria drejtohet nga një kryeministër, dhe ka një zëvendëskryeministre, si dhe përbëhet nga 17 ministra, 10 prej të cilëve janë gra. Qeveria vendore: Zgjedhjet vendore të vitit 2019 rezultuan me 8 kryetare bashkie nga gjithsej 61 bashki (ose 13%). Krahasuar me vitin 2016, kur kishte 6 kryetare bashkie ose 9,8%, vihet re një rritje prej 3,2%. Në zgjedhjet e pjesshme vendore të marsit 2022 u regjistruan gjithsej 19 kandidatë/kandidate për kryetar bashkie (3 gra dhe 16 burra) dhe në 6 bashkitë ku u mbajtën këto zgjedhje, rezultuan fitues 6 kryetarë/kryetare bashkie (2 gra dhe 4 burra). Gratë në këshillat bashkiakë përbëjnë rreth 44% të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Për sa i përket buxhetit me bazë gjinore, bazuar në ndryshimet e vitit 2016 të ligjit organik të buxhetit, barazia gjinore përbën një nga parimet thelbësore të sistemit buxhetor dhe udhëzimet standarde të buxhetit të nxjerra në baza vjetore përfshijnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, si pjesë e kritereve buxhetore të shtetit. Që nga viti 2019, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Menaxhimit Financiar (AFMIS) përfaqëson një mjet gjurmues për alokimet e buxhetit të përgjegjshëm gjinor dhe që nga viti 2022, projekt buxhetit i bashkëngjitet një deklaratë e buxhetit gjinor.

Fondet e buxhetit të shtetit gjatë këtyre pesë viteve kanë ardhur në rritje, ku përqindja e totalit të shpenzimeve buxhetore në programet buxhetore afatmesme (PBA) për çështjet gjinore është rritur nga 2.3% për PBA 2017–2019 në 9% për PBA 2022–2024, si dhe 10% për buxhetin e përgjegjshëm gjinor në tri vitet e fundit. Fondet buxhetore për BPGJ në PBA 2017–2019 rezultojnë në 90 milionë dollarë dhe 410 milionë dollarë për PBA 2022–2024.

Për herë të parë në vitin 2020, Sistemi i ri Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar mundësoi monitorimin e ekzekutimit të buxhetit dhe bëri të mundur përllogaritjen e vlerës së saktë të fondeve të

[38] Ligji nr. 124/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, 'Për mbrojtjen nga diskriminimi'".

BPGJ-së të shpenzuara nga institucionet qendrore. Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore gjithashtu ka krijuar mundësi për përfshirjen e efektshme të BPGJ-së në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi buxhetor vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV) kanë për detyrë të trajtojnë çështjet e pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore në të paktën një nga objektivat e politikave të programeve, duke identifikuar qartë produktet dhe treguesit gjinorë.

Shqipëria ka reflektuar aspektin e integrimit gjinor gjatë procesit të identifikimit dhe planifikimit të reformave brenda Agjendës së Reformave së Facilitetit të Rritjes dhe do të përpiqet ta bëjë këtë gjatë zbatimit të saj, duke garantuar, që përfitimet e këtyre reformave të ndahen në mënyrë të barabartë midis grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

5.1 Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta në shtyllën e kapitalit njerëzor

Disa reforma të parashikuara pritet të kontribuojnë në përmirësimin e barazisë gjinore. Në fushën e politikave të kapitalit njerëzor, ne do të punojmë drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës përmes masave dhe programeve aktive të tregut të punës. Fokusi do t'i kushtohet nxitjes së punësimit të vajzave të reja, veçanërisht të atyre që nuk janë në arsim, punësim, formim profesional (NEEVT), përmes zbatimit të programeve përkatëse për pjesëmarrjen në tregun e punës dhe skemat e adresimit të papunësisë.

Brenda fushës së kapitalit njerëzor, reformat do të drejtohen për nga sigurimi i aksesit dhe mundësive të barabarta në fëmijërinë e hershme dhe për arsimin e detyrueshëm, duke përfshirë sigurimin e mjeteve digjitale, TIK-ut dhe formimit profesional, me fokus të veçantë në adresimin e nevojave të grupeve të cenueshme përmes masave aktive në tregun e punës. Reforma e kurrikulës së arsimit parashkollor bazohet edhe në barazinë gjinore, diversitetin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve të kësaj grup-moshe. Rishikimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca në arsimin fillor dhe të mesëm do të konsideronte dhe do të siguronte kornizën për të përvetësuar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, mbështetjen e kulturës së paqes dhe jo dhunës, qytetarisë globale, vlerësimin e diversitetit të kulturave dhe kontributin që jep kultura për zhvillimin e qëndrueshëm. Agjenda e Reformave përfshin kompetenca dhe arsimim digjital, duke marrë në konsideratë dhe duke përfshirë aftësitë digjitale për gratë dhe vajzat, të cilat do të ndihmojnë në rritjen e arsimit dhe zhvillimit profesional. Ngushtimi i ndarjes digjitale mes vajzave dhe djemve do të konsiderohet edhe në masat që lidhen me aftësitë e TIK-ut në arsim.

Duke miratuar dhe zbatuar Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA), qeveria do të gjenerojë më shumë të ardhura, të cilat mund të alokohen drejt programeve dhe shërbimeve që përfitojnë gratë dhe vajzat, si arsimi, kujdesi shëndetësor dhe mirëqenia sociale.

Politikat e qarta për përdorimin e tokës do t'i fuqizojnë gratë duke siguruar që të drejtat e tyre pronësore njihen dhe mbrohen. Gratë që zotërojnë tokë ose pasuri mund të kenë pavarësi më të madhe ekonomike dhe fuqi vendimmarrëse brenda familjeve të tyre.

Përmirësimi i klimës së investimeve mund të krijojë më shumë mundësi për gratë sipërmarrëse dhe pronare biznesi që të kenë akses në financim dhe të rrisin bizneset e tyre. Krijimi i një mjedisi mbështetës për bizneset inovatore, veçanërisht ato që janë në përputhje me agjendën e gjelbër dhe digjitale, do të sjellë mundësi për gratë sipërmarrëse. Sigurimi i mbështetjes dhe burimeve përkatëse financiare do të ndihmojë bizneset në pronësi të grave të lulëzojnë në sektorët në zhvillim, duke rritur pavarësinë e tyre ekonomike dhe kontributin në ekonomi.

Krahas kësaj, Agjenda e Reformave do të promovojë në mënyrë aktive të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, reformat në fushën e politikave të kapitalit njerëzor do të synojnë përmirësime në jetën e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet masave të përshtatura aktive të tregut të punës.

5.2 Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta në shtyllën e klimës së biznesit

Pjesëmarrja e grave në biznes është rritur gjatë dekadës së fundit dhe 31.2 për qind e bizneseve në vend ose drejtohen ose zotërohen nga gratë. Megjithatë, shumica e ndërmarrjeve të grave janë biznese të vogla me kapital të pamjaftueshëm dhe norma të ulëta fitimi (për shembull, në prodhim dhe bujqësi). Pjesëmarrja aktive e grave në zhvillimin e sektorit privat duhet të rritet, veçanërisht për gratë në zonat rurale, dhe ndikimi i sjelljeve dhe normave diskriminuese gjinore është i pranishëm në të gjitha nivelet.

Në fushën e politikave të zhvillimit të sektorit privat dhe mjedisit të biznesit, ne do të punojmë drejt përmirësimit të aksesit të grave në financa përmes skemave të granteve dhe duke mbështetur drejtpërdrejt NVM-të dhe bizneset fillestare në pronësi të grave.

5.3 Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta në shtyllën e tranzicionit digjital dhe të gjelbër

Tranzicioni drejt energjisë së gjelbër do t'i japë përparësi mbështetjes për grupet e cenueshme nëpërmjet një metodologjie për të përcaktuar grupet e varfra në energji dhe instrumentet e monitorimit. Nga ana tjetër, do të ndërmerren masat e eficiencës energjetike që synojnë familjet e cenueshme nga energjia duke miratuar planin e veprimit për adresimin e varfërisë energjetike, duke përfshirë përcaktimin e masave që synojnë të ndihmojnë familjet me energji të varfër dhe konsumatorët e cenueshëm.

Në përputhje me praktikat e BE-së dhe me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit, kuadri ligjor dhe rregullator që rregullon lidhjen digjitale, ligjin e komunikimit elektronik dhe planin kombëtar të brezit të gjerë siguron akses në shërbime të barabarta mbi baza të barabarta. Shqipëria synon të zhvillojë më tej infrastrukturën e saj digjitale, rrjetet dhe shërbimet e ardhshme të bazuara në rrjete komunikimi të hapura, globale, ndërvepruese, të besueshme dhe të sigurta. Këto rrjete mbështesin të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe drejtësinë. Konkretisht, përfshirja gjinore brenda këtij sektori është forcuar nga dispozitat e ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon mundësi dhe akses të barabartë për të gjitha gjinitë, duke garantuar që askush të mos mbetet pas në transformimin digjital.

5.4 Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta në shtyllën e Parimeve Themelore dhe Shtetit të së Drejtës

Agjenda e Reformave përfshin masa dhe veprime që konsolidojnë, mbrojnë dhe promovojnë më tej të drejtat themelore të njeriut për të gjithë individët, përfshirë gratë dhe vajzat. Masat për zbatimin e reformave në fushën e Shtetit të së Drejtës dhe Demokracisë, të Drejtave Themelore dhe të Shoqërisë Civile, përfshijnë veprime në lidhje me rritjen e lirisë së shprehjes në përputhje me standardet evropiane, promovimin e transparencës dhe rritjen e aksesit në informimin e qytetarëve, rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike etj.

Agjenda e Reformave përputhet me një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, duke u fokusuar në disa fusha të politikave për përmirësimin e të drejtave të bazuara te qytetari. Konkretisht, për sa iu përket të drejtave themelore dhe shtetit të së drejtës, do të bëhen përpjekje për të rritur aksesin e qytetarëve në një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kjo përfshin nismat për reduktimin e çështjeve të prapambetura, përshpejtimin e zgjidhjes së çështjeve, veçanërisht atyre që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe sigurimin e llogaridhënies dhe efikasitetit më të madh në sistemin gjyqësor. Në fushën e reformës dhe digjitalizimit të administratës publike, do të ndërmerren hapa për të mbështetur të drejtën e qytetarëve për miradministrim.

Duke përafruar programet e arsimit dhe formimit profesional (AFP) me aftësitë e kërkuara nga tregu i punës, gratë dhe vajzat do të kenë akses në trajnime në fusha me kërkesa të larta, duke çuar në përmirësimin e perspektivave të punës dhe fuqizimin ekonomik. Përmirësimi i efikasitetit të politikave të papunësisë do të sigurojë mbështetje më të mirë për gratë që janë të papuna ose që kërkojnë punësim. Aksesi në programet e trajnimit, shërbimet e punësimit dhe ndihma financiare do t'i fuqizojë gratë që të rihyjnë në fuqinë punëtore ose ndërrojnë karrierë.

Duke i pajisur shkollat dhe universitetet publike me infrastrukturë të përshtatshme TIK-u dhe duke promovuar aftësitë digjitale te të rinjtë, duke përfshirë të rejat, gratë dhe vajzat, do të fitojnë aftësi thelbësore për ekonominë digjitale. Kjo i fuqizon të ndjekin karriera në fusha të lidhura me teknologjinë dhe të marrin pjesë plotësisht në fuqinë punëtore digjitale, duke mbyllur hendeqet gjinore në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë).

Gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë shpërpjesëtimore nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, çka mund të përkeqësojë pabarazitë dhe të kufizojë aksesin në mundësi. Forcimi i përpjekjeve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe sigurimi i kuadrit institucional në lidhje me luftën kundër drogës, do të krijojë një mjedis më të sigurt dhe më të barabartë për suksesin e grave dhe vajzave, duke reduktuar barrierat në arsim, punësim dhe pjesëmarrje në jetë publike. Krahas kësaj, do të kontribuojë në krijimin e mjediseve më të sigurta dhe më të shëndetshme ku gratë dhe vajzat mund të ndjekin qëllimet dhe aspiratat e tyre pa frikë apo intimidim.

Me krijimin e Zyrës për Rikuperimin e Aseteve, gratë dhe vajzat mund të përfitojnë nga zbatimi i përmirësuar i ligjeve kundër krimeve financiare. Asetet e rikuperuara mund të riinvestohen në programe dhe shërbime sociale nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt gratë dhe vajzat, si: arsimi, kujdesi shëndetësor dhe mbështetja për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu, pastrimi i parave shpesh lehtëson aktivitetet kriminale që dëmtojnë gratë dhe vajzat, si trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore. Parandalimi dhe lufta kundër pastrimit të parave do të rrisë ndërprerjen e këtyre rrjeteve kriminale, do të mbrojë popullatat e cenueshme dhe do të sigurojë që burimet të shpërndahen për qëllime legjitime dhe të dobishme, duke përfshirë programet që mbështesin fuqizimin e grave.

Një sistem gjyqësor i drejtë dhe transparent është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave dhe mbajtjen përgjegjës së autorëve të dhunës dhe diskriminimit me bazë gjinore. Duke konsoliduar pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit, këto masa do të sigurojnë që gratë dhe vajzat të kenë akses në drejtësi dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë sipas ligjit. Liria e shprehjes është thelbësore për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Duke rritur lirinë e shprehjes në përputhje me standardet evropiane, gratë dhe vajzat do të ushtrojnë më mirë të drejtat e tyre për të shprehur opinionet e tyre, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë më mirë në diskursin publik pa frikë nga censura apo hakmarrja. Kjo sigurisht që do të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe demokratike ku gratë dhe vajzat vlerësohen dhe respektohen.

5.5 Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta gjatë zbatimit të Agjendës së Reformave

Gjatë zbatimit të Agjendës së Reformave, do të sigurohet bashkëpunimi me aktorët përkatës që janë të përfshirë në procesin e zbatimit dhe se përfitimet e reformave të tilla në aspektin e rritjes ndahen në mënyrë të barabartë midis grupeve të synuara që u përkasin të dy gjinive dhe/ose proporcionalisht me nevojat e tyre. Kjo praktikë e mirë ka filluar tashmë gjatë konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që merren me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në fund të marsit dhe majit 2024. Vështrimet dhe ekspertiza e tyre analitike e sjellë nga disa prej OSHC-ve më aktive që merren me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave do të jenë të dobishme në përgatitjet e zbatimit të këtyre reformave. Ky proces largpamës do të përfshijë gjithashtu monitorim të vazhdueshëm nga OSHC-të që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, duke synuar sigurimin e integrimit efektiv gjinor përgjatë këtij procesi ambicioz të reformës.

Agjenda e Reformave përfshin nisma specifike që trajtojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë fuqizimin e grave dhe vajzave. Kjo përfshin promovimin e aksesit të barabartë në punësim, arsim dhe aftësi, mundësi ekonomike etj. Masat e përshkruara në Agjendën Kombëtare të Reformave Shqiptare kanë potencialin të ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e grave dhe vajzave në disa mënyra.

5.6 Përshpejtimi dhe kontributi në Agjendën e Gjelbër

Agjenda e Reformave ka potencialin të kontribuojë ndjeshëm në përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër në përputhje me Agjendën e Gjelbër 2020 për Ballkanin Perëndimor. Ka disa reforma që mund të përforcojnë mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit, zbutjen e ndryshimeve klimatike, reziliencën klimatike, reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët. Reformat në lidhje me fushën e politikave të tranzicionit në energji të gjelbër përfshijnë masa që do të përshpejtojnë zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët, veçanërisht atë që lidhet me energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë dhe vendosjen e skemës ETS në fuqi deri në vitin 2030, duke:

- Mundësuar lidhjen e tregut të energjisë elektrike ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë dhe krijimin e një tregu të energjisë elektrike brenda ditës, reformat do të nxisin integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në rrjet. Kjo lehtëson kalimin në një ekonomi me karbon të ulët duke rritur pjesën e energjisë së rinovueshme në përzierjen e energjisë dhe duke reduktuar varësinë nga lëndët djegëse.

- Rregullimet graduale të tarifave me çmimet e tregut, të cilat mund të nxisin eficiencën dhe ruajtjen e energjisë, ndërkohë që sigurojnë përballueshmërinë për familjet e cenueshme. Duke trajtuar varfërinë energjetike, reformat promovojnë barazinë sociale dhe qëndrueshmërinë duke nxitur përqafimin e zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme.

- Një plan veprimi transparent dhe konkurrues për energjinë e rinovueshme ofron qartësi dhe siguri për investitorët, duke nxitur investimet në projektet e energjisë së rinovueshme. Kjo përshpejton shpërndarjen e infrastrukturës së energjisë së rinovueshme, duke kontribuar në reduktimin e çlirimit të gazeve serrë dhe diversifikimin e përzierjes së energjisë.

- Çmimi i karbonit, i cili nxit reduktimin e emetimeve dhe nxit investimet në teknologji dhe praktika me karbon të ulët. Duke u fokusuar në paketën e Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA), Shqipëria mund të harmonizojë mekanizmat e saj të çmimit të karbonit me standardet e BE-së, duke lehtësuar reduktimin e emetimeve dhe duke nxitur investimet në nismat miqësore me klimën, do të përpiqet të mbrojë mjedisin në Shqipëri, veçanërisht nëpërmjet dekarbonizimit të sektorit të industrisë, duke përmirësuar skemën MRVA dhe duke promovuar industritë me ndotje të ulët. Kjo do të mbrojë në mënyrë të tërthortë biodiversitetin pranë zonave industriale ose ku ndotja e tyre mund të ndikojë në biodiversitet.

- Strategjitë afatgjata të rinovimit të ndërtesave dhe skemat e eficiencës së energjisë nxisin kursimin e energjisë, reduktojnë çlirimin e gazeve serrë nga ndërtesat dhe rrisin qëndrueshmërinë ndaj klimës. Këto reforma kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike, përmirësimin e rehatisë në ambientet e brendshme dhe reduktimin e kostove të energjisë për familjet dhe bizneset.

-Zbatimi i MRVA-së (Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi) duke miratuar ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për t'u përafruar me acquis-në e BE-së për MRVA-në mund të kontribuojë ndjeshëm në përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër në përputhje me Agjendën e Gjelbër 2020 për Ballkanin Perëndimor.

Zbatimi i MRVA-së përfshin monitorimin dhe raportimin mbi emetimet e gazeve serrë dhe tregues të tjerë mjedisorë. Duke u përafruar me standardet dhe *acquis* së BE-së, Shqipëria do të forcojë masat e saj për mbrojtjen e mjedisit dhe do të sigurojë ruajtjen më të mirë të biodiversitetit nëpërmjet mbledhjes dhe raportimit më të saktë të të dhënave. Kjo mund të çojë në politikëbërje më të informuar dhe përpjekje të synuara për ruajtjen. MRVA-ja lehtëson gjurmimin e çlirimit të gazeve serrë, çka është thelbësore për strategjitë efektive të zbutjes së ndryshimeve klimatike. Duke miratuar MRVA-në dhe duke u përafruar me standardet e BE-së, Shqipëria do të rrisë gjithashtu aftësinë e saj për të monitoruar dhe për të menaxhuar emetimet, për të identifikuar fushat për përmirësim dhe për të zbatuar masa për të reduktuar çlirimin e karbonit. Kjo kontribuon drejtpërdrejt në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke ndihmuar Shqipërinë të vendosë dhe të arrijë objektiva ambiciozë për reduktimin e emetimeve. Monitorimi dhe raportimi i saktë i të dhënave mjedisore, duke përfshirë treguesit e lidhur me klimën, do të përmirësojë aftësinë e Shqipërisë për të vlerësuar dhe për t'iu përgjigjur ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Duke ndërtuar gatishmërinë institucionale dhe të tregut për zbatimin e MRVA-së, Shqipëria do të forcojë qëndrueshmërinë e saj ndaj ndryshimeve klimatike duke kuptuar më mirë dobësitë dhe duke zbatuar masat e përshtatjes. Për më tepër, MRVA-ja do të kontribuojë në reduktimin e riskut nga fatkeqësitë duke ofruar sisteme të paralajmërimit të hershëm dhe instrumente vendimmarrëse të bazuara në të dhëna për të zbutur ndikimet e fatkeqësive të lidhura me klimën. Zbatimi i MRVA-së kërkon miratimin e masave për monitorimin dhe reduktimin e çlirimit të gazeve serrë, çka është thelbësore për kalimin në një ekonomi me karbon të ulët.

Duke u përafruar me standardet e BE-së për MRVA-në dhe duke ndërtuar gatishmërinë institucionale dhe të tregut, Shqipëria do të krijojë një mjedis më të favorshëm për investime në energjinë e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe teknologjitë e tjera me karbon të ulët. Kjo do të stimulojë rritjen ekonomike, do të krijojë vende pune të gjelbra dhe do të nxisë inovacionin duke reduktuar varësinë nga lëndët djegëse dhe duke kontribuar në përpjekjet e përgjithshme për dekarbonizimin. Si përmbledhje, zbatimi i MRVA-së, duke miratuar ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për t'u përafruar me *acquis-in e* BE-së për MRVA-në, mund të çojë përpara agjendën e tranzicionit të gjelbër të Shqipërisë duke përforcuar mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët.

Në përgjithësi, Agjenda e Reformave përfshin hapa kritikë për arritjen e objektivave të përcaktuar në Agjendën e Gjelbër 2020 për Ballkanin Perëndimor, avancimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe kalimin drejt një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme.

PJESA 2: PËRSHKRIMI I FUSHAVE TË POLITIKËS DHE REFORMAVE PËRKATËSE

Ky seksion i Agjendës së Reformave përfshin një prezantim gjithëpërfshirës të masave (hapat cilësorë dhe sasiorë) që Shqipëria do të zbatojë gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje në përputhje me specifikimet dhe afatet e detajuara në shtojcën I të Agjendës së Reformave.

Kalendari i zbatimit të masave të planifikuara përcaktohet për periudha gjashtëmujore, duke filluar më 31 dhjetor 2024 dhe duke përfunduar më 31 dhjetor 2027. Sipas Rregullores (BE) 2024/1449, data përfundimtare e zbatimit, 31 dhjetor 2027, për përmbushjen e kushteve të pagesës në lidhje me grupin përfundimtar të masave, përfshin kohën e nevojshme që Komisioni të vlerësojë përmbushjen me sukses të kushteve të pagesës në fjalë dhe miratimin e mëvonshëm të vendimit për livrim nga Komisioni. Prandaj, siç parashikohet në nenin 13(1), pikën (i) të Rregullores (BE) 2024/1449, Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa cilësorë dhe sasiorë të rënë dakord deri më 31 gusht 2027, si datën më të vonë, dhe të paraqesë një kërkesë të justifikuar siç duhet për lëvrimin e fondeve në lidhje me kushtet e përmbushura të pagesës për këta hapa sasiorë dhe cilësorë, pa vonesë.

Në bazë të nenit 21(5) të Rregullores (BE) 2024/1449, në rast se Komisioni e ka vlerësuar negativisht përmbushjen e kushteve të pagesës, Shqipëria mund të marrë masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse brenda një periudhe 12 mujore nga vlerësimi fillestar negativ, referuar nenit 21(4) të Rregullores (BE) 2024/1449. Gjatë vitit të parë të zbatimit, konsiderohet një afat prej 24 muajsh, i llogaritur nga vlerësimi fillestar negativ. Në çdo rast, siç përcaktohet në nenin 21(6) të Rregullores (BE) 2024/1449, çdo shumë që korrespondon me kushtet e pagesës, që nuk janë përmbushur deri më 31 dhjetor 2028, nuk do t'i kërkohet Shqipërisë.

6. FUSHA E POLITIKËS 1: PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT

1.1. KLIMA E BIZNESIT

R – 1.1.1 Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe e sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA)

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) luan rol kyç në rritjen e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe përmirësimin e sistemit tatimor. Qëllimi kryesor është të adresojë mangësitë dhe joefikasitetin në mbledhjen e të ardhurave përmes një qasjeje të koordinuar dhe strategjike. SAA ofron një kuadër gjithëpërfshirës për zbatimin e reformave tatimore, duke harmonizuar politikën tatimore, administrimin dhe reformat ligjore me objektivat e zhvillimit të vendit, dhe duke krijuar një plan koherent dhe afatgjatë për rritjen e të ardhurave.

Drafti i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që nga viti 2019 me asistencën e FMN-së. Zbatimi i draftstrategjisë u shty nga viti 2020 në vitin 2022 për shkak të pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, situatës së pandemisë së COVID-19 dhe pasojave ekonomike të konfliktit Rusi-Ukrainë.

Që nga janari 2022, Shqipëria ka zbatuar në mënyrë efektive disa reforma kryesore fiskale pas zbatimit të draftit të SAA-së 2022–2026, duke arritur etapa të rëndësishme. Draftstrategjia është konsultuar për një periudhë të gjatë kohore me të gjithë aktorët përkatës. Këto reforma përfshijnë futjen e ndryshimeve në paketën fiskale për 2022-n, 2023-n dhe 2024-n, duke përfshirë rritjen e akcizave sipas rekomandimit të FMN-së. Ligji për tatimin mbi të ardhurat, i miratuar në vitin 2023, vendosi norma tatimore progresive për bizneset e vogla dhe ruajti tatimin progresiv mbi të ardhurat. Përmirësimet në sistemin fiskal, nëpërmjet faturimit elektronik, rritën ndjeshëm të ardhurat nga TVSH-ja.

Ministria e Financave ka planifikuar rishikimin e draftstrategjisë dhe zbatimin e masave të reja fiskale gjatë viteve 2025–2027, kryesisht në fushën e administrimit tatimor, nëpërmjet reduktimit të informalitetit, rritjes së vetëdeklarimit dhe menaxhimit më të mirë të riskut për industritë që janë në rritje, si turizmi, akomodimi, ndërtimet etj. Strategjia e rishikuar e SAA-së, e cila do të diskutohet dhe mbështetet nga asistenca teknike e FMN-së, është planifikuar të miratohet brenda vitit 2024.

Një nga objektivat kryesorë të SAA-së është rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme (MAB), e cila është kritike për qëndrueshmërinë fiskale dhe financimin e shërbimeve publike dhe programeve të zhvillimit. Pas miratimit të strategjisë, brenda qershorit 2025, mund të bëhet vlerësimi i të gjitha përjashtimeve tatimore për të vendosur mbi heqjen graduale të ndonjërës prej tyre, dhe për të vendosur nëse përdorimi i grupeve të të dhënave nga palët e treta mundëson hetime të pasurive të pajustifikuara.

Qeveria është e angazhuar të zbatojë SAA-në, dhe të gjitha masat e saj. Një nga shtyllat e SAA-së do të përfshijë përmirësimin dhe konsolidimin e administratës tatimore, me masat e saj përkatëse. Një nga masat e shtyllës për përmirësimin, konsolidimin dhe administrimin tatimor përfshin përdorimin e të dhënave nga palët e treta, si përdorimi i të dhënave në lidhje me shërbimet utilitare (energji, ujë) dhe regjistrimi i automjeteve, për të mundësuar zbatimin e programit të administrimit tatimor të hetimeve të

aseteve të pajustifikuara për pasuritë e tatimpaguesve, brenda dhjetorit 2026. Në këtë drejtim, do të kryhet edhe analiza e të dhënave nga deklaratat e DIVA-s brenda dhjetorit 2024.

Një masë tjetër e rëndësishme që lidhet me Shtyllën e SAA-së për përmirësimin dhe konsolidimin e administratës tatimore, pjesë e SAA-së dhe si e tillë do të zbatohet, përfshin plotësimin e regjistrit të pasurive së tatimpaguesve për 10% të tatimpaguesve brenda dhjetorit 2026. Janë 128.000 tatimpagues aktivë dhe pritet të ketë një regjistër për 10%, ose afërsisht për 12.800 tatimpagues.

Një tjetër masë e rëndësishme në lidhje me përmirësimin e administrimit tatimor të SAA-së, që do të zbatohet në kuadër të Agjendës së Reformave, përfshin kryerjen e procedurave të kontrollit për 200 tatimpagues të përzgjedhur, bazuar në vlerësimin e riskut, brenda dhjetorit 2026. Në këtë aspekt, për sa u përket tatimpaguesve të përzgjedhur për procedurat e kontrollit, këta janë individë që do të kontrollohen, dhe do të përzgjidhen prej tyre 100 individë nga tatimpaguesit më të pasur, ndërsa 100 do të përzgjidhen në bazë të informacionit për individët edhe nga palët e treta, si regjistrimi i automjeteve, energjia, uji.

Një masë e rëndësishme në lidhje me përmirësimin e administrimit tatimor të SAA-së, që do të zbatohet në kuadër të Agjendës së Reformave, përfshin rritjen e nivelit të plotësimit paraprak të TVSH-së dhe kthimeve të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga Fiskalizimi) në 100%. Për sa i përket plotësimit paraprak, kjo pritet të zbatohet në 38.000 deklarata TVSH-je dhe rreth 73.000 deklarata individuale mbi të ardhurat personale, ose zbatim në masën 100%. Brenda dhjetorit 2026, do të hartohen dhe zbatohen deklarata të reja për kthimet e tatimit mbi të ardhurat personale.

Administrata tatimore do të forcojë ecurinë e hetimeve kundër mashtrimit tatimor, si një nga masat në lidhje me përmirësimin e administratës tatimore, si shtyllë në SAA, e cila do të zbatohet në kuadër të Agjendës së Reformave. Brenda qershorit 2027, do të kryhen të paktën 500 analiza hetimore kumulative. Këto analiza janë kontrolle hetimore të kryera nga strukturat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor që trajtojnë fenomene si: pastrim parash, krijim skemash mashtrimi me TVSH-në, fshehje të ardhurash, evazion fiskal, punësim të paligjshëm dhe falsifikim dokumentesh etj. Për të ulur incidencën e korrupsionit në administratën tatimore, brenda qershorit 2025, do të hartohet dhe miratohet Plani i Integritetit.

Tabela 1: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA)

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Përmirësimi i efikasitetit dhe sistemit efektiv të taksave, duke rritur të ardhurat e qeverisë dhe duke promovuar qëndrueshmërinë fiskale.	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) e përditësuar dhe e miratuar **(dhjetor 2024)**, duke përfshirë (ndër të tjera) një masë për një vlerësim të të gjitha përjashtimeve tatimore, me synim vendimmarrjen për heqjen graduale të përjashtimeve, si edhe për mundësimin e përdorimit të të dhënave nga palë të treta për hetimin e pasurive të pajustifikuara (**qershor 2025**). Përfshirja në SAA dhe zbatimi i masave për përmirësimin e administrimit tatimor, si përdorimi i të dhënave nga palët e treta (energjia elektrike, uji, regjistrimi i automjeteve), për të mundësuar programin e administratës tatimore mbi hetime të pasurive të pajustifikuara të aseteve të tatimpaguesve **(dhjetor 2026);** plotësimi i regjistrit të pasurive të tatimpaguesve me 10% të tatimpaguesve të regjistruar **(dhjetor 2026);** rritja e plotësimit paraprak të deklaratave të TVSH-së dhe deklaratave të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga fiskalizimi) (**dhjetor 2026**); forcimi i performancës së hetimeve kundër mashtrimit tatimor (**qershor 2027).**	1.1.1 Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe e sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA).

Plani i zbatimit dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
R.1.1.1. - Rritja e mobilizimit të të ardhurave të			**Ministria e Financave**

brendshme dhe e sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA).			**(MF)**
Hapi 1 - Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) e përditësuar dhe e miratuar **(dhjetor 2024)**, duke përfshirë (ndër të tjera) një masë për një vlerësim të të gjitha përjashtimeve tatimore, me synim vendimmarrjen për heqjen graduale të përjashtimeve, si edhe për mundësimin e përdorimit të të dhënave nga palë të treta për hetimin e pasurive të pajustifikuara (**qershor 2025**). - Përgatitja e përmbledhjes së SAA-së dhe e analizave të mangësive në SAA (qershor 2024). - Hartimi dhe konsultimi i dokumentit të SAA-së (shtator 2024). - Miratimi i SAA-së nga Këshilli i Ministrave deri në (dhjetor 2024). - Përgatitja e një raporti analize mbi vlerësimin e të gjitha përjashtimeve tatimore për të përcaktuar nëse ndonjë prej tyre mund të hiqet gradualisht, dhe për të vendosur nëse është i mundur përdorimi i grupeve të të dhënave nga palët e treta që mundësojnë hetime të pasurive të pajustifikuara (qershor 2025).	(dhjetor 2024) (qershor 2025)	Statusi i SAA-së: nuk ka VKM në fuqi VKM ekzistuese	MF Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Hapi 2 - Përfshirja në SAA dhe zbatimi i masave për përmirësimin e administrimit tatimor, si përdorimi i të dhënave nga palët e treta (energjia elektrike, uji, regjistrimi i automjeteve), për të mundësuar programin e administratës tatimore mbi hetime të pasurive të pajustifikuara të aseteve të tatimpaguesve (dhjetor 2026); plotësimi i regjistrit të pasurive të tatimpaguesve me 10% të tatimpaguesve të regjistruar (dhjetor 2026); rritja e plotësimit paraprak të deklaratave të TVSH-së dhe deklaratave të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga fiskalizimi) (dhjetor 2026); forcimi i performancës së hetimeve kundër mashtrimit tatimor (qershor 2027). ● Kryerja e analizës së të dhënave nga deklaratat e DIVA-s (dhjetor 2024). - Përdorimi i të dhënave nga regjistri i shoqërive utilitare (energji elektrike, ujë) regjistrimi i automjeteve, bashkive për të mundësuar programin e administratës tatimore të hetimeve të pasurive të pajustifikuara mbi pasuritë e tatimpaguesve (dhjetor 2026). - Administrata tatimore plotëson regjistrin e pasurive të tatimpaguesve për 10% të tatimpaguesve (dhjetor 2026). - Kryerja e procedurave të kontrollit për 200 tatimpaguesit e përzgjedhur, bazuar në vlerësimin e riskut (dhjetor 2026). - Plotësimi paraprak i deklaratave të TVSH-së dhe kthimeve të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga fiskalizimi) në masën 100% (dhjetor 2026). - Hartimi dhe zbatimi i deklaratave të reja për kthimet e tatimit mbi të ardhurat personale (dhjetor 2026). - Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit (qershor 2025). - Kryerja e të paktën 500 analizave hetimore, bazuar	(dhjetor 2026) (dhjetor 2026) (dhjetor 2026) (qershor 2027)	Lista e individëve të audituar Gjendja e regjistrit për pasuritë e tatimpaguesve: 0% Statusi ekzistues i deklaratave të plotësuara paraprakisht të TVSH-së dhe kthimeve të tatimit mbi të ardhurat personale: Në mars 2023, u zbatua plotësimi dhe dorëzimi automatik i librave të shitjeve, proces i cili ka rezultuar i suksesshëm. Jemi në fazat fillestare të plotësimit paraprak të deklaratës së TVSH-së. Për sa i përket pasqyrës së të ardhurave personale DIVA, jemi në pritje të hartimit dhe zbatimit të pasqyrave të reja tatimore të përcaktuara në ligjin e ri "Për tatimin mbi të ardhurat" nr. 29/2023.	MF Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

në planet vjetore (qershor 2027).		Numri ekzistues i hetimeve: 193 raste në vitin 2023	

R - 1.1.2 Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës

Në Shqipëri, konteksti aktual lidhur me politikën e tokës dhe shërbimet e kadastrës pasqyron një kuadër kompleks të karakterizuar nga sfida historike dhe përpjekje të vazhdueshme reformuese. Historikisht, Shqipëria është përballur me çështje që lidhen me pronësinë informale të tokës, sistemet e kaluara në kohë dhe joefikasitetin burokratik, duke krijuar pengesa për investimet dhe duke penguar zhvillimin ekonomik.

Duke njohur nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse, Shqipëria ka nisur një rrugëtim për modernizimin e politikës së tokës dhe shërbimeve kadastrale. Gjatë viteve të fundit, ka pasur një përpjekje të përbashkët për të adresuar këto sfida dhe për të krijuar një mjedis më transparent, më efikas dhe më miqësor për investimet. Kjo përpjekje nxitet nga të kuptuarit se një kuadër i fuqishëm i rregullimit të tokës është thelbësor për tërheqjen e investimeve, nxitjen e rritjes ekonomike dhe sigurimin e aksesit të barabartë në burimet e tokës.

Pavarësisht progresit të bërë në vitet e fundit, vazhdon të ketë sfida të rëndësishme. Kalimi nga sistemet kadastrale në letër në ato digjitale ka qenë gradual dhe procesi i digjitalizimit po vazhdon ende në shumë fusha. Për më tepër, çështje të tilla si mosmarrëveshjet për tokën, pretendimet për mbivendosje dhe infrastruktura e pamjaftueshme, paraqesin sfida të vazhdueshme për menaxhimin efektiv të tokës.

Në përgjithësi, ndërkohë që Shqipëria ka bërë hapa përpara në modernizimin e politikës së saj të tokës dhe shërbimeve të kadastrës, rrugëtimi drejt rregullimit efektiv të tokës është në vazhdim. Duke i trajtuar drejtpërdrejt sfidat ekzistuese dhe duke zbatuar reformat e synuara, Shqipëria mund të zhbllokojë potencialin e plotë të saj dhe të hapë rrugën për zhvillimin dhe prosperitetin e qëndrueshëm ekonomik. Për më tepër, fokusi në reformat e politikës së tokës është një element tjetër i rëndësishëm për përmirësimin e mjedisit të investimeve në Shqipëri. Duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shërbimet e kadastrës shtetërore dhe politika të qarta për përdorimin e tokës, qeveria kërkon të trajtojë një nga shqetësimet kryesore për investitorët: pronësinë e tokës dhe aksesin në tokë. Miratimi i Udhërrëfyesit gjithëpërfshirës për proceset e digjitalizimit, përfshirë digjitalizimin e titujve dhe hartave të pronësisë kadastrale, pasqyron angazhim për përmirësimin e administrimit të tokës dhe lehtësimin e të drejtave pronësore. Për më tepër, krijimi i një Plani Integriteti me masa të fuqishme kundër korrupsionit nxjerr në pah angazhimin për të siguruar kushte të barabarta për investitorët dhe për të promovuar praktikat etike të punës. Miratimi i Planit të Integritetit do të demonstrojë më së miri ecurinë e zbatimit që rezulton në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve, për shërbime si; regjistrimi i titujve të pronësisë, regjistrimi i të drejtave reale dhe detyrimeve mbi pronën, lëshimi i certifikatave të ndryshme etj., nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Këto masa do të përfshihen në Planin e Integritetit, i cili do të monitorohet çdo vit.

Përballë këtyre sfidave, Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin e saj për avancimin e përpjekjeve për reformën e tokës dhe hartimin e politikave të qarta për përdorimin e tokës, duke demonstruar një qasje proaktive për adresimin e çështjeve të vjetra.

Miratimi i një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të siguruar planifikimin e politikës së digjitalizimit dhe proceseve përkatëse për kadastrën shënon një kalim të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës dhe efikasitetit në shërbimet shtetërore të kadastrës. Digjitalizimi fuqizon qytetarët dhe bizneset me akses të lehtë në informacionin dhe shërbimet e pronave përmes platformave digjitale, duke eliminuar nevojën për vizita fizike në zyrat e kadastrës dhe duke reduktuar në këtë mënyrë asimetrinë e informacionit. Kjo hapje e shtuar jo vetëm që nxit besimin, duke minimizuar hapësirën për informacione të fshehura ose të pasakta, por gjithashtu mundëson auditim dhe verifikim më të lehtë të të dhënave digjitale.

Për sa i përket eficiencës, miratimi i Udhërrëfyesit drejton ndërhyrjet, duke reduktuar vonesat burokratike dhe duke u mundësuar sistemeve digjitale të menaxhojnë njëkohësisht një vëllim më të madh transaksionesh. Automatizimi i detyrave rutinë, rrit më tej efikasitetin, duke liruar burimet njerëzore, duke i lejuar punonjësit e kadastrës t'i kushtojnë kohën e tyre adresimit të çështjeve më komplekse dhe përmirësimit të shërbimit ndaj klientit. Për më tepër, menaxhimi i të dhënave digjitale redukton ndjeshëm

gjasat për gabime ose mospërputhje, duke siguruar një rrjedhë pune më të qetë dhe më efikase në përgjithësi.

Krijimi i një grupi pune ndërinstitucional për miratimin e një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për finalizimin e proceseve të digjitalizimit do të përcaktojë qasjen strategjike, do të sigurojë financimin e nevojshëm dhe do të vendosë afate kohore për përfundimin me sukses të nismës së digjitalizimit.

Arritja e përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar rrit më tej transparencën dhe efikasitetin. Kjo siguron që të gjitha pronat t'i nënshtrohen një procesi të standardizuar dhe të plotë regjistrimi, duke reduktuar

- 34% (1,3 mln) kartela të përfunduara (dhjetor 2024);
- 14% (0,56 mln) kartela të përfunduara (qershor 2025);
- 14% (0,56 mln) kartela të përfunduara (dhjetor 2025);
- 14% (0,56 mln) kartela të përfunduara (qershor 2026).

mospërputhjet dhe duke nxitur besimin e publikut. Përmirësimi i procesit të regjistrimit fillestar përmirëson efikasitetin, duke reduktuar vonesat administrative dhe duke minimizuar gabimet, duke lejuar kadastrën të japë përgjigje më të shpejta ndaj kërkesave dhe të përshpejtojë transaksionet e pronës.

Territori i Shqipërisë është i ndarë në 3058 zona kadastrale. Për 2763 zona kadastrale (ose 90% të totalit të zonave kadastrale), procesi i regjistrimit fillestar ka përfunduar dhe për 295 zona kadastrale nuk ka përfunduar ende procesi i regjistrimit fillestar dhe gjendja për këto të fundit paraqitet si më poshtë:

- për 45 zona kadastrale, procesi i regjistrimit fillestar është në vazhdim dhe pritet të përfundojë me afatet e shpjeguara në Hapin 1 të AR.
- nga 250 zonat kadastrale ku nuk ka filluar procesi i regjistrimit fillestar, për 108 zona kadastrale pritet të përfundojë me afatin e shpjeguar në hapin 1.

Prandaj, 95% e numrit të përgjithshëm (numri total është 3058 zona kadastrale), pritet të përfundojë deri në qershor 2026, dhe përqindja e zonave kadastrale të mbetura të papërfunduara deri atëherë do të jetë më pak se 5% nga 142 zonat kadastrale të mbetura të papërfunduara.

Duhet theksuar se në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, titujt e pronësisë, pasi administrohen, regjistrohen në regjistrin kadastral. Regjistri kadastral përbëhet nga kartelat e pasurisë, që përmbajnë informacione kyçe të pronës, si numri i zonës kadastrale, emri i zonës kadastrale, numri i pronës, indeksi i hartës, pronari i pronës, numri i aktit të blerjes, vlera e pronës, numri referencë lidhur me titullin e pronës të depozituar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, dhe çdo të drejtë, detyrim dhe kufizim mbi pronën. Ky regjistër kadastral, i përbërë nga kartela e pasurive të paluajtshme, është duke u digjitalizuar, dhe të gjithë titujt e pronësisë të depozituara manualisht janë duke u skanuar.

Ka përfunduar regjistrimi i parë i pronave të paluajtshme për 2,763 zona kadastrale, të cilat përbëjnë 90% të të gjitha zonave kadastrale në Republikën e Shqipërisë. Deri në qershor 2026, do të përfundojnë 95% e zonave kadastrale që mbulojnë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për ato zona kadastrale, ku ka përfunduar regjistrimi fillestar, po bëhet digjitalizimi i kartelave të pronave dhe skanimi i titujve të pronësisë. Kjo është e nevojshme, sepse një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit për këto zona kadastrale është përgatitur manualisht dhe titujt e pronësisë depozitohen fizikisht në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Duhet theksuar se regjistrimi fillestar në Republikën e Shqipërisë ka filluar në vitin 1994.

Ka gjithsej 4,076,000 kartela, dhe në bazën e të dhënave të ASHK-së deri më 31 maj 2024 janë përfshirë 2,703,935 kartela digjitale[39], por nga ky numër, vetëm 1,000,000 kartela digjitale (24%) janë plotësisht të digjitalizuara, dhe numri i mbetur prej 1,703,935 kartelave (42%) do të ridigjitalizohen, sepse gjatë viteve janë bërë transaksione të reja manuale, por nuk janë pasqyruar në këto kartela ekzistuese të digjitalizuara.

Nevojitet digjitalizimi i 1,372,065 kartelave shtesë (34%), të cilat ende nuk i janë nënshtruar procesit të digjitalizimit. Prandaj, janë gjithsej 3,076,000 kartela (76%), të cilat pritet të përfundojnë në afatet e shpjeguara në hapin 2 të AR-së.

[39] Sipas ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.2.2016) në nenin 2, pika 6, jepet përkufizimi i mëposhtëm: "Kartelë" është fleta e volumit të regjistrit që mbahet për çdo pasuri të paluajtshme.". Me fjalë të tjera, "kartelë" është një faqe nga vëllimi i regjistrit që mbahet për çdo pjesë të pasurisë së paluajtshme.

Me kryerjen e regjistrimit fillestar në 95% të të gjitha zonave kadastrale, digjitalizimin e të gjitha kartelave dhe hartave të pasurive të paluajtshme në letër dhe digjitalizimin e të gjitha proceseve të ASHK-së, qëllimi kryesor është të arrihet reduktimi i vonesave kohore të shërbimeve kadastrale, rritja e efikasitetit, ofrimi i shërbimeve nga Agjencia e Kadastrës, duke marrë masa kundër korrupsionit dhe mitëmarrjes.

Një fokus tjetër i Agjendës së Reformave do të jetë miratimi i Planit të Integritetit të Kadastrës, me masa të konsoliduara kundër korrupsionit. Plani i Integritetit do të përgatitet përmes një qasjeje me pjesëmarrje, duke përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile, dhomës së avokatisë, dhomës së noterëve, bankave dhe shoqatave të biznesit etj., dhe do të pasqyrojë plotësisht komentet e palëve të interesuara. Plani i Integritetit do të monitorohet që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie në ofrimin e shërbimeve të kadastrës dhe të demonstrohet ecuria e mirë e zbatimit, duke rezultuar në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve.

Për më tepër, palët e interesit, si agjentët e pasurive të paluajtshme dhe avokatët, përfitojnë nga proceset e thjeshtuara, duke i lejuar ata t'u shërbejnë klientëve në mënyrë më efektive. Në përgjithësi, këto përmirësime kontribuojnë për një ekonomi të konsoliduar, qarkullim më të lehtë të pronës dhe përmirësim të praktikave profesionale, duke i pozicionuar shërbimet kadastrale si mundësues të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale.

Tabela 2: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve shtetërore të kadastrës, për investitorët dhe qytetarët, dhe ofrimi i politikës së qartë për përdorimin e tokës

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Kontributi për një sistem më transparent, efikas dhe të përgjegjshëm mbi të drejtat pronësore, duke promovuar zhvillimin ekonomik, investimet dhe stabilitetin social.	Regjistrimi fillestar është kryer në 95% të të gjitha zonave kadastrale **(qershor 2026).** Digjitalizimi i të gjithë kartelave manuale të pasurive të paluajtshme ka përfunduar dhe digjitalizimi përparon, në përputhje me Udhërrëfyesin gjithëpërfshirës, për të arritur rezultate të prekshme me përfundimin e proceseve të digjitalizimit, të miratuar deri në qershor 2025 **(qershor 2026).** Miratimi i një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të arritur rezultate të prekshme për përfundimin e proceseve të digjitalizimit, me qëllim që titujt e mëparshëm të pronësisë, të administruara fizikisht në zyrë, për pasuritë e paluajtshme dhe hartat kadastrale në të gjitha zonat kadastrale të digjitalizohen, duke i dhënë përparësi zonave me rëndësi ekonomike, dhe që regjistrimi fillestar të përfundojë plotësisht (**qershor 2025).** Miratimi i një politike mbi tokën dhe masat e nevojshme administrative, buxhetore dhe koordinuese për fillimin e zbatimit të saj, në vitin 2028 **(qershor 2027**). Miratimi i një plani integriteti **(dhjetor 2025)**, duke përfshirë masa të efektshme antikorrupsion që reflektojnë mendimin e palëve të interesuara (përfaqësues të shoqërisë civile, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, shoqatave përfaqësuese të sistemit bankar dhe shoqatave të biznesit etj.), me synimin për të përmirësuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve dhe treguar rezultate në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve, për shërbimet si regjistrimi i titujve të pronësisë, regjistrimi i të drejtave reale mbi pronën apo regjistrimi i detyrimeve, lëshimi i vërtetimeve të ndryshme, të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës **(dhjetor 2027).**	**1.1.2** Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R.1.1.2 - Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët, dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës			**Ministria e Drejtësisë (MD)**
Hapi 1 – Regjistrimi fillestar është kryer në 95% të të gjitha zonave kadastrale **(qershor 2026).** - 30 zona kadastrale të përfunduara (dhjetor 2024) - 15 zona kadastrale të përfunduara (qershor 2025) - 108 zona kadastrale të përfunduara (qershor 2026)	(qershor 2026)	90%	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
Hapi 2 - Digjitalizimi i të gjithë kartelave manuale të pasurive të paluajtshme ka përfunduar dhe digjitalizimi përparon, në përputhje me Udhërrëfyesin gjithëpërfshirës, për të arritur rezultate të prekshme me përfundimin e proceseve të digjitalizimit, të miratuar deri në qershor 2025 **(qershor 2026).** - 34% e kartelave të përfunduara (dhjetor 2024) - 14% kartela të përfunduara (qershor 2025); - 14% kartela të përfunduara (dhjetor 2025); - 14% 0,56 mln kartela të përfunduara (qershor 2026).	(qershor 2026)	24%	ASHK
Hapi 3 – Miratimi i një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të arritur rezultate të prekshme për përfundimin e proceseve të digjitalizimit, me qëllim që titujt e mëparshëm të pronësisë, të administruara fizikisht në zyrë, për pasuritë e paluajtshme dhe hartat kadastrale në të gjitha zonat kadastrale të digjitalizohen, duke i dhënë përparësi zonave me rëndësi ekonomike, dhe që regjistrimi fillestar të përfundojë plotësisht (**qershor 2025).** - Vlerësimi i nevojave për infrastrukturë dhe teknologji, si dhe shpërndarja e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare - Hartimi i një udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për digjitalizimin e të gjitha shërbimeve dhe hartave kadastrale në letër (qershor 2025). - Hartimi i një plani financimi për udhërrëfyesin (qershor 2025).	(qershor 2025)	Nuk ekziston një udhërrëfyes për proceset e digjitalizimit	ASHK/ Komiteti Ndërministror
Hapi 4 - Miratimi i një politike mbi tokën dhe masat e nevojshme administrative, buxhetore dhe koordinuese për fillimin e zbatimit të saj, në vitin 2028 **(qershor 2027**). - Rishikimi i bazës ligjore për urdhrin e KM-së për Komitetin Ndërministror për Politikën e Tokës. - Përgatitja e një skice mbi politikën e tokës. - Hartimi i dokumentit të Politikës së Tokës dhe konsultimi me grupet e interesit dhe palët e treta. - Miratimi i dokumentit të politikës së tokës. - Përgatitja e metodologjisë për monitorimin e politikës së tokës. - Paketa e marrëveshjeve të zbatimit të projektimit (qershor 2027).	(qershor 2027)	Nuk ka politikë të tokës në fuqi	Komiteti Ndërministror
Hapi 5 - Miratimi i një plani integriteti **(dhjetor 2025)**, duke përfshirë masa të efektshme antikorrupsion që reflektojnë mendimin e palëve të interesuara (përfaqësues të shoqërisë civile, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, shoqatave përfaqësuese të sistemit bankar dhe shoqatave të biznesit etj.), me synimin për të përmirësuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve dhe treguar rezultate në përmirësim të ndjeshëm të cilësisë, transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve, për shërbimet si regjistrimi i titujve të pronësisë, regjistrimi i të drejtave reale mbi pronën apo regjistrimi i detyrimeve, lëshimi i vërtetimeve të ndryshme, të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës **(dhjetor 2027).**	(dhjetor 2025) (dhjetor 2027)	Nuk ka plan integriteti Nuk ka zbatim të Planit të Integritetit	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MSHAPA)

- Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Punës. - Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Riskut. - Hartimi i Planit të Veprimit për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, bazuar në Dokumentin e Vlerësimit të Riskut. - Miratimi i Planit të Integritetit (dhjetor 2025). - Krijimi i një organi monitorues *ad hoc* për të vlerësuar zbatimin e Planit.			

R - 1.1.3 Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikat e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore

- Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve:

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm vitet e fundit për të rritur transparencën e investimeve. Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, përputhja me praktikat e BE-së, përfshin një kombinim të harmonizimit rregullator, stimujve, reformave të qeverisjes, masave të transparencës dhe përdorimit strategjik të burimeve publike. Këto masa synojnë krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime, sigurimin e menaxhimit të përgjegjshëm të aseteve publike dhe nxitjen e rritjes ekonomike.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të rritur tërheqjen dhe transparencën e investimeve në përputhje me praktikat e BE-së, duke pasur parasysh rëndësinë e transparencës në tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja. Miratimi i një ligji për Partneritetin Publik-Privat (PPP) të përafruar me standardet e BE-së, deri në qershor 2025, dhe krijimi i një kuadri për një strukturë të dedikuar të ndihmës shtetërore tregojnë angazhimin e Shqipërisë për të nxitur një mjedis të favorshëm për investime. Këto masa synojnë të thjeshtojnë proceset e investimeve, të sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe të ofrojnë qartësi në rregulloret e ndihmës shtetërore, duke lehtësuar kështu proceset e vendimmarrjes për investime.

Megjithëse është bërë progres, mbeten sfida në lidhje me objektivat e përshkruar në Planin e Rritjes. Duke i dhënë përparësi transparencës dhe integritetit në politikat dhe praktikat e investimeve, Shqipëria është e gatshme të zhbllokojë potencialin e saj të plotë ekonomik dhe të tërheqë investime të qëndrueshme që nxisin rritjen dhe zhvillimin gjithëpërfshirës.

Shqipëria ka një sistem gjithëpërfshirës të prokurimit elektronik (SPE), i cili ka rritur transparencën, ka lehtësuar aksesin, procedurat e thjeshtuara, ka reduktuar kostot e transaksionit dhe ka përmirësuar mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave. Në përgjithësi, sistemi i prokurimit ka një nivel të lartë përafrimi me *acquis* të BE-së. Megjithatë, sfida mbetet rritja e efikasitetit në prokurimet publike dhe intensifikimi i përpjekjeve për të rritur pjesëmarrjen në prokurimet publike, pasi numri mesatar i ofertuesve mbetet i ulët për procedurat që tejkalojnë pragjet e BE-së, dhe në vitin 2021, një e pesta e të gjitha kontratave u dhanë pas një procesi që përfshiu vetëm një ofertë. Për më tepër, pjesëmarrja e ofertuesve të huaj do të ishte e ulët. Në fushën e koncesioneve/PPP-ve, si kërkesë ligjore, analiza e vlerës për paratë duhet të kryhet sistematikisht përpara miratimit të të gjitha PPP-ve.

Siç thuhet edhe në Raportin e Shqyrtimit Analitik (*screening*) të Grup-kapitullit të Parë për Shqipërinë, përafrimi shtesë me ligjet e BE-së është i nevojshëm në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik-privat (PPP). Aktualisht, ligji për koncesionet dhe ligji për partneritetit publik-privat (PPP), së bashku me rregulloret e tyre përkatëse, janë vetëm pjesërisht në sinkron me *acquis* të BE-së. Për të arritur harmonizimin e plotë, parashikohet një ligj i ri, i cili do të trajtojë disa fusha kyçe, me fokus aspektet ligjore të koncesioneve dhe PPP-ve. Gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime në drejtim të forcimit të monitorimit të shoqërive me pronësi shtetërore (SHPSH)[40], përmes zgjerimit të monitorimit të SHPSH-ve, duke përfshirë Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe ndërmarrjet e tjera shtetërore që mund të kenë ndikim buxhetor. Për më tepër, me bashkënënshkrimin e urdhrit të përbashkët[41] të MIE dhe MF, kryhet mbledhje mujore informacioni në lidhje me raportimin dhe shlyerjen e detyrimeve reciproke që shoqëritë me pronësi shtetërore të sektorit të energjisë kanë me njëra-tjetrën dhe me subjektet e tjera shtetërore (Ujësjellësi, DPT etj.), modalitetet që përfshihen në udhëzimin buxhetor shtesë të ministrit të Financave.

[40] Draftstrategjia e MFP-së 2023–2027.

[41] Urdhri i përbashkët nr. 304, datë 17.12.2020, "Për miratimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike" dhe urdhër i përbashkët i MIE-së dhe MF-së nr. 379, datë 30.9.2021, "Për zbatimin e planit të masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike".

Një sfidë tjetër është përfshirja e PPP-ve në Listën Kombëtare Unike të Projekteve (NSPP), e cila është një instrument që është pjesë e menaxhimit të investimeve publike. Lista Kombëtare Unike e Projekteve (NSPP) është përgatitur nga SASPAC[42] dhe miratuar me VKM, dhe siguron një parakusht që projektet të përfshihen në ciklin e investimeve publike. Integrimi i PPP-ve në Listën Kombëtare Unike të Projekteve (NSPP), siguron që projektet të kenë prioritet dhe të përafrohen me objektivat më të gjerë të zhvillimit ekonomik dhe social. Gjithashtu, integrimi efektiv çon në shpërndarje më të mirë të burimeve, duke reduktuar tepricat dhe duke siguruar që projektet të kontribuojnë në prioritetet kombëtare.

- **Përmirësimi i rregullimit të ndihmës shtetërore:**

Rregullimi i ndihmës shtetërore në Shqipëri është i strukturuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh aspiratat e vendit për integrim në BE. Kuadri rregullator për ndihmën shtetërore në Shqipëri rregullohet kryesisht nga ligji për ndihmën shtetërore, i cili është në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji për ndihmën shtetërore, i miratuar në vitin 2014 dhe i ndryshuar më pas, ofron bazën për kontrollin e ndihmës shtetërore në Shqipëri. Ai përcakton parimet dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore dhe synon të sigurojë që një ndihmë e tillë të mos deformojë konkurrencën dhe tregtinë brenda vendit dhe me BE-në.

Organi kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore në Shqipëri është Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH).[43] KNSH-ja është autoriteti vendimmarrës që zbaton rregullat e ndihmës shtetërore në vend dhe që monitoron dhe siguron pajtueshmërinë me rregulloret e ndihmës shtetërore. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit luan rol të rëndësishëm në administrimin dhe koordinimin e politikave të ndihmës shtetërore. KNSH-ja është përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e masave të ndihmës shtetërore të propozuara nga autoritetet publike. Ajo siguron që këto masa të jenë në përputhje me ligjin për ndihmën shtetërore dhe udhëzimet e BE-së. Raportimi i rregullt dhe transparenca janë komponentë thelbësorë. KNSH-ja publikon raporte vjetore mbi ndihmën shtetërore të dhënë, duke ofruar detaje mbi llojet dhe shumat e ndihmës dhe përputhshmërinë e tyre me rregulloret kombëtare dhe të BE-së.

Politika e ndihmës shtetërore e Shqipërisë po përafrohet në mënyrë progresive me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Kjo përfshin miratimin e udhëzimeve dhe praktikave të BE-së për të siguruar që ndihma shtetërore të mos ndikojë negativisht në konkurrencën brenda tregut të vetëm të BE-së. Përafrimi përfshin gjithashtu futjen graduale të skemave të pajtueshme me BE-në dhe heqjen graduale të ndihmës së papajtueshme.

Një nga sfidat kryesore në rregullimin e ndihmës shtetërore në Shqipëri është sigurimi i zbatimit të qëndrueshëm dhe efektiv të kuadrit ligjor. Reformat po zbatohen në vazhdimësi për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin e kontrollit të ndihmës shtetërore, në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Sigurimi i një Autoriteti të pavarur operativ të ndihmës shtetërore është element thelbësor për krijimin e një klime të favorshme për bizneset, për rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike dhe sigurimin e menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve publike. Po bëhen përpjekje për të vlerësuar strukturën teknike përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore. Objektivi ynë është krijimi i pavarësisë së komisionit dhe strukturës së sekretariatit që do të mbështesë komisionin në çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën shtetërore, si dhe të përcaktohet kuadri që do të sigurojë këtë pavarësi. Autoriteti i Ndihmës Shtetërore do të konsiderohet plotësisht funksional me marrjen e mandatit të tij, duke arritur plotësimin me staf dhe duke siguruar një buxhet të pavarur. Vendosja e modalitetit optimal të ndihmës shtetërore do të përmirësojë politikëbërjen shtetërore, duke siguruar një konkurrencë të shëndetshme dhe transparente në treg në dobi të bizneseve dhe zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.

Në qershor 2024, u përgatit një vlerësim fillestar dhe po vazhdohet me vlerësimin për opsionet optimale, ku do të bëhet vlerësimi i mëtejshëm i nivelit politik, edhe nga BE-ja, dhe parashikohet që në shtator t'i paraqitet qeverisë dhe të finalizohet një alternativë e miratuar brenda dhjetorit 2024. Në varësi

[42] Miratuar me VKM nr. 447, datë 26.7.2023, "Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2024–2026".

[43] Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, kryesuar nga ministri përgjegjës për ekonominë. Anëtarët e tjerë emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, ministrit përgjegjës për Integrimin Evropian, ministrit të Drejtësisë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

të opsionit të zgjedhur, do të jenë të qarta ndryshimet rregullatore dhe masat e tjera që do të zbatohen për të siguruar pavarësinë e plotë të Ndihmës Shtetërore dhe për të përmirësuar qeverisjen e saj. Gjithashtu, në varësi të alternativës së zgjedhur, do të punohet për angazhimet buxhetore në lidhje me versionin e miratuar.

- Përmirësimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe qeverisjes:

Shoqëritë me pronësi shtetërore (SHPSH) janë aktorë të rëndësishëm ekonomikë dhe mund të rrisin aktivitetin ekonomik dhe konkurrueshmërinë nëse sigurohen rregulla të barabarta loje me shoqëritë private. SHPSH-të në Shqipëri operojnë në një mënyrë kryesisht të decentralizuar nën përgjegjësinë e disa ministrive. Për sa u përket kushteve të barabarta me shoqëritë private, SHPSH-të në Shqipëri janë themeluar sipas ligjit për shoqëritë, në përputhje me praktikat e mira.

Një direktivë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me përbërjen dhe kualifikimet e bordeve mbikëqyrëse të shoqërive aksionere shtetërore, e miratuar në prill të vitit 2022, përcakton, se të gjitha shoqëritë aksionere shtetërore duhet të kenë borde drejtuese, dhe, se përgjegjësitë për emërimin e anëtarëve të tyre ndahen ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ministrive përkatëse sektoriale, në përputhje me procesin e përshkruar më sipër. Direktiva përcakton disa kritere minimale të kualifikimeve, për shembull ato që u kërkojnë kandidatëve të bordit të kenë të paktën pesë vjet përvojë profesionale dhe i ndalon individët që kanë konflikt interesi, siç përcaktohet në një ligj të posaçëm për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Për shumicën e SHPSH-ve, vendet e lira të bordit nuk janë konkurruese ose të hapura për publikun. Përkundër pranisë së këtyre kërkesave minimale, ekziston sfida që në praktikë procesi i emërimit në bordin e SHPSH-ve të jetë transparent. Në këtë aspekt, mbetet si mundësi forcimi i procesit të emërimit të bordeve, në mënyrë që të sigurohet që bordet e SHPSH-ve të kenë një numër të mjaftueshëm profesionistësh të kualifikuar, përmes procedurave të hapura dhe të bazuara në merita, që do të forconin efikasitetin e korporatës.

Në këtë aspekt, do të ndërmerren disa hapa në kuadër të Agjendës së Reformave. Së pari, do të përcaktohen udhëzime të qarta, transparente dhe të bazuara në merita për emërimin e anëtarëve të bordit. Këto udhëzime do të përputhen me praktikat dhe standardet më të mira të BE-së për emërimet në bord. Bazuar në udhëzimet e reja, do të rishikohen dhe ndryshohen aktet ekzistuese ligjore dhe rregulloret që rregullojnë SHPSH-të për të përfshirë procedurat e reja të emërimit. Qëllimi është të sigurohen procedura të hapura, transparente dhe të bazuara në merita për përzgjedhjen e anëtarëve të pavarur të bordit të SHPSH-ve, të cilat do të kontribuojnë për qeverisje më profesionale, transparente dhe efektive të SHPSH-ve, duke rritur rolin e tyre në ekonomi dhe duke u përafruar me rregullat më të gjera dhe standardet konkurruese.

Gjithashtu, do të bëhet vlerësimi i pavarësisë së ndihmës shtetërore dhe vlerësimi i modeleve dhe propozimeve për politikëbërje dhe vendimmarrje për opsionin optimal dhe fillimin e punës për miratimin e kuadrit ligjor. Analiza e kryer e të gjitha SHPSH-ve do të shqyrtojë performancën e SHPSH-ve, në mënyrë që të vlerësojë dhe klasifikojë SHPSH-të bazuar në matricat e performancës për të identifikuar "performuesit e lartë" dhe "performuesit e ulët". "Performuesit e ulët" mund të përjashtohen nga grupi i SHPSH-ve që i nënshtrohen reformës në bordin e anëtarëve, pasi "performuesit e ulët" mund të vlerësohen se do t'u nënshtrohen vendimeve për zhvillimin e procedurave të likuidimit. Shoqëritë që janë në proces likuidimi tashmë janë deklaruar si të tilla dhe qëllimi i administrimit të tyre është thjesht menaxhimi i shitjeve të aseteve dhe jo menaxhimi i interesave tregtare. Gjithashtu, analiza do të sigurojë identifikimin e shoqërive që kanë funksione strategjike, në fushat që lidhen me sovranitetin shtetëror dhe sigurinë kombëtare etj. Në këtë drejtim, SHPSH-të me funksione strategjike mund të vlerësohen si jo të përshtatshme për t'iu nënshtruar procedurave të reja. Procedurat e ndjekura nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (MEKI) për kalimin e një shoqërie në likuidim:

- Objekti i aktivitetit bëhet i parealizueshëm (kur për arsye të ndryshme bëhet i pamundur vazhdimi i aktivitetit).
- Nëse, si rezultat i humbjeve të shkaktuara, kapitali i vetë shoqërisë është më i ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar.
- Në rastet kur përfundon kohëzgjatja për të cilën është krijuar.
- Dhe në raste të tjera të parashikuara me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtinë dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ose statutin e secilës shoqëri.

Rregulloret e përditësuara dhe të miratuara do të zbatohen për SHPSH-të e kualifikuara, për të pasur anëtarë të pavarur të bordit përmes një procedure të hapur, transparente dhe të bazuar në meritë.

Tabela 3: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikat e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritjet
Kontribuon për një klimë më të favorshme investimi, shpërndarje efikase të burimeve dhe përmirësim të qeverisjes, duke nxitur përfundimisht zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik.	Miratimi i ligjit mbi PPP-të/koncesionet në përputhje me *Acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian (qershor 2025) dhe PPP/koncesionet fillojnë të integrohen plotësisht në Listën Unike Kombëtare të Projekteve (dhjetor 2025). Miratimi i kuadrit ligjor për të siguruar një Autoritet, me pavarësi operacionale, të Ndihmës Shtetërore dhe i masave operacionale përkatëse (buxheti) (dhjetor 2025). Të sigurohet që të gjithë anëtarët e rinj të bordeve të SHPSH[44]-ve emërohen përmes procedurave transparente dhe të bazuara në merita (dhjetor 2024) dhe ndryshimi i rregullimeve përkatëse për të përfshirë rregulla për emërimin e anëtarëve të bordeve të SHPSH-ve, përmes proceseve të rekrutimit të hapura dhe të bazuara në merita (qershor 2025). Zgjerimi i kritereve për anëtarë të pavarur të bordeve të SHPSH-ve, përmes procedurave të hapura dhe të bazuara në merita, aplikohet "kudo ku është e mundur" (d.m.th., për të gjithë ato SHPSH, të cilat nuk klasifikohen me "performancë të ulët" etj., pas një analize fizibiliteti) **(dhjetor 2026).**	1.1.3 Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikat e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R.1.1.3 - Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikat e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Hapi 1 - Miratimi i ligjit mbi PPP[45]/koncesionet në përputhje me Acquis dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian **(qershor 2025)** dhe PPP/koncesionet fillojnë të integrohen plotësisht në Listën Unike Kombëtare të Projekteve (**dhjetor 2025**).	(qershor 2025) (dhjetor 2025)	Legjislacioni ekzistues PPP/Koncesione jo plotësisht të integruara në NSPP	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) & Ministria e Financave (MF)
Hapi 2 - Miratimi i kuadrit ligjor për të siguruar një Autoritet, me pavarësi operacionale, të Ndihmës Shtetërore dhe i masave operacionale përkatëse (buxheti) **(dhjetor 2025).**	(dhjetor 2025)	Nuk ka bazë ligjore për një Autoritet të pavarur operativ të Ndihmës Shtetërore	(MEKI)
Hapi 3 – Të sigurohet që të gjithë anëtarët e rinj të bordeve të SHPSH[46]-ve emërohen përmes procedurave transparente dhe të bazuara në merita **(dhjetor 2024)** dhe ndryshimi i rregullimeve përkatëse për të përfshirë	dhjetor 2024 qershor 2025	Statusi i procedurave ekzistuese për emërimin e anëtarëve të	(MEKI)

[44] SHPSH – shoqëri në pronësi shtetërore.
[45] Partnertiteti publik privat.
[46] SHPSH – shoqëri në pronësi shtetërore.

rregulla për emërimin e anëtarëve të bordeve të SHPSH-ve, përmes proceseve të rekrutimit të hapura dhe të bazuara në merita (**qershor 2025**). Zgjerimi i kritereve për anëtarë të pavarur të bordeve të SHPSH-ve, përmes procedurave të hapura dhe të bazuara në merita, aplikohet "kudo ku është e mundur" (d.m.th., për të gjithë ato SHPSH, të cilat nuk klasifikohen me "performancë të ulët" etj., pas një analize fizibiliteti) **(dhjetor 2026).**	dhjetor 2026	bordeve Rregulloret ekzistuese	

R - 1.1.4 Përmirësimi i kuadrit të tërheqjes së investimeve dhe në veçanti i kuadrit të IHD-ve dhe i mjedisit të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit

Shqipëria e ka njohur prej kohësh rëndësinë e promovimit të eksportit dhe ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve si shtytësit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Gjatë disa viteve të fundit, janë zbatuar masa të ndryshme për të lehtësuar eksportet, për të rritur tregtinë dhe për të mbështetur ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare në të gjithë sektorët me potencial rritjeje, veçanërisht në tregun e vetëm të BE-së. Ky angazhim nënvizohet nga fokusi strategjik i vendit për përmirësimin e klimës së biznesit, duke përfshirë miratimin e politikave gjithëpërfshirëse të tokës që synojnë të garantojnë transparencë dhe efikasitet në përdorimin e tokës.

Konteksti ekzistues i kuadrit të tërheqjes së investimeve të Shqipërisë, veçanërisht për sa i përket kuadrit të investimeve të huaja direkte (IHD) dhe klimës së biznesit, pasqyron një përpjekje të bashkërenduar për të përmirësuar rregulloret, për të modernizuar shërbimet e biznesit dhe për të rritur transparencën për tërheqje të më shumë investime të huaja. Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka nisur një sërë reformash që synojnë krijimin e një mjedisi më të favorshëm për investitorët, përafrimin me standardet e BE-së dhe nxitjen e rritjes ekonomike.

I miratuar në vitin 2021, BIDS-i dhe plani i tij i veprimit ofrojnë një kuadër gjithëpërfshirës për rritjen ekonomike afatmesme të Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në avancimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME) dhe investimeve. Strategjia përshkruan vizionin për një ekonomi shqiptare konkurruese, të nxitur nga inovacioni dhe njohuritë, duke krijuar vende të reja dhe të përmirësuara pune përmes shfrytëzimit të transformimit digjital dhe ndryshimeve në zinxhirin global të vlerave, me theks në zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin evropian dhe rajonal.

Për sa u përket investimeve, BIDS thekson shtimin e masave për promovimin dhe lehtësimin e investimeve specifike që synojnë grupe të ndryshme, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Një aspekt kyç i strategjisë është një program zhvillimi i furnizuesve që synon rritjen e sofistikimit të SME-ve vendore, duke i ndihmuar ato të konkurrojnë në mënyrë më efektive dhe të integrohen në zinxhirët e furnizimit global dhe rajonal të investitorëve të huaj.

Duke pranuar rolin jetik të bizneseve fillestare në nxitjen e një ekonomie të drejtuar nga inovacioni dhe njohuritë, BIDS synon gjithashtu të krijojë një mjedis mbështetës biznesi, lidhur me ligjin e vitit 2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve" dhe programin e BE-së për inovacionin. Vëmendje e veçantë u kushtohet grave sipërmarrëse dhe bizneseve fillestare që ofrojnë zgjidhje apo produkte/shërbime digjitale që kontribuojnë në ekonominë e gjelbër dhe qarkulluese.

Po bëhen përpjekje për të finalizuar një draftstrategji të Specializimit Inteligjent (S3), një proces që po vazhdon që nga viti 2016. S3 është parashikuar si një mjet i ri për të rritur inovacionin dhe për të stimuluar zhvillimin rajonal, i mbështetur nga BE-ja dhe i miratuar nga secila prej ekonomive të BB6 dhe Turqisë. Qasja S3 synon të kontribuojë në agjendën ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, duke identifikuar fushat prioritare ku investimet publike në kërkim, zhvillim dhe inovacion mund të kenë ndikimin më të madh. Draftstrategjia është aktualisht në proces konsultimi dhe pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2024.

Një aspekt i rëndësishëm i kuadrit të tërheqjes së investimeve të Shqipërisë është modernizimi i shërbimeve të biznesit nëpërmjet iniciativave të derregullimit dhe digjitalizimit. Vendi e ka njohur rëndësinë e reduktimit të pengesave burokratike dhe përmirësimit të lehtësisë së të bërit biznes për të tërhequr investitorët e huaj. Iniciativa të tilla si miratimi i ligjeve të investimeve, thjeshtimi i procedurave administrative për bizneset dhe zbatimi i platformave të qeverisjes elektronike kanë qenë komponentët

kryesorë të kësaj përpjekjeje modernizimi. Këto masa synojnë të thjeshtojnë proceset, të rrisin transparencën dhe të reduktojnë burokracinë, duke krijuar kështu një mjedis më të favorshëm për investime dhe aktivitet ekonomik.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e tërheqjes së investimeve dhe klimës së biznesit. Megjithatë, sfida të tilla si inercia burokratike, kufizimet e kapaciteteve etj., mbeten pengesa që duhet të adresohen. Ecja përpara, përpjekjet e vazhdueshme për zbatimin e reformave, forcimi i institucioneve dhe rritja e qeverisjes ekonomike do të jenë vendimtare në konsolidimin e pozicionit të Shqipërisë si një destinacion tërheqës për investimet e huaja.

Agjenda e Reformave ka prioritet zhvillimin e programeve dhe nismave për nxitjen e eksporteve për të lehtësuar ndërkombëtarizimin e sipërmarrjeve shqiptare. Këto përpjekje përfshijnë miratimin e programeve të nxitjes dhe lehtësimit të eksporteve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet evropiane. Shqipëria duhet të bëjë një analizë mbi programin e eksporteve në lidhje me listën e sektorëve ekonomikë me potencial të lartë për rritje dhe eksport në tregun e vetëm të BE-së, duke parashikuar një vlerësim për adresimin e kësaj mase. Për më tepër, fokusi është dhënë në rritjen e masave për lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e aksesit në tregjet e huaja përmes marrëveshjeve tregtare dhe partneriteteve.

Në përputhje me këta objektiva, Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu hapa për të forcuar zinxhirët e saj të vlerave dhe për të mbështetur industritë me potencial të konsiderueshëm rritjeje. Duke nxitur partneritetet midis bizneseve vendase dhe homologëve ndërkombëtarë, Shqipëria synon të përfitojë nga avantazhet e saj krahasuese dhe të rrisë konkurrencën e sektorëve kryesorë, si: prodhimi, turizmi dhe bujqësia.

Tabela 4: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përmirësimi i kuadrit të tërheqjes së investimeve dhe në veçanti i kuadrit të IHD-ve dhe i mjedisit të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Kontribuimi për reformimin e klimës së biznesit, përmirësimin e praktikave rregullatore dhe sigurimin e një ekonomie më dinamike dhe konkurruese.	Miratimi i ligjit(eve) të unifikuara të investimeve dhe akteve nënligjore kryesore në zbatim të legjislacionit, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së (**dhjetor 2026).** Miratimi i ndryshimeve ligjore për të lehtësuar procedurat administrative për bizneset **(dhjetor 2024).** Miratimi i ndryshimeve ligjore për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e inspektimit për bizneset **(dhjetor 2025).** Përgatitja e Udhërrëfyesit për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e raportimit të biznesit **(dhjetor 2025).** Miratimi i një plani veprimi për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për Politikat e SME-ve (**dhjetor 2025**).	1.1.4 Përmirësimi i kuadrit të tërheqjes së investimeve dhe në veçanti i kuadrit të IHD-ve dhe i mjedisit të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
R 1.1.4 Përmirësimi i kuadrit të tërheqjes së investimeve dhe në veçanti kuadri i IHD-ve dhe mjedisi i biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit.			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Hapi 1 – Miratimi i ligjit(eve) të unifikuara të investimeve dhe akteve nënligjore kryesore në zbatim të legjislacionit, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së (dhjetor 2026). - Faza e fushëveprimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të kuadrit ligjor aktual dhe kontekstit institucional dhe lehtësimi i procedurave të administrimit, lidhur me investimet (dhjetor 2024). - Analiza e mangësive ligjore të *Acquis* të BE-së (qershor 2025).	(dhjetor 2026)	Ligjet dhe aktet nënligjore ekzistuese	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

- Projektligjet dhe aktet nënligjore në lidhje me legjislacionin e investimeve (dhjetor 2025). - RIA dhe konsultimet publike (qershor 2026). - Miratimi i kuadrit ligjor për ligjet e unifikuara të investimeve (dhjetor 2026).			
Hapi 2 - Miratimi i ndryshimeve ligjore për të lehtësuar procedurat administrative për bizneset (dhjetor 2024). - Raporti i Analizës së Derregullimit të Shërbimeve të Biznesit (qershor 2024). - Miratimi i ndryshimeve ligjore për të lehtësuar procedurat administrative për bizneset (dhjetor 2024).	(dhjetor 2024)	Rregulloret ekzistuese	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSHNKB)
Hapi 3 - Miratimi i ndryshimeve ligjore për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e inspektimit për bizneset (dhjetor 2025). - Raporti i Analizës së Inspektorateve (dhjetor 2024). - Miratimi i paketës së ndryshimeve ligjore (dhjetor 2025). - Lista e kontrollit e publikuar në faqet e QKB-së, Inspektoratit Qendror (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Procedurat ekzistuese të inspektimit	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSHNKB)
Hapi 4 - Përgatitja e Udhërrëfyesit për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e raportimit të biznesit **(dhjetor 2025).** - Raporti i analizës së praktikës së biznesit (dhjetor 2024). - Hartimi i kuadrit të thjeshtuar të raportimit (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Nuk ekziston një udhërrëfyes për përmirësimin e praktikës së raportimit të biznesit	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSHNKB)
Hapi 5 - Miratimi i një plani veprimi për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për politikat e SME-ve (**dhjetor 2025**). - Vlerësimi i indeksit të politikave të OECD-së për NVM-të – analiza e dobësive dhe pikave të forta të Shqipërisë dhe fushat për ndërhyrje në politika (dhjetor 2024). - Plani i veprimit për përmirësimin e renditjes (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Nuk ka plan veprimi për përmirësimin e renditjes në Indeksin e Politikave të OECD-së për NVM-të	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

R - 1.1.5 Vendosja e sistemeve inteligjente të transportit (SIT) dhe E-transporti

Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë hapa përpara drejt modernizimit të infrastrukturës së saj të transportit, me fokus të veçantë në Sistemet Inteligjente të Transportit (ITS) për të rritur efikasitetin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë në sektorin e transportit. Konteksti ekzistues i transportit në Shqipëri pasqyron si sfidat ashtu edhe mundësitë, të formuara nga faktorë të tillë si tiparet gjeografike, tendencat e urbanizimit dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik.

Vendndodhja strategjike e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor, me akses në rrugët dhe portet kryesore tregtare, tregon rëndësinë e rrjeteve efikase të transportit për lehtësimin e tregtisë rajonale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, vendi përballet me sfida, të tilla si: infrastruktura e pamjaftueshme rrugore, bllokimi i trafikut dhe shqetësimet e sigurisë rrugore, të cilat kanë implikime për zhvillimin ekonomik, turizmin dhe cilësinë e përgjithshme të jetës.

Për të adresuar këto sfida, Shqipëria ka zbatuar nisma të ndryshme që synojnë përmirësimin e sistemeve të transportit dhe promovimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj përpjekjeje është miratimi i Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS), të cilat përdorin teknologjinë për të optimizuar fluksin e trafikut, për të përmirësuar sigurinë rrugore dhe për të reduktuar ndikimin mjedisor.

Prezantimi i zgjidhjeve të ITS-së, duke përfshirë sistemet inteligjente të menaxhimit të trafikut, mbledhjen elektronike të tarifave dhe monitorimin e trafikut në kohë reale, është gati të revolucionarizojë transportin në Shqipëri. Këto sisteme mundësojnë koordinim më të mirë të fluksit të trafikut,

përmirësojnë sigurinë rrugore përmes zbulimit të rreziqeve dhe incidenteve, dhe ofrojnë të dhëna të vlefshme për vendimmarrje të informuar nga autoritetet e transportit.

Për më tepër, integrimi i ITS-së me masa të tjera të politikave, si miratimi i një politike gjithëpërfshirëse të tokës, është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve të investimeve në transport. Duke siguruar transparencë dhe efikasitet në përdorimin e tokës, politika e tokës mund të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës së transportit, si rrjetet rrugore dhe sistemet e transitit publik, në një mënyrë të qëndrueshme.

Pavarësisht progresit në zbatimin e ITS-së dhe projekteve të infrastrukturës së transportit, vazhdojnë të mbeten sfida, duke përfshirë kufizimet e financimit, kufizimet e kapaciteteve institucionale dhe problematikat e koordinimit midis palëve të interesit. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme, iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve dhe reforma rregullatore për të krijuar një mjedis të favorshëm për inovacionin dhe investimet në transport.

Rezultatet e pritshme për hapat lidhur me ofrimin e transportit elektronik të mallrave dhe ITS-në janë si më poshtë:

- Përmirësimi i efikasitetit të rrjetit të transportit të mallrave: Zbatimi i transportit elektronik të mallrave do të mundësojë shkëmbim më të thjeshtë informacioni, reduktim të dokumentacionit dhe planifikim të optimizuar të logjistikës, duke kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të transportit të mallrave dhe reduktimin e vonesave kufitare.

- Përmirësimi i sigurisë dhe monitorimit të përmirësuar të ngarkesave: Ofrimi i sistemeve të transportit elektronik të mallrave do të përmirësojë monitorimin e lëvizjeve të ngarkesave, duke mundësuar gjurmim më të mirë, masa sigurie dhe pajtueshmëri rregullatore, duke përmirësuar kështu sigurinë e përgjithshme të ngarkesave dhe efikasitetin e transportit.

- Rritja e efikasitetit të rrjetit rrugor: Zbatimi i ITS-së do të mundësojë përmirësimin e fluksit të trafikut, uljen e mbipopullimit dhe planifikimin e optimizuar të rrugës, duke kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të transportit rrugor.

- Përmirësimi i sigurisë dhe sigurimit në rrugë: Ofrimi i ITS-së do të përmirësojë monitorimin në kohë reale të kushteve të trafikut, duke mundësuar reagime më të shpejta ndaj incidenteve dhe emergjencave, duke përmirësuar kështu sigurinë e përgjithshme dhe sigurinë në rrugë.

- Përmirësimi i sigurisë hekurudhore: Teknologjitë e ITS-së kontribuojnë në rritjen e sigurisë brenda rrjetit hekurudhor duke zbatuar sisteme të avancuara të sinjalizimit dhe kontrollit të trenave, siç është ETCS-ja (Sistemi Evropian i Kontrollit të Trenave). Këto sisteme ndihmojnë në parandalimin e përplasjeve, shpejtësisë së tepërt dhe rreziqeve të tjera të sigurisë duke ofruar kapacitete monitorimi dhe ndërhyrjeje në kohë reale.

- Përmirësimi i efikasitetit të rrjetit hekurudhor: Duke zbatuar zgjidhjet ITS, si ERTMS (Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor), operatorët hekurudhorë mund të optimizojnë lëvizjet e trenave, të reduktojnë vonesat dhe të përmirësojnë kapacitetin e përgjithshëm të rrjetit. Sistemet e monitorimit dhe kontrollit në kohë reale mundësojnë përdorim më efikas të infrastrukturës dhe burimeve, duke çuar në operime pa problematika dhe në ulje të kohës së udhëtimit.

- Ndërveprimi hekurudhor: Kornizat e ITS-së promovojnë ndërveprimin midis sistemeve dhe operatorëve të ndryshëm hekurudhorë, duke mundësuar operacione të pandërprera ndërkufitare dhe shërbime të ndërveprueshme. Protokollet e standardizuara të komunikimit dhe formatet e shkëmbimit të të dhënave sigurojnë përputhshmërinë ndërmjet komponentëve të ndryshëm të infrastrukturës hekurudhore, duke lehtësuar transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

Tabela 5: Rezultatet dhe produktet e pritshme – vendosja e sistemeve inteligjente të transportit (SIT) dhe E-transporti

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritjet
Modernizimi i infrastrukturës së transportit të Shqipërisë, duke përmirësuar efikasitetin, sigurinë dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së, teksa përmirësohet integrimi i Shqipërisë në rrjetin evropian të transportit, përmes	Miratimi i legjislacionit përkatës për tu harmonizuar me Rregulloren e BE-së 2020/1056 mbi Informacionin Elektronik të Transportit të Mallrave (eFTI[47])	**1.1.5** Vendosja e sistemeve inteligjente të transportit (SIT) dhe E-transporti

[47] Electronic Freight Transport Information (e-FTI).

lehtësimit më efikas dhe pa probleme të operacioneve ndërkufitare të transportit dhe logjistikës.	**(qershor 2025).** Ratifikimi i Protokollit shtesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave mbi "fletëshoqërimin elektronik" (eCMR[48]) për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave, të nevojshme për ta vendosur në zbatim eFTI **(dhjetor 2025).** Miratimi i legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit për transportin rrugor, në përputhje me *Acquis* të Bashkimit Evropian **(dhjetor 2026)** dhe zbatimi i fazës së parë të sistemeve të mbledhjes së të dhënave të trafikut dhe sistemeve të informacionit të përdoruesve të transportit rrugor **(qershor 2027).** Miratimi i legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit [49] për transportin hekurudhor, në përputhje me *Acquis* të Bashkimit Evropian (**qershor 2027).**	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R 1.1.5. Ofrimi i sistemeve të transportit elektronik dhe inteligjent të mallrave.			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)** **Ministria e Financave/ Doganat Shqiptare** **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**
Hapi 1 - Miratimi i legjislacionit përkatës për tu harmonizuar me Rregulloren e BE-së 2020/1056 mbi Informacionin Elektronik të Transportit të Mallrave (eFTI) (qershor 2025): - Krijimi i grupit të përbashkët të punës që përfshin ministritë përkatëse për zbatimin e Rregullores dhe caktimi i ministrisë koordinuese për zbatimin e Rregullores eFTI (pra ministria kryesuese) (dhjetor 2024) - Transpozimi i Rregullores eFTI në legjislacionin kombëtar (qershor 2025)	(qershor 2025)	Statusi i legjislacionit ekzistues	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) Ministria e Financave / Dogana Shqiptare Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
Hapi 2 - Ratifikimi i Protokollit shtesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave mbi "fletëshoqërimin elektronik" (eCMR[50]) për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave, të nevojshme për ta vendosur në zbatim eFTI (dhjetor 2025): - Miratimi zyrtar i protokollit për ratifikimin nga	(dhjetor 2025)	Legjislacioni ekzistues	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) Ministria e Financave / Dogana Shqiptare Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

[48] e-CRM (Electronic Consignment Note).
[49] ITS - Intelligent Transport Systems / Sistemet Inteligjente të Transportit (SIT).
[50] e-CRM (*Electronic Consignment Note*).

Qeveria (qershor 2025). - Ratifikimi nga Parlamenti (dhjetor 2025).			
Hapi 3 – Miratimi i legjislacionit përkatës për kuadrin dhe standardet e ITS-së për rrugët, në përputhje me *Acquis* të BE-së (dhjetor 2026) dhe zbatimi i fazës së parë të sistemeve të mbledhjes së të dhënave të trafikut dhe sistemeve të informacionit të përdoruesve të rrugës (qershor 2027): - Ndryshimi i Udhëzimit ekzistues të ministrit me qëllim transpozimin e plotë të legjislacionit përkatës për kuadrin dhe standardet e ITS-së për rrugët (Direktiva ITS 2023/2661 që ndryshon Direktivën ITS 2010/40) (dhjetor 2026). - Udhëzuesi i ri i Ministrit, për të transpozuar plotësisht Rregulloren e Deleguar (BE) 2015/962 – Shërbimet e informacionit për trafikun në kohë reale në mbarë BE-në (RTTI) dhe Rregulloren e Deleguar (BE) 2022/670 – Informacion për trafikun në kohë reale në mbarë BE-në shërbimet (RTTI) – (dhjetor 2024). - Ndërtimi dhe furnizimi i godinës së Qendrës së Kontrollit të Trafikut dhe Monitorimit, duke përfshirë infrastrukturën e ITS-së, harduerin, softuerin, ekranet e monitorit dhe pajisjet e komunikimit - (dhjetor 2024). - Vendosja e pajisjeve të ITS-së (sensorë, kamera, sinjalistikë elektronike rrugore etj.) përgjatë disa segmenteve rrugore (për 200 km) - (qershor 2027). - Rregullorja e deleguar (BE) 2024/490 - ofrimi i shërbimeve multimodale të informacionit për udhëtimet në mbarë BE-në - (qershor 2027).	(dhjetor 2026) (qershor 2027)	Legjislacioni ekzistues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
Hapi 4 - Miratimi i legjislacionit përkatës për kuadrin dhe standardet e ITS-së për hekurudhat, në përputhje me *Acquis* të BE-së (qershor 2027): - Miratimi me akt të posaçëm ligjor i dokumentit të politikave për zhvillimin e ITS-së në sektorin hekurudhor dhe detar në Shqipëri (ERTMS) – dhjetor 2024. - Transpozimi i Direktivës së Ndërveprimit 2016/797 që ndryshon Direktivën 2008/57/KE në legjislacionin shqiptar. Për realizimin e kësaj mase kemi parashikuar 11 akte ligjore (Urdhër i Ministrit për miratimin e rregulloreve), për: - TSI - Aplikimet telematike për shërbimin e pasagjerëve – qershor 2024. - TSI – Siguria në tunelet hekurudhore – dhjetor 2025; - Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 1300/2014, e datës 18 nëntor 2014, mbi specifikimet teknike për ndërveprimin në lidhje me aksesueshmërinë e sistemit hekurudhor të Bashkimit Evropian për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar – (dhjetor 2025). - TSI – Infrastruktura e miratuar brenda dhjetorit 2026. - TSI – Energjia, miratuar brenda dhjetorit 2026. - TSI, mjetet hekurudhore – lokomotiva dhe pasagjerë – dhjetor 2026. - TSI, zhurma – dhjetor 2026. - TSI – Komanda e Kontrollit dhe Sinjalizimi – qershor 2027. - TSI – mjetet hekurudhore – vagonët e mallrave –	(qershor 2027)	Rregulloret ekzistuese	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë **(**MIE)

qershor 2027. - TSI – Operacioni dhe Menaxhimi i Trafikut – qershor 2027. - TSI – Aplikimet telematike për shërbimin e mallrave – qershor 2027. - Përafrimi i plotë i Vendimit Zbatues të Komisionit (BE) 2018/1614, i datës 25 tetor 2018, që përcakton specifikimet për regjistrat e automjeteve, të përmendura në nenin 47 të Direktivës (BE) 2016/797 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe për ndryshimin dhe shfuqizimin e Vendimit të Komisionit 2007/756/EC – që përfshin 'Të dhënat e regjistrimit të automjeteve të transferuara në Regjistrin Evropian të Automjeteve (EVR) të ERA' (dhjetor 2025).			

R - 1.1.6 Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje

Shqipëria e ka njohur prej kohësh rëndësinë e promovimit të eksportit dhe ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve si shtytësit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Gjatë disa viteve të fundit, janë zbatuar masa të ndryshme për të lehtësuar eksportet, për të rritur tregtinë dhe për të mbështetur ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare në të gjithë sektorët me potencial rritjeje.

Strategjia e Investimeve dhe Zhvillimit të Biznesit 2021–2027 (BIDS) dhe Plani i saj i Veprimit ofrojnë drejtim gjithëpërfshirës për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe në tërheqjen e investimeve. AIDA ka një mandat të gjerë, duke mbuluar nxitjen e eksportit dhe zhvillimin e SME-ve, si dhe nxitjen, lehtësimin dhe mbajtjen e investimeve.

Sipas INSTAT-it, pesha e eksporteve me vlerë neto (shërbime dhe mallra) në raport me PBB-në për vitin 2024 (viti i matur 2023) është 39%. Qëllimi është të sigurohet rritja e peshës së eksporteve (shërbimeve dhe mallrave) në raport me PBB-në, ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së në vlerë neto është 40 % (qershor 2027).

Këto përpjekje përfshijnë miratimin e programeve të nxitjes dhe lehtësimit të eksporteve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh rolin kritik që luajnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në nxitjen e rritjes ekonomike të Shqipërisë, është thelbësore të rriten përpjekjet për nxitjen e eksportit. Përshtatja e këtyre nismave për të adresuar sfidat specifike me të cilat përballen NVM-të në eksportimin e mallrave dhe shërbimeve të tyre, jo vetëm që do të nxisë gjithëpërfshirjen, por gjithashtu do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi ekonomik më të qëndrueshëm dhe dinamik.

Duke pasur parasysh përqindjen e vogël të NVM-ve eksportuese në Shqipëri, ofrimi i asistencës së synuar për këto sipërmarrje është thelbësore. Kjo asistencë do të ndihmonte në mbylljen e hendekut midis shoqërive të mëdha dhe NVM-ve dhe mund të çonte potencialisht në përmirësimin e lidhjeve midis NVM-ve dhe shoqërive shumëkombëshe që operojnë në ekonomi. Zgjerimi i programeve të nxitjes së eksporteve për të përfshirë shoqëritë joeksportuese dhe NVM-të mund të krijojë një ekosistem eksporti më të larmishëm dhe më të fuqishëm. Kjo qasje do të ndihmonte bizneset individuale të zgjerojnë shtrirjen e tyre në treg duke kontribuar në rritjen e përgjithshme ekonomike, duke rritur numrin e shoqërive që marrin pjesë në tregtinë ndërkombëtare.

Zgjerimi i objektit të iniciativave përtej përfituesve tradicionalë të angazhuar tashmë në aktivitetet eksportuese do të rrisë kontributin e eksporteve në PBB. Shumë shoqëri shqiptare joeksportuese, të cilësuara shpesh si eksportues të mundshëm, mund t'u mungojë ndërgjegjësimi, burimet ose njohuritë e nevojshme për të hyrë në tregjet ndërkombëtare. Zgjerimi i shtrirjes së programeve të promovimit të eksportit te këta eksportues potencialë synon t'u sigurojë atyre mbështetjen, trajnimin dhe burimet e nevojshme për të eksploruar dhe për të hyrë në tregjet globale.

Në këtë drejtim, programi i ri i nxitjes dhe lehtësimit të eksporteve do të përfshinte masat që lidhen me: i. mbështetjen specifike për NVM-të; ii. aksesin në financimin e NVM-ve (ndihma financiare, grante ose subvencione për të ndihmuar NVM-të të mbulojnë kostot që lidhen me hyrjen dhe zgjerimin në tregjet e huaja); iii. mbështetjen për infrastrukturën cilësore për eksportet; iv. promovimin e rrjeteve dhe lidhjeve (lehtësimi i lidhjeve ndërmjet NVM-ve dhe shoqërive shumëkombëshe për të krijuar partneritete, sipërmarrje të përbashkëta dhe integrim në zinxhirët e furnizimit global), etj. Duke përfshirë këto elemente, programi i ri i nxitjes së eksportit do të ndihmojë NVM-të shqiptare të kapërcejnë barrierat ndaj eksportit, të futen në tregje të reja dhe të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjithashtu, vendi është plotësisht i angazhuar për të siguruar parakushtet e nevojshme për eksportin e mallrave bujqësore, duke përafruar plotësisht legjislacionin përkatës për këtë sektor me *acquis* të BE-së, si ligjin për kontrollet zyrtare, ligjet për shëndetin e kafshëve dhe për shëndetin e bimëve, si dhe duke siguruar përgatitjen e akteve nënligjore përkatëse.

Fokusi është gjithashtu në rritjen e masave për lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e aksesit në tregjet e huaja, përmes marrëveshjeve tregtare dhe partneriteteve. Në këtë aspekt, do të përgatitet Programi për Lehtësirat e Tregtisë dhe Transportit, i cili do të përfshijë disa komponentë, duke përfshirë nevojat sipas Udhërrëfyesit të Korridoreve/Korsive të Gjelbra për zbatimin dhe lehtësimin e tregtisë rajonale.

Për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për rritjen e eksportit, duhet të adresohet lehtësimi i tregtisë dhe transportit me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim, synimi është të sigurohet lehtësimi i tregtisë dhe transportit edhe përmes përvojës së Korridoreve të Gjelbra/Korsive të Gjelbra, që u krijuan me shpërthimin e COVID-19 për të parandaluar mungesën e mallrave thelbësore dhe pajisjeve mjekësore. Nisja e iniciativës është dëshmuar si një nga shembujt më të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal, duke arritur të ruajë flukset tregtare, jo vetëm për përfitime ekonomike, por edhe për luftë efektive kundër pandemisë.

Në Samitin e Sofjes të mbajtur në nëntor 2020, liderët e Ballkanit Perëndimor shprehën mbështetjen e tyre për të shtrirë Korridorin e Gjelbër dhe Korsitë e Gjelbra në të gjitha pikat e kalimit të kufijve (PKK) në Ballkanin Perëndimor dhe me shtetet anëtare fqinje të BE-së. Një vit pas nisjes së iniciativës, Korridoret/Korsitë e Gjelbra janë shtrirë në të gjitha PKK-të rrugore brenda CEFTA-s dhe tre PKK hekurudhore. U nënshkruan 5 marrëveshje mirëkuptimi midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, midis Italisë dhe Malit të Zi, dhe Italisë dhe Shqipërisë (korsitë blu), dhe midis Kroacisë dhe Malit të Zi dhe Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, duke mundësuar dërgimin e të dhënave nga CEFTA tek vendet anëtare të BE-së të përfshira dhe lehtësimin e eksportit të CEFTA-s. Tregtarët që transportojnë mallra thelbësore duhet të kenë përparësi kalimi në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Koncepti i zgjeruar kontribuon në reduktimin e kohës së pritjes në PKK-të dhe në uljen e kostove të transportit, dhe tregtisë për të gjitha bizneset.

Megjithatë, nevojitet shumë më tepër progres në këtë drejtim, dhe për këtë arsye, synimi është të miratohet një program lehtësimi i tregtisë dhe transportit që përfshin si komponent Korsitë e Gjelbra/Korridoret e Gjelbra, me masat përkatëse të buta dhe të forta, veprimet dhe ndërhyrjet me kosto për zbatim, që dalin nga Udhërrëfyesi ETC. Qëllimi është të shtohen dhe të përmirësohen korridoret dhe pikat e kalimit kufitar për të lehtësuar reformat tregtare në kufi dhe për të përmirësuar efikasitetin e transportit në nyjat kryesore. Këto masa mund të integrohen në një paketë më të gjerë masash për lehtësimin e tregtisë dhe transportit.

Masat e zinxhirit të vlerave mund të rrisin ndjeshëm konkurrueshmërinë dhe efikasitetin e sektorëve të ndryshëm në ekonominë shqiptare. Shqipëria është e përkushtuar të sigurojë progres në nismat rregullatore dhe/ose masat mbështetëse, në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerave industriale me Bashkimin Evropian. Veçanërisht në lidhje me lëndët e para kritike dhe mjekësinë kritike për të cilat BE-ja ka një interes të veçantë për të bashkëpunuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Kohët e fundit në Shqipëri ka pasur disa zhvillime, në lidhje me entitetet e reja të vendosura në zinxhirin e vlerave dhe proceset e përshpejtuara të integrimit në partneritete, të cilat ia vlen të përmenden.

Sipas Partneritetit të ri Evropian të bashkëfinancuar dhe të bashkëprogramuar si pjesë e Planit Strategjik të *Horizon Europe* për 2025–2027, ftohen të marrin pjesë vendet e asociuara. Në qershor të vitit

2024, Shqipëria mori një kërkesë nga Komisioni Evropian për të shprehur zyrtarisht angazhimin për këtë program. Programi fokusohet në pesë fusha kyçe të partneritetit me BE-në: shëndeti mendor, pyjet dhe pylltaria për një të ardhme të qëndrueshme, lëndët e para për tranzicionin e gjelbër dhe digjital, përgatitja dhe qëndrueshmëria ndaj pandemisë, dhe trashëgimia kulturore. Hapat e ardhshëm në kuadër të këtij angazhimi mbeten:

- Vlerësimi i fushave të angazhimit dhe kostot, dhe përfitimet e lidhura me të (brenda gushtit 2024);
- Vendimmarrja, përfshirë dispozitat buxhetore, institucionet përgjegjëse dhe koordinatorët (brenda gushtit 2024);
- Letra e shprehjes së angazhimit për zonat e dakordësuara (brenda 15 shtatorit 2024);
- Procedurat rregullatore për aplikim në program (brenda dhjetorit 2024).

Shqipëria po punon për të harmonizuar kuadrin e saj rregullator me standardet e Bashkimit Evropian për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e produkteve mjekësore. Ky përafrim është thelbësor për pjesëmarrjen në Partneritetin Mjekësor Kritik dhe integrimin në zinxhirin më të gjerë evropian të vlerave.

Shqipëria mban statusin e anëtarit të Aleancës së Medikamenteve Kritike (CMA[51]), e cila është një mekanizëm konsultativ që bashkon palët përkatëse të interesit nga shtetet anëtare të BE-së, industritë kryesore, shoqëria civile dhe komuniteti shkencor. Aleanca synon të identifikojë fushat dhe prioritetet kryesore për veprim, duke propozuar zgjidhje për të forcuar furnizimin me medikamente kritike në BE, duke rritur përfundimisht përpjekjet për të parandaluar dhe trajtuar në mënyrë efektive mungesat.

Në kuadër të CMA-së, Komisioni i Evropian do të kryejë hartëzimin për të krijuar një pamje të plotë të industrisë farmaceutike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Studimi duhet të jetë i disponueshëm deri në fund të nëntorit 2024. Më pas, BE-ja mund të konsiderojë zhvillimin e partneriteteve strategjike me partnerët e Ballkanit Perëndimor për prodhimin e medikamenteve kritike, duke reflektuar si kërkesat ashtu edhe nevojat vendore në nivel BE-je dhe global. Pasi të bëhen anëtarë të Forumit CMA, partnerët do të jenë në gjendje të shkëmbejnë dhe diskutojnë me palët e tjera të interesit për të identifikuar veprimet dhe mjetet më të përshtatshme, për të trajtuar në mënyrë efektive cenueshmëritë në zinxhirët e furnizimit me medikamente kritike.

Shqipëria po pozicionohet brenda partneritetit mjekësor kritik dhe zinxhirit të vlerave, duke përafruar kuadrin rregullator me standardet e BE-së, duke nxitur prodhimin vendas, duke rritur elasticitetin e zinxhirit të furnizimit, duke nxitur kërkimin dhe inovacionin, duke përmirësuar gatishmërinë për shëndetin publik dhe duke ndërtuar bashkëpunime ndërkombëtare. Po bëhen përpjekje për të rritur prodhimin vendas të medikamenteve thelbësore. Këtu përfshihet investimi në infrastrukturë, teknologji dhe burime njerëzore për të rritur kapacitetin e sektorit farmaceutik dhe për të reduktuar varësinë nga importet.

Shqipëria punon për integrimin me sistemet dhe kuadrot evropianë, përfshirë Agjencinë Evropiane të Barnave (EMA), për të përmirësuar sektorët e saj të kujdesit shëndetësor dhe mjekësor. Ky bashkëpunim përfshin miratimin e udhëzimeve të BE-së, pjesëmarrjen në partneritete ndërkombëtare dhe angazhimin në iniciativa që synojnë përmirësimin e zinxhirit të furnizimit me barna të vendit, mjedisin rregullator dhe infrastrukturën e shëndetit publik. Shqipëria po kërkon në mënyrë aktive të forcojë bashkëpunimet me shtetet anëtare të BE-së dhe Komisionin Evropian, si dhe me organizatat ndërkombëtare. Këto partneritete janë thelbësore për shkëmbimin e njohurive, asistencën teknike dhe ndërtimin e kapaciteteve në mjekësinë kritike dhe zinxhirin e vlerave. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe pjesëmarrja në projektet kërkimore të financuara nga BE-ja janë jetike për zhvillimin e barnave të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Përmirësimi i infrastrukturës së shëndetit publik dhe gatishmëria për kriza shëndetësore është prioritet. Këtu përfshihet zhvillimi i strategjive për gatishmërinë ndaj pandemisë dhe sigurimi i disponueshmërisë së produkteve mjekësore kritike në kohë nevoje.

Hapja e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë për lëndët e para, në prill 2024, shënon një moment vendimtar në rrugën e Shqipërisë drejt modernizimit dhe avancimit të sektorit të lëndëve të para dhe përgatitjes së saj për sfidat e së ardhmes. Qendra e zhvillon

[51] *Critical Medicine Alliance* – CMA.

veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin kombëtar[52] dhe bazuar në standardet e vendosura nga EIT për Lëndët e Para për RIS HUB, nëpërmjet grupit ndërinstitucional të punës, i cili funksionon si platformë heliks e katërfishtë për sektorin e lëndëve të para, me përfaqësues nga institucionet përkatëse shtetërore, shoqëri që ushtrojnë aktivitet në industri, bota akademike dhe shoqëria civile.

Misioni i Qendrës është të koordinojë aktivitetin, në lidhje me inovacionin dhe zhvillimin në sektorin e lëndëve të para, në bashkëpunim me Institutin Evropian të Teknologjisë (EIT) dhe Inovacionit për Lëndët e Para, me qëllim: i. fuqizimin e rajonit me infrastrukturën e duhur për të zhbllokuar potencialin e tij mineral dhe ndërtimin e lidhjeve të forta ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Evropës; ii. lidhjen e biznesit me tregjet, projektet me financimin, talentin me industrinë dhe inovacionin me aplikimin; iii. kontribuimin në agjendën e "Aktit të lëndëve të para kritike" dhe mbështetjen e krijimit të zinxhirëve të sigurt të furnizimit për Evropën.

Qendra Rajonale Shqiptare e Inovacionit për Lëndët e Para EIT, si një qendër për inovacionin, bashkëpunimin dhe praktikat e qëndrueshme, do të jetë një hap i rëndësishëm në transformimin e sektorit të lëndëve të para në Shqipëri, duke forcuar angazhimin e qeverisë shqiptare për të arritur objektivat e aktit të BE-së për lëndët e para kritike (akti i BE-së për CRM-në) dhe për ta kthyer Shqipërinë në një partner strategjik të BE-së për këtë sektor. Duke pasur parasysh se sektori i lëndëve të para është pjesë e prioriteteve të planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor, kjo nismë do të kontribuojë në mënyrë thelbësore në zhvillimin rajonal dhe pozicionimin strategjik të Shqipërisë edhe brenda zinxhirit të vlerave të BE-së.

Mbështetja e posaçme e qeverisë shqiptare për sektorin e lëndëve të para, siç pasqyrohet në Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3), e cila synon ta kthejë Shqipërinë në një lojtar kyç në peizazhin industrial dhe si një partner strategjik i BE-së në integrimin në zinxhirët e furnizimit global, por edhe përfshirja e këtij sektori në prioritetet e qeverisë shqiptare për t'u mbështetur nga Plani i Rritjes, dëshmojnë objektivin ambicioz të Shqipërisë në rrugën e integrimit në BE.

Prioritizimi i këtij sektori, duke përfshirë ngritjen dhe fuqizimin e kësaj Qendre, erdhi si rezultat i konsultimeve të gjera me aktorë të heliksit të katërfishtë në Shqipëri (qeveria, akademikët, biznesi, shoqëria civile), në kuadër të S3, si dhe tryezave të rrumbullakëta, organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila evidentoi nevojën dhe interesin e aktorëve të këtij sektori për të investuar në teknologji dhe inovacion, dhe për t'u rritur me objektivin për t'u integruar në zinxhirin e vlerave të BE-së, por edhe për të investuar në kapitalin njerëzor, që është një aspekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e sektorëve prioritarë dhe tashmë prioritet për qeverinë shqiptare.

Qendra Rajonale e Inovacionit do të shërbejë si një qendër për sektorin e lëndëve të para të Shqipërisë, do të mbështesë Shqipërinë për të realizuar potencialin e pasur të sektorit të lëndëve të para dhe për të ndërtuar lidhje të forta midis Ballkanit Perëndimor dhe Evropës. Qendra Rajonale e Inovacionit do të luajë rol të fortë në zbatimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent të Qeverisë (S3), si pjesë e një prej tre sektorëve kryesorë prioritarë në Shqipëri.

Qendra Rajonale e Inovacionit do të lehtësojë shkëmbimin dhe bashkëpunimin e informacionit në të gjithë rrjetin e lëndëve të para të EIT-së dhe më gjerë, duke ndërtuar sinergji me programet kombëtare shqiptare, përfshirë ato në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor. Qendra do të fokusohet, gjithashtu, në ndërtimin e aftësive dhe sipërmarrjes, veçanërisht në mesin e grave studente dhe studiuese, duke promovuar edukimin STEM të përshtatur për nevojat e ardhshme të industrisë.

Qendra do të bëhet nyje kryesore për palët e interesit të sektorit të lëndëve të para në Shqipëri dhe më gjerë, duke mbështetur shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, duke krijuar sinergji me programet kombëtare shqiptare dhe evropiane, duke ndihmuar në avancimin e sipërmarrjes dhe aftësive, dhe

---

[52] Qendra e Lëndëve të Para të EIT-së është krijuar dhe vepron në bazë të:
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 6.12.2023, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para" (Qendra Rajonale e Inovacionit EIT për Lëndët e Para);
- Urdhrit të Kryeministrit nr. 22, datë 2.2.2024, "Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Parë" (Qendra Rajonale e Inovacionit EIT për Lëndët e Para);
- Urdhrit të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës pranë Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para" (Qendra Rajonale e Inovacionit EIT për Lëndët e Para).

promovimin e edukimit STEM të përshtatur me nevojat e industrisë së ardhshme, me fokus të veçantë në:

- ngritjen e kapaciteteve njerëzore, duke investuar në trajnimin dhe zhvillimin e aftësive të stafit të specializuar në fushën e lëndëve të para;
- krijimin e kapaciteteve kërkimore përmes infrastrukturës së hapur kërkimore, duke optimizuar investimet në laboratorë dhe pajisje, dhe aplikimin e teknologjive të reja dhe qasjeve inovative në këtë sektor;
- modernizimin e sektorit minerar, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese për ta përshtatur atë me kërkesat e kohës dhe standardet ndërkombëtare, si dhe për të përmbushur kërkesat e një industrie teknologjikisht të avancuar dhe për të krijuar hapësira për krijimin e partneriteteve strategjike.

Këto angazhime do të mundësojnë, që sektori minerar të pajiset për t'u përshtatur dhe për të operuar në një mjedis më të gjerë ndërkombëtar evropian, duke krijuar qasje dhe partneritete të reja që ndihmojnë Shqipërinë të jetë një partner strategjik i BE-së dhe duke e pozicionuar Shqipërinë në krye të Ballkanit Perëndimor në trajektoren e saj drejt integrimit në BE.

Zbatimi i masave të zinxhirit të vlerave në Shqipëri përfshin një qasje strategjike për analizimin, zhvillimin dhe optimizimin e fazave të ndryshme të prodhimit dhe shpërndarjes në sektorë kyç. Kjo qasje do të kërkonte bashkëpunim ndërmjet palëve të interesit, si ministritë e linjës, agjencitë dhe Qendra EIT, investime në infrastrukturë dhe teknologji, mbështetje për politikat dhe fokus në lidhjet dhe diversifikimin e tregut. Nëpërmjet këtyre masave, Shqipëria mund të rrisë performancën e saj ekonomike, konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në shumë sektorë.

Në këtë drejtim, së pari do të kryhej analiza dhe hartëzimi i zinxhirit të vlerave në sektorët me potencialin më të lartë për rritje dhe eksport në tregun e vetëm të BE-së. Analiza do të përfshijë çdo hap, nga prodhimi në treg, duke përfshirë blerjen e lëndëve të para, prodhimin, logjistikën, shpërndarjen dhe shitjet. Gjithashtu, do të identifikojë pengesat dhe mundësitë, mungesën e efikasitetit dhe fushat për përmirësim, të tilla si mangësitë e zinxhirit të furnizimit, nevojat e teknologjisë dhe çështjet e aksesit në treg. Kjo do të angazhojë palët e interesuara, duke përfshirë bashkëpunimin me aktorët e industrisë, agjencitë qeveritare dhe institucionet akademike, për njohje të gjithanshme.

Bazuar në këtë analizë, do të ndërmerren masa të buta për sa u përket masave rregullatore për të adresuar dobësitë e sektorit, në lidhje me zinxhirin e vlerave dhe për të promovuar partneritetin me BE-në. Për sa u përket materialeve kritike, fokusi do të jetë përafrimi me Aktin e Lëndëve të Para (rregullorja), kur ai të jetë miratuar nga BE-ja, dhe sigurimi i zbatimit të tij.

Gjithashtu, do të zhvillohen dhe hartohen ndërhyrje strategjike, për të adresuar pengesat, të tilla si futja e teknologjive moderne në prodhim dhe përpunim për të rritur produktivitetin dhe cilësinë, për të lehtësuar aksesin në financa, duke zhvilluar produkte dhe shërbime financiare që mbështesin aktivitetet e zinxhirit të vlerave, veçanërisht për NVM-të, etj. Në iniciativat që lidhen me mjekësinë kritike, anëtarësimi në Aleancën Mjekësore të BE-së, si dhe udhëzimet e HERA[53]-s, do të kontribuojnë në orientimin e veprimeve me përpjekje drejt përafrimit me BE-në dhe aksesin në tregun e vetëm të BE-së. Përafrimi i plotë me *acquis* të BE-së për barnat, për përdorim nga njerëzit, është i nevojshëm për Shqipërinë, nëse ajo synon që barnat e saj të prodhuara në vend të pranohen në BE. Këtu përfshihet miratimi i standardeve dhe praktikave rregullatore të BE-së, në lidhje me prodhimin, autorizimin dhe kontrollin e cilësisë së barnave, si dhe ndryshimet e nevojshme rregullatore për të arritur këtë përafrim, të cilat do të mundësojnë akses në treg dhe do të garantojnë cilësinë dhe sigurinë e barnave të saj sipas standardeve të BE-së.

Tabela 6: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje.

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Kontributi në nxitjen e rritjes ekonomike, rritjen e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare	Miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (dhjetor 2025). Miratimi i ligjeve për Kontrollet Zyrtare (qershor 2026) për Shëndetin e Kafshëve dhe për Shëndetin	1.1.6 Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe

[53] *Health Emergency Preparedness and Response* (HERA).

dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet tregtisë strategjike dhe politikave rregullatore.	e Bimëve, në përputhje të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian (qershor 2025) dhe përgatitja e akteve nënligjore (dhjetor 2026). Progres i arritur në iniciativat rregullatore (dhjetor 2025/qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse, në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (dhjetor 2027).[54] Progres i vazhdueshëm në zbatimin e iniciativave të Korridoreve të Gjelbra (*Green Lanes*) për lehtësimin e tregtisë, duke miratuar një program për lehtësimin e tregtisë dhe transportit (dhjetor 2025)[55]. Rritja e peshës së eksporteve (shërbime dhe mallra) ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së është në vlerë neto 40% (qershor 2027).	mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R 1.1.6 Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje.			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Hapi 1 – Miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (dhjetor 2025). - Vlerësimi dhe prioritizimi i industrive/sektorëve/ produkteve potenciale për rritje, për të hartuar lehtësimin e eksportit dhe ndërkombëtarizimin e masave dhe promovimin e ndërmarrjeve (mars 2025); - Hartimi i programit dhe konsultimi i biznesit (qershor 2025); - Miratimi i Programit të Nxitjes dhe Lehtësimit të Eksportit (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Nuk ka asnjë program ekzistues për promovimin dhe lehtësimin e eksporteve.	MEKI
Hapi 2 – Miratimi i ligjeve për kontrollet zyrtare (qershor 2026), për shëndetin e kafshëve dhe për Shëndetin e Bimëve, në përputhje të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian (qershor 2025) dhe përgatitja e akteve nënligjore (dhjetor 2026): - Miratimi i ligjit të ri për shëndetin e kafshëve (qershor 2025); - Miratimi i ligjit të ri për shëndetin e bimëve (qershor 2025); - Miratimi i ligjit të ri për kontrollin zyrtar (qershor 2026). - Njëzet e dy akte nënligjore zbatuese të miratuara brenda dhjetorit 2026: - - Miratimi i dhjetë akteve nënligjore në zbatim të ligjit për shëndetin e kafshëve;	(qershor 2026) (qershor 2025) (dhjetor 2026)	Legjislacioni ekzistues. Nuk ka akte nënligjore ekzistuese.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

[54] Shqipëria është aktualisht në pritje të udhërrëfyesit të BE-së për zinxhirët e vlerave për të filluar përcaktimin e hapave të nevojshëm rregullatorë.

[55] Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.

- Miratimi i dhjetë akteve nënligjore në zbatim të ligjit për shëndetin e bimëve; - Miratimi i pesë akteve nënligjore në zbatim të ligjit të kontrollit zyrtar.			
Hapi 3 – Progresi i arritur në iniciativat rregullatore (dhjetor 2025/qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse, në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (dhjetor 2027).	(dhjetor 2025) (qershor 2026) (dhjetor 2027)	Nuk ka iniciativa ligjore ekzistuese. Statusi i legjislacionit në fuqi për zinxhirin e vlerave.	Ministria e Ekonomisë e Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)
Hapi 4 – Progresi i vazhdueshëm në zbatimin e iniciativave të Korridoreve të Gjelbra (*Green Lanes*) për lehtësimin e tregtisë, duke miratuar një program për lehtësimin e tregtisë dhe transportit (dhjetor 2025)[56].	(dhjetor 2025)	Programi ekzistues TTFP	Ministria e Ekonomisë e Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)
Hapi 3 – Rritja e peshës së eksporteve (shërbime dhe mallra) ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së është në vlerë neto 40% (qershor 2027). - Raporti bazë i përgatitur (dhjetor 2024); - Miratimi i strategjisë së promovimit të eksportit (qershor 2025); - Vlerësimi i ndikimit të masave të mbështetjes së eksportit (qershor 2026); - Arritja e objektivit (viti 2026/qershor 2027).	(qershor 2027)	39.2% (2023)	MEKI

7. FUSHA E POLITIKËS 2: KAPITALI NJERËZOR

2.1 Arsimi

Shqipëria ka miratuar ligjin "Për arsimin dhe formimin profesional" dhe ka zbatuar një "Strategji të re Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për periudhën 2023–2030". Qëllimi i ligjit "Për arsimin dhe formimin profesional" është të krijojë një sistem koheziv të AFP-së, të aftë për t'i u përshtatur ndryshimeve socio-ekonomike dhe teknologjike. Ky sistem përputhet me kornizat më të gjera arsimore dhe u përgjigjet kërkesave vendore dhe globale të tregut të punës, ndërkohë që siguron mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit profesional. Njëkohësisht, "Strategjia Kombëtare për Aftësitë dhe Punësimin 2023–2030" i jep prioritet punësimit cilësor dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës për të gjithë. Ai trajton 16 sfida dhe jep zgjidhjet përkatëse, të strukturuara rreth pesë qëllimeve kryesore: a) adresimi i mospërputhjeve të aftësive në të gjitha profesionet; b) rritja e niveleve të aftësive të të dyja gjinive në fuqinë punëtore; c) përmirësimi i funksionalitetit të tregut të punës; d) lehtësimi i ndërmjetësimit dhe ofrimit të programeve të mbështetjes gjithëpërfshirëse të punësimit; dhe e) garantimi i mundësive të punës së denjë në mënyrë universale.

R - 2.1.1 Rishikim i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës

Shqipëria ka vazhduar progresin e konsiderueshëm drejt garantimit që si burrat ashtu edhe gratë të kenë akses në mundësi të shtuara punësimi. Pas pandemisë, e cila ndikoi negativisht në tregun e punës, një trend pozitiv vërehet gjatë viteve 2022–2023, në të gjithë treguesit e tregut të punës. Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për popullsinë 15–64 vjeç, në tremujorin e dytë 2023, është 75.8%. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 3.0% më e lartë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës është rritur me 0.1%. Shkalla e punësimit për popullsinë 15–64 vjeç në tregun e punës në vitin 2022 është 65%. Ndërsa gjatë tremujorit të dytë 2023,

[56] Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.

shkalla e punësimit për popullsinë 15–64 vjeç është 67,4% me një rritje prej 2,7 p.p. krahasuar me tremujorin e dytë 2022. Shkalla e punësimit është përmirësuar ndjeshëm veçanërisht te gratë nga 53.8% në 2021-shin në 58.9% në 2022-shin dhe hendeku gjinor në punësim ka ardhur duke u ulur nga 14.4% në 2021-shin në 14.2% në 2022-shin. Megjithatë, pabarazia gjinore në punësim mbetet problematike, ku shkalla e punësimit të meshkujve e tejkalon atë të femrave me 12.4%. Shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart në tregun e punës në vitin 2022 është 10.9%. Në tremujorin e dytë 2023, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 10.7% me një rënie prej 0.4 p.p. krahasuar me tremujorin e dytë 2022 dhe me 0.1 pikë përqindje (p.p.) krahasuar me tremujorin e parë 2023.

Niveli i punësimit dhe shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve ka ardhur në rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Shkalla e punësimit për të rinjtë 15–24 vjeç për vitin 2022 ishte 29.0% me një rritje prej 2.6 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe shkalla e pjesëmarrjes 38.6% me një rritje prej 2.3 p.p. krahasuar me 2021-shin. Megjithatë, të dyja shifrat mbeten të ulëta krahasuar me shkallën e punësimit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së përgjithshme. Shkalla e papunësisë është në rënie të vazhdueshme, por ende mbetet pas në raport me pjesën tjetër të popullsisë së rritur. Për sa i përket përqindjes së të rinjve që nuk janë në punësim në arsim apo trajnim (NEET), në vitin 2022 ishte 25.2% me një rënie prej 0.9 p.p. krahasuar me 2021. Shkalla e NEET ishte 5.2 p.p. më e lartë për gratë (27.8%) sesa për burrat (22.6%) në 2022. Në Shqipëri ka një përqindje të lartë të të rinjve që nuk janë në punësim në arsim apo trajnim (NEET), që është pothuajse dyfishi i mesatares së BE-27.

Në sistemin e arsimit dhe formimit profesional janë ndërmarrë disa reforma, si në kuadrin ligjor ashtu edhe në hartimin e politikave, për të siguruar një sistem të përshtatshëm që ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të duhura. Disa nga nismat e ndërmarra për miratimin, zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për zhvillimin e kuadrit të sigurimit të cilësisë dhe lidhjen e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, synojnë të rrisin rëndësinë, transparencën, dhe cilësinë e ofertës së aftësive në tregun e punës në Shqipëri. Sistemi i AFP-së ka nevojë për përfshirje më të lartë të sektorit privat, si në përmbajtjen dhe rregullimin e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, ashtu edhe drejtpërdrejt përmes të të nxënit të bazuar në punë. Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023–2030 ka vendosur si masë prioritare zhvillimin e një oferte të AFP-së, që është më e rëndësishme, fleksibël dhe e rregulluar, bazuar në evidenca, dhe që siguron vazhdimësi.

Zhvillimi i një sistemi të besueshëm dhe cilësor të AFP-së në vend është një proces i dyanshëm, që kërkon kohë jo vetëm për rritjen dhe përmirësimin e ofruesve të AFP-së, por edhe për rritjen dhe konsolidimin e sektorit privat. Bashkëpunimi me sektorin privat në ofrimin e AFP-së është ndoshta më i zhvilluari në sektorin e punësimit dhe aftësive, kryesisht falë bashkëpunimit në nivel zbatimi ndërmjet ofruesve të AFP-së dhe shoqërive për kryerjen e praktikave në ambientet e biznesit. Angazhimi i sektorit privat në zhvillimin e ofertës së AFP-së paraqitet përmes Komiteteve të Aftësive Sektoriale, ku kontributi i sipërmarrjeve të biznesit do të përdoret në përshtatjen e përmbajtjes së AFP-së dhe programeve të trajnimit, duke përfshirë zhvillimin dhe vlefshmërinë e standardeve profesionale në sektorët prioritarë është vendimtar.

Rezultati i përpjekjeve për të rritur cilësinë dhe rëndësinë e AFP-së në tregun e punës për të rinjtë dhe të rriturit, është zhvillimi dhe zbatimi i kuadrit të sigurimit të cilësisë, i cili bazohet në ndërveprimin dhe krahasimin e rezultateve të vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së me ato të jashtme, proceset e vlerësimit si akreditimi, monitorimi dhe inspektimi (do të aktivizohen së shpejti). Miratimi dhe fillimi i zbatimit të procesit të akreditimit të ofruesve të AFP-së është një hap shumë i rëndësishëm për krijimin e një kulture cilësore në sistem.

Një dimension shumë i rëndësishëm i sigurimit të cilësisë në AFP është kualifikimi fillestar dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve të shkollave profesionale. Në këtë drejtim, të dyja proceset janë institucionalizuar në vitin 2022 dhe janë në vazhdim.

Informacioni i nxjerrë nga sistemi i inteligjencës së aftësive do të përdoret për të përshtatur dhe përditësuar ofertën e AFP-së dhe për të zgjeruar ofertën e AFP-së pas arsimit të mesëm. Një proces i tillë do të kryhet nëpërmjet një metodologjie që kombinon informacionin e tregut të punës dhe analizën e nevojave për aftësi me zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në këtë kuptim,

KSHK/Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale do të vazhdojë të zhvillohet dhe zbatohet më tej nëpërmjet hartimit të kualifikimeve të reja profesionale ose përditësimit të atyre ekzistuese.

Tabela 7: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Rishikim i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritje
Kontribuon për një sistem më të përgjegjshëm dhe efektiv të AFP-së, duke përgatitur më mirë studentët për fuqinë punëtore dhe duke mbështetur zhvillimin ekonomik, duke: - siguruar harmonizimin me nevojat e industrisë, duke rritur punësueshmërinë e të diplomuarve. - u fokusuar tek aftësitë specifike të sektorit dhe gjetjen e punës, një përqindje më e lartë e të diplomuarve të AFP-së ka të ngjarë të sigurojnë punësim në sektorët e tyre përkatës menjëherë pas diplomimit, duke kontribuar në uljen e shkallës së papunësisë dhe përmirësimin e rezultateve ekonomike.	Dy (2) komitete shtesë të Aftësive Sektoriale (Bujqësia; (Energjia) Aftësitë e Gjelbërta) janë krijuar dhe funksionojnë, duke kontribuar në përshtatjen e përmbajtjes së AFP-së dhe programeve të trajnimit, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave të AFP-së **(qershor 2026).** Pesë (5) Kurrikula të Arsimit dhe Formimit Profesional[57] (përfshirë standardet e profesioneve përkatëse), në fushat e përcaktuara në Strategjinë e Specializimit Inteligjent[58] (S3), janë rishikuar nga Agjencia Kombëtare e AFP-së dhe Kualifikimeve dhe janë miratuar nga ministria përgjegjëse për AFP-në (**qershor 2026).** 85% e mësuesve përkatës të AFP-së janë trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP-së (**dhjetor 2026).** 50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së janë punësuar në sektorin përkatës të studimeve të tyre (3 muaj/6 muaj) pas diplomimit (të ndarë sipas gjinisë dhe llojit (të punësuar/të vetëpunësuar/vazhdojnë studimet e larta dhe punojnë në të njëjtën kohë); e monitoruar për çdo vit **(qershor 2027).**	2.1.1 Rishikim i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Periudhat kohore	Baza	Institucionet përgjegjëse
R - 2.1.1 Rishikimi i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Dy (2) komitete shtesë të Aftësive Sektoriale (Bujqësia; (Energjia) Aftësitë e Gjelbërta) janë krijuar dhe funksionojnë, duke kontribuar në përshtatjen e përmbajtjes së AFP-së dhe programeve të trajnimit, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave të AFP-së (qershor 2026): - Prioritizimi dhe përcaktimi i sektorit të parë për ngritjen e KS (2024); - Miratimi i urdhrit të përbashkët të ministrave, përkatësisht MAS-së dhe MEKI-t (2025); - Përzgjedhja e anëtarëve të KS (2025); - Miratimi i urdhrit të përbashkët të ministrave, përkatësisht MAS-së dhe MEKI-t (dhjetor 2025); - Kufizimi i sektorit të dytë për ngritjen e KS (2025); - Përzgjedhja e anëtarëve të KS (2026); - Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të dy mbledhjeve të KS, të zhvilluara me dy	(qershor 2026)	2 komitete sektoriale	MEKI, MAS, AKAFPK

[57] AFP- Arsimi dhe Formimi Profesional.

[58] S3 – *Smart Specialisation Strategy* - Strategjia e Specializimit Inteligjent (SSI).

komitete sektoriale (qershor 2026).			
Pesë (5) Kurrikula të Arsimit dhe Formimit Profesional[59] (përfshirë standardet e profesioneve përkatëse), në fushat e përcaktuara në Strategjinë e Specializimit Inteligjent[60] (S3), janë rishikuar nga Agjencia Kombëtare e AFP-së dhe Kualifikimeve dhe janë miratuar nga ministria përgjegjëse për AFP-në (qershor 2026): - Prioritizimi i nevojave nga ML-të për kurrikulat e reja/rishikuara (qershor 2025); - 5 standarde profesionale dhe standarde të kualifikimeve të hartuara dhe verifikuara (dhjetor 2025); - 5 kurrikulat e AFP-së të zhvilluara bazuar te standardet ku bazohen kualifikimet (qershor 2026).	(qershor 2026)	Statusi i kurrikulave të rishikuara të AFP-së sipas Strategjisë së Specializimit Inteligjent S3 (0).	MEKI, MAS, AKAFPK
85% e mësuesve përkatës të AFP-së janë trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP-së (dhjetor 2026): - Hartimi i programit të trajnimit të mësuesve bazuar te nevojat e mësuesve për zbatimin e 5 kurrikulave të reja/të rishikuara (korrik 2026); - Kryerja e programit të trajnimit (dhjetor 2026); - Kryerja e vlerësimit të mesëm të normave aktuale të punësimit (dhjetor 2025); - Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të reja për të rritur punësueshmërinë (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	Statusi i mësuesve të trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP-së.	MEKI, MAS, AKAFPK
50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së janë punësuar në sektorin përkatës të studimeve të tyre (3 muaj/6 muaj) pas diplomimit (të ndarë sipas gjinisë dhe llojit (të punësuar/të vetëpunësuar/vazhdojnë studimet e larta dhe punojnë në të njëjtën kohë); e monitoruar për çdo vit (qershor 2027) ● Kryerja e vlerësimit të mesëm të normave aktuale të punësimit (dhjetor 2025); ● Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të reja për të rritur punësueshmërinë (dhjetor 2026); ● 50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së që kanë një punë në sektorin përkatës të studimeve të tyre (qershor 2027).	(qershor 2027)	38%/baza 2023. Rezultatet e vitit 2023 të të diplomuarve në vitin akademik 2021–2022.	MEKI, MAS, AKPA, (AKAFPK/NAVETQ)

R – 2.1.2 Përditësimi i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm

Agjenda e Reformave 2024–2027 do të miratojë dhe zbatojë një sistem të ri të vlerësimit të performancës, i cili konsiston në një metodologji dhe instrumente për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale, për mësuesit në nivelet fillore dhe të mesme, me theks të veçantë te kompetencat e TIK-ut, brenda muajit qershor 2027. Ky hap i parë do të zbatohet së pari nëpërmjet përgatitjes së metodologjisë dhe instrumenteve, së dyti do të përmirësohen kapacitetet e drejtorëve të shkollave dhe specialistëve të njësive/zyrave arsimore vendore, duke trajnuar të paktën 50% të tyre. Më pas, do të bëhet një vlerësim i mësuesve, për të verifikuar nivelin e realizimit të kuadrit të kompetencave digjitale të mësuesve.

Risitë e përditësuara të kurrikulës do të konsistojnë në përditësimin e kompetencave kyç për të nxënit gjatë të gjithë jetës në përmbushje të Rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe të Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021–2026. Integrimi i lëndëve STEM, për të promovuar një kuptim gjithëpërfshirës në kurrikulën e shkencës, matematikës, inxhinierisë dhe teknologjisë në aplikime praktike

[59] AFP- Arsimi dhe Formimi Profesional.

[60] S3 – *Smart Specialisation Strategy* – Strategjia e Specializimit Inteligjent (SSI).

nëpërmjet projekteve ndërkurrikulare, eksperimenteve, simulimeve dhe zgjidhjes së problemeve në situata reale.

Hapi i parë i rëndësishëm përfshin miratimin dhe zbatimin e një sistemi të ri të vlerësimit të performancës, i cili konsiston në miratimin e një metodologjie dhe instrumentesh, për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale për mësuesit në nivelet fillore dhe të mesme. Miratimi dhe zbatimi i një sistemi të ri të vlerësimit të performancës, i fokusuar në vlerësimin e kompetencave digjitale, veçanërisht të kompetencave të TIK-ut, do të çonte në përmirësimin e performancës së mësuesve në përdorimin efektiv të teknologjisë në klasë. Mësuesit me formim të mirë në kompetencat digjitale mund të integrojnë teknologjinë në metodat e tyre të mësimdhënies, duke rritur angazhimin e studentëve dhe rezultatet e të nxënit. Hapi i dytë do të përfshijë përditësimin e kurrikulave bazë, në arsimin bazë parauniversitar që lidh arsimin me nevojat e tregut të punës, përkatësisht lëndët "Shkenca natyrore, Arte, Teknologji dhe TIK, dhe Gjuhët dhe Komunikimi". Përditësimi i kurrikulës bazë për t'u përshtatur nevojave të tregut të punës siguron që studentët të pajisen me aftësitë dhe njohuritë përkatëse që kërkohen në fuqinë punëtore. Duke përfshirë lëndë, të tilla si: Shkencat e Natyrës, Artet, Teknologjia, TIK, Gjuhët dhe Komunikimi, studentët mund të zhvillojnë një grup aftësish të plotë që i përgatit ata për mundësitë e ardhshme të punësimit. Si hap i tretë, 95% e mësuesve do të trajnohen për kurrikulat e reja dhe do të fillojë zbatimi i kurrikulave të reja.

Këta hapa synojnë të rrisin cilësinë e arsimit të ofruar në nivelet e arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë. Duke vlerësuar dhe përmirësuar performancën e mësuesve, duke përditësuar kurrikulat për të përmbushur nevojat aktuale dhe duke u siguruar që mësuesit janë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme, sistemi arsimor mund t'i përgatisë më mirë nxënësit për sukses, si në arsimin e mëtejshëm, po ashtu edhe në fuqinë punëtore. Theksimi i kompetencave digjitale dhe përafrimi i arsimit me nevojat e tregut të punës promovon një kulturë të të mësuarit gjatë të gjithë jetës si ndërmjet mësuesve dhe studentëve.

Përdorimi i platformave ndërvepruese për përvoja të personalizuara të të mësuarit, përdorimi i simulimeve dhe laboratorëve virtualë për të përmirësuar të kuptuarit e koncepteve komplekse përmes të mësuarit të përzier, të menduarit llogaritës që nga vitet e para të arsimit, integrimin e kodimit në lëndë të ndryshme për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve, integrimin e inteligjencës artificiale (IA) në kurrikul, duke përfshirë diskutimet mbi implikimet etike të teknologjive të IA-së, dhe edukimin e nxënësve për përdorimin e sigurt të internetit do t'i ndihmojë ata të eksplorojnë botën digjitale në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi. Kurrikula do të fokusohet gjithashtu në përgatitjen e nxënësve për karrierën e ardhshme dhe arsimimin e mëtejshëm. Kjo përfshin ofrimin e orientimeve profesionale, praktikave dhe udhëzimeve për zbulimin e aftësive.

Programi Kombëtar "Artet, Zejet dhe Sporti", i njohur edhe si programet jashtëshkollore (JOM), u zbatua gjatë vitit 2023, në sistemin arsimor parauniversitar në 200 shkolla, si qendra komunitare të përzgjedhura, duke angazhuar 644 anëtarë të stafit mësimor dhe 10,423 nxënës në 613 grupe, duke i mbështetur këto shkolla me burime materiale për të ndihmuar aktivitetet krijuese. Ky program inkurajon zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve në arsimin fillor dhe të lartë, krijimtarinë, inovacionin dhe angazhimin në nisma, aktivitete dhe projekte të kryera në shkolla në bashkëpunim dhe partneritet me prindërit, komunitetin dhe bizneset vendase.

Ky program synon të nxisë mësimin e artit dhe punimeve artizanale përmes aktiviteteve praktike, të promovojë aftësitë sipërmarrëse të nxënësve sa i përket ruajtjes dhe promovimit të vlerave të komunitetit ku ata jetojnë, si dhe të trashëgimisë sonë kulturore në fusha të ndryshme, si p.sh.: pikturë, veprimtari bujqësore etj.

Programi "Artet dhe Zejet", si një aktivitet jashtëshkollor në shkolla, mund të kontribuojë në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve dhe të rinjve, duke i pajisur ata me aftësi të vlefshme, duke nxitur krijimtarinë dhe inovacionin, duke promovuar ndërgjegjësimin dhe vlerësimin kulturor dhe duke ngjallur ndjenjën e komunitetit dhe mirëqenies personale. Në këtë drejtim, qeveria synon të zgjerojë programin nga 200 shkolla ose 17% të shkollave, në 26% të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm, brenda dhjetorit të vitit 2025, në 43% të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm brenda dhjetorit të vitit 2026 dhe në 65% të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm brenda qershorit të vitit 2027. Përfituesit e kësaj reforme janë: nxënësit e arsimit parauniversitar nga klasa 1 deri në 12, dhe mësuesit e drejtuesit në klasat 1–12 të arsimit parauniversitar.

Palët e interesit të përfshira: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, zyra vendore e arsimit parauniversitar, shkollat, donatorët, sindikatat etj.

Tabela 7: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritje**
Kontribuon për një sistem arsimor modern, të dobishëm dhe efektiv, duke i përgatitur më mirë nxënësit për kërkesat e fuqisë punëtore dhe duke promovuar zhvillimin gjithëpërfshirës.	Miratimi dhe zbatimi i një sistemi të ri të vlerësimit të performancës (një metodologji dhe instrumente për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale) për mësuesit e arsimit parauniversitar, veçanërisht për kompetencat TIK (qershor 2027). Përditësimi i kurrikulës bazë në arsimin parauniversitar, me qëllim për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës, përkatësisht në lëndët "Shkencat e natyrës, Artet, Teknologjia dhe TIK, dhe Gjuhët dhe Komunikimi" (dhjetor 2026). 95% e mësuesve janë trajnuar (qershor 2027) për kurrikulat e reja (programet e zhvillimit profesional për 50% të programeve lëndore) (dhjetor 2025). Fillimi i zbatimit të kurrikulës së re (qershor 2027). Zgjerimi i programit "Art dhe Zeje" në 65% të shkollave të arsimit parauniversitar (qershor 2027).	2.1.2 Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar

Plani i zbatimit dhe përgjegjësitë.

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
R-2.1.2 Përditësimi i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm			**Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**
Hapi 1 – Miratimi dhe zbatimi i një sistemi të ri të vlerësimit të performancës (një metodologji dhe instrumente për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale) për mësuesit e arsimit parauniversitar, veçanërisht për kompetencat TIK (qershor 2027): - Përgatitja e metodologjisë dhe instrumenteve për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve (qershor 2025); - Ngritja e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave dhe specialistëve të njësive arsimore vendore me të paktën 50% të tyre të trajnuar (dhjetor 2025); - Vlerësimi i mësuesve, për të verifikuar nivelin e realizimit të kuadrit të kompetencave digjitale të mësuesve (qershor 2027).	(qershor 2027)	Statusi i vlerësimit aktual të performancës për mësuesit në nivelet fillore dhe të mesme: Aktualisht, vlerësimi i performancës së mësuesit bëhet nga drejtori i shkollës sipas formateve të hartuara nga vetë drejtorët, bazuar tek standardet profesionale të mësuesit.	MAS, ASCAP, AKAP
Hapi 2 – Përditësimi i kurrikulës bazë në arsimin parauniversitar, me qëllim për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës, përkatësisht në lëndët "Shkencat e natyrës, artet, teknologjia dhe TIK-u, dhe gjuhët dhe komunikimi" (dhjetor 2026): - Përditësimi i kornizës kurrikulare sipas qasjes STEM (dhjetor 2024); - Përditësimi i 50% të programeve lëndore që do të zbatohen (dhjetor 2025); - Rishikimi i programeve lëndore sipas	(dhjetor 2026).	Statusi i kurrikulave bërthamë aktuale në arsimin bazë parauniversitar: Aktualisht, në sistemin arsimor parauniversitar, në të gjitha shkollat po zbatohet kurrikula me kompetencat e hartuara në vitin 2014.	MAS, ASCAP

qasjes STEM për klasat përkatëse (dhjetor 2026).			
Hapi 3 – 95% e mësuesve janë trajnuar për kurrikulat e reja (programet e zhvillimit profesional për 50% të programeve lëndore) (qershor 2027). - Hartimi i programit të zhvillimit profesional dhe materialeve mbështetëse për mësuesit për metodologji efektive dhe zbatimin e kurrikulës së përditësuar sipas qasjes STEM (dhjetor 2024); - Programet e zhvillimit profesional për 50% të programeve lëndore (PL) të përditësuara që do të zbatohen sipas qasjes STEM (dhjetor 2025); - 30% e mësuesve të trajnuar për 50% të programeve lëndore (PL), të përditësuara (qershor 2026); - Trajnimi i të paktën 95% të mësuesve që po zbatojnë kurrikulat e reja sipas klasave përkatëse për zbatimin e kurrikulës sipas qasjes STEM (qershor 2027).	(qershor 2027) (dhjetor 2025)	Statusi i mësuesve aktualë të trajnuar për kurrikulat e reja (0 mësues). Aktualisht, të gjithë mësuesit janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës ekzistuese, ndërsa mësuesit do të trajnohen kur të kemi kurrikulën e përditësuar. Statusi aktual i programeve të zhvillimit profesional për programet lëndore (PL).	MAS, ASCAP, IAL
Hapi 4 – Fillimi i zbatimit të kurrikulave të reja (qershor 2027). - Zbatimi i kurrikulës së re sipas klasave përkatëse për lëndët e përditësuara (qershor 2027).	(qershor 2027)	Statusi aktual i zbatimit të kurrikulave të reja: Zbatimi i kurrikulës së përditësuar nuk ka filluar.	MAS, ASCAP, AKAP, DRAP, ZVA, shkollat
Hapi 5- Zgjerimi i programit "Art dhe Zeje" në 65% të shkollave të arsimit parauniversitar (qershor 2027). - Zgjerimi i programit "Artet dhe Zejet" në 26% të shkollave bazë dhe të mesme (dhjetor 2025); - Zgjerimi i programit "Artet dhe Zejet" në 43% të shkollave bazë dhe të mesme (dhjetor 2026); - Zgjerimi i programit "Artet dhe Zejet" në 65% të shkollave bazë dhe të mesme (qershor 2027).	(qershor 2027).	200 shkolla (17% e totalit aktual).	MAS, MSHFR, ASCAP, AKAP, DRAP, ZVA, shkollat

R – 2.1.3 Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke vendosur një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) ofrojnë kuadrin për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Zbatimi i sigurimit të cilësisë në përputhje me ESG-të (*European Standards and Guidelines*) është një nga angazhimet kryesore të Procesit të Bolonjës. Si të tillë, ESG-të ofrojnë bazën për rritjen e besimit, lëvizshmërisë dhe njohjes ndërmjet sistemeve të arsimit të lartë. ESG- të ndahen në tri pjesë: Sigurimi i brendshëm i cilësisë, Sigurimi i jashtëm i cilësisë, Agjencitë e sigurimit të cilësisë.

ESG-të janë krijuar për t'u aplikuar në të gjithë arsimin e lartë, pavarësisht nga vendi ose mënyra e realizimit. Standardet përcaktojnë praktikën e rënë dakord dhe të pranuar, ndërsa udhëzimet përshkruajnë se si mund të zbatohen standardet, megjithatë kjo ndryshon në varësi të kontekstit.

ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), është një anëtar i ENQA-së që nga viti 2010 dhe statusi i saj është rinovuar në vitin 2022, për një periudhë 5-vjeçare. ASCAL-i ka

nisur punën për përfundimin e ESG-ve lidhur me rolin e saj, duke filluar me përditësimin e akteve të brendshme të funksionimit të saj, angazhimin e një studenti në grupet e vlerësimit të jashtëm, përfshirjen e një studenti në rolin monitorues në BA, etj. Të gjitha këto bënë të mundur aplikimin e ASCAL-it në ENQA. Gjithashtu, ASCAL-i ka nisur punën për rishikimin e kodit të cilësisë dhe mbështetjen/qasjen e tij ndaj ESG-ve. Kodi i cilësisë është subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme, në varësi të ndryshimit në ESG-të.

Nga 24 standarde të ESG-ve, Shqipëria ka zbatuar plotësisht njëzet prej tyre. Në kuadër të Agjendës së Reformave 2024–2027, fokusi do të vendoset për të siguruar zbatimin e pjesshëm të ESG 3.3. dhe ESG 2.7, deri në dhjetor 2025. ESG 2.7 lidhet me "Proceset e ankesave dhe apelimeve duhet të përcaktohen qartë si pjesë e projektimit të proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë dhe t'u komunikohen institucioneve", ndërsa ESG 3.3. "Agjencitë duhet të jenë të pavarura dhe të veprojnë në mënyrë autonome. Ato duhet të kenë përgjegjësi të plotë për operacionet e tyre dhe rezultatet e këtyre operacioneve të jenë pa ndikim nga palë të treta.". ESG-ja ofron një listë të aspekteve që konsiderohen të rëndësishme:

- Pavarësia organizative, e demonstruar nga dokumentacioni zyrtar (p.sh. instrumentet e qeverisë, aktet legjislative ose statutet e organizatës) që përcakton pavarësinë e punës së agjencisë nga palët e treta, si: institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe organizatat e tjera të interesit.

- Pavarësia operacionale: përcaktimi dhe funksionimi i procedurave dhe 23 metodave të agjencisë, si dhe emërimi i ekspertëve të jashtëm ndërmerren në mënyrë të pavarur nga palët e treta, si: institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe palët e tjera të interesuara.

- Pavarësia e rezultateve formale: ndërsa ekspertët nga grupet përkatëse të interesit, veçanërisht studentët, marrin pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë, rezultatet përfundimtare të proceseve të sigurimit të cilësisë mbeten përgjegjësi e agjencisë.

Situata aktuale në Shqipëri, në lidhje me ESG 2.7 është se nuk ekziston një sistem apelimi. Kjo do të trajtohet në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave. Për sa i përket ESG 3.3., MAS-i do ta përmbushë atë pjesërisht, duke plotësuar komponentin e tretë (pavarësia e rezultateve formale veçanërisht studentët, marrin pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë), duke synuar përfshirjen e studentëve. Këta komponentë që lidhen me ESG 2.7 dhe ESG 3.3 do të jenë pjesë e Dokumentit të Politikës që Ministria e Arsimit dhe Sportit aktualisht po harton. Gjithashtu, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë do të përditësohet, duke trajtuar edhe ESG 2.7. dhe ESG 3.3., i cili është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (IAL), që përcakton standardet e cilësisë, të detyrueshme për zbatim nga institucionet e arsimit të lartë.

Tabela 9: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke vendosur një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritje
Kontribuimi për një sistem arsimor më gjithëpërfshirës, efikas dhe të orientuar drejt cilësisë, duke përgatitur më mirë individët për fuqinë punëtore dhe duke nxitur mundësitë e të nxënit gjatë të gjithë jetës, duke: - rritur aftësitë e fuqisë punëtore dhe mundësive të punësimit, nëpërmjet njohjes së të nxënit të mëparshëm; - siguruar standardet e cilësisë, duke çuar në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe rritjen e besimit në arsimin dhe trajnimin profesional, nëpërmjet akreditimit të ofruesve të AFP-së; - Përafrimi me standardet evropiane: zbatimi i standardeve dhe udhëzimeve	Rregullimi dhe miratimi i kuadrit për njohjen/vlefshmërinë e përvojës së mëparshme të të mësuarit joformal dhe informal, dhe përfshirja e kualifikimeve të "të mësuarit përgjatë të gjithë jetës", përfshirë mikrokredencialet, në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (qershor 2026). 90% e ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së hyjnë në procesin e akreditimit (qershor 2027). Zbatimi i pjesshëm i ESG[61]-ve (përkatësisht ESG 2.7 dhe ESG 3.3) dhe futja e referencave të qarta në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të Kornizës Shqiptare, si kritere për akreditim (dhjetor 2025).	2.1.3 Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke vendosur një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. .

[61] ESG – *European Standards and Guidelines*.

evropiane (ESG), të cilat do të rrisin sigurimin e cilësisë së arsimit, duke promovuar transparencën, llogaridhënien dhe njohjen ndërkombëtare.		

Plani i zbatimit dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R-2.1.3 Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke vendosur një marrëdhënie të qartë dhe transparente ndërmjet niveleve kombëtare të kualifikimeve dhe niveleve përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Hapi 1 – Rregullimi dhe miratimi i kuadrit për njohjen/vlefshmërinë e përvojës së mëparshme të të mësuarit joformal dhe informal. dhe përfshirja e kualifikimeve të "të mësuarit përgjatë të gjithë jetës", përfshirë mikrokredencialet, në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (qershor 2026). - Hartimi i modelit të VPNIL-së bazuar tek analiza e modeleve ekzistuese në vende të tjera me sisteme të përputhshme të AFP-së (2024); - Zhvillimi i fazave dhe proceseve të VPNIL-së dhe hartimi i udhëzimit të ministrit (dhjetor 2024); - Pilotimi i përfshirjes së TNGjJ-së në KSHK për të orientuar përmirësimet në kuadrin ligjor (2025); - Kryerja e studimit të fizibilitetit për përfshirjen e mikrokredencialeve (2025); - Kuadri ligjor i plotë për të trajtuar përfshirjen e kualifikimeve gjatë të gjithë jetës, duke përfshirë mikrokredencialet (qershor 2026).	(qershor 2026)	Statusi i kuadrit ligjor në fuqi: nuk ekziston një kuadër ligjor, në lidhje me kualifikimet e përjetshme, duke përfshirë mikrokredencialet.	MEKI, AKPA (ASCAP, AKAFPK)
Hapi 2 – 90% e ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së hyjnë në procesin e akreditimit (qershor 2027): - Publikimi dhe shpërndarja e informacionit, për ofruesit e AFP-së, punëdhënësit dhe nxënësit, të sistemit të akreditimit (dhjetor 2024); - Kryerja e trajnimit të vazhdueshëm për vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit (shkurt 2025); - Zbatimi i procesit të akreditimit për të gjithë aplikantët (qershor 2027).	(qershor 2027)	Aktualisht, 28% e ofruesve të AFP-së i janë nënshtruar procesit të akreditimit.	MEKI, NAVETQ/AKAFPK (ASCAP)
Hapi 3 - Zbatimi i pjesshëm i ESG[62]-ve (përkatësisht ESG 2.7 dhe ESG 3.3) dhe futja e referencave të qarta në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të Kornizës Shqiptare, si kritere për akreditim (dhjetor 2025). Rishikimi i kodit të cilësisë së AL-së dhe mbështetja/qasja e tij ndaj ESG-ve (qershor 2025). - Plotësimi i pjesshëm i ESG-ve në lidhje me ASCAL-in, duke filluar me përditësimin e akteve të brendshme të funksionimit të tij, angazhimin e një studenti në grupet e vlerësimit të jashtëm, etj. (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Statusi i ESG 2.7 dhe ESG 3.3.: i pazbatuar .	MAS, ASCAP, IAL, ASCAL

[62] ESG – *European Standards and Guidelines*.

R – 2.1.4. Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), duke u mbështetur te tendencat botërore aktuale të arsimit, ka vendosur si prioritet integrimin e TIK-ut dhe digjitalizimin e arsimit në strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar. Kompetenca digjitale nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, në kohën e lirë dhe në komunikim. Ai mbështetet në aftësitë bazë kompjuterike për të gjetur, prodhuar, krijuar, paraqitur dhe ndarë informacione, si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet e informacionit në internet. Në kuadrin kurrikular të arsimit parauniversitar në Shqipëri, kompetenca digjitale është një kompetencë ndërsektoriale, e cila synohet të zhvillohet nga të gjitha lëndët përkatëse dhe jo vetëm nga lënda e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026 ka ndër objektivat e saj synimin 4: "Edukimi digjital dhe aftësitë digjitale: Transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies; Përshtatja dhe integrimi i teknologjisë digjitale është thelbësor jo vetëm për komunikimin, administrimin dhe menaxhimin, por është gjithashtu një aset në mbështetjen e të mësuarit dhe mësimdhënies". Sfida më e madhe në zhvillimin e kompetencave për mësuesit është nevoja për kompetenca specifike digjitale, që u mundësojnë atyre të përdorin teknologjinë për të mbështetur, përmirësuar dhe transformuar procesin e mësimdhënies, si dhe për përgjegjësi të tjera në shkollë.

Padyshim që ngritja e infrastrukturave të TIK-ut është një sfidë që çon në ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet. Forcimi i sistemeve dhe inkurajimi i ofrimit të shërbimeve *online* kërkon një angazhim konkret për zhvillimin e aftësive të TIK-ut që nga fëmijëria e hershme. Jo pa qëllim, ky angazhim tashmë është ndërmarrë dhe kanë filluar investimet e para në këtë drejtim. Aktualisht, rishikimi i kurrikulës së TIK-ut, përfshirë edhe atë në klasën e parë, nxit të menduarit krijues te nxënësit dhe orientimin e tyre drejt zgjidhjes së problemeve.

Përmirësimi i infrastrukturës digjitale, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe drejtorëve të shkollave, mirëmbajtja e pajisjeve etj., vazhdojnë të mbeten sfida kryesore. Kjo do të kërkojë ndryshime në standardet, mjetet dhe profilet mësimore ekzistuese.

Ne synojmë investimet në TIK që çojnë në përdorimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit në të gjitha nivelet, përfshirë arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë. Infrastruktura e TIK-ut do të garantojë ofrimin e shërbimeve *online* në të gjitha nivelet e arsimit dhe do të nxisë zhvillimin e kapaciteteve me aftësinë për të përdorur TIK-un.

Të gjitha sa më sipër, do të kontribuojnë në një digjitalizim më të avancuar të sistemit arsimor kombëtar, përmirësimin e rezultateve mësimore të nxënësve në nivelin parauniversitar dhe krijimin e më shumë mundësive të punësimit për ta dhe kapitalit më të mirë njerëzor për digjitalizim më të avancuar të ekonomisë shqiptare. Programi do të mundësojë, gjithashtu, ngritjen e kapaciteteve institucionale për përdoruesit e sistemit të përmirësuar me synimin për një bashkëpunim digjital më efektiv midis mësuesve, studentëve dhe familjeve të tyre.

Për sa u përket investimeve, Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027, do të fokusohet në mbështetjen e sigurimit të brezit të gjerë me shpejtësi të lartë në 95% të shkollave publike në krahasim me 33,2% të shkollave në 2023. Brezi i gjerë me shpejtësi të lartë është thelbësor për të mundësuar burime arsimore moderne, për të lehtësuar mësimin digjital dhe për të siguruar që nxënësit dhe mësuesit të kenë akses në informacionin dhe mjetet në internet.

Për më tepër, fokusi do të jetë në zbatimin e 200 shkollave[63] me *Smart Labs* dhe infrastrukturë të veçantë digjitale. Në fakt, niveli fillestar është 100 shkolla në programet *Smart Labs* në vitin 2023. Gjithashtu, është ofruar një aplikim pranë WBIF-së për të mbështetur financimin e 615 shkollave, për t'u mbështetur nga CEB-ja (marrëveshje kredie e paguar nga buxheti i shtetit) dhe WBIF-ja, për të cilin nuk ka asnjë konfirmim apo marrëveshje. Kjo shifër përfshin 200 shkollat që do të mbështeten nga Agjenda e Reformave dhe 615 shkollat që pritet të financohen nga WBIF-ja. *Smart Labs* përfshijnë teknologji moderne arsimore, internet me shpejtësi të lartë, mjete ndërvepruese dhe burime të tjera digjitale që përmirësojnë përvojën e mësimdhënies dhe të të nxënit.

[63] *Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.*

Përfitues të reformës janë nxënësit e arsimit parauniversitar në klasat 1–12 dhe mësues e drejtues të arsimit parauniversitar të klasave 1–12. Përfitues të kësaj reforme do të jenë edhe universitetet dhe studentët e tyre.

Palët e interesit të përfshira: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet e arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Parauniversitare, AKSHI, drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, zyra vendore e arsimit parauniversitar, shkollat, donatorët, sindikatat etj.

Tabela 10: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritje**
Promovimi i përfshirjes digjitale, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe mbështetja e zhvillimit të një fuqie punëtore të aftë e të përgatitur për ekonominë digjitale.	95% të shkollave publike me lidhje *broadband* me shpejtësi të lartë (të paktën 30 Mbit) (dhjetor 2025). Krijimi i *Smart Labs*[64], shoqëruar secili me infrastrukturën përkatëse digjitale, në 75% të shkollave publike (qershor 2027)[65]. Futja e lëndës TIK në të gjitha klasat e arsimit bazë dhe trajnimi i 500 mësuesve të arsimit parauniversitar për të dhënë mësim këtë lëndë (dhjetor 2026). Përmirësimi i kapaciteteve TIK në IAL[66], duke zhvilluar dhe konsoliduar një platformë të menaxhimit të informacionit për arsimin e lartë (dhjetor 2026). Certifikimi sistematik për programet e aftësive digjitale të arrijë në certifikimin e 6000 individëve (dhjetor 2026).	2.1.4 Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike.

Plani i zbatimit dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike			**Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**
Hapi 1 – 9 5% të shkollave publike me lidhje *broadband* me shpejtësi të lartë (të paktën 30 Mbit) (dhjetor 2025): - Përgatitja e termave të referencës (qershor 2025); - Publikimi i njoftimit të prokurimit (dhjetor 2025); - Shpallja e ofertuesit fitues dhe nënshkrimi i kontratës (dhjetor 2025); - Konfigurimet teknike për të siguruar lidhje interneti me shpejtësi të lartë për 95% të shkollave publike (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	33,2% në 2023	MAS, AKSHI, MIE
Hapi 2 – Krijimi i *Smart Labs*[67], shoqëruar secili me infrastrukturën përkatëse digjitale, në 75% të shkollave publike (qershor 2027): • Përfundimi i *Smart Labs* në 200 shkolla duke përfshirë trajnime teknike	(qershor 2027)	Statusi i "*Smart Labs*" të ngritura konkretisht – 100 *Smart Labs*. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në bashkëpunim me	MAS, AKSHI

[64] Program i qeverisë shqiptare që përfshin pajisjen e shkollave me laboratorë teknologjikë (laboratorë *smart*) të përshtatshëm për mësimdhënien e lëndës së TIK-ut në kushtet më optimale.

[65] Ky hap i reformës është pa paragjykim ndaj rregullave për aktivitetet e pranueshme, ku mbështetja e marrë nga një program tjetër financimi nuk mund të mbulojë të njëjtën kosto.

[66] IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë.

[67] Program i Qeverisë Shqiptare që përfshin pajisjen e shkollave me laboratorë teknologjikë (laboratorë smart) të përshtatshëm për mësimdhënien e lëndës së TiK në kushtet më optimale.

(dhjetor 2024). • Ngritja e kapaciteteve për përdorim më efikas të *Smart Labs* në funksion të mësimdhënies (dhjetor 2025). • Shtrirja e investimeve në infrastrukturën TIK në pjesën tjetër të shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm (qershor 2026 – 40% e të gjitha shkollave), (qershor 2027 – 75% e të gjitha shkollave).		Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, po zbaton projektin *Smart Labs* në të gjithë vendin (ngritja e *Smart Labs* – rrjeti i laboratorëve TIK për sistemin arsimor parauniversitar." Ky projekt po realizohet në tri faza kryesore: Faza e parë, përfshinte zbatimin e 100 *Smart Labs*-eve të parë, i cili ishte edhe projekti pilot (financuar me buxhetin e shtetit dhe donacionin e AADF-së). Kjo fazë ka përfunduar. Faza e dytë përfshin zbatimin e 216 laboratorëve shtesë me mbështetje financiare nga Banka Botërore (hua). Për pjesën e infrastrukturës së *Smart Lab*-eve, kjo fazë do të përfundojë në korrik 2024. Ndërkohë vijon procesi i prokurimit të mobilieve, trajnimit të mësuesve, trajnimit të drejtorëve të shkollave ku po zbatohet ky projekt, krijimit të kurrikulës së klasave të treta etj. Faza e tretë përfshin zbatimin e 654 *Smart Lab* -ëve shtesë në 615 shkolla në të gjithë vendin në sistemin arsimor parauniversitar. Kjo fazë do të zbatohet në periudhën 2024–2028. Burimi financiar për realizimin e kësaj faze është si më poshtë: • Granti i WBIF: 10,347,577 euro (25% e kostos totale). • Buxheti i shtetit: 3,318,423 euro (8% e kostos totale) hua nga CEB: 27,000,000 euro (67% e kostos totale).	
Hapi 3 – Futja e lëndës TIK në të gjitha klasat e arsimit bazë dhe trajnimi i 500 mësuesve të arsimit parauniversitar për të dhënë mësim këtë lëndë (dhjetor 2026). • Hartimi i kurrikulave të reja të TIK-ut për nivelet I–II–III të arsimit fillor dhe rishikimi i kurrikulave ekzistuese për nivelet IV–V në përputhje me qasjen e re të kodimit nga klasa e parë (qershor 2025). • Përgatitja e manualeve të trajnimit të mësuesve që i referohen kësaj qasjeje, të paktën për nivelet III–V (dhjetor	(dhjetor 2026)	Gjendja e kurrikulave aktuale të TIK-ut në arsimin fillor; Ka përfunduar rishikimi i kurrikulave të TIK-ut për nivelet I–II–III; Janë përgatitur edhe manuale për nivelet I–II; Manualet e nxënësve dhe mësuesve për nivelin III janë në proces. Trajnimi i mësuesve të TIK-ut të niveleve I–II kryhet	MAS, ASCAP,

2025). • Hartimi i programit të trajnimit të mësuesve të TIK-ut në përputhje me kurrikulën e re të TIK-ut, për klasat (I–V) (qershor 2026). • Trajnimi i të paktën 500 mësuesve në sistemin parauniversitar për zbatimin e kurrikulës së TIK-ut në klasat (I–V) (dhjetor 2026).		vetëm në shkollat që aktualisht kanë laboratorë SMART (100 shkollat e mbështetura nga AADF-ja dhe 200 shkollat e Bankës Botërore).	
Hapi 4 - Përmirësimi i kapaciteteve TIK në IAL[68], duke zhvilluar dhe konsoliduar një platformë të menaxhimit të informacionit për arsimin e lartë (dhjetor 2026) - Hartimi i TeR-ve për sistemin e menaxhimit të informacionit në IAL – Sistemi SMIAL (dhjetor 2024) - Funksionalizimi i sistemit dhe trajnimi i stafit të IAL-ve (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	Statusi i kapaciteteve aktuale të TIK-ut në IAL: nuk ekziston një platformë e menaxhimit të informacionit në arsimin e lartë.	MAS
Hapi 6 – Certifikimi sistematik për programet e aftësive digjitale të arrijë në certifikimin e 6000 individëve (dhjetor 2026). - Certifikimi i deri në 3000 individëve për aftësitë digjitale[69] (qershor 2025). - Certifikimi i 6000 individëve për aftësitë digjitale (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026).	2820 individë në 2022	MEKI, AKPA

2.2 Tregu i punës

Zhvillimet në tregun e punës kanë qenë pozitive dhe në rikuperim të vazhdueshëm pas rënies së aktivitetit ekonomik të shkaktuar nga pandemia. Kuadri strategjik i hartuar për tregun e punës lidhet me "Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023–2030".

Gjatë të gjithë vitit 2023, tregu i punës vazhdoi tendencën e rënies së nivelit të papunësisë dhe niveleve më të larta të punësimit. Këto prirje pasqyrojnë dinamikën pozitive të situatës së përgjithshme ekonomike në Shqipëri deri në tremujorin e tretë të vitit 2023. Për nëntë muajt e parë të vitit 2023, rritja vjetore e numrit të individëve të punësuar ishte mesatarisht 2,7 për qind. Nga këndvështrimi i ofertës së punës, kjo rritje e punësimit është nxitur kryesisht nga rritja e vazhdueshme e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe, më tej, shkalla e punësimit, e cila në tremujorin e tretë të 2023 arriti në 76 për qind (nga 73,4 për qind një vit më parë, T3-2022) dhe 67,7 për qind (nga 65,4 për qind një vit më parë, T3-2022), respektivisht. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e vitit 2023 (për grupmoshën 15–64 vjeç) ishte 11,2 për qind, duke rënë nga niveli 11,3 për qind në të njëjtën periudhë të vitit 2022. Konkretisht, për tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e papunësisë për grupmoshat 15–64 vjeç u regjistrua në nivelin 11,0 për qind. Për grupmoshën 15 vjeç e lart, shkalla e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023 shënoi një nivel edhe më të ulët prej rreth 10,5 për qind.

Sigurimi dhe nxitja e punësimit në vend dhe angazhimi i të rinjve në punësim të qëndrueshëm kërkon politika edhe më të forta nga qeveria, për të trajtuar në mënyrë efektive fenomenin e emigrimit të të rinjve.

Megjithatë, rritja e fundit e punësimit nuk përputhet me një rritje të barasvlershme të kontribuesve të sigurimeve shoqërore, gjë që mund të tregojë një rritje të punësimit informal. Shkalla e papunësisë për moshat 15–29 vjeç ka qenë vazhdimisht mbi 20%, duke paraqitur nga njëra anë një rritje të përqindjes së pjesëmarrjes së tyre me 3 pikë përqindjeje, por nga ana tjetër një rritje të numrit të të papunëve të moshës 25–29 vjeç. Megjithëse rritja e punësimit vazhdoi në gjysmën e parë të 2023-shit me një mesatare prej 3,5%, nuk e uli normën e përgjithshme të papunësisë, kryesisht për shkak të rritjes së numrit të të rinjve të papunë (15–29).

[68] IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë.
[69] Kumulative nga 2024.

R – 2.2.1 Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Punësimit

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM-ja nr. 173/2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030", Plani i Veprimit për zbatimin e saj, si dhe Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore. Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (SKPA) 2023–2030 është "Punësim cilësor dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës për të gjithë". Qëllimet e politikës së kësaj strategjie janë:

- Zhvillimi i aftësive dhe përshtatja më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë mundësi punësimi;
- Mundësimi i punësimit të denjë për gratë dhe burrat nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës.

Objektivi kryesor është identifikimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme nxitëse në vend për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, me qëllim krijimin e punësimit cilësor dhe trajnimit të vazhdueshëm për të gjithë.

Hapat e parashikuar në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027" (AKR 2024–2027) synojnë trajtimin e papunësisë dhe promovimin e mundësive të punësimit, duke përfshirë sa vijon:

- Targetim i diversifikuar i PATP-së: PATP-ja synon grupe specifike të punëkërkuesve, duke përfshirë ata që marrin ndihmë ekonomike, individë të papunë afatgjatë dhe individë të papunë afatgjatë me arsim bazë ose pa arsim të mëparshëm. Duke ofruar mbështetje të diversifikuar të përshtatur për nevojat e këtyre grupeve, politika synon të rrisë punësueshmërinë e tyre dhe shanset për të gjetur punësim të qëndrueshëm. Gjatë vitit 2023, numri i përgjithshëm i punëkërkuesve ishte 76.580, nga të cilët 41.533 ishin gra, 26.909 merrnin ndihmë ekonomike, 6.870 ishin romë dhe egjiptianë dhe 1.607 ishin persona me aftësi të kufizuara.
- Rritja e Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP): qëllimi është rritja e numrit të individëve të papunë të regjistruar që marrin pjesë në programet aktive të tregut të punës në 8%. Këto programe mund të përfshijnë trajnime, shërbime për vendosjen e punës, punësim të subvencionuar ose nisma të tjera të projektuara për të ndihmuar individët të rihyjnë në fuqinë punëtore. Numri i punëkërkuesve të papunë që përfituan nga PATP-ja gjatë vitit 2023 arrin në 10.017 individë, nga të cilët 2.635 kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit dhe 7.382 nga kurset e formimit profesional. Për gjashtë muajt e parë, numri i përfituesve të PATP-së është 5008 punëkërkues të papunë, ose 6,5% e bazës së të dhënave.
- Angazhimi i zgjeruar me zyrat e punësimit: synohet rritja e numrit të punëkërkuesve të regjistruar në zyrat e punësimit në 60% të totalit të popullsisë së papunë. Numri i individëve të regjistruar në bazën e të dhënave të AKPA-s gjatë vitit 2023 është 76.580 punëkërkues të papunë.
- Zgjerimi i Formimit Profesional: fokusi është rritja e numrit të individëve të papunë të regjistruar në programet e formimit profesional në 20% të totalit të popullsisë së papunë. Formimi profesional i pajis individët me aftësi dhe kualifikime specifike që përputhen me kërkesat e tregut të punës, duke rritur gjasat e tyre për të gjetur punë. Numri i individëve, që iu nënshtruan kurseve të formimit profesional gjatë vitit 2023, arrin në 7.382 persona (individë unikë pasi u eliminuan dublikatat për shkak të ndjekjes së më shumë se një kursi brenda vitit).
- Programet e Nxitjes së Punësimit (PNP): synimi është të lehtësojnë punësimin e individëve të papunë përmes PNP-së së AKPA-s, me një objektiv prej 5,000 punësime. Kjo masë thekson rëndësinë e promovimit të mundësive të punësimit dhe lehtësimit të përputhjeve ndërmjet punëkërkuesve dhe punëdhënësve, me fokus te barazia gjinore dhe mbështetja për grupet e cenueshme. Numri i individëve të papunë që janë punësuar përmes programit PNP të AKPA-s është 2.635 gjatë vitit 2023.

Në përgjithësi, këto masa synojnë të trajtojnë papunësinë, duke ofruar mbështetje të synuar, duke rritur aksesin te shërbimet e punësimit, duke zgjeruar mundësitë e trajnimit dhe duke promovuar krijimin e vendeve të punës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit. Fokusi tek të dhënat e kategorizuara sipas gjinisë dhe grupeve të cenueshme nxjerr në pah një angazhim për të siguruar përfshirje dhe barazi në rezultatet e punësimit.

Tabela 11: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Punësimit

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritje
	Ofrim i programeve aktive të tregut të punës, të reja dhe të diversifikuara, që synojnë mbështetjen për	2.2.1 Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Punësimit

Ulja e niveleve të papunësisë, duke ofruar mbështetje të synuar, duke rritur pjesëmarrjen në aktivitetet e kërkimit të punës dhe duke përmirësuar aftësitë e punëkërkuesve, duke nxitur përfundimisht rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale.	punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, punëkërkuesit e papunë afatgjatë dhe punëkërkuesit e papunë afatgjatë me arsim bazë/pa arsim paraprak (qershor 2025). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në programet aktive të tregut të punës në 8% (qershor 2026). Rritja e numrit të regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve (qershor 2026). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë në formimin profesional në 20% të totalit të punëkërkuesve të papunë (dhjetor 2026). Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes programeve të promovimit të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në 5000 (të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe grupeve vulnerabël) (dhjetor 2027).	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R 2.2.1 Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Punësimit			**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**
Hapi 1 – Ofrimi i programeve aktive të tregut të punës, të reja dhe të diversifikuara, që synojnë mbështetjen për punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, punëkërkuesit e papunë afatgjatë dhe punëkërkuesit e papunë afatgjatë me arsim bazë/pa arsim paraprak (qershor 2025) - VKM-ja për PATP-në e re për integrimin social të grupeve të cenueshme dorëzuar për miratim (qershor 2024); - Miratuar PATP-ja për integrimin social të grupeve të cenueshme (2024); - Kryerja e programit të trajnimit për PATP-në e re (2024); - PATP-ja për integrimin social të grupeve të cenueshme është funksionale (qershor 2025).	(qershor 2025)	PATP-të ekzistuese (2023)	MEKI, (AKPA)
Hapi 2 – Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në programet aktive të tregut të punës në 8% (qershor 2026): - Digjitalizimi i procedurave dhe thjeshtimi i pjesëmarrjes në PATP (dhjetor 2024); - Miratuar buxheti i rritur për PATP-të (dhjetor 2025); - 8% e punëkërkuesve të papunë të regjistruar në programet aktive të tregut të punës (qershor 2026).	(qershor 2026)	6,5% niveli bazë janar–qershor 2023 (punëkërkuesit e papunë të regjistruar, të trajtuar me formim profesional ose PNP).	MEKI, (AKPA)
Hapi 3 – Rritja e numrit të regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve (qershor 2026): - Digjitalizimi i shkëmbimit të informacionit me Sistemin e Shërbimit Social (dhjetor 2024); - Rritja e Regjistrimit të NEET-ve nga programi i Garancisë Rinore (dhjetor 2025);	(qershor 2026)	2023-shi është 48,2%.	MEKI , (AKPA)

- 60% e totalit të të papunëve punëkërkues të regjistruar në zyrat e punës (qershor 2026).			
Hapi 4 - Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë në Formimin Profesional në 20% të totalit të punëkërkuesve të papunë (dhjetor 2026): - Zbatimi i sistemit digjital të Formimit Profesional (qershor 2024). - Miratuar rregullorja për operacionalizimin e qendrave multifunksionale (dhjetor 2025); - 20% e totalit të punëkërkuesve të papunë në formimin profesional (kumulativ) (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	2023-shi është 9,7 %.	MEKI, (AKPA)
Hapi 5 – Rritja e numrit të punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes programeve të promovimit të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në 5000 (të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe grupeve vulnerabël (dhjetor 2027): - Numri i punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes PNP-ve të AKPA-së është 3500 (dhjetor 2025). - Numri i punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes PNP-ve të AKPA-së është 4300 (dhjetor 2026). - Numri i punëkërkuesve të papunë që punësohen përmes PNP-ve të AKPA-së është 5000, të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe grupeve të cenueshme (dhjetor 2027).	(dhjetor 2027)	2.635 përfitues në 2023-shin.	MEKI, (AKPA)

2.3 Kërkimi dhe zhvillimi

Shkenca, teknologjia dhe inovacioni konsiderohen thelbësore për një shoqëri të bazuar në dije në të gjitha fazat e zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Investimet kryhen për krijimin, shpërndarjen dhe aplikimin e njohurive me synimin e përmbushjes së objektivave afatgjatë të zhvillimit. Sistemi i kërkimit shkencor përfshin institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore-shkencore, zhvillimin e dijes dhe teknologjisë (inovacionin), si dhe ndërmarrjet private që operojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit. Një ndikim i rëndësishëm në rezultatet shkencore ka qenë përafrimi i aktiviteteve kërkimore me direktivat e BE-së dhe nismat evropiane, veçanërisht me programet kuadër *Horizon* 2020 dhe aktualisht *Horizon Europe*.

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 në Shqipëri fokusohet veçanërisht te:

- Përmirësimi i infrastrukturës bazë kërkimore për të mbështetur në mënyrë të përshtatshme formimin universitar në tri nivele (BSc, MSc, PhD);
- Krijimi i ekselencës shkencore në fushat prioritare të kërkimit shkencor;
- Tërheqja e njerëzve të kualifikuar në sistemin shqiptar të kërkimit;
- Forcimi i lidhjeve ndërmjet organizatave kërkimore shkencore dhe sektorit privat për të promovuar inovacionin si bazë për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës;
- Rritja e perceptimit dhe të kuptuarit publik të shkencës, me qëllim të ndërgjegjësimit për rolin e inovacionit dhe teknologjive të reja për shoqërinë dhe ekonominë; dhe
- Zhvillimi i një Plani Stimujsh, duke garantuar sigurimin e burimeve të nevojshme për tërheqjen e fondeve evropiane që synojnë rritjen e pjesëmarrjes, interesit, përvojës dhe kontributit të mundshëm të komunitetit shkencor dhe teknologjik shqiptar në këto programe.

Në programet kuadër të BE-së, Shqipëria është plotësisht e lidhur me *Horizon Europe*. Pjesëmarrja në program në vitin 2022 është përmirësuar pasi Shqipëria ka marrë pjesë në programet kuadër të BE-së për Kërkim dhe Inovacion (9 projekte me një financim total prej 1,7 milionë eurosh). Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje për të rritur më tej pjesëmarrjen e sektorit privat në *Horizon Europe*. Përpjekjet kombëtare për inovacion duhet të përafrohen me agjendën e re evropiane të inovacionit.

R – 2.3.1 Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit, duke miratuar kornizën strategjike aftësuese

Sistemi kombëtar shqiptar i kërkimit rregullohet nga ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë". Një ligj i ri është në zhvillim e sipër dhe pritet të miratohet deri në dhjetor të vitit 2024. "Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030" identifikon politikat kryesore, një vizion, synime dhe objektiva strategjikë për zhvillimin e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit duke e harmonizuar atë me parimet e ERA-s.

Në vitin 2022, Shqipëria mori pjesë për herë të parë në analizën evropiane të Tabelës Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (*European Inovation Scoreboard* – EIS)[70], me të dhëna të mbledhura me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Statistikave. Nuk disponohen të dhëna për financimin dhe shpenzimet e K&ZH në Shqipëri deri më sot ose për kërkuesit që kryejnë veprimtari kërkimore. Këta tregues mungonin në EIS. Me 23 tregues të disponueshëm, Shqipëria konsiderohet një inovatore në zhvillim me performancë në 41,7% të mesatares së BE-së. Shqipëria nuk ka ende një regjistrim për infrastrukturën kërkimore në IAL-të publike dhe private.

Shqipëria është gjithashtu ende në hapat e parë në lidhje me qasjen e të dhënave të hapura të kërkimit dhe nismat ndërmerren në kuadër të projekteve të financuara nga BE-ja, si Shërbimet e të Dhënave të Evropës Juglindore (SEEDS), që synojnë krijimin e shërbimeve të reja të të dhënave në Ballkanin Perëndimor.

Shkenca përfaqëson një ndryshim thelbësor drejt nxitjes së një ekonomie të udhëhequr nga inovacioni në Shqipëri. Miratimi i këtyre masave sinjalizon një angazhim për përafrimin e kërkimit dhe zhvillimit kombëtar me standardet ndërkombëtare, gjë që është thelbësore për rritjen e avantazhit konkurrues të Shqipërisë në arenën globale. Duke lehtësuar aksesin e studiuesve shqiptarë në një platformë që ofron akses falas në botimet kërkimore, jo vetëm mbështetet përparimi akademik dhe shkencor, por gjithashtu promovohet transparenca dhe bashkëpunimi përmes parimeve të *Open Science*.

Për më tepër, krijimi i një plani veprimi për ta shtyrë Shqipërinë drejt klasifikimit si një novator i moderuar në Tabelës Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (EIS) është veçanërisht i rëndësishëm.

Si fazë e parë, ne do të përgatisim një analizë, për të kuptuar më mirë metodologjinë e EIS-it, sipas së cilës do të identifikojmë pikat e forta dhe të dobëta, dhe do të hartojmë masa për trajtimin e çështjeve të politikave, në mënyrë që të sigurojmë rritje në renditjen e tabelës së pikëzimit. Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm se dy veprime janë shumë të rëndësishme, pasi të kryhet kjo analizë e plotë:

- një progres thelbësor në raportim, i cili do të na ndihmojë të kuptojmë vlerën e metodologjisë dhe tabelës së rezultateve si një mjet;
- një plan veprimi, i cili do të na çojë në përmirësimin e renditjes në EIS dhe arritjen e progresit (niveli i progresit do të jetë më i qartë pasi të përpunojmë planin me masat e politikave dhe objektivat konkretë për t'u arritur).

Veçanërisht, plani i veprimit, me masa specifike për të përmirësuar raportimin dhe performancën në 32 tregues të Tabelës Evropiane të Pikëzimit të Inovacionit (EIS), nënvizon një qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar kapacitetin e vendit për inovacion. Këto veprime do të pasqyrojnë një vizion strategjik që i jep përparësi kërkimit dhe inovacionit si shtytësit kryesorë të rritjes ekonomike dhe përparimit shoqëror.

Tabela Evropiane e Pikëzimit të Inovacionit përbëhet nga 32 tregues të grupuar në 12 dimensione si: sisteme kërkimore tërheqëse, investim i fortë në kërkim dhe zhvillim dhe përdorim i teknologjive të informacionit. Për Shqipërinë janë mbledhur dhe raportuar 18 tregues deri në vitin 2014. Synimi është që në kuadër të Planit të Veprimit, masat që do të orientojnë përpjekjet tona drejt rritjes së pikëve në renditjen e ESI-t, të sigurojnë një raportim më të mirë, duke rritur numrin e treguesve raportues nga 18 në vitin 2024 në 24 tregues që do të raportohen në vitin 2025. INSTAT-i do të vazhdojë punën për të prodhuar të dhëna përkatëse dhe të fundit, për të rritur rezultatin e Shqipërisë dhe për t'u klasifikuar mbi

[70] Tabela Evropiane e Pikëzimit të Inovacionit ofron një vlerësim krahasues të performancës së Kërkimit dhe Inovacionit të shteteve anëtare të BE-së, vendeve të tjera evropiane dhe fqinjëve rajonalë. Ajo i ndihmon vendet të vlerësojnë pikat e forta dhe të dobëta të sistemeve të tyre kombëtare të inovacionit dhe të identifikojnë sfidat që duhet të adresojnë. Bazuar te rezultatet e tyre, vendet ndahen në katër grupe të performancës: Udhëheqësit e inovacionit, novatorët e fortë, novatorët e moderuar dhe novatorët në zhvillim.

mesataren e novatorëve në zhvillim. Këto përpjekje të udhëhequra nga metodologjia e EIS-it do të fokusohen në fushat kryesore të mëposhtme: Digjitalizimi, Kërkimi dhe zhvillimi, Përdorimi i teknologjive të informacionit, qëndrueshmëria mjedisore etj. Këto përmirësime janë pjesë e angazhimit tonë të vazhdueshëm për të ofruar statistika të sakta, të dobishme dhe në kohën e duhur.

Përfituesit e reformës janë: universitetet, institucionet kërkimore.

Palët e interesit të përfshira: Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKKSHI, AKSHI, studiues etj.

Tabela 12: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit, duke miratuar kornizën strategjike aftësuese

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritje
Avancimi i ekosistemit të kërkimit dhe inovacionit të Shqipërisë, nxitja e rritjes ekonomike dhe rritja e konkurrencës së saj globale.	Miratimi i Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) (dhjetor 2024). Miratimi i ligjit dhe zbatimi i legjislacionit për shkencën dhe kërkimin, në përputhje me politikën e Zonës Evropiane të Kërkimit (dhjetor 2025). Krijimi nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor i një platforme për promovimin e Shkencës së Hapur, duke u dhënë studiuesve shqiptarë akses në botimet kërkimore të mundësuara nga institucionet e tyre (qershor 2027). Miratimi i një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (*European Inovation Scoreboard*), me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI (dhjetor 2025).	**2.3.1** Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit, duke miratuar kornizën strategjike aftësuese

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R-2.3.1 Forcimi i mjedisit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit, duke miratuar kornizën strategjike aftësuese			**Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**
Hapi 1 – Miratimi i Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) (dhjetor 2024): • Finalizimi i projekt strategjisë; • Miratimi i projektstrategjisë së Specializimit Inteligjent dhe i Modelit të Qeverisjes për zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit, nga Komisioni Ndërministror për S3; • Dërgimi i projekt strategjisë për verifikim nga JRC/KE; • Përditësimi i variantit përfundimtar të S3 në përputhje me komentet e JRC/KE; • Konsultimi publik i dokumentit përfundimtar; • Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga Këshilli i Ministrave (dhjetor 2024).	(dhjetor 2024)	Nuk ka strategji S3 në fuqi.	Zv./Kryeministre
Hapi 2 – Miratimi i ligjit dhe zbatimi i legjislacionit për shkencën dhe kërkimin, në përputhje me politikën e Zonës Evropiane të Kërkimit (dhjetor 2025): • Miratimi i "Ligjit të ri për shkencën dhe kërkimin në Shqipëri" (dhjetor 2024); • Miratimi i akteve nënligjore në përputhje	(dhjetor 2025)	Statusi i legjislacionit aktual për shkencën dhe kërkimin në fuqi (nuk ka ligj).	MAS, AKKSHI

me kuadrin ligjor të ERIC-së, që lehtëson ngritjen dhe funksionimin e infrastrukturës kërkimore (dhjetor 2025).			
Hapi 3 – Krijimi nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor i një platforme për promovimin e Shkencës së Hapur, duke u dhënë studiuesve shqiptarë akses në botimet kërkimore të mundësuara nga institucionet e tyre (qershor 2027): • AKKSHI do të krijojë mjete dhe metoda që do të promovojnë shkencën e hapur (qershor 2026); • MAS-i, AKKSHI dhe AKSHI të krijojnë ACRIS (një infrastrukturë informacioni të qëndrueshme digjitale) si ruajtje e të dhënave për studiuesit, publikimet dhe projektet kërkimore (qershor 2027).	(qershor 2027)	Asnjë platformë në *Open Science.*	MAS, AKKSHI, AKSHI
Hapi 4 – Miratimi i një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (*European Inovation Scoreboard*), me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI (dhjetor 2025). • Harta e palëve të interesit (institucionet qendrore të politikëbërjes dhe zbatimit) (dhjetor 2024); • Vlerësimi i Tabelës Evropiane të Pikëzimit të Inovacionit në Shqipëri – analiza e pikave të dobëta dhe pikave të forta të Shqipërisë dhe fushat për ndërhyrje në politika (dhjetor 2024); • Përcaktimi i qeverisjes, procesit të rishikimit dhe kadencës (qershor 2025); • Nismat dhe projektet e deritanishme; të ndiqet një qasje e menaxhimit të portofolit midis institucioneve (qershor 2025); • Plani i veprimit për përmirësimin e renditjes (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Statusi i planit të veprimit për EIS-in: Aktualisht nuk ekziston asnjë plan veprimi për EIS-in.	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

8. FUSHA E POLITIKËS 3: DIGJITALE

3.1 Digjitale

Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026 përvijon katër shtylla kryesore:

- Qeveria digjitale: Mundësimi i politikave digjitale, proceseve inteligjente dhe zgjidhjeve të përparuara në platforma të sigurta;
- Biznesi digjital: Shërbime të aksesueshme, proaktive dhe veprime të gatshme për biznes;
- Qytetarët digjitalë: Qytetarët dhe privatësia, transparenca e të dhënave dhe shërbimet ndaj qytetarëve;
- Edukimi digjital dhe aftësitë digjitale: Transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies.

Agjenda Digjitale synon të përmirësojë shërbimet publike, operacionet e biznesit, angazhimin e qytetarëve dhe edukimin, duke investuar në teknologji të avancuara kompjuterike, inteligjencën artificiale, *blockchain* dhe sigurinë kibernetike. Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026 përputhet me Agjendën Digjitale 2030 të BE-së, duke theksuar përmirësimin e infrastrukturës digjitale, promovimin e inovacionit dhe sipërmarrjes digjitale, përmirësimin e aftësive dhe edukimit digjital, përmirësimin e shërbimeve publike digjitale dhe duke i dhënë përparësi sigurisë kibernetike dhe besimit.

Në përgjithësi, si Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026, ashtu edhe Agjenda Digjitale e BE-së 2030 ndajnë synime të përbashkëta të përdorimit të teknologjive digjitale për të nxitur rritjen ekonomike, për të përmirësuar shërbimet publike, për të përmirësuar aftësitë digjitale dhe për të forcuar sigurinë kibernetike. Të dyja synojnë të shfrytëzojnë potencialin e digjitalizimit për të promovuar zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në rajonet e tyre përkatëse.

Fusha e Politikave 3 përputhet me prioritetet e përshkruara në Agjendën Digjitale Shqipëri 2022–2026. Fusha e politikave synon të rrisë produktivitetin dhe efikasitetin përmes konkurrencës dhe reformave rregullatore, të cilat janë thelbësore për nxitjen e inovacionit dhe avancimit teknologjik. Fusha e politikave mbështet synimet e Agjendës Digjitale në Shqipëri për të zhvilluar aftësi të avancuara digjitale dhe për të nxitur investimet në teknologjitë më të avancuara. Për më tepër, theksi i Agjendës së Reformave në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe edukimit përputhet me objektivat e Agjendës Digjitale për modernizimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e aftësitë kibernetike. Në përgjithësi, Agjenda e Reformave plotëson Agjendën Digjitale në Shqipëri, duke krijuar një mjedis të favorshëm për transformimin digjital, duke nxitur konkurrencën dhe duke siguruar autonomi strategjike në sferën digjitale, me synimin përfundimtar që Shqipëria të bëhet globalisht konkurruese, strategjikisht autonome dhe e transformuar në pikëpamjen digjitale.

Objektivat e propozuar në fushën e politikave 3 u përgjigjen sfidave të identifikuara në reformat strukturore, pjesë e Programit më të fundit të Reformës Ekonomike të Shqipërisë për 2024–2026, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka prezantuar Masën e Reformës 4.2, e cila fokusohet në rritjen e aksesit tek *e-shërbimet*, përmirësimin e kompetencave digjitale të përdoruesve dhe forcimin e nismave *GovTech*. Aktivitetet kryesore të parashikuara për vitet në vijim përfshijnë ngritjen dhe funksionimin e 200 *Smart Labs* nga AKSHI dhe pajisjen me laptopë për 5.500 mësues të shkollave të mesme, duke siguruar përdorimin efektiv të Sistemit SMIP (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar). Këto nisma janë të harmonizuara në mënyrë strategjike me objektivat e përshkruar në fushën e politikave 2.

Fusha e politikave 3 vë theksin tek inovacioni institucional, duke nënvizuar nevojën për të përmirësuar strukturat e qeverisjes. Për më tepër, fusha e politikave fokusohet te promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje, modernizimi i ndërhyrjeve të qeverisë dhe zbatimi i reformave gjithëpërfshirëse për të përmirësuar qeverisjen, mbështetjen e rritjes ekonomike dhe forcimin e institucioneve.

Vitet e fundit, është njohur gjithnjë e më shumë rëndësia e zgjerimit të qeverisjes elektronike në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe aksesit në shërbimet publike. Për të siguruar zbatimin dhe qëndrueshmërinë e suksesshme të praktikave të qeverisjes elektronike, është e domosdoshme të krijohet një kuadër ligjor i qëndrueshëm, që përputhet me përparimet teknologjike dhe proceset administrative. Kuadri ligjor dhe rregullator në lidhjen digjitale, ligji për komunikimet elektronike nr. 54/2024, datë 30.5.2024 dhe Plani Kombëtar i *Broadband*-it, miratuar me VKM-në nr. 434, datë 3.6.2020, janë të përafruara me praktikat e BE-së dhe në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes së plotë dhe mosdiskriminimit. Në veçanti neni 1 dhe neni 5, i ligjit nr. 54/2024, promovojnë zhvillimin e lidhjes digjitale dhe synojnë të sigurojnë akses në shërbime mbi baza të barabarta.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa specifikë për të çuar përpara përpjekjet e saj të digjitalizimit në përgatitje për anëtarësimin në BE, duke përfshirë miratimin e një Agjende Digjitale dhe Planit të Veprimit për 2022–2026, duke u fokusuar në rritjen e aftësive digjitale, zhvillimin e shërbimeve digjitale dhe përafrimin me standardet e BE-së. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut është një nga prioritetet e qeverisë dhe pjesë e objektivave strategjikë kombëtarë për zhvillim dhe integrim.

Shqipëria po i përqafon këto zhvillime dhe ka identifikuar në dokumentet shtetërore (SKZHI 2030, PRE 2024–2026, Plani Kombëtar *Broadband*) lidhjen digjitale dhe infrastrukturën *broadband*, si prioritete kyçe për të zhvilluar më tej infrastrukturën e saj digjitale, rrjetet dhe shërbimet e së ardhmes bazuar në rrjete komunikimi të hapura, globale dhe të ndërveprueshme, të besueshme dhe të sigurta, ku respektohen të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe drejtësia.

R – 3.1.1 Përputhshmëria me rregulloren e identitetit digjital dhe zbatimi i *e-portofolit* digjital për shërbimet publike

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të saj digjitale në vitet e fundit, e nxitur nga një angazhim për të modernizuar qeverisjen, për të rritur efikasitetin dhe për të promovuar rritjen ekonomike. Qeveria e ka njohur rëndësinë e digjitalizimit si një shtytës kryesor i zhvillimit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për shfrytëzimin e teknologjisë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, promovimin e transparencës dhe rritjen e angazhimit të qytetarëve.

Një aspekt i dukshëm i përpjekjeve të Shqipërisë për transformimin digjital është miratimi i shërbimeve digjitale të sigurta për të lehtësuar ndërveprimet e pandërprera midis qytetarëve, bizneseve dhe strukturave shtetërore. Përfshirja e zgjidhjeve të identitetit digjital, si kartat e identifikimit elektronik dhe nënshkrimet digjitale, ka përmirësuar proceset administrative dhe ka rritur sigurinë dhe integritetin e transaksioneve *online*. Zbatimi i portofolit elektronik digjital për shërbimet publike, siç përshkruhet në Planin e Rritjes, nënvizon më tej angazhimin e Shqipërisë për të ofruar shërbime digjitale të sigurta dhe praktike për qytetarët e saj.

Pavarësisht këtyre përparimeve, sfidat vijojnë sa i përket ofrimit në shkallë të gjerë dhe zbatimit efektiv të shërbimeve digjitale dhe të sigurta në të gjithë sektorët e shoqërisë. Çështje të tilla, si lidhja e kufizuar e internetit në zonat rurale, kërcënimet e sigurisë kibernetike dhe ndarja digjitale midis grupeve të ndryshme demografike përbëjnë ende pengesa për realizimin e potencialit të plotë të Agjendës së transformimit digjital të Shqipërisë. Trajtimi i këtyre sfidave do të kërkojë investime të qëndrueshme në infrastrukturën digjitale, ndërtimin e kapaciteteve dhe masat e sigurisë kibernetike, si dhe nxitjen e partneriteteve me sektorin privat dhe shoqërinë civile për të promovuar zhvillimin digjital gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Duke përqafuar nënshkrimet dhe vulat elektronike, nisma synon jo vetëm të thjeshtojë procedurat administrative, por edhe të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore, duke reduktuar mbështetjen në dokumentacionin në letër dhe duke minimizuar emetimet që lidhen me vizitat fizike të qytetarëve në zyrat e institucioneve. Digjitalizimi i shërbimeve vendore pritet të zgjerohet gjithashtu dhe të sjellë më shumë efikasitet, por edhe përfitime të prekshme mjedisore, pasi reduktimi i përdorimit të letrës dhe emetimeve të transportit kontribuon në reduktimin e ndotjes së ajrit.

Për më tepër, përfshirja e teknologjive digjitale në të gjithë sektorët përputhet me objektivat më të gjerë të qëndrueshmërisë, duke përmirësuar aksesin në shërbimet publike dhe duke reduktuar gjurmën e karbonit që lidhet me proceset tradicionale burokratike. Investimet në platformën *e-Albania* tregojnë një angazhim për të përmirësuar përvojën e përdoruesit dhe cilësinë e shërbimit, duke nxitur kështu besimin e qytetarëve dhe duke stimuluar inovacionin dhe rritjen ekonomike.

Për ta realizuar këtë, Shqipëria do të përmbushë hapat e mëposhtëm deri në vitin 2027:

- Shqipëria do të sigurojë hartimin dhe miratimin e legjislacionit përkatës për ta përafruar me rregulloren e re të BE-së për Identitetin Digjital, brenda qershorit 2026.

- Shqipëria do të bëjë përpjekje për t'i u bashkuar listës së besuar të vendeve të treta të BE-së, për vlefshmërinë e nënshkrimeve elektronike, si nënshkrim elektronik i avancuar për të arritur efektin ligjor të nënshkrimit të shkruar me dorë në BE, brenda dhjetorit 2025. Ndërkohë, Shqipëria do të ndërmarrë hapin e parë drejt njohjes reciproke të shërbimeve të besuara të kualifikuara.

- Shqipëria synon të arrijë implementimin e identiteteve elektronike, që lejojnë lidhjen me shërbimet digjitale të administratës publike (duke përfshirë të paktën 22 shërbime elektronike aktuale në *e-Albania* në fushën e taksave, sociale dhe arsimore), brenda dhjetorit 2026.

Përshkrimi i treguesit: Deri në mars 2026, aplikacioni *SQsign* do të inkorporojë metoda biometrike dhe teknologji NFC për identifikimin dhe verifikimin e sigurt të përdoruesit. Deri në shtator 2026, aplikacioni do të integrohet në portalin qeveritar *e-Albania*, duke lehtësuar verifikimin pa probleme të përdoruesit. Deri në dhjetor 2026, AKSHI do të garantojë përputhshmërinë me rregulloret e BE-së për identifikimin elektronik të sigurt brenda portalit. Për më tepër, deri në dhjetor 2027, AKSHI do të marrë pjesë në nismën EU ID *Wallet*, duke u përafruar me kornizat e identitetit digjital të BE-së për ndërlidhjen ndërkufitare.

Baza

- Aktualisht, aplikacioni *SQsign* mbështet identifikimin biometrik nëpërmjet skanimit të gjurmëve të gishtave në nivelin e aplikacionit, por nuk rakordon gjurmën e gishtit në aplikacion me gjurmën e gishtit të administruar nga NFC-ja për pasaportën.

- Zbatimi përfshin futjen e teknologjive biometrike që mundësojnë rakordim në kohë reale midis gjurmës së gishtërinjve dhe njohjes së fytyrës nga njëra anë, me të dhënat e pasaportës të administruara nga NFC-ja.

Njësia matëse

- Numri dhe përqindja e shërbimeve publike të integruara në portofolin elektronik digjital (*Digital e-Wallet*);

- Numri i qytetarëve që përdorin portofolin elektronik digjital;

- Koha për të vënë në zbatim portofolin elektronik digjital.

Burimi i verifikimit: Verifikimi do të bazohet te raportet e zbatimit të projektit, dokumentacioni teknik, rezultatet e testimit të përdoruesve dhe konfirmimet zyrtare të pjesëmarrjes në nismën *EU ID Wallet*.

Aktualisht, aplikacioni *SQsign* mbështet identifikimin biometrik nëpërmjet skanimit të gjurmëve të gishtërinjve në nivelin e aplikacionit, por nuk rakordon gjurmën e gishtit në aplikacion me gjurmën e gishtit të administruar nga NFC-ja për pasaportën. Zhvillimet kryesore përfshijnë:

- Zbatimi i rakordimit në kohë reale të gjurmëve të gishtërinjve dhe njohjes së fytyrës me të dhënat e pasaportës përmes NFC-së deri në mars 2026.

- Integrimi i aplikacionit të përmirësuar *SQsign* në portalin *e-Albania* deri në shtator 2026.

- Sigurimi i pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së për identifikim elektronik të sigurt deri në dhjetor 2026.

- Pjesëmarrja në nismën e *EU ID Wallet* për ndërlidhjen ndërkufitare deri në dhjetor 2027.

Subjektet përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e hapave: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

- Gjithashtu, në dhjetor 2026, Shqipëria do të zbatojë një Portofol Digjital për shërbimet elektronike publike, në përputhje me standardet e BE-së, duke pilotuar të paktën 10 shërbime elektronike publike, si pjesë të Portofolit të Identitetit Digjital të shërbimeve elektronike publike.

Përshkrimi i treguesit: Deri në dhjetor 2026, AKSHI do të zbatojë një Portofol Digjital për ruajtjen e centralizuar të dokumenteve elektronike, duke përfshirë dokumentet e krijuara me vulë elektronike, dhe do të integrojë një Portofol Digjital si modul të veçantë në platformën e nënshkrimit elektronik dhe brenda aplikacionit *SQsign* për lehtësinë e përdoruesve shqiptarë.

Baza

- Aktualisht, secili përdorues ruan dokumentet e veta në rubrikën "Dokumentet e mia", të portalit qeveritar *e-Albania*.

- Më pas, këto dokumente elektronike do të kalojnë në formatin e portofolit digjital për çdo shtetas shqiptar.

Njësia matëse

- Numri dhe përqindja e shërbimeve publike të integruara në portofolin elektronik digjital;

- Numri i qytetarëve që përdorin portofolin elektronik digjital;

- Koha për të zbatuar portofolin elektronik digjital.

Burimi i verifikimit: Verifikimi do të bazohet në raportet e zbatimit, progresin teknik të integrimit, rezultatet e testimit të pranimit të sistemit të integrimit në Portalin qeveritar *e-Albania*.

Subjektet përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e hapave: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

- Shqipëria synon të nënshkruajë kërkesat e marrëveshjes së njohjes së ndërsjellë, që deri në qershor 2027 ta bëjë gati për nënshkrim me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor, dhe në dhjetor 2027, Shqipëria synon të arrijë pjesëmarrje të plotë në *EU ID Wallet*.

Për të siguruar integrimin e perspektivave dhe konsideratave gjinore në zbatimin e kësaj reforme, institucioni përgjegjës do të masë zbatimin e monitorimit me ndjeshmëri gjinore. Për shembull, kur vihet në zbatim një portofol digjital për shërbimet publike elektronike, AKSHI do të gjurmojë përdorimin e tij nëpër demografi të ndryshme. Duke monitoruar numrin e qytetarëve që përdorin portofolin elektronik digjital, të ndara sipas gjinisë, moshës dhe vendndodhjes (rurale/urbane), politikëbërësit mund të

vlerësojnë dhe trajtojnë çdo pabarazi gjinore, me qëllim që të garantohet akses dhe përfitime të barabarta për të gjitha segmentet e popullsisë. Kjo qasje e orientuar prej të dhënave, jo vetëm që promovon gjithëpërfshirjen, por gjithashtu rrit efektivitetin dhe mbulimin e shërbimeve publike digjitale.

Tabela 13: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përputhshmëria me rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i *e-Portofolit Digjital* për shërbimet publike

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritje**
Rritja e aftësive digjitale të vendit, sigurimi i shërbimeve digjitale të sigurta, të besueshme dhe miqësore me përdoruesit, që përputhen me standardet evropiane dhe nxisin bashkëpunimin rajonal.	Miratimi i legjislacionit përkatës për t'u harmonizuar me rregulloren e re të Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital (eIDAS 2 Regulation 2024/1183) (qershor 2026). Përfshirja në listën e besuar të Vendeve të Treta të Bashkimit Evropian për validimin e nënshkrimeve elektronike, si nënshkrim elektronik i avancuar për të arritur efektin ligjor të nënshkrimit fizik në BE, si hap i parë drejt njohjes reciproke të shërbimeve të kualifikuara të besuara (dhjetor 2025). Zbatimi i identiteteve elektronike të verifikuara nëpërmjet NFC[71] (qershor 2026), që lejojnë lidhjen me shërbimet digjitale të administratës publike (duke përfshirë të paktën 22 shërbime elektronike aktuale në *e-Albania* në fushën e taksave, shërbimeve sociale dhe arsimore) (dhjetor 2026) dhe pjesëmarrje të plotë në Portofolin e Identitetit Elektronik të Bashkimit Evropian (dhjetor 2027). Zbatimi i një Portofoli Digjital për shërbimet elektronike publike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke e pilotuar si pjesë të Portofolit të Identitetit Digjital të *e-shërbimeve* publike, për të paktën 10 *e-shërbime* publike (dhjetor 2026). Kërkesat e marrëveshjeve të njohjes reciproke janë të përgatitura dhe gati për nënshkrim me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor (qershor 2027).	3.1.1 Përputhshmëria me rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i *e-Portofolit Digjital* për shërbimet publike

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
R-3.1.1 Përputhshmëria me rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i *e-Portofolit Digjital* për shërbimet publike			**Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)**
Hapi 1 - Miratimi i legjislacionit përkatës për t'u harmonizuar me rregulloren e re të Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital (eIDAS 2 Regulation 2024/1183) (qershor 2026). ✓ Ngritja e një grupi pune për të hartuar legjislacionin që përafron kërkesat eIDAS2 (qershor 2024); ✓ Projektligji i parë i përgatitur (dhjetor 2024); ✓ Kryerja e procesit të konsultimit (konsultimi publik dhe me akte elektronike), dhe njëkohësisht do të	(qershor 2026)	Ligji ekzistues nuk është në përputhje me rregulloren e re të BE-së për Identitetin Digjital (eIDAS 2)	AKSK

[71] *NFC Users Identity Verification* – procesi i përdorimit të teknologjisë së komunikimit në terren të afërt (*Near Field Communication* - NFC) për të verifikuar identitetin e një përdoruesi. NFC-ja është një teknologji komunikimi *wireless*/me valë që lejon pajisjet të shkëmbejnë të dhëna në distanca të shkurtra, zakonisht disa centimetra.

zhvillohen edhe takime me grupet e interesit (qershor 2025); ✓ Projektligji i miratuar nga qeveria (dhjetor 2025); ✓ Hyrja në fuqi dhe miratimi i ligjit të ri "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara" nga Kuvendi (qershor 2026).			
Hapi 2 - Përfshirja në listën e besuar të vendeve të treta të Bashkimit Evropian për validimin e nënshkrimeve elektronike, si nënshkrim elektronik i avancuar për të arritur efektin ligjor të nënshkrimit fizik në BE, si hap i parë drejt njohjes reciproke të shërbimeve të kualifikuara të besuara (dhjetor 2025). ✓ Kërkesë zyrtare nga Autoriteti drejtuar DG-CNECT (dhjetor 2024); ✓ Fillimi i vlerësimit teknik të aspekteve ligjore dhe teknike të nënshkrimeve elektronike nga DG-CNECT (periudha e parashikuar maj 2025); ✓ Rekomandimet e Komisionit Evropian (shtator 2025); ✓ Plotësimi i kritereve teknike (punët teknike të adresuara për të përfshirë treguesit TC LOTL në EU TC AdES LOTL) (varet nga rekomandimi i Komisionit Evropian); ✓ Njohja reciproke e shërbimeve të kualifikuara të besuara (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Shqipëria nuk është pjesë e listës së vendeve të treta të BE-së për verifikimin e nënshkrimeve elektronike	AKSK
Hapi 3 - Zbatimi i identiteteve elektronike të verifikuara nëpërmjet NFC-së (qershor 2026) që lejojnë lidhjen me shërbimet digjitale të administratës publike (duke përfshirë të paktën 22 shërbime elektronike aktuale në *e-Albania* në fushën e taksave, shërbimeve sociale dhe arsimore) (dhjetor 2026) dhe pjesëmarrje të plotë në Portofolin e Identitetit Elektronik të Bashkimit Evropian (dhjetor 2027). ✓ Zbatimi i funksionaliteteve identifikuese në aplikacionin ***SQsign*** përmes metodave biometrike (mars 2026); ✓ Verifikimi i identitetit të përdoruesit përmes teknologjisë NFC (mars 2026); ✓ Integrimi i aplikacionit në portalin qeveritar ***e-Albania*** për verifikimin e përdoruesit (shtator 2026); ✓ AKSHI do të mundësojë identifikimin elektronik të sigurt në portalin qeveritar ***e-Albania*** në përputhje me rregulloren e BE-së (dhjetor 2026); ✓ Pjesëmarrja në ***EU ID Wallet*** (dhjetor 2027).	(qershor 2026) (dhjetor 2026) (dhjetor 2027)	Statusi i verifikimit të identitetit Aktualisht, aplikacioni *SQsign* mbështet identifikimin biometrik nëpërmjet skanimit të gjurmëve të gishtave në nivelin e aplikacionit, por nuk rakordon gjurmën e gishtit në aplikacion me gjurmën e gishtit të administruar nga NFC-ja për pasaportën. Statusi i verifikimit të identitetit: Në zhvillim. Aktualisht, aplikacioni *SQsign* mbështet identifikimin biometrik nëpërmjet skanimit të gjurmëve të gishtave në nivelin e aplikacionit, por	AKSHI

		nuk rakordon gjurmën e gishtit në aplikacion me gjurmën e gishtit të administruar nga NFC-ja për pasaportën. Zhvillimet kryesore përfshijnë: • Zbatimi i rakordimit të gjurmëve të gishtërinjve dhe njohjes së fytyrës me të dhënat e pasaportës përmes NFC deri në mars 2026. • Integrimi i aplikacionit të përmirësuar *SQsign* në portalin *e-Albania* deri në shtator 2026. • Sigurimi i pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së për identifikim elektronik të sigurt deri në dhjetor 2026. • Pjesëmarrja në nismën e *EU ID Wallet* për ndërlidhjen ndërkufitare deri në dhjetor 2027	
Hapi 4 – Zbatimi i një Portofoli Digjital për shërbimet elektronike publike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke e pilotuar si pjesë të Portofolit të Identitetit Digjital të *e-shërbimeve* publike, për të paktën 10 e-shërbime publike (dhjetor 2026): ✓ Zbatimi i Portofolit Digjital për ruajtjen e centralizuar të dokumenteve elektronike të përdoruesve të portalit të qeverisë ***e-Albania*** (nëntor 2026); ✓ Përfshirja e dokumenteve të krijuara me vulë elektronike nga portali ***e-Albania*** (dhjetor 2026); ✓ Integrimi i Portofolit Digjital si një modul i veçantë në platformën e nënshkrimit elektronik, si dhe brenda aplikacionit ***SQsign*** për lehtësinë e përdoruesit (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	Statusi i portofolit digjital për shërbimet publike elektronike: Në zhvillim. (aktualisht, për çdo përdorues, dokumentet elektronike ruhen në rubrikën "Dokumentet e mia" të portalit *e-Albania).* Është planifikuar zbatimi i një Portofol Digjital për ruajtjen e centralizuar të dokumenteve elektronike deri në dhjetor 2026, i cili do të përfshijë një modul *Digital Wallet* të integruar në platformën e nënshkrimit elektronik dhe aplikacionin *SQsign*.)	AKSHI
Hapi 5 - Kërkesat e marrëveshjeve të njohjes reciproke janë të përgatitura dhe gati për nënshkrim me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor (qershor 2027):	(qershor 2027)	Nuk ka kërkesa për marrëveshje të njohjes reciproke	AKSK/AKSHI

✓ Miratimi i legjislacionit përkatës për t'u harmonizuar me rregulloren e re të BE-së për identitetin digjital (qershor 2026); ✓ Zbatimi i kërkesave të reja nga OKSHB-ja (dhjetor 2026); ✓ Kërkesat e marrëveshjes së njohjes reciproke për marrëveshjet e mundshme me partnerët e Ballkanit (qershor 2027).			

R - 3.1.2 Përafrimi i kuadrit rregullator për qëndrueshmërinë kibernetike, duke përfshirë kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse

Vitet e fundit, Shqipëria ka dëshmuar një transformim të shpejtë digjital në sektorë të ndryshëm, i nxitur nga përparimet në teknologji dhe nga mbështetja në rritje në infrastrukturën digjitale. Megjithatë, ky tranzicion ka sjellë edhe sfida të reja, veçanërisht në fushën e sigurisë kibernetike. Ndërsa Shqipëria përpiqet të nxisë një mjedis të favorshëm biznesi dhe të përqafojë mundësitë e paraqitura nga digjitalizimi, rritja e qëndrueshmërisë kibernetike merr rëndësi themelore.

Shqipëria ka njohur rëndësinë e qëndrueshmërisë kibernetike në mbrojtjen e aseteve të saj digjitale, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sigurimin e besimit të qytetarëve, bizneseve dhe investitorëve. Vendi ka marrë masa proaktive për të përforcuar kapacitetet e sigurisë kibernetike, duke u përafruar me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Një nga nismat kryesore në këtë përpjekje është krijimi i një kuadri të qëndrueshëm ligjor dhe rregullator. Shqipëria ka bërë hapa përpara në miratimin e legjislacionit dhe rregulloreve për të adresuar shqetësimet e sigurisë kibernetike, duke përfshirë ligjin për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave. Ky kuadër ligjor ofron një bazë solide për rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë, duke krijuar mekanizma për menaxhimin e rrezikut dhe reagimin ndaj incidenteve, dhe duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet palëve përkatëse të interesuara.

Për më tepër, Shqipëria ka prioritet forcimin e kapaciteteve dhe përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për të fuqizuar individët dhe organizatat për të zbutur në mënyrë efektive kërcënimet kibernetike. Nëpërmjet nismave të tilla si programet e trajnimit për sigurinë kibernetike, fushatat ndërgjegjësuese dhe partneritetet publike private, qeveria kërkon të kultivojë kulturën e ndërgjegjësimit kibernetik dhe t'i pajisë palët e interesit me njohuri dhe aftësi për të lundruar në mënyrë të sigurt në hapësirën kibernetike.

Paralelisht, Shqipëria po forcon infrastrukturën e saj të sigurisë kibernetike për t'u bërë ballë kërcënimeve kibernetike në zhvillim. Investimet në teknologji, si sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve, *firewall*-et dhe mekanizmat e enkriptimit, po bëhen për të forcuar qëndrueshmërinë e rrjeteve dhe sistemeve kritike. Për më tepër, po bëhen përpjekje për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe mekanizmat e bashkëpunimit, për të lehtësuar përgjigjen në kohë ndaj incidenteve dhe kërcënimeve kibernetike.

Ndërsa Shqipëria përparon agjendën e saj digjitale dhe ndjek rritjen dhe zhvillimin ekonomik, qëndrueshmëria kibernetike mbetet një gur themeli i strategjisë së saj. Duke nxitur një ekosistem digjital të sigurt dhe elastik, Shqipëria synon të shfrytëzojë potencialin transformues të teknologjisë duke mbrojtur qytetarët e saj, bizneset dhe interesat kombëtare.

Duke iu referuar situatës aktuale me të cilën po përballet Republika e Shqipërisë, ku sulmet kibernetike janë shtuar, duke paraqitur një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare, është parë e nevojshme të merren masat e duhura për rritjen e sigurisë kibernetike në vend.

Misioni kryesor i AKSK-së përfshin ruajtjen e sigurisë kombëtare kibernetike duke siguruar mbrojtjen e rrjeteve kompjuterike, sistemeve dhe shërbimeve të besuara nëpërmjet vendosjes së standardeve dhe protokolleve të sigurisë dhe monitorimit të rregullt të zbatimit të tyre.

Për të arritur këtë qëllim, shihet si i nevojshëm forcimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike në përputhje me *acquis* të BE-së në fushën e sigurisë kibernetike. AKSK-ja ka çuar përpara angazhimin e vet duke rishikuar kuadrin ligjor, me synimin që të arrihet përafrim i nivelit të lartë me direktivën NIS2, siç është ligji i ri "Për sigurinë kibernetike" i miratuar më 21 mars 2024.

Në kuadër të zbatimit të ligjit të ri "Për sigurinë kibernetike", është i nevojshëm forcimi i strukturave përgjegjëse për sigurinë kibernetike, masat e sigurisë kibernetike, investimet në teknologji dhe rritja e kapaciteteve njerëzore përgjegjëse për sigurinë kibernetike.

Në zbatim të ligjit "Për sigurinë kibernetike", i cili është pjesërisht i përafruar me Direktivën NIS 2, parashikohet që lista e infrastrukturave të informacionit të përditësohet të paktën një herë në dy vjet. Gjithashtu, ky ligj përfshin edhe dy shtojca që pasqyrojnë sektorët, në përputhje me shtojcat e Direktivës NIS 2.

CERT – është një strukturë *ad hoc* përgjegjëse për hartimin e planit të reagimit ndaj emergjencave, menaxhimin dhe zgjidhjen e emergjencave dhe krizave kibernetike.

Me krijimin e një plani të menaxhimit të krizave dhe krijimin e një strukture të dedikuar për trajtimin e emergjencave të krizave kibernetike, do të qartësohen procedurat specifike që duhen ndjekur në situata emergjente. Kjo qasje synon të menaxhojë dhe zbusë me sukses këto situata duke përshkruar qartë hapat dhe përgjegjësitë e përfshira.

Duke iu referuar hapave të përshkruara në lidhje me masat e reformës, objektivi është rritja e sigurisë kibernetike kombëtare. Kjo nismë përqendrohet te zhvillimi i mbrojtjeve të fuqishme kundër kërcënimeve kibernetike, forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturave kombëtare dhe sigurimi i një mjedisi digjital më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe organizatat. Me zbatimin e kësaj reforme, qeveria synon të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës dhe efektiv për mbrojtjen dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike, duke siguruar kështu të dhëna dhe shërbime kritike në të gjithë vendin.

Duke qenë se digjitalizimi i çdo shërbimi po përjeton një rritje të shpejtë dhe të ndjeshme në të gjithë sektorët, si publik ashtu edhe privat, paraqitet nevoja urgjente për të rritur sigurinë në ofrimin e këtyre shërbimeve. Për të ruajtur sigurinë e këtyre shërbimeve, është thelbësore të krijohet një kuadër ligjor që parashikon dhe përfshin çdo risi në përputhje me *acquis* të BE-së, si identifikimi elektronik në distancë, portofolat digjitalë dhe siguria e përmirësuar e ofrimit të shërbimeve.

Përfitues të kësaj reforme janë institucionet publike dhe subjektet private, infrastrukturat e informacionit, bizneset dhe shoqëria në përgjithësi, në kuadër të rritjes së sigurisë kibernetike kombëtare. Qytetarët (shoqëria në tërësi) në lidhje me përdorimin e shërbimeve *online*; Administrata publike; Ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara.

Palët e interesit: Ofruesit e portofolit të identitetit elektronik; Ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara; Administrata Publike; bankat; Kompanitë e parave elektronike

Tabela 14: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përafrimi i kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike, duke përfshirë kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritje**
Forcimi i infrastrukturës dhe gatishmërisë së vendit për sigurinë kibernetike, duke u përafruar me standardet evropiane dhe duke rritur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e aseteve kombëtare kritike ndaj kërcënimeve kibernetike.	Përditësimi i listës së infrastrukturës kritike në fushëveprimin e ligjit të zbatueshëm të vendit në përputhje me Direktivën NIS2[72] (qershor 2025). CERT[73]-et kombëtare dhe qeveritare janë plotësisht funksionale, në përputhje me kërkesat e NIS2 (dhjetor 2025) dhe arrijnë të paktën statusin e 'të akredituarit' në TF CSIRT[74] *Trusted Introducer* [75] (dhjetor 2026). Zbatimi dhe bërja plotësisht funksionale e kornizave (korniza CVD[76], kuadri i menaxhimit të krizave) të vendosura sipas përafrimit të NIS2 (dhjetor 2025). AKSK[77] vepron si autoritet kompetent (siç përcaktohet në Direktivën NIS2) dhe është	**3.1.2.** Përafrimi i kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike, duke përfshirë kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse

[72] NIS – *Network and Information Security* (NIS) *Directive of EU*.
[73] CERT – *Computer Emergency Response Team.*
[74] TF CSIRT – *Task Force on Computer Security Incident Response Teams*.
[75] *Trusted Introducer* – Prezantuesi i besuar: Shërbimi i Prezantuesit të Besuar është një kornizë brenda TF-CSIRT e ngritur për të krijuar besim dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis CSIRT-ve. Prezantuesi i besuar vlerëson dhe akrediton CSIRT bazuar në respektimin e tyre ndaj standardeve specifike dhe praktikave më të mira.
[76] Korniza CVD (*Coordinated Vulnerability Disclosure Framework*) – Korniza e koordinuar e zbulimit të cenueshmërisë krijon procedura për identifikimin, raportimin dhe adresimin e dobësive të sigurisë në sistemet e informacionit. Ka si funksion, që dobësitë të zbulohen në mënyrë të koordinuar, duke i lejuar organizatat të zbusin rreziqet përpara se ato të shfrytëzohen.
[77] AKSK – Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)

	funksional: me staf të mjaftueshëm, të pajisur me kompetenca mbikëqyrëse e që kryen kontrolle mbikëqyrëse (dhjetor 2026).	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
3.1.2. Përditësimi i kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike, duke prezantuar kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse			**AKSK**
Hapi 1 - Përditësimi i listës së infrastrukturës kritike në fushëveprimin e ligjit të zbatueshëm të vendit në përputhje me Direktivën NIS2 (qershor 2025). ✓ Zhvillimi i një draft metodologjie për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturës së informacionit (maj 2024); ✓ Konsultimet publike dhe takime me grupet e interesit në lidhje me draftin e kësaj metodologjie (qershor 2024); ✓ Përgatitja e variantit përfundimtar dhe miratimi i këtij të fundit (dekreti i Këshillit të Ministrave) (shtator 2024); ✓ Identifikimi i infrastrukturës së informacionit në bazë të kritereve të kësaj metodologjie (tetor 2024); ✓ Hartimi i kësaj liste, ezaurimi i procesit të konsultimit me grupet e interesit dhe miratimi i listës me VKM (qershor 2025).	(qershor 2025)	Lista ekzistuese nuk është përditësuar në përputhje me Direktivën NIS2.	AKSK
Hapi 2 - CERT[78]-et kombëtare dhe qeveritare janë plotësisht funksionale, në përputhje me kërkesat e NIS2 (dhjetor 2025) dhe arrijnë të paktën statusin e 'të akredituarit' në TF CSIRT[79] *Trusted Introducer* [80] (dhjetor 2026). - Plotësimi i kuadrit ligjor, pasi "Ligji për sigurinë kibernetike" është miratuar së fundmi dhe do të hyjë në fuqi së shpejti, duke nisur procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të tij. Ligji përmban rreth 19 akte nënligjore (qershor 2025); - Ngritja e SOC Kombëtar – krijimi i platformave (platforma për menaxhimin e incidenteve kibernetike, monitorimin e infrastrukturës, vlerësimin e rrezikut, etj.) (dhjetor 2025); - Përshtatja e politikave dhe procedurave të bazuara në SIM 3 dhe akreditimi nga TF-CSIRT (dhjetor 2026); - Zhvillimi i një plani kombëtar për reagimin	(dhjetor 2025) (dhjetor 2026)	Legjislacioni ekzistues për CERT-in. Statusi i akreditimit: Nuk ka një akreditim nga BE-ja.	AKSK

[78] CERT – *Computer Emergency Response Team.*
[79] TF CSIRT – *Task Force on Computer Security Incident Response Teams.*
[80] *Trusted Introducer* – Prezantuesi i besuar: Shërbimi i Prezantuesit të Besuar është një kornizë brenda TF-CSIRT e ngritur për të krijuar besim dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis CSIRT-ve. Prezantuesi i besuar vlerëson dhe akrediton CSIRT bazuar në respektimin e tyre ndaj standardeve specifike dhe praktikave më të mira.

ndaj incidenteve dhe krizave të sigurisë kibernetike në shkallë të gjerë (dhjetor 2024). - Hartimi i legjislacionit vartës sipas "Ligjit të Sigurisë Kibernetike" në lidhje me krizat kibernetike, konkretisht: - Procedurat për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizave kibernetike (qershor 2025). - Krijimi, organizimi dhe funksionimi i CERT (Ekipi i Reagimit të Emergjencave Kibernetike) (dhjetor 2025).			
Hapi 3 - Zbatimi dhe bërja plotësisht funksionale e kornizave (korniza CVD[81], kuadri i menaxhimit të krizave) të vendosura sipas përafrimit të NIS2 (dhjetor 2025). - Hartimi, miratimi dhe hyrja në fuqi e të 19 akteve nënligjore të përcaktuara në ligjin "Për sigurinë kibernetike (qershor 2025); - Nisja e hapave dhe koordinimi me ministrinë përgjegjëse për ndryshimin dhe miratimin e ligjit "Për akreditimin në Republikën e Shqipërisë", për të përfshirë në këtë ligj akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit, si dhe ligjin "Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë", për të mundësuar zbatimin e dënimit të pezullimit/revokimit të lejeve/autorizimit/ licencës (qershor 2025); - Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit të sigurisë kibernetike nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe regjistrimi i tyre nga Autoriteti (qershor 2026); - Plotësimi i strukturës së autoritetit me staf të kualifikuar, si dhe trajnime të vazhdueshme të stafit (qershor 2026); - Duke vepruar si një autoritet kompetent i pajisur me kompetenca mbikëqyrëse sipas kërkesave të direktivës NIS 2 (dhjetor 2026).	(dhjetor 2025)	Nuk ka strukturë *ad hoc* CERT/Forum Ekspertësh.	AKSK
Hapi 4 – AKSK[82] vepron si autoritet kompetent (siç përcaktohet në Direktivën NIS2) dhe është funksional: me staf të mjaftueshëm, pajisur me kompetenca mbikëqyrëse e që kryen kontrolle mbikëqyrëse (dhjetor 2026) - të përcaktuara në ligjin "Për sigurinë kibernetike (qershor 2025); - Nisja e hapave dhe koordinimi me ministrinë përgjegjëse për ndryshimin dhe miratimin e ligjit "Për akreditimin në Republikën e Shqipërisë", për të përfshirë në këtë ligj akreditimin e Organeve të Vlerësimit të	(dhjetor 2026)	Nuk ka një autoritet në funksion, në përputhje me Direktivën NIS2.	AKSK

[81] Korniza CVD (*Coordinated Vulnerability Disclosure Framework*) - Korniza e koordinuar e zbulimit të cenueshmërisë krijon procedura për identifikimin, raportimin dhe adresimin e dobësive të sigurisë në sistemet e informacionit. Ka si funksion, që dobësitë të zbulohen në mënyrë të koordinuar, duke i lejuar organizatat të zbusin rreziqet përpara se ato të shfrytëzohen.
[82] AKSK – Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

Konformitetit, si dhe ligjin "Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë", për të mundësuar zbatimin e dënimit të pezullimit/revokimit të lejeve/autorizimit/ licencës (qershor 2025); - Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit të sigurisë kibernetike nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe regjistrimi i tyre nga Autoriteti (qershor 2026); - Plotësimi i strukturës së autoritetit me staf të kualifikuar, si dhe trajnime të vazhdueshme të stafit (qershor 2026); - Duke vepruar si një autoritet kompetent i pajisur me kompetenca mbikëqyrëse sipas kërkesave të direktivës NIS 2 (dhjetor 2026).			

R – 3.1.3 Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme

Vitet e fundit, Shqipëria ka përparuar me infrastrukturën e saj digjitale për të mbështetur rritjen ekonomike, inovacionin dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Me fokus te garantimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë, qeveria ka zbatuar nisma të ndryshme për të përmirësuar lidhjen digjitale, sigurinë kibernetike dhe kornizat rregullatore.

Për më tepër, qeveria ka ndërmarrë hapa për të harmonizuar kuadrin e saj ligjor me praktikat e BE-së në zhvillimin e infrastrukturës digjitale. Duke miratuar legjislacionin përkatës për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret e BE-së për vendosjen e brezit të gjerë dhe sigurinë kibernetike, Shqipëria synon të rrisë elasticitetin e saj digjital dhe të promovojë besimin në ekosistemin e saj digjital.

Paralelisht, Shqipëria ka prioritet rritjen e masave të sigurisë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën e saj digjitale nga kërcënimet në zhvillim. Nëpërmjet krijimit të një kuadri për qëndrueshmërinë kibernetike dhe forcimit të institucioneve përkatëse, Shqipëria kërkon të zbusë rreziqet që lidhen me sulmet kibernetike dhe të sigurojë besueshmërinë dhe stabilitetin e infrastrukturës së saj digjitale.

Infrastruktura e lidhjes digjitale do të jetë një tjetër dimension i investimeve në infrastrukturë, me përfundimin e investimeve për lidhjen rajonale me rrjetet *broadband* evropiane, në kombinim me masat reformuese të politikave të ndërmarra në përputhje me angazhimet e integrimit digjital.

Për sa i përket infrastrukturës digjitale, masat e reformës së politikave përbëhen nga veprimet e mëposhtme si pjesë e reformës:

1. Miratimi i legjislacionit përkatës për brezin e gjerë (*broadband*) për ta përafruar me *acquis* të BE-së dhe aktin e infrastrukturës gigabit me hyrjen në fuqi në BE;

Ligji shqiptar për brezin e gjerë bazohet në direktivën BCRD dhe ligji nr. 120/2016, është në fuqi që nga viti 2016; Duke qenë se BCRD-ja do të zëvendësohet së shpejti me aktin e infrastrukturës gigabit, pasi nga ana tjetër Kodi i Komunikimit Elektronik të BE-së (EECC) është një pjesë e rëndësishme e masave reformuese për rrjetet me brez të gjerë (*broadband*) dhe me kapacitet shumë të lartë, hapat/veprimet e mëposhtme do të integrohen në këtë masë reformuese:

- Ligji i ri për komunikimet elektronike bazuar në Kodin e Komunikimit Elektronik të BE-së (EECC) i miratuar brenda qershorit 2024;
- Dhjetë akte nënligjore zbatuese të miratuara brenda vitit 2025;
- BCO i krijuar dhe funksional në MIE brenda vitit 2024;
- Vlerësimi i nevojës për vendosjen e lidhjeve me brez të gjerë në zonat e bardha/rurale të përfunduar brenda tremujorit të parë 2025;
- Ligji i ri për brezin e gjerë - transpozimi i aktit të infrastrukturës gigabit në legjislacionin kombëtar - i miratuar brenda qershorit 2026;

Tabela 15: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritje**

Përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës digjitale kombëtare dhe sigurimi që përparimet teknologjike të jenë të sigurta dhe të përafruara me standardet më të larta evropiane, duke e pozicionuar vendin në ballë të inovacionit dhe sigurisë digjitale.	Miratimi i legjislacionit përkatës për *broadband* për ta përafruar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe aktin e infrastrukturës gigabit, me hyrjen në fuqi në Bashkimin Evropian **(qershor 2026).** Zbatimi i masave rregullatore dhe të kapaciteteve institucionale për të siguruar futjen e infrastrukturave 5G, në përputhje me instrumentet 5G të sigurisë kibernetike të BE-së **(qershor 2025**).	3.1.3. Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
3.1.3. Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme			**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MPB)**
Hapi 1 - Miratimi i legjislacionit përkatës për *broadband* për ta përafruar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe aktin e infrastrukturës gigabit, me hyrjen në fuqi në Bashkimin Evropian (qershor 2026). - Ligji i ri për komunikimet elektronike bazuar në Kodin e Komunikimit Elektronik të BE-së (EECC) i miratuar (qershor 2024); - Dhjetë akte nënligjore zbatuese të miratuara (dhjetor 2025); - BCO krijuar (dhjetor 2024); - Vlerësimi i nevojës për vendosjen e lidhjeve me brez të gjerë në zonat e bardha/rurale përfunduar (mars 2025); - Ligji i ri për brezin e gjerë, transpozimi i aktit të infrastrukturës gigabit në legjislacionin kombëtar i miratuar (qershor 2026).	(qershor 2026)	Ligji ekzistues për brezin e gjerë i bazuar në BCRD.	MIE
Hapi 2 - Zbatimi i masave rregullatore dhe të kapaciteteve institucionale për të siguruar futjen e infrastrukturave 5G, në përputhje me instrumentet 5G të sigurisë kibernetike të BE-së (qershor 2025). - Miratimi i dispozitave ligjore për fuqinë rregullatore për sigurinë 5G (qershor 2024); - Miratimi i rregullores për kushtet minimale për ankand të spektrit 5G në përputhje me paketën e instrumenteve të sigurisë 5G (dhjetor 2024); - Përfundimi i ankandit 5G, duke përfshirë dhënien e frekuencave për ofertuesit e suksesshëm të lidhur me kërkesat e mbulimit 5G (mars 2025); - Kushtet e mbulimit të rrjetit 5G të përfshira në licenca/autorizime (mars 2025); - Rritja e kapaciteteve të AKEP-it/ekspertizës së zhvilluar nga organi rregullator i pavarur i	(qershor 2025)	Ka kapacitete ekzistuese institucionale dhe rregullatorë.	MIE AKEP

ngarkuar me zhvillimin e ankandit/licencimit 5G (qershor 2025).			

3.2 Rritja e përfshirjes së biznesit në potencialin e agjendës së gjelbër dhe digjitale

R - 3.2.1 Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare

Shqipëria ka punuar në nxitjen e një mjedisi favorizues për bizneset novatore, veçanërisht në fushën e agjendave të gjelbra dhe digjitale.

Konteksti ekzistues pasqyron një qasje të shumanshme për të promovuar inovacionin dhe sipërmarrjen, me fokus të veçantë te sektorët e gjelbër dhe digjitalë. Përpjekjet e Shqipërisë shtrihen përtej reformave administrative për të përfshirë kornizat rregullatore të favorshme për inovacionin. Miratimi i ligjeve në përputhje me praktikat e BE-së, si ligji i unifikuar i investimeve dhe rregulloret që rregullojnë ndihmën shtetërore dhe partneritetin publik privat, nënvizojnë angazhimin e Shqipërisë për të krijuar kushte të barabarta për bizneset. Këto masa synojnë të rrisin tërheqjen dhe transparencën e investimeve duke nxitur një mjedis konkurrues biznesi që inkurajon inovacionin dhe sipërmarrjen.

Në sferën digjitale, Shqipëria ka nisur një rrugëtim për të modernizuar infrastrukturën e saj dhe për të promovuar njohuritë digjitale. Në tërësi, angazhimi i Shqipërisë, për një mjedis të favorshëm për bizneset inovative në agjendën e gjelbër dhe digjitale, pasqyron një përpjekje të përbashkët për të shfrytëzuar fuqinë transformuese të teknologjisë dhe qëndrueshmërisë. Me nxitjen e bashkëpunimin ndërmjet sektorit publik dhe privat, me investimet në infrastrukturë dhe kapital njerëzor dhe me zbatimin e politikave të menduara përpara, Shqipëria po punon drejt pozicionimit të vetvetes si një lider rajonal në inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Fokusi kryesor i Agjendës së Reformave qëndron në përmirësimin e mjedisit mbështetës për bizneset novatore dhe shfrytëzimin nga ato të potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, duke përfshirë mundësimin e mbështetjes financiare përkatëse. Në këtë aspekt, do të miratohet Strategjia e Specializimit Inteligjent 2024–2030, e cila ofron kuadrin e politikave kryesore në lidhje me specializimin inteligjent të ekonomisë dhe si një kuadër reformash kyçe në drejtim të forcimit të mjedisit kombëtar të Shqipërisë për kërkim dhe inovacion. Ky kuadër strategjik është krijuar për të identifikuar fushën prioritare ku investimet në kërkim, inovacion dhe teknologji mund të sjellin një vlerë të shtuar për rritjen inteligjente të Shqipërisë. Kjo strategji do të lejojë rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe novatore të Shqipërisë nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe tërësore, në përputhje me udhëzimet e Bashkimit Evropian për specializimin inteligjent. Procesi i hartimit të S3 është planifikuar dhe ekzekutuar në mënyrë të përpiktë bazuar në një udhërrëfyes të dakorduar bashkërisht me Qendrën e Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Evropian, duke filluar me një hartëzim të detajuar të potencialit ekonomik të Shqipërisë nëpërmjet analizave të gjera sasiore. Kjo fazë fillestare vendosi bazën për një analizë cilësore të mëvonshme, që synon përcaktimin e fushave prioritare për specializimin inteligjent. Pas këtyre fazave analitike, u iniciua Procesi i Zbulimit të Sipërmarrjes (EDP), i cili përfshinte 33 takime konsultimesh me palët e interesuara (tryezë e rrumbullakët, seminare, takime dypalëshe me vendet fqinje, ngjarje kombëtare, etj.) duke përfshirë më shumë se 1600 përfaqësues nga qeveria, shoqëria civile, akademia, dhe komuniteti i biznesit përgjatë vitit 2022 dhe 2023. S3 do të përfshijë reforma të ndryshme sipas fushave prioritare vertikale dhe horizontale që pritet të gjenerojnë rezultate të rëndësishme për rritjen e zgjuar të Shqipërisë dhe rritjen e konkurrencës, dhe, në të njëjtën kohë, duke forcuar sfondin kombëtar të kërkimit dhe inovacionit. Rezultatet specifike të nxitura nga këto reforma përfshijnë një kuadër strategjik të mirëpërcaktuar që mbështet identifikimin dhe zhvillimin sistematik të sektorëve.

Aktualisht S3 është në fazat përfundimtare të hartimit nën drejtimin e Zëvendëskryeministrit. Pas miratimit nga Komisioni Evropian, strategjia do të paraqitet për miratim nga Këshilli i Ministrave në Shqipëri dhe është planifikuar të fillojë të zbatohet në fund të vitit 2024 ose në fillim të vitit 2025. Ky afat kohor nënvizon përafrimin e strategjisë me kornizat më të gjera të politikave kombëtare dhe të BE-së.

Përfituesit fundorë të synuar të kësaj reforme janë të gjithë aktorët heliks të katërfishtë të Shqipërisë, duke lejuar rritjen e kapaciteteve dhe konkurrencës së bizneseve dhe institucioneve kërkimore shqiptare. Zbatimi i suksesshëm i S3 do të jetë një dëshmi e angazhimit të Shqipërisë për të përqafuar një ekonomi të orientuar nga dija, duke rritur ndjeshëm profilin e vendit si një komb inovator dhe largpamës.

Për më tepër, së shpejti do të miratohet Strategjia Inovative e Sipërmarrjes. Ajo paraqet vizionin për të rritur potencialin e sipërmarrjes dhe inovacionit në vendin tonë. Kjo strategji stimulon rritjen e ekosistemit *startup* dhe zhvillimin e të gjitha shtresave të ekosistemit, duke përfshirë nivelin mikro, të mesëm dhe makro, dhe gjeneron rrathë sinergjikë brenda ekosistemit dhe sektorëve me prioritet ekonomik në vend. Kjo strategji hedh themelet për ndryshimin e krijimit të vlerave kombëtare të Shqipërisë, duke adresuar tre shtylla: ekosistemi inovator sipërmarrës, sektorët strategjikë (S3), si dhe zhvillimi gjithëpërfshirës. Në qendër të kësaj strategjie do të jetë rritja dhe forcimi i rolit të sipërmarrësit, nëpërmjet promovimit të inovacionit, zhvillimit të talenteve vendase, krijimit të mjediseve të përshtatshme për rritje dhe zhvillim, si dhe mbështetjes së financimit dhe politikave të përshtatshme për sipërmarrjen. Strategjia do të përfshijë aspekte të agjendës së gjelbër dhe digjitale mbi sipërmarrjen novatore dhe K&ZH.

Hapat e mëtejshëm do të konsistojnë në sigurimin e zbatimit të kornizës strategjike, përmes miratimit të aktit(eve) ligjor mbi instrumentet e mbështetjes së inovacionit, duke përmirësuar praktikën aktuale në përputhje me praktikat e BE-së, si dhe përgatitjen dhe zbatimin e një skeme grantesh me fokus që inkubatorët/përshpejtuesit, NVM-të dhe/ose *startup*-et fillestare, që synojnë zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale, të kenë financim të mjaftueshëm.

Tabela 16: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 3.2.1. Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritje
Përmirësimi i sfondit kombëtar të inovacionit, mbështetja e bizneseve në zhvillim dhe sigurimi që sipërmarrësit të kenë burimet dhe mjedisin e nevojshëm për të zhvilluar dhe përshkallëzuar zgjidhje inovative. Ai e pozicionon vendin si një lojtar konkurrues në tregun global, veçanërisht në sektorët e teknologjisë së gjelbër dhe digjitale.	Miratimi i Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative (dhjetor 2024) Miratimi i akteve nënligjore për instrumente të mbështetjes së inovacionit, duke përmirësuar praktikën aktuale, në përputhje me praktikat e BE-së (dhjetor 2025). Përgatitja (dhjetor 2025) dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus në inkubatorët/përshpejtuesit, duke synuar zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale (dhjetor 2026). Përgatitja (dhjetor 2024) dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus tek SME-të dhe/ose *startup*-et, ku 30% e grantit përcaktohet për SME-të dhe/ose *startup*-et, që synojnë zgjidhje të gjelbra dhe/ose digjitale (dhjetor 2025).[83]	**3.2.1.** Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
3.2.1 Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare			**Ministri i Shtetit për** Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSHSKB)
Hapi 1 - Miratimi i Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative (dhjetor 2024). - Hulumtimi i mjedisit të sipërmarrjes në Shqipëri dhe përmirësimi i projekt dokumentit të strategjisë	(dhjetor 2024)	Nuk ka strategji të sipërmarrjes.	MSHSKB

[83] Agjencia mbështet NVM-të dhe *startup*-et me mekanizma financimi, inkubatorët do t'i mbështesin me asistencë teknike dhe akses tek aktivitete të dijes. Agjencia *Startup* do të mbështesë NVM-të që mund të jenë të njëjta, ose të tjera, me mundësi financimi, të cilat mund të vijnë në formën e granteve, kredive dhe instrumenteve të tjera. NVM-të dhe *startup*-et do të përjashtohen nga dublikimet në mekanizmat e mbështetjes financiare.

përmes konsultimit të hapur (qershor 2024). Miratimi i agjendës së gjelbër dhe digjitale për sipërmarrjen novatore dhe K&ZH, si pjesë e strategjisë, dhe miratimi i strategjisë (dhjetor 2024)			
Hapi 2 - Miratimi i akteve nënligjore për instrumente të mbështetjes së inovacionit, duke përmirësuar praktikën aktuale, në përputhje me praktikat e BE-së (dhjetor 2025). - Rishikimi dhe sugjerimi i përmirësimit të kuadrit ligjor për investimet e kapitalit në *startup*-e (dhjetor 2024); - Përmirësimi i kuadrit ligjor për investimin e kapitalit në *startup*-e dhe zhvillimi i një koncepti në lidhje me produktet financiare për *startup*-et (dhjetor 2025); Projekti i Modelit të Biznesit të Ndërtimit të Fondit të Inovacionit (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Legjislacioni ekzistues nuk është në përputhje me praktikat e BE-së për inovacionin dhe kompanitë inovative.	MSHSKB
Hapi 3 - Përgatitja (dhjetor 2025) dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus në inkubatorët/përshpejtuesit, duke synuar zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale (dhjetor 2026). ✓ Zhvillimi i fushëveprimit të ndërhyrjeve/instrumenteve mbështetëse të gjelbra dhe digjitale: i. Harta e universiteteve, inkubatorëve/përshpejtuesve, programeve të partnerëve të zhvillimit dhe/ose nismave të biznesit që synojnë mbështetjen për zgjidhjet e gjelbra dhe digjitale nga NVM-të/*startup*-et; ii. Rritja e ndërgjegjësimit në fushën e gjelbër dhe digjitale, duke angazhuar sipërmarrësit dhe korporatat në aktivitete të përbashkëta (30.8.24); iii. Analizimi dhe rekomandimi i ndërhyrjeve bazuar tek Agjenda e Gjelbër e BE-së, në lidhje me legjislacionin shqiptar dhe strategjinë ekzistuese të Specializimit Inteligjent (qershor 2025). ✓ Zhvillimi i instrumenteve mbështetëse të zgjidhjeve të gjelbra dhe digjitale: i. Rishikimi i legjislacionit ekzistues që ndikon te veprimet e financimit për zgjidhjet e gjelbra dhe digjitale, të fokusuar te *startup*-et dhe rekomandimi	(dhjetor 2025) (dhjetor 2026)	Skema ekzistuese e granteve nuk fokusohet tek inkubatorët dhe përshpejtuesit. Skema ekzistuese synon 0 inkubatorë dhe përshpejtues që fokusohen te zgjidhjet e gjelbra dhe digjitale Për sa i përket agjendës së gjelbër dhe digjitale, ky komponent është përfshirë në strategji dhe në këtë fazë po ndërtojmë strukturën e financimit që adreson këto zhvillime teknologjike me një fond të dedikuar.	MSHSKB

i përmirësimeve (dhjetor 2025); ii. Hartimi dhe zbatimi i pistës së financimit të gjelbër dhe digjital në skemat e granteve publike (qershor 2025): o *Startup*-et dhe NVM-të: hartimi i një instrumenti bashkëfinancimi me korporatat që synojnë NVM-të dhe *startup*-et që punojnë në fushën e gjelbër dhe digjitale (dhjetor 2024) o Përshpejtuesi: Krijimi i Programit të Përshpejtuesit të gjelbër dhe digjital - mbështetja e 10 sipërmarrësve për të aplikuar në programet e financuara nga BE-ja dhe partnerët e tjerë të zhvillimit (qershor 2026) Inkubatorët/Universitetet: hartimi i një skeme grantesh për universitete dhe inkubatorë të përzgjedhur me fokus tek agjenda e gjelbër dhe digjitale (dhjetor 2025) - Mbështetja e të paktën 10 *spinoffs* potencialë në universitetet shqiptare, nëpërmjet financimit të posaçëm (dhjetor 2026).			
Hapi 4 - Përgatitja (dhjetor 2024) dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus tek SME-të dhe/ose *startup*-et, ku 30% e grantit përcaktohet për SME-të dhe/ose *startup*-et, që synojnë zgjidhje të gjelbra dhe/ose digjitale (dhjetor 2025).	(dhjetor 2024) (dhjetor 2025)	Thirrja aktuale nuk mbulon zgjidhjet e agjendës së gjelbër dhe digjitale për NVM-të. Skema ekzistuese synon 0% të NVM-ve dhe fondeve fillestare, me fokus te zgjidhjet e gjelbra dhe digjitale Thirrja aktuale nuk përfshin zgjidhjet e agjendës së gjelbër dhe digjitale (Për sa i përket agjendës së gjelbër dhe digjitale, ky komponent është përfshirë në strategji dhe në këtë fazë, MAS-ja po ndërton strukturën e financimit që adreson këto zhvillime teknologjike me një fond të posaçëm. Statusi i fokuseve/prioriteteve të	MSHNKB

		skemës së granteve	

9. FUSHA E POLITIKËS 4: ENERGJIA/TRANZICIONI I GJELBËR

4.1 Reformat e tregut

Shqipëria ka politika gjithëpërfshirëse dhe kuadër ligjor të lidhur me sektorin e energjisë. Miratuar në vitin 2018, Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 është dokumenti strategjik kryesor për sektorin e energjisë, i cili fokusohet në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe në minimizimin e ndikimeve mjedisore me kosto të përballueshme për shqiptarët. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) është miratuar në vitin 2021. Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) është pjesë e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK). Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK), i miratuar në vitin 2021, duhet përditësuar dhe zbatuar që të përmbushen objektivat e energjisë dhe klimës për vitin 2030. Gjithashtu, planet e veprimit të efikasitetit të energjisë dhe energjisë së rinovueshme duhet të miratohen sipas kuadrit PKEK 2030, duke përfshirë objektivat e miratuar për energjinë dhe klimën për vitin 2030. Në vitin 2022, u miratua plani kombëtar i veprimit për trajtimin e krizës së energjisë, duke u fokusuar te mbështetja e familjeve në nevojë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) gjatë dimrit të vitit 2022–2023, duke vazhduar përpjekjet drejt qëndrueshmërisë dhe elasticitetit të energjisë përmes burimeve të larmishme të energjisë.

Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në reformimin e tregut të energjisë elektrike, duke synuar rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe konkurrencës. Operatori i sistemit të transmetimit është ndarë dhe certifikuar. Ndarja ligjore e operatorit të sistemit të shpërndarjes nga dega e furnizimit u arrit përmes ristrukturimit të OSHEE-së së dikurshme në një shoqëri me tri degë të licencuara, përkatësisht si furnizuesi i shërbimit universal (FSHU), furnizuesi i tregut të lirë (FTL) dhe operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH).

Për më tepër, Shqipëria po përafron në mënyrë aktive tregun e energjisë elektrike me standardet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian (BE) për të rritur integrimin dhe konkurrencën. Hapa të rëndësishme janë marrja e masave sikurse miratimi i ndryshimeve ligjore për ta përafruar me paketën e integrimit të energjisë elektrike të BE-së dhe krijimi i tregut të energjisë elektrike brenda ditës. Duke u përafruar me direktivat dhe praktikat më të mira të BE-së, Shqipëria synon të promovojë tregtinë ndërkufitare të energjisë elektrike, të përmirësojë efikasitetin e tregut dhe të tërheqë investime në sektorin e energjisë.

Pjesë përbërëse e tranzicionit energjetik të Shqipërisë janë përpjekjet për të përmirësuar kuadrin rregullator për energjinë e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë. Zhvillimi i planeve transparente dhe konkurruese të veprimit për shpërndarjen e energjisë së rinovueshme, thjeshtimi i procedurave të lejeve dhe krijimi i komuniteteve të energjisë së rinovueshme demonstron angazhimin e Shqipërisë për të promovuar burimet e qëndrueshme të energjisë dhe për të reduktuar emetimet e gazeve serrë.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, sfida mbetet lidhur me integrimin në tregun e energjisë elektrike të BE-së, duke përfshirë nevojën për investime të mëtejshme në infrastrukturë, forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe për adresimin e varfërisë energjetike. Me angazhim të vazhdueshëm ndaj reformave dhe me nisma strategjike të përshkruara në Planin e Rritjes, Shqipëria është e gatshme të zbulojë potencialin e saj energjetik, të rrisë konkurrencën në treg dhe të kontribuojë në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike.

R - 4.1.1 Përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike, për të mundësuar integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës (*intra day*), operacionalizimin e paketës në përputhje me planin e integrimit të operatorëve për bashkim të tregjeve deri në vitin 2025

Albanian Power Exchange sh.a. – ALPEX-i është krijuar nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) të Shqipërisë dhe Kosovës. Ai është përgjegjës për aspektet operative dhe menaxhuese të tregjeve me shumicë të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar). Modeli i tregut të energjisë elektrike është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13 korrik 2016, "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike" (i ndryshuar). ALPEX-i ka përzgjedhur një nga anëtarët e *Price Coupling Regional* (PCR) si ofrues shërbimi, për të aksesuar shërbimin e algoritmit evropian për llogaritjet e çmimeve, vëllimeve dhe fluksit të energjisë. Më 29 shtator 2022, ALPEX-i licencohet si operator tregu nga Bordi i ERE-s, me vendimin

nr. 247. Më 12 prill 2023, ALPEX-i zbatoi Tregun e Ditës në Avancë (DAM) në Shqipëri. Më 1 shkurt 2024, ai zbatoi DAM-in së bashku me bashkimin e tregut të DAM-it midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Aktualisht, ALPEX-i po punon me OST-të e Shqipërisë dhe Kosovës për zbatimin e ankandeve brenda ditës për Shqipërinë dhe për bashkimin e tregut IDA ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri po kalon reforma të rëndësishme për t'u përafruar me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe për t'u integruar në nismën Bashkimi i Tregut të Ditës në Avancë (SDAC). Ky integrim synon të rrisë efikasitetin e tregut, të promovojë tregtinë ndërkufitare të energjisë elektrike dhe të nxisë bashkëpunimin rajonal. ALPEX-i ka hartuar rregullat e tregut në përputhje me modelin evropian, duke përfshirë kryesisht dispozitat në Rregulloren (BE) 2019/943. Këto rregulla për tregun u miratuan nga Bordi i ERE-s më 27 dhjetor 2022.

Thelbi i integrimit të tregut qëndron në përafrimin e rregullave të tregut të Shqipërisë me rregulloret e BE-së, veçanërisht me Direktivën dhe Rregulloren e Energjisë Elektrike (BE) 2019/943. Kuadri rregullator i Shqipërisë duhet të rishikohet për të siguruar përputhjen e standardeve të BE-së me dizajnin e tregut, konkurrencën, transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Kjo përfshin rishikimin e legjislacionit dhe rregulloreve që pjesëmarrësit e tregut të luajnë në mënyrë të barabartë, si dhe lehtësimin e tregtisë ndërkufitare të energjisë elektrike.

Shqipëria duhet të miratojë mekanizmat e bashkimit të tregut për të lehtësuar zbulimin efikas të çmimeve dhe optimizimin e flukseve ndërkufitare të energjisë elektrike. Bashkimi i tregut integron tregjet shqiptare të energjisë elektrike në një treg të vetëm pan-evropian, duke harmonizuar mekanizmat e çmimeve dhe dispeçimit.

Shqipëria po bashkëpunon me vendet fqinje dhe Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO-ve) për të zbatuar zgjidhjet e bashkimit të tregut, ku bashkimi i tregut Shqipëri–Kosovë DAM është një rast i tillë i integrimit. ALPEX-i ka krijuar mekanizma transparentë të monitorimit të tregut, duke publikuar të dhënat e tregut në një platformë të dedikuar, duke siguruar përputhjen me kërkesat e raportimit.

Për më tepër, ALPEX-i ka përforcuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e tregut nëpërmjet mbikëqyrjes rregullatore efektive, mbikëqyrjes së tregut dhe mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Integrimi në Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë ofron një mundësi të rëndësishme për Shqipërinë, që të rrisë efikasitetin e tregut të energjisë elektrike, të promovojë bashkëpunimin rajonal dhe të mbështesë objektivat e tranzicionit energjetik.

Duke ndërmarrë hapat e mësipërm të reformës, Shqipëria mund të krijojë një mjedis rregullator të favorshëm, të forcojë institucionet e tregut dhe të rrisë gatishmërinë e infrastrukturës për të realizuar plotësisht përfitimet e bashkimit të tregut dhe për të kontribuar në zhvillimin e një tregu evropian më të integruar dhe më të qëndrueshëm të energjisë elektrike.

Shqipëria është e përfshirë, subjektet kanë nisur aktivitetet për transpozimin e paketës së re të integrimit të energjisë elektrike. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nisur procesin e rishikimeve të kërkuara në legjislacionin për transpozimin e Direktivës së Energjisë Elektrike, rregullores së energjisë elektrike 2019/943, rregullores ACER 2019/942 dhe rregullores 2019/941, për gatishmërinë ndaj rrezikut. Ndërkohë, ka pasur progres në diskutimet për transpozimin e rregulloreve/kodeve të rrjetit dhe udhëzimeve të mbetura (CACM; FCA; EBLG; SOGL; ER) në legjislacionin dytësor, të cilat janë në një masë të madhe nën kompetencën e operatorit të sistemit të transmetimit OST, si dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Procesi ka nisur nga një ekip konsulence në OST për analizën e akteve rregullatore dhe nënligjore në fuqi dhe për zbatimin e rregulloreve/kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit të sipërpërmendura (CACM; FCA; EBLG; SOGL; ER). OST është pjesë e Task-Forcës EnC në ENTSO-E, ku ka pasur diskutime për transpozimin dhe zbatimin e paketës së re të komunitetit të energjisë.

OST-të e Palëve Kontraktuese të EnC-së janë nxitur nga EnC për zbatimin e bashkëpunimit rajonal dhe për përgatitjen e TCM-së rajonale, nëpërmjet ENTSO-E.

Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit po bashkëpunon në mënyrë proaktive me OST-të e tjera në vendet e Evropës Jug Lindore (EJL), për krijimin e Rajonit të Llogaritjes së Kapaciteteve "Hije" nën kujdesin e ENTSO-E, që është hapi i parë për përgatitjen e Metodologjisë së Koordinuar të Rajonit të Llogaritjes së Kapaciteteve "Hije" të Evropës Jug Lindore (EJL) dhe për pjesëmarrjen në Qendrat

Rajonale të Koordinimit. Në fazën aktuale ka opinione të ndryshme nga OST-të e rajonit për konfigurimin e Rajonit për Llogaritjen e Kapaciteteve të Evropës Juglindore (EJL). Nevojitet një kuadër ndërmjetësimi për të rregulluar situatën.

Operatori shqiptar i Sistemit të Transmetimit (së bashku me OST-të e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës), si hap të parë drejt krijimit të një platforme rajonale të alokimit në përputhje me FCA-në e miratuar, ka përgatitur për diskutim propozimin për krijimin e një Platforme Alokimi Rajonal, sipas nenit 48 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave 2022/03/MC, më 15 dhjetor 2022. Ky propozim u është shpërndarë OST-ve të tjera të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (Serbia, Moldavia, Ukraina) për diskutim dhe i është përcjellë EnCS. Vlen për t'u theksuar se procesi i bashkëpunimit rajonal varet kryesisht nga ndërveprimet e të gjitha palëve të përfshira, pavarësisht përpjekjeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar. Sipas Udhëzimit të Balancimit të Energjisë Elektrike, OST-të kanë ndërmarrë iniciativa për bashkëpunimin e rezervave ndërkufitare. Këto nisma përfshijnë: IGCC, PICASSO, TERRE, MARI.

OST-ja nuk është ende pjesë e nismave për bashkëpunim, por duke pasur parasysh zbatimin e rregulloreve të reja, së shpejti OST-së do t'i duhet të nisë punën përgatitore për t'u përfshirë në ndarjen dhe shkëmbimet e rezervave ndërkufitare. Ky është një aktivitet sfidues, jo vetëm për përgatitjen e akteve rregullatore të nevojshme, por edhe për analizën e detajuar të kushteve teknike që duhen plotësuar nga OST-ja për të qenë pjesë e këtyre platformave. OST-ja është pala kryesore e interesit (57.25%) e Kompanisë Shqiptare të Shkëmbimit të Energjisë Elektrike me emrin ALPEX, së bashku me KOSTT (42.75%), e cila është regjistruar në tetor 2020, me selinë në Tiranë, Shqipëri, dhe me një degë në Prishtinë, Kosovë.

Më 12 prill 2023, ALPEX-i ka filluar funksionimin e Tregut të Ditës në Avancë për Shqipërinë. Më 1 shkurt 2024, ai ka filluar funksionimin e Tregut të Ditës në Avancë të Kosovës dhe të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë të Shqipëri–Kosovë. OST-të, PX-të dhe NRA-të e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Greqisë po hartojnë Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë (nëntor 2023).

OST-ja është qenë anëtare e ENTSO-E që nga marsi 2017. OST-ja ka nënshkruar NDA Globale dhe është vëzhguese në SDAC që më 29 janar 2018. Por, procesi për pranimin e ALPEX-it si vëzhgues në SDAC është pezulluar për shkak të votës negative të EMS-së dhe SEPEX-it (përkatësisht OST-ja Serbe dhe PX). Vëzhgimi është hapi paraprak për anëtarësimin e OST-së dhe ALPEX-it në SDAC, si parakusht për të mundësuar bashkimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë.

Sfidat kryesore mbeten vlerësimi, kuptimi dhe zbatimi i duhur i secilës prej rregulloreve/kodeve të rrjetit dhe udhëzimeve (CACM; FCA; EBLG; SOGL; ER). Përgatitja e secilit prej akteve dhe më tej përpunimi, hartimi dhe përgatitja e secilit prej termave dhe kushteve të parashikuara në këto rregullore/kode dhe udhëzime të rrjetit, kërkon një përfshirje të madhe të burimeve njerëzore dhe nënkupton edhe vlerësimin e kushteve teknike dhe kërkesave që duhet të plotësohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për zbatimin e tyre në praktikë, me synimin e krijimit të tregut të energjisë elektrike brenda ditës, për të mundësuar bashkimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së me Shqipërinë dhe funksionalizimin e paketës në përputhje me planin e integrimit të operatorëve të bashkimit të tregut.

Sipas ndryshimeve në ligjin shqiptar për energjinë elektrike, aktet nënligjore të mëposhtme do të përgatiten dhe do t'i propozohen për miratim NRA-së:

- OST-ja duhet të marrë pjesë në propozimin për konfigurimin e Rajonit të Llogaritjes së Kapaciteteve të Evropës Juglindore (EJL) në përputhje me CACM-në e miratuar, përfshirë Metodologjinë e Koordinuar të Llogaritjes së Kapacitetit për OST dhjetor 2025).

- OST-ja duhet të marrë pjesë në procesin e krijimit të një Platforme Rajonale të Shpërndarjes sipas nenit 48 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, sikurse është miratuar (OST dhjetor 2025).

Tabela 16: Rezultatet dhe produktet e pritshme - Përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike, për të mundësuar integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës (*intra day*), operacionalizimin e paketës në përputhje me planin e integrimit të operatorëve për bashkim të tregjeve deri në vitin 2025

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Modernizimi dhe integrimi evropian i tregut kombëtar të	Miratimi i ndryshimeve ligjore për ta përafruar me paketën e integrimit të energjisë elektrike[84],	**4.1.1.** Përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike, për

[84] Afatet nuk janë evidenca të afatit ligjor të përcaktuar në paketën e integrimit të energjisë elektrike.

energjisë elektrike për të siguruar funksionimin në mënyrë më efikase dhe në harmoni me siste... duke promovuar kështu sigurinë energjetike dhe stabilitetin e tregut.	në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe fillimin e zbatimit (qershor 2025).		të mundësuar integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të ... energjisë elektrike brend... *day)*, operacionalizimin ... përputhje me planin ... operatorëve për ba... deri në vitin 2025.
Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
4.1.1. Përafrimi me paketën e integrimit të energjisë elektrike mundëson bashkimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës, operacionalizimin e paketës në përputhje me planin e integrimit të operatorëve të bashkimit të tregut deri në vitin 2026			**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**
Hapi 1 – Miratimi i ndryshimeve ligjore për t'u përafruar me paketën e integrimit të energjisë elektrike[85], në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe fillimi i zbatimit të tyre (qershor 2025). - Projekt-amendamentet e ligjit për sektorin e energjisë elektrike (shtator 2024). - Miratimi i ligjit "Për disa ndryshime në ligjin 43/2015 të Sektorit të Energjisë Elektrike", në përputhje me paketën e Integrimit të Energjisë Elektrike (qershor 2025).	(qershor 2025)	Ligji pa ndryshime ligjore për përafrimin me paketën e integrimit të energjisë elektrike.	MIE
Hapi 2 – Vazhdimi i zbatimit të Paketës së Integrimit të Energjisë elektrike, duke vënë në funksion tregun e energjisë elektrike brenda ditës (*intra day*)[86], në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë (dhjetor 2024). - IDM "*Go live*" (dhjetor 2024).	(dhjetor 2024)	Nuk ka treg brenda ditës që funksionon. ALPEX-i po zhvillon aktivitetet për funksionalizimin e Tregut Brenda Ditës (IDM).	MIE
Hapi 3 – Vazhdimi i zbatimit të Paketës së Integrimit të Energjisë Elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST[87]) dhe Operatori i emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (*NEMO-Nominated Electricity Market Operator*), duke ndërmarrë veprimet e nevojshme kombëtare për t'u integruar (*market coupling*)[88] me tregun	(dhjetor 2025)	Bashkimi i tregut të ditës në avancë me BE-në.	MIE, ERE, TSO, OST

Zbatimi dhe përgjegjësitë

[85] Afatet janë pa paragjykim të afatit ligjor të përcaktuar në paketën e integrimit të energjisë elektrike.
[86] *Intra-day market* – Tregu i energjisë elektrike "brenda ditës".
[87] Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
[88] *Market coupling* – Integrimi/lidhja e tregut: Është një metodë e përdorur në tregun e energjisë për të integruar/lidhur tregje të ndryshme të energjisë elektrike, duke lejuar shpërndarjen efikase të energjisë elektrike përtej kufijve. Synon të optimizojë

e ditës në avancë (*day ahead market*)[89] të Bashkimit Evropian, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë (dhjetor 2025). - Rishikimi i rregullave të tregut, në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/943 të datës 5 qershor 2019, për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (tetor 2025). - Zbatimi i tregtimit të produkteve të energjisë elektrike me rezolucion 15-minutësh për Tregun e Ditës në Avancë (dhjetor 2025). - Sigurimi i respektimit të ALPEX-it me Global CACM NDA (qershor 2025). - Pjesëmarrja me ALPEX-in, së bashku me Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të Shteteve Anëtare dhe Palëve Kontraktuese të Bashkimit Evropian (BE), për të zhvilluar një plan integrimi për Operacionin e Bashkimit të Tregut (MCO) (*JET-EnC Parties*, qershor 2025). - OST-ja duhet të identifikojë dhe të plotësojë mangësitë ligjore dhe teknike të nevojshme për anëtarësimin në platformat balancuese të BE-së dhe t'i aplikojë (OST qershor 2025); - Përgatitja dhe miratimi i Planit MCO (OST dhjetor 2025); - Përgatitja dhe miratimi i TCM-ve të nevojshme për t'i u bashkuar tregut të ditës në avancë me BE-në (OST dhjetor 2025); - Paraqitja e kërkesave nga ALPEX-i dhe OST-ja për të qenë vëzhgues në Tryezën e Punës së Kufirit Italian (ALPEX-OST_ mars 2024); - ALPEX do t'i bashkohet një Projekt Zbatimi Vendor (LIP) për kufijtë Greqi–Shqipëri–Kosovë (ALPEX-OST_ dhjetor 2025); - Hartimi dhe miratimi i procedurave për SIDC Shqipëri–Kosovë në lidhje me legjislacionin shqiptar (ALPEX-OST_shtator 2024); - Ekzekutimi i testeve të integrimit dhe lidhjes (OST/PX të përbashkët & CCP) (ALPEX-OST_mars 2025); - Ekzekutimi i testit FIT (ALPEX-OST_ mars 2025); - Ekzekutimi i testeve të simulimit/procedurës (ALPEX-OST_ qershor 2025); - Rregullorja (BE) 2015/1222: Përcaktimi i një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e mbipopullimit (OST/ERE,			

përdorimin e kapacitetit të transmetimit dhe të përmirësojë efikasitetin e tregut duke përshtatur ofertën dhe kërkesën në të gjithë rajonet.

[89] *Day ahead market* – Tregu i "ditës në avancë" për energjinë elektrike.

dhjetor 2024); - Rregullorja (BE) 2016/1719: Përcaktimi i një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve të ardhshme (OST/ERE mars 2025); - Rregullorja (BE) 2017/2195: Përcaktimi i një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike (OST/ERE mars 2025); - Rregullorja (BE) 2017/2196: Për vendosjen e kodit të rrjetit për urgjencën dhe restaurimin e energjisë elektrike (OST/ERE, mars 2025); - Rregullorja (BE) 2017/1485: Përcaktimi i një udhëzuesi për operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike (OST/ERE, mars 2025); - OST-ja të ngrihet sipas propozimit për *Shadow* CCR lidhur me CACM, të përgatisë Metodologjinë e Koordinuar të Llogaritjes së Kapacitetit për Rajonin e Llogaritjes së Kapacitetit të Evropës Juglindore (EJL) dhe të lëshojë autorizimin për të hyrë në marrëveshje me RCC-në me bazë evropiane për kufirin me shtetet e BE-së (OST, dhjetor 2025); - OST-ja të miratojë Propozimin për krijimin e një Platforme Rajonale të Shpërndarjes sipas nenit 48 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave 2022/03/MC më 15 dhjetor 2022 (OST, dhjetor 2025).			

R – 4.1.2 Rregullimet graduale të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e varfërisë energjitike

Sektori i energjisë elektrike në Shqipëri ka ndërmarrë reforma të rëndësishme vitet e fundit, të cilat synojnë modernizimin e infrastrukturës, rritjen e efikasitetit dhe promovimin e politikave të orientuara nga tregu. Në fokus të këtyre reformave është kalimi nga një sistem tarifor shumë i rregulluar në një mekanizëm çmimi të bazuar në tregun e energjisë elektrike. Ky tranzicion është pjesë e përpjekjeve për të harmonizuar sektorin energjetik të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Një nga masat kyçe në këtë tranzicion është përshtatja graduale e tarifave të energjisë elektrike me çmimet e tregut. Ky proces synon të krijojë një mjedis tregu më konkurrues dhe transparent, ku çmimet përcaktohen nga dinamika e ofertës dhe kërkesës dhe jo nga ndërhyrja publike. Duke përshtatur tarifat me çmimet e tregut, Shqipëria kërkon të stimulojë investimet në sektorin e energjisë, të përmirësojë mekanizmat e mbulimit të kostos për prodhuesit e energjisë elektrike dhe të rrisë eficiencën e përgjithshme të tregut të energjisë elektrike.

Shqipëria ka ndjekur zbatimin e derregullimit të tarifave, si pjesë e angazhimit të saj për miratimin e Paketës së Energjisë. Klasifikimi i klientëve është bërë sipas pikës së lidhjes të konsumatorëve, me tension të ulët, të mesëm ose të lartë. Ligji aktual për sektorin e energjisë elektrike, i përafruar me paketën e tretë të energjisë, është zbatuar përmes mekanizmit të Furnizuesit Universal nën një PSO, si dhe përmes Furnizuesit të Burimit të Fundit që operon si furnizues në tension të ulët dhe të mesëm. Në fakt, zbatimi i derregullimit ka nisur në vitin 2016, me hapjen e tregut me pakicë për konsumatorët e mëdhenj të furnizuar në rrjetin e transmetimit të tensionit të lartë. Nga viti 2022, klientët e furnizuar në rrjetin e tensionit të mesëm (nën OSSH), janë njoftuar se u është dhënë një periudhë furnizimi, maksimumi dy vite, për ata konsumatorë që janë të gatshëm të hyjnë në tregun me pakicë.

Nga janari i vitit 2024, konsumatorët e furnizuar në rrjetin 20 KV hyjnë në tregun e shitjes me pakicë, pjesë e të cilit është edhe NSH, FTL sh.a., pjesë e grupit OSHEE, e cila lehtëson procesin, si dhe përgatitet për aktivitetin e qasjes ndaj tregut. Megjithatë, zbatimi i plotë i derregullimit për tensionin e mesëm dhe të lartë ndikohet nga faktorë të ndryshëm, si pandemia e Covid-19, kriza energjetike, gatishmëria e rrjetit, nevojat për digjitalizim, gatishmëria e pjesëmarrësve të tregut, njohuritë rregullatore të tregut të pjesëmarrësve, etj. Nga ana tjetër, politika e de-rregullimit ka sjellë, si për pjesëmarrësit e tregut, por edhe për klientët, pasiguri dhe rreziqe në treg që zakonisht pasohen nga mundësitë dhe me e rëndësishmja nga ekspozimi financiar. Konsumatorët në periudhën e krizës kanë kërkuar që të mbështeten, duke denoncuar derregullimin dhe rrezikun e afërt të ekspozimit të tregut. Por në ditët e sotme, me derregullimin në fuqi dhe çmimin më të favorshëm të tregut, ata e kanë shfrytëzuar një detyrim të tillë për derregullim më shumë si një të drejtë.

Furnizuesit e licencuar janë faktorizuar nga sjellja e klientëve, si dhe nga tregu. Megjithatë, përgjigja ndaj interesimit ka qenë e kënaqshme dhe ka plotësuar nevojat. Në periudhën pasuese, do të vazhdojë të ketë rëndësi vendimtare ndjekja e stabilitetit të një aktiviteti të tillë, si dhe realizimi i finalizimit të këtij derregullimi me kujdes ndaj ndikimeve që mund të pasojnë në zbatimin e këtyre aktiviteteve. Për ta arritur këtë, Shqipëria synon të rezervojë instrumentet e nevojshme për balancimin e këtyre ndikimeve dhe për trajtimin e varfërisë energjetike dhe klientëve vulnerabël.

Për këtë arsye, si dhe për të garantuar stabilitetin makroekonomik, ne synojmë të ndërmarrim aktivitetet dhe masat e nevojshme për zbatimin e politikave për klientët në nevojë dhe për varfërinë e energjetike, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së dhe me kontekstin vendor.

Derregullimi do të zbatohet për klientët me tension të mesëm dhe të lartë, lidhur me paketën energjitike, me mbështetjen e SLR-së për çmimin e rregulluar. Aktualisht, derregullimi është bërë për klientët e furnizuar në 20, 35 dhe 110 kV. Plani i veprimit për të vazhduar derregullimin e Segmentit 6 dhe 10 kV do të dorëzohet brenda shtatorit 2024 dhe do të miratohet brenda dhjetorit 2024, duke synuar derregullimin e tregut me pakicë 6 - 110 kV.

Procesi i derregullimit i cili ka filluar që prej vitit 2026 është ende duke u zbatuar, me qëllim që të arrihet brenda afatit të caktuar. Palët e interesuara njihen dhe janë të vetëdijshme për zbatimin e këtij procesit. Ndikimi i derregullimit dhe adresimi i varfërisë energjetike do të jenë pjesë e procesit për daljen graduale të ndërhyrjes publike. Do të përgatitet një metodologji për përcaktimin e grupeve të varfra nga energjia dhe një plan veprimi për të adresuar ndikimin tek konsumatorët vulnerabël.

Tabela 17: Rezultatet dhe produktet e pritshme - Rregullimet graduale të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e varfërisë energjetike.

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritjet
Përmirësimi i kuadrit rregullator të tregut të energjisë elektrike, duke promovuar një mjedis çmimesh më konkurrues dhe të drejtë, duke siguruar gjithashtu që popullata e cenueshme të marrë mbështetjen e nevojshme, për të menaxhuar nevojat për energji në mënyrë efektive.	Tërheqja graduale nga ndërhyrja publike në përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike, nëpërmjet derregullimit të tensionit të mesëm dhe të lartë (Plani Veprimit/dhjetor 2024), në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë (dhjetor 2025). Zhvillimi i metodologjisë për të përcaktuar grupet e prekura nga varfëria energjetike dhe mjetet e monitorimit, si dhe masat e eficiencës së energjisë që synojnë konsumatorin në nevojë, duke miratuar planin e veprimit për adresimin e varfërisë energjetike (qershor 2026).	**4.1.2.** Rregullimet graduale të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e varfërisë energjetike.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
R 4.1.2. Rregullimet graduale të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e varfërisë energjitike			**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**
Hapi 1- Tërheqja graduale nga ndërhyrja publike në përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike, nëpërmjet derregullimit të tensionit të mesëm dhe të lartë (Plani Veprimit/dhjetor 2024), në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë (dhjetor 2025). (Dhjetor 2024). • Hartimi i planit të veprimit për derregullimin e tensionit të mesëm dhe të lartë, në përputhje me ligjin për Sektorin e Energjisë (MIE, shtator 2024); • Konsultimi dhe miratimi i planit të veprimit për derregullimin e tensionit të mesëm dhe të lartë, në përputhje me ligjin për Sektorin e Energjisë (MIE, dhjetor 2024); • Çrregullimi i tregut me pakicë në tensionin e mesëm dhe të lartë (dhjetor 2025).	(dhjetor 2024) (dhjetor 2025)	Asnjë plan veprimi për derregullimin e tensionit të mesëm dhe të lartë. Nuk ka masa për derregullimin e tregut me pakicë në tensionin e mesëm dhe të lartë.	MIE
Hapi 2 - Zhvillimi i metodologjisë për të përcaktuar grupet e prekura nga varfëria energjetike dhe mjetet e monitorimit, si dhe masat e eficiencës së energjisë që synojnë konsumatorin në nevojë, duke miratuar planin e veprimit për adresimin e varfërisë energjetike (qershor 2026): - Zhvillimi i metodologjisë për përcaktimin e grupeve të varfra energjetike dhe hartimi i një plani masash për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e konsumatorit vulnerabël (dhjetor 2024); - Miratimi i planit të veprimit të masave për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e konsumatorit vulnerabël (qershor 2026).	(qershor 2026)	Nuk ka metodologji për të përcaktuar grupet e varfra nga energjia.	MIE

4.2 ENERGJITË E RINOVUESHME

R - 4.2.1 Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme: Planifikimi trevjeçar i miratuar

Shqipëria do të përshpejtojë zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Shqipërinë, në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky Plan Veprimi konfirmon angazhimin tonë për të miratuar objektivat e energjisë dhe klimës 2030, angazhimin tonë për të miratuar paketa legjislative që lehtësojnë integrimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe përmirësojnë monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të gazeve serrë, siç propozohet nga Komisioni Evropian.

Objektivat e miratuar për energjinë dhe klimën do të shërbejnë si bazë për transformimin e ekonomisë së Shqipërisë, në përputhje me Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (PKEK-të) dhe me angazhimet për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050.

Në kuadrin e diversifikimit të energjisë elektrike, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të nxitur konkurrencën, kosto-efektivitetin dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në tregjet e energjisë elektrike nëpërmjet ankandeve të tyre për skemat mbështetëse të bazuara në treg. Ne synojmë shtrirjen e energjisë së rinovueshme, përshpejtimin e vendosjes dhe integrimin e energjisë së rinovueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, në përputhje me objektivat evropian 2030 dhe 2050 të politikës së energjisë dhe klimës.

Konsiderohen si çështje me përparësi zhvillimi i infrastrukturës prioritare të energjisë elektrike dhe energjisë së rinovueshme, projekteve të integrimit të tregut dhe prioriteteve të politikave për energjinë e rinovueshme, si dhe përshpejtimi i zbatimit të projekteve prioritare të infrastrukturës, me qëllim përmirësimin e funksionimit dhe dekarbonizimit të tregjeve të energjisë në Shqipëri.

Kjo reformë do të kontribuojë në rritjen e investimeve në fushën e energjisë së rinovueshme, si dhe në rritjen e të ardhurave nga ky sektor, si dhe në sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Zbatimi i kësaj reforme do të reduktojë emetimet e gazeve serrë, duke ndikuar në mbrojtjen e mjedisit.

Përfituesit kryesorë janë qytetarët, investitorët.

Reforma do të zbatohet nga institucionet e Qeverisë së Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator Shqiptar, OST-ja, OSSH-ja, Prodhuesi Publik (KESH), në bashkëpunim me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, me partnerët ndërkombëtarë, me palët e interesit, me përfaqësues të biznesit, etj.

Tabela 18: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 4.2.1. Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme: Planifikimi trevjeçar i miratuar

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Demonstrimi i përkushtimit për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë përmbush objektivat mjedisorë dhe mbështet rritjen ekonomike, duke inkurajuar zhvillimin e teknologjive dhe infrastrukturës së gjelbër.	Miratimi i një plani ankandi, me bazë sasiore, për të paktën 600 mw instalime të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme për tre vitet e ardhshme (300 mw në proces konsiderohen si pjesë e planit trevjeçar të ankandit) (**dhjetor 2024**).	4.2.1. Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme: Planifikimi trevjeçar i miratuar.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
R. 4.2.1 Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme: Planifikimi trevjeçar i miratuar			
Miratimi i një plani ankandi, me bazë sasiore, për të paktën 600 mw instalime të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme për tre vitet e ardhshme (300 mw në proces konsiderohen si pjesë e planit trevjeçar të ankandit) (**dhjetor 2024**). - Hartimi i planit të ankandit me bazë sasiore për të paktën 600 mw instalime të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme për tre vitet e ardhshme (tetor 2024); - Miratimi i planit të ankandit me bazë sasiore për të paktën 600 mw instalime të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme për tre vitet e ardhshme (dhjetor 2024);	Dhjetor 2024	Nuk ka plan ankandi me bazë sasiore për energjitë e rinovueshme 600 mw.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

R – 4. 2. 2 Zbatimi i Direktivës së Energjisë të Rinovueshme: miratimi i legjislacionit RES[90], riorganizimi i lejeve, krijimi i komuniteteve të energjisë së rinovueshme, funksionalizimi i garancive të origjinës

Sektori energjetik i Shqipërisë po hyn në një epokë transformimesh të rëndësishme për shkak të zhvillimeve të intensifikuara në përdorimin e energjisë së rinovueshme. Diversifikimi i burimeve të energjisë (së rinovueshme) do të ketë ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në rritjen e konkurrencës dhe në sigurinë e furnizimit si rezultat i përdorimit të burimeve të reja të energjisë (diellore dhe erë), të cilat do të rrisin prodhimin vendas të energjisë në tregun e vendit. Regjimi aktual ligjor dhe rregullator në fushën e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë është në përputhje me direktivën (BE) 2018/2001.

[90] RES – *Renewable Energy Sources*.

Gjatë vitit 2023, ligji nr. 24/2023, datë 23.3.2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", në përputhje me direktivën (BE) 2018/2001, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në kuadër të projektit rajonal të zbatuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, u krijua një regjistër elektronik për garancitë e origjinës (GO) në Shqipëri. Pika tjetër kritike për arritjen e një sistemi GO plotësisht funksional përfshin miratimin e rregullave të deklarimit dhe llogaritjen e përzierjes së energjisë së mbetur. Ligji i ri nr. 24/2023, datë 23.3.2023, "Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme" ka përfshirë dispozitat e nevojshme ligjore për emetimin e GO-së për të gjitha llojet e transportuesve të energjisë, përfshirë gazin e rinovueshëm dhe ngrohjen e ftohjen.

Komuniteti i energjisë së rinovueshme, si një koncept i ri në legjislacionin shqiptar, do të mundësojë dhe stimulojë anëtarësimin e familjeve me të ardhura të ulëta ose në nevojë. Qëllimi kryesor i këtyre subjekteve është ofrimi i përfitimeve mjedisore, ekonomike ose sociale të komunitetit për aksionerët ose anëtarët e tyre, ose për zonat lokale ku ato operojnë. Komuniteti i energjisë së rinovueshme do të ketë të drejtën: të prodhojë, konsumojë, ruajë, ndajë, shesë energji të rinovueshme dhe të sigurojë grumbullim përmes marrëveshjeve të blerjes së energjisë së rinovueshme, të aksesojë të gjitha tregjet e përshtatshme të energjisë drejtpërdrejt ose përmes grumbullimit, në mënyrë jodiskriminuese, dhe të mbështesë si prodhues prioritar në përputhje me ligjin nr. 24/2023.

Kuadri ligjor i Shqipërisë nuk është në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë, të përcaktuara në DAR II për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse të biomasës. Kriteret pritet të inkorporohen në një ligj të veçantë. Miratimi i një ligji të tillë është thelbësor për të garantuar përdorimin e konsiderueshëm të biokarburanteve nga Shqipëria, me qëllim për të kontribuar efektivisht në arritjen e objektivit 2030 RES.

Kjo reformë do të kontribuojë në rritjen e rolit të qytetarëve në tregun e energjisë elektrike, investimeve në fushën e energjisë së rinovueshme, si dhe në rritjen e të ardhurave nga ky sektor. Zbatimi i kësaj reforme do të reduktojë emetimet e gazeve serrë, duke mbrojtur kështu mjedisin. Përfituesit kryesorë janë qytetarët, investitorët.

Reforma do të zbatohet nga institucionet e Qeverisë së Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator Shqiptar, OST-ja, OSSH-ja, prodhuesi publik (KESH), në bashkëpunim me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, me partnerët ndërkombëtarë, me palët e interesit, me përfaqësues të biznesit, etj.

Tabela 19: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 4.2.2 Zbatimi i Direktivës së Energjisë të Rinovueshme: miratimi i legjislacionit RES, riorganizimi i lejeve, krijimi i komuniteteve të energjisë së rinovueshme, funksionalizimi i garancive të origjinës.

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Progresi i rëndësishëm në strategjinë kombëtare për kalimin në një sistem energjie më të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit, duke kontribuar si në sigurinë kombëtare të energjisë ashtu edhe në qëllimet globale mjedisore.	Miratimi i ligjit të harmonizuar me Direktivën e Energjisë së Rinovueshme të vitit 2018 për biomasën/biokarburantet, përfshirë qëndrueshmëri dhe kriteret e uljes të emetimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet (qershor 2025). Sistem funksional për lëshimin e garancive të origjinës për energjinë e rinovueshme (dhjetor 2024). Miratimi i ndryshimeve në rregullat në fuqi për dhënien e lejeve, për të thjeshtuar procedurat e lejeve për burimet e rinovueshme (njësi familjare dhe instalime të mëdha) (qershor 2025). Miratimi i kornizës ligjore për krijimin e komuniteteve të energjisë (qershor 2026). Të paktën 600 mw kapacitete të reja të energjisë së rinovueshme të instaluara (qershor 2027). Pjesa që zë energjia nga burimet e rinovueshme në totalin bruto të energjisë, arrihet sipas Planit Kombëtar në fuqi për Energjinë dhe Klimën (qershor 2027).	**4.2.2.** Zbatimi i Direktivës së Energjisë të Rinovueshme: miratimi i legjislacionit RES, riorganizimi i lejeve, krijimi i komuniteteve të energjisë së rinovueshme, funksionalizimi i garancive të origjinës.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
4.2.2. Zbatimi i Direktivës së Energjisë të Rinovueshme: miratimi i legjislacionit RES, riorganizimi i lejeve, krijimi i komuniteteve të energjisë së rinovueshme, funksionalizimi i garancive të origjinës.			**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**
Hapi 1 - Miratimi i ligjit të harmonizuar me Direktivën e Energjisë së Rinovueshme të vitit 2018 për biomasën/biokarburantet, përfshirë qëndrueshmëri dhe kriteret e uljes të emetimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet (qershor 2025). - Hartimi i projektligjit për biokarburantet, në përputhje me Direktivën e Energjisë së Rinovueshme të vitit 2018 (dhjetor 2024); - Procesi i miratimit të projektligjit për biokarburantet, në përputhje me Energjinë e Rinovueshme të vitit 2018 (qershor 2025)	(qershor 2025)	Nuk ka ligj për biokarburantet të harmonizuar me Direktivën e Energjisë së Rinovueshme të vitit 2018 për biomasën/biokarburantet, përfshirë qëndrueshmërinë dhe kriteret e kursimit të emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet;	MIE
Hapi 2 - Sistem funksional për lëshimin e garancive të origjinës për energjinë e rinovueshme (dhjetor 2024). • Sistemi për lëshimin e çertifikatave të origjinës në përputhje me Sistemin Evropian të Çertifikatave të Energjisë (Qershor 2024). • Operacioni i GO-së do të kryhet në qendrën e komunikimeve ndër-regjistrore (dhjetor 2024).	(dhjetor 2024)	Garancitë e origjinës për energjinë e rinovueshme	MIE
Hapi 3 - Miratimi i ndryshimeve në rregullat në fuqi për dhënien e lejeve, për të thjeshtuar procedurat e lejeve për burimet e rinovueshme (njësi familjare dhe instalime të mëdha) (qershor 2025). - Hartimi i legjislacionit dytësor për procedurat e dhënies së lejeve për energjitë e rinovueshme (dhjetor 2024). - Miratimi i legjislacionit dytësor për procedurat e dhënies së lejeve për energjitë e rinovueshme. (qershor 2025).	(qershor 2025)	Nuk ka ndryshime ligjore - për të thjeshtuar procedurat e lëshimit të lejeve për burimet e rinovueshme	MIE
Hapi 4 - Miratimi i komizës ligjore për krijimin e komuniteteve të energjisë (qershor 2026). - Draftimi i kuadrit ligjor për themelimin e Komuniteteve të Energjisë (dhjetor 2025). - Miratimi i kuadrit ligjor për themelimin e Komuniteteve të Energjisë (qershor 2026)	(qershor 2026)	Nuk ka kuadër ligjor për komunitetet e energjisë elektrike	MIE
Hapi 5 - Të paktën 600 MË kapacitete të reja të energjisë së rinovueshme të instaluara (qershor 2027). - 600 MW kapacitete gjeneruese të rinovueshme në funksionim, krahasuar me kapacitetet e instaluara më 1 qershor 2024 - Miratimi i planit të ankandit të bazuar në sasinë (dhjetor 2024) - Të paktën 600 MW kapacitete gjeneruese të rinovueshme e të shtuara funksionojnë, krahasuar me 01 janar 2024 (qershor 2027)	(qershor 2027)	Rritja e burimeve të rinovueshme	MIE
Hapi 6 - Pjesa që zë energjia nga burimet e rinovueshme në totalin bruto të energjisë, arrihet sipas Planit Kombëtar në fuqi për Energjinë dhe Klimën (qershor 2027). - Rishikimi i PKEK (qershor 2025) - Matja e zbatimit të PKEK (qershor 2026) - Rishikimi i PKEK (dhjetor 2026) - Të arrihet pjesa RES në përzierjen bruto të energjisë sipas PKEK-it në fuqi, më qershor 2027	(qershor 2027)	Prodhimi RES sipas standardit EUROSTAT	MIE

4.3 MIRATIMI ETS

R - 4.3.1 Puna për çmimin e karbonit me synimin për të pasur një ETS[91] në fuqi deri në vitin 2030: fokusimi në paketën MRVA

Strategjia e Energjisë për Shqipërinë 2018–2030, si dokument kryesor strategjik për sektorin energjetik të vendit, është koherent me politikat dhe strategjitë e tjera kombëtare dhe objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Një nga pesë dimensionet që mbështet strategjia e energjisë është dekarbonizimi i ekonomisë. Në dhjetor të vitit 2021,Shqipëria miratoi Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në përputhje me Strategjinë e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), e cila është në përputhje me Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm; me detyrimet që dalin nga nënshkrimi i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);

[91] ETS – *Emitting Trade System* (ETS) – Sistemi i tregtimit të shkarkimeve (të karbonit).

me *acquis*-in e Energjisë dhe Klimës për Komunitetin e Energjisë për periudhën 2021–2030. Referuar politikave dhe masave të planifikuara të PaM-ve, përfshihet edhe ngritja ETS në Shqipëri, me synim kontributin në arritjen e objektivit KKP për reduktimin e emetimit të GS nga sektori i industrisë, si dhe objektivin PKEK për dekarbonizimin e ekonomisë.

Shqipëria është e angazhuar, përmes miratimit të Agjendës së Gjelbër dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor 2021–2030, si dhe të Udhërrëfyesit të Komunitetit të Energjisë për Dekarbonizimin (2022), madje përmes miratimit të "Skemës së Tregtimit të Emetimeve (ETS)".

Rregullorja e miratuar së fundi (BE) 2023/956 mbi Mekanizmin e Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM[92]) në BE shërben si katalizator për këtë proces, pasi imponon kosto administrative dhe financiare për importuesit e mallrave CBAM në BE nga vendet e treta dhe Palët Kontraktuese të EnC, përfshirë Shqipërinë. Mekanizmi i ri do të imponojë një çmim karboni në importin e mallrave të caktuara, të prodhuara jashtë BE-së bazuar në emetimet e karbonit, në përfundim duke reduktuar emetimet globale dhe duke ndihmuar në arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit për Klimën, si dhe në balancimin e disavantazheve konkurruese të kompanive vendase që prodhojnë mallra me emetim intensiv brenda BE-së. CBAM-i do të llogarisë edhe rastet kur importuesi ka paguar një çmim karboni në një vend të tretë. Më pas, importuesi mund të kërkojë një reduktim të numrit të certifikatave CBAM që do të dorëzohen, për të marrë parasysh çmimin e karbonit të paguar në vendin e origjinës për emetimet e deklaruara. Kjo synon shmangien e një barre të dyfishtë dhe motivimin e vendeve jashtë BE-së që të vendosin taksat dhe tatimet e tyre mbi emetimet që mund t'i mbledhin vetë.

Për sa i përket importit të energjisë elektrike, ekziston mundësia e përjashtimit të tij nga aplikimi i CBAM-it, nëse tregu i energjisë elektrike i Shqipërisë integrohet me tregun e BE-së dhe plotëson disa kushte që lidhen me legjislacionin për klimën dhe energjinë. Këto kushte përfshijnë zbatimin e një sistemi të tregtimit të emetimeve (ETS) deri në vitin 2030. Lidhja e ngushtë midis integrimit të tregut të energjisë elektrike dhe dekarbonizimit përmes CBAM-it kërkon një qasje më të harmonizuar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave.

Më 15 dhjetor 2022, Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë miratoi një paketë ligjore që detyron Palët Kontraktuese të EnC-së, përfshirë Shqipërinë, të transpozonin rregulloret e MRVA-së në sistemet ligjore kombëtare. Vendosja e rregullave të përshtatshme të monitorimit, raportimit, verifikimit dhe akreditimit lidhur me emëtimet e gazeve serrë në Palët Kontraktuese, duhet në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian, si parakusht për hartimin pasues të elementeve kryesore të sistemit ETS. Paketa tashmë përfshin pjesë të përshtatura të Direktivës ETS dhe mbulon dispozitat e zgjedhura e të nevojshme për të filluar ndërtimin e një kuadri mbikëqyrës institucional dhe rregullator në nivel kombëtar. Për më tepër, teksti i përshtatur përfshin edhe listën e kategorive të aktiviteteve për të cilat zbatohet Direktiva, lidhur me detyrimet e MRVA-së.

Ligji Shqiptar "për Ndryshimet Klimatike nr. 155/2020, në kapitullin III (nenet 8–21) ka parashikuar sistemin MRV që duhet të krijohet dhe detyrimet që lindin për operatorët (veprimtaritë industriale), operatorët e avionëve dhe anijeve, lidhur me grumbullimin e të dhënave për këtë sistem. Gjithashtu, sipas VKM 889/2022, është miratuar rregullorja për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të GS dhe informacione të tjera lidhur me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar (rregullorja e qeverisjes (BE) 2018/1999).

Si hap i parë, meqenëse direktiva 2003/87 ndryshoi rrënjësisht në maj të vitit 2023 (përmes direktivave 2023/959 dhe 2023/958), është e nevojshme të rishikohen ndryshimet, në mënyrë që ligji kombëtar për ndryshimet klimatike të jetë në përputhje me ato pjesë të Direktivës së përditësuar të ETS (direktiva 2003/87/EC), me qëllim krijimin e bazës së nevojshme ligjore për MRVA.

Për më tepër, aktet nënligjore duhet të përputhen me rregulloren MRR (rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2018/2066 për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve serrë, e ndryshuar

[92] Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE-së (CBAM) është instrument i politikës, i hartuar për të reduktuar gjasat për rrjedhjen e karbonit, duke vendosur një çmim karboni për mallrat e importuara. Ky mjet pasqyron angazhimet e BE-së për reduktimin e emëtimeve të gazrave serrë nën paketën "Fit for 55", që bizneset e BE-së dhe ato jo të BE-së të luajnë në mënyrë të barabartë. Periudha kalimtare e CBAM-it, i cili fillon më 1 tetor 2023 dhe vazhdon deri në fund të vitit 2025, përfshin detyrimet e raportimit. Megjithatë, nga 1 janari 2025, do të zbatohet edhe çmimi i karbonit.

me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2020/2085); dhe me rregulloren AVR (rregullorja (BE) 2018/2067 për verifikimin e të dhënave dhe për akreditimin e verifikuesve, në mënyrë që të vendoset kuadri i nevojshëm rregullator për përfshirjen e çmimit të karbonit.

Nëpërmjet ligjit nr. 116/2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit" është transpozuar rregullorja (EC) nr. 765/2008, e rishikuar për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe për mbikëqyrjen e tregut në lidhje me marketingun e produkteve, i cili vazhdon të zbatohet për aspektet e akreditimit të verifikuesve që nuk trajtohen nga rregullorja AVR-ja. Kjo do të mundësojë njohjen e verifikuesve të jashtëm.

Megjithatë, për të garantuar përshtatjen e duhur dhe graduale të tregut me kërkesat që do t'u vendosen operatorëve, të cilët do të kenë detyrimin të raportojnë lidhur me emëtimet e GES sipas MRVA, është i nevojshëm ndërtimi i kapaciteteve për të rritur njohuritë teknike të stafit lidhur me përshtatjen e aktivitetit ekonomik. Mbështetja e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve duhet të përfshijë: trajnimin e operatorëve industrialë për hartimin e planeve të monitorimit (kategorizimi, sistemi i nivelit, qasja bazuar në llogaritje, pasiguria, etj.); Verifikimin dhe Raportimin (Raporti vjetor i shkarkimeve me të dhëna të verifikuara për emëtimet; Raporti i verifikimit; Raporti i përmirësuar).

Ligji Shqiptar "Për Ndryshimet Klimatike" 155/2020, kapitulli III (nenet 8–21), ka parashikuar sistemin MRV që duhet të krijohet dhe detyrimet që lindin për operatorët lidhur me mbledhjen e të dhënave për këtë sistem, duke transpozuar pjesë të direktivës ETS 2003/87 të BE-së.

Për të garantuar përshtatjen e duhur dhe të qetë të tregut me kërkesat që do t'i imponohen operatorëve sipas paketës MRVA, është e nevojshme ngritja e kapaciteteve për rritjen e njohurive teknike të stafit, si dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e paketës MRVA.

Tabela 20: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 4.3.1. Puna për çmimin e karbonit me synimin për të pasur një ETS në fuqi deri në vitin 2030: fokusimi në paketën MRVA

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Përmirësimi i kuadrit kombëtar për monitorimin mjedisor dhe zbatimi i mekanizmave, sikurse çmimi i karbonit, që nxisin praktika të qëndrueshme, për përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare mjedisore dhe për pozicionimin e ekonomisë për të përfituar nga alternativat më të pastra dhe më të qëndrueshme të rritjes.	Zbatimi i MRVA-së (Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi) duke miratuar ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për t'u përafruar plotësisht me *acquis* të Bashkimit Evropian për MRVA-në[93] dhe duke përgatitur institucionet dhe tregun për të zbatuar Monitorimin, Raportimin, Verifikimin dhe Akreditimin (MRVA) (dhjetor 2025) ***Shënim**: "Hapat e reformës janë vendosur pa paragjykim të afateve ligjërisht të detyrueshme, të përcaktuara sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, dhe nuk ndikojnë në zbatimin dhe detyrimin e këtij të fundit dhe anasjelltas.*	**4.3.1.** Puna për çmimin e karbonit me synimin për të pasur një ETS në fuqi deri në vitin 2030: fokusimi në paketën MRVA.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

[93] *Shënim*: Hapat e reformës nuk paragjykojnë afatet ligjërisht të detyrueshme të përcaktuara sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe nuk ndikojnë në zbatueshmërinë dhe vënien në funksion të këtij të fundit dhe anasjelltas.

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
4.3.1. Puna për çmimin e karbonit me synimin për të pasur një ETS në fuqi deri në vitin 2030: fokusimi në paketën MRVA			**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)**
Step 1 – Zbatimi i MRVA-së (Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi) duke miratuar ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për tu përafruar plotësisht me Acquis të Bashkimit Evropian për MRVA-në dhe duke përgatitur institucionet dhe tregun për të zbatuar Monitorimin, Raportimin, Verifikimin dhe Akreditimin (MRVA) (dhjetor 2025) ✓ Kryerja e një analize për ndryshimin e ligjit lidhur me ndryshimet klimatike dhe aktet nënligjore përkatëse për përafrimin me Direktivën e përditësuar ETS të BE-së (qershor 2024) ✓ Vlerësimi i operatorëve në Shqipëri, të cilët potencialisht do të jenë pjesë e zbatimit të acquis MRVA (qershor 2024) ✓ Miratimi i ndryshimeve në ligj për ndryshimet klimatike (dhjetor 2024) ✓ Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për harmonizimin me rregulloren e MR-së (Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/2066 për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve serrë; 2.) Rregullorja AV (Rregullorja (BE) 2018/2067 për verifikimin e të dhënave dhe për akreditimin e verifikuesve); (dhjetor 2025) ✓ Miratimi i ndryshimeve ligjore për ta harmonizuar plotësisht me Acquis MRVA të BE-së; (dhjetor 2024) ✓ Miratimi i akteve nënligjore për t'u përafruar plotësisht me Acquis MRVA të BE-së (qershor 2025) ✓ Trajnime të stafit të institucioneve publike përkatëse për zbatimin e paketës MRVA (MTT, MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) (shtator 2025) ✓ Trajnime të operatorëve për krijimin e Planit të Monitorimit (shtator 2025) ✓ Emërimi dhe fillimi i funksionimit të strukturave publike përgjegjëse për zbatimin e MRVA-së. (dhjetor 2025)	(dhjetor 2025)	Nuk ka ndryshime ligjore në MRVA; nuk ka kapacitete në MRVA	MTM

4.4 EFICIENCA E ENERGJISË DHE NDOTJA E AJRIT

R – 4.4.1 Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë

Sektori i energjisë është një sektor strategjik për integrimin e Shqipërisë në BE dhe në tregjet rajonale të energjisë, si dhe për arritjen e objektivave të Agjendës së Gjelbër.

Agjencia për Eficiencë të Energjisë po bashkëpunon me BERZH-in, në kuadër të programit REEP PLUS, për përgatitjen e Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave. Drafti i parë u përgatit dhe u dorëzua në mars të vitit 2023.

Për sa i përket legjislacionit të ri të transpozuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përgatitur gjatë vitit 2023 dhe ka miratuar nga Këshilli i Ministrave gjatë prillit 2024, projektligjin "Për etiketimin e produkteve të lidhura me energjinë". Ky projektligj është në proces miratimi në Kuvend.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, dhe ligjit 116/2016, "Për performancën energjetike në ndërtesa", gjatë viteve 2023–2024, janë miratuar disa akte nënligjore. Disa të tjera janë përgatitur dhe janë në proces për miratim.

Investimet në eficiencën e energjisë janë duke vazhduar përmes buxhetit të shtetit dhe projekteve të ndihmës financiare, përmes stimujve nga pushteti vendor për investime individuale në masat EE të sektorit rezidencial dhe përmes finalizimit të disa studimeve të fizibilitetit që janë në proces nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Agjencia e Eficiencës së Energjisë po vijon me gjenerimin e certifikatave të performancës energjetike në ndërtesa, si dhe me ndjekjen e një sërë projektesh në eficiencën energjetike dhe performancën energjetike të ndërtesave, përmes shumë projekteve për auditimin e ndërtesave publike në disa bashki, duke kryer studime dhe duke i zbatuar përmes ndërtimit.

Tabela 21: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 4.4.1. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Rritja e eficiencës së energjisë dhe standardeve të ndërtimit të vendit, zvogëlimi i ndikimit mjedisor dhe lëvizja drejt qëllimeve të qëndrueshmërisë, duke i përafruar kështu me standardet ndërkombëtare dhe duke vendosur një pikë referimi për politikat e ardhshme të energjisë dhe zhvillimin e infrastrukturës.	Miratimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave dhe parashikimi i financimit të nevojshëm të përcaktuar për 2025 dhe 2026, për të përmbushur objektivin vjetor të rinovimit prej 3% për ndërtesat publike qeveritare ekzistuese (**dhjetor 2024**). Miratimi i legjislacionit kombëtar për t'u përafruar me rregulloret e etiketimit **(dhjetor 2024)** dhe rregulloret e eko-dizajnit për ngrohësit lokalë të hapësirës me lëndë djegëse të ngurta dhe ngritja respektivisht e infrastrukturës dhe kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen e tregut (**dhjetor 2025).** Skema e detyrimit të eficiencës së energjisë miratohet në Ligjin për eficiencën e energjisë (**dhjetor 2025;** aktet nënligjore**/dhjetor 2026),** miratohen masa në përputhje me Direktivën e Eficiencës së Energjisë (EED[94]), dhe vendosen sisteme të matjes, kontrollit dhe verifikimit në përputhje me kërkesat e Direktivës së Eficiencës së Energjisë (**qershor 2027).** Zbatimi i objektivave vjetorë për rinovimin e ndërtesave në përputhje me treguesit indikativë (numri i ndërtesave publike të rinovuara), të përfshira në strategjinë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave (ndryshimet ligjore në ligjin përkatës/**qershor 2025;** 2% e ndërtesave publike të rinovuara si objektiv/**qershor 2027).**	**4.4.1.** Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë.

[94] *Energy Efficiency Directive* (EED).

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet përgjegjëse
4.4.1. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së efiçiencës së energjisë			**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**
Hapi 1 - Miratimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave dhe parashikimi i financimit të nevojshëm të përcaktuar për 2025 dhe 2026, për të përmbushur objektivin vjetor të rinovimit prej 3% për ndërtesat publike qeveritare ekzistuese (dhjetor 2024). **1.** Përgatitja e draft strategjisë dhe planit përkatës të veprimit (shtator 2024) **2.** Miratimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave në kuadër të PKEK-it të ndryshuar (dhjetor 2024)	(dhjetor 2024)	Nuk ka strategji për rinovimin afatgjatë të ndërtesave	MIE
Hapi 2 - Miratimi i legjislacionit kombëtar për t'u përafruar me rregulloret e etiketimit (dhjetor 2024) dhe rregulloret e eko-dizajnit për ngrohësit lokalë të hapësirës me lëndë djegëse të ngurta dhe ngritja respektivisht e infrastrukturës dhe kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen e tregut (dhjetor 2025). **3.** Miratimi i ligjit "Për etiketimin e produkteve të lidhura me energjinë" (dhjetor 2024). **4.** Projektligji "Për përcaktimin e kërkesave të Eko-Dizajnit për produktet që lidhen me energjinë" (qershor 2025) **5.** Miratimi i ligjit "Për përcaktimin e kërkesave të Eko-Dizajnit për produktet që lidhen me energjinë" (dhjetor 2025).	(dhjetor 2024) (dhjetor 2025)	Nuk ka akt ligjor në fuqi për etiketimin në përputhje me *acquis* të BE-së Nuk ka rregullore për eko-dizajnin	MIE
Hapi 3 - Skema e detyrimit të efiçiencës së energjisë miratohet në Ligjin për efiçiencën e energjisë (dhjetor 2025; aktet nënligjore /dhjetor 2026), miratohen masa në përputhje me Direktivën e Efiçiencës së Energjisë (EED[95]), dhe vendosen sisteme të matjes, kontrollit dhe verifikimit në përputhje me kërkesat e Direktivës së Efiçiencës së Energjisë (qershor 2027). - Projektligji "Për ndryshimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë" (dhjetor 2024) - Miratimi i ligjit "Për ndryshimin e Eficiencës së Energjisë" (dhjetor 2025) - Projekti i legjislacionit dytësor për skemën e detyrimit të eficiencës së energjisë. (qershor 2026) - Miratimi i skemës së detyrimit të Eficiencës së Energjisë (qershor 2027)	dhjetor 2025 dhjetor 2026 (qershor 2027)	Nuk ka akt ligjor në fuqi për krijimin e skemës së Eficiencës së Energjisë Nuk ka akte nënligjore në fuqi Nuk ka sisteme matjeje, kontrolli dhe verifikimi	MIE
Step 4 – Zbatimi i objektivave vjetore për rinovimin e ndërtesave në përputhje me treguesit indikativë (numri i ndërtesave publike të rinovuara), të përfshira në strategjinë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave (Ndryshimet ligjore në ligjin përkatës / qershor 2025; 2% e ndërtesave publike të rinovuara si objektiv/qershor 2027). **6.** Ndryshimet ligjore të ligjit përkatës (qershor 2025) **7.** Ndryshimet ligjore të ligjit përkatës (qershor 2027)	Qershor 2025 (qershor 2027)	Nuk ka ndryshime ligjore në ligjin përkatës Nuk ka strategji për rinovimin e ndërtesave Nuk ka inventar. Objektivi prej 2% i miratuar në ligjin për EE, por i pazbatuar përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave	MIE

10. FUSHA E POLITIKËS 5: SHTETI I SË DREJTËS/THEMELORET

5.1 Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është një prej prioriteteve të institucioneve shqiptare, si dhe një nga kriteret kryesore për integrimin e vendit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtë me rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, në përmirësimin e kuadrit ligjor, në përmirësimin e cilësisë së hetimit dhe në forcimin ndërinstitucional dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, Shqipëria është palë e disa konventave përkatëse të Këshillit të Evropës. Madje, është palë në konventat përkatëse të Kombeve të Bashkuara. Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale me 8 vende të treta, disa prej të cilave mbulojnë ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar. 20 Ekipe të Përbashkëta Hetimore në Prokurorinë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe 18 Ekipe të Përbashkëta Hetimore janë aktive në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, të mbështetura dhe të asistuara nga EUROJUST. Shqipëria ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me EUROJUST-in dhe ka caktuar një prokuror ndërlidhës në Hagë.

Shqipëria merr pjesë aktivisht në punën e EUROJUST-it dhe që nga prilli i vitit 2022 deri në shkurt të vitit 2023 është përfshirë në 83 raste të reja, shumica e të cilave lidhen me veprimtaritë e pastrimit të parave, trafikimin e drogës dhe krimin e organizuar. Vendi ka caktuar dy pika kontakti për EUROJUST-in, njëra prej të cilave, nga Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë, është caktuar Korrespondent Kombëtar për Çështjet e Terrorizmit. Sa i përket kërkesës së përshpejtuar të Shqipërisë për integrim, në dhjetor të vitit 2022, Rrjeti i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore i caktoi Shqipërisë statusin e vëzhguesit. Komisioni thekson se të gjitha elementet e bashkëpunimit janë përcaktuar tashmë (marrëveshjet e bashkëpunimit, emërimi i prokurorëve ndërlidhës, caktimi i pikave të kontaktit, pjesëmarrja në grupe të ndryshme ekspertësh/fokus grupe).

Shqipëria ka pasur një bashkëpunim në rritje me EUROPOL-in, gjë që vihet re edhe nga numri i rasteve dhe mesazheve të shpërndara, që kanë sjellë një numër të konsiderueshëm operacionesh të suksesshme kundër rrjeteve të krimit të organizuar transnacional. Ky bashkëpunim i vazhdueshëm jo vetëm që ka forcuar përpjekjet e Shqipërisë për të luftuar krimin e organizuar dhe për të rritur sigurinë e brendshme e rajonale, por ka forcuar edhe lidhjet e vendit me agjencitë ligjzbatuese evropiane. Shtimi i përpjekjeve të koordinuara dhe i inteligjencës me ritme të shpejta ka sjellë prishjen e disa rrjeteve kriminale, arrestimin e të dyshuarve kryesorë dhe ndërprerjen e aktiviteteve të paligjshme, duke filluar nga krimi i rëndë dhe i organizuar.

Që prej vitit 2013, Shqipëria ka zbatuar një marrëveshje operacionale dhe strategjike me EUROPOL-in dhe ka emëruar dy oficerë ndërlidhës në selinë në Hagë. Në bazë të marrëveshjes së rishikuar me EUROPOL-in, Policia e Shtetit Shqiptar ka zgjeruar aksesin në kanalin SIENA për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Po ashtu, edhe Doganës dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF) u është mundësuar akses në SIENA. Shqipëria merr pjesë si vëzhguese në Rrjetin Evropian të Ekipeve Aktive të Kërkimit të të Arratisurve (ENFAST) dhe është angazhuar në mënyrë aktive në Platformën Multidisiplinare Evropiane kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT), duke emëruar një Koordinator Kombëtar për EMPACT.

Shqipëria garanton që shkëmbimi i të dhënave të gjurmëve të gishtave të bëhet në përputhje me vendimin kuadër 2008/977/JHA, që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor për çështjet penale.

Sipas statistikave, në vitin 2023 janë koordinuar dhe zhvilluar 55 operacione policore, duke përfaqësuar një rritje prej 32,2% krahasuar me vitin 2022. E njëjta prirje në rritje vihet re edhe në shkëmbimin e informacionit me EUROPOL-in. Policia e Shtetit Shqiptar do të vijojë punën për të forcuar angazhimin me përfaqësuesit e projektit analitik të EUROPOL-it dhe ekipin mbështetës për EMPACT-in. Përmes kësaj synohet të thellohet bashkëpunimi i përgjithshëm me EUROPOL-in dhe përfshirja në projektet analitike dhe aktivitetet e EMPACT-it, si dhe pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta ndërkombëtare.

R - 5.1.1. Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonale/ndërkombëtare, për të kontribuar në përmirësimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve

Kuadri ligjor i Shqipërisë parashikon tre lloje konfiskimesh: konfiskimin penal, konfiskimin pavarësisht ekzistencës së një vendimi për dënim dhe konfiskimin administrativ. Tashmë në Shqipëri është vënë në dispozicion dhe në funksion Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK–ZRA).

Një nga reformat më të rëndësishme për luftën kundër krimit të organizuar, e cila rekomandohet në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, të publikuar në nëntor të vitit 2023, është krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, strukturës përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale. Krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve është një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të siguruar një kuadër të plotë institucional për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Në vitin 2023, ministri i Punëve të Brendshme ngriti një grup pune për hartimin e ligjit "Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve".

Grupi i punës ka hartuar projektligjin mbi bazën e të cilit do të krijohet Zyra e Rikuperimit të Aseteve në Policinë e Shtetit, që do të jetë përgjegjëse për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të produkteve të të veprës penale dhe pasurive të tjera të lidhura me to, që mund të bëhen objekt i një urdhri bllokimi, sekuestrimi ose konfiskimi të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor.

Gjithashtu, ZRA-ja do të shërbejë si pikë kontakti kombëtare për shkëmbimin e informacioneve, spontanisht ose me kërkesë, që do të lehtësojë gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave që vijnë/rrjedhin nga veprimtaritë kriminale, ose kanë lidhje me to, dhe do të mbledhë dhe përpunojë statistika gjithëpërfshirëse, si statistikat në ndihmë të ZRA-së për përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrave të saj, të vëna në dispozicion nga organet gjyqësore kombëtare dhe organet kombëtare pjesëmarrëse në hetimin financiar. Gjatë procesit të hartimit, Grupi i Monitorimit u asistua nga ekspertë të Këshillit të Evropës përmes vlerësimeve dhe sugjerimeve, që u morën në konsideratë nga Grupi i Punës.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, projektligji iu dorëzua ministrive përkatëse për komente dhe u publikua në Platformën e Konsultimeve Publike. Ai pritet të miratohet brenda vitit 2024. Pas miratimit të ligjit për ZRA-në dhe brenda vitit 2025, Shqipëria do të dorëzojë një aplikim për anëtarësim në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve (Rrjeti Carin).

Përveç procesit të hartimit të ligjit, është bërë e realizueshme edhe krijimi i infrastrukturës institucionale për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve. Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme "Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit", ZRA-ja do të shërbejë si strukturë qendrore pranë Departamentit të Policisë Kriminale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dhe është identifikuar si "Njësia ZRA dhe e Analizës Financiare". Treguesit që matin "operacionalizimin" e ZRA-së janë:

- Miratimi i ligjit për ZRA-në dhe hyrja në fuqi e procedurave standarde të operimit;
- Rekrutimi i drejtorit dhe stafit të ZRA-së;
- Numri i bazave të të dhënave të policisë të aksesuara nga ZRA-ja;
- Numri i kërkesave të ardhshme dhe të vazhdueshme për informacion, brenda dhe jashtë vendit.

Lufta kundër krimit të organizuar vijon të jetë fokus kryesor për Shqipërinë dhe një aspekt thelbësor i arritjes së qëllimeve të saj është dhe fuqizimi i shoqërisë civile për parandalimin e korrupsionit dhe kriminalitetit. Shënjestrimi dhe sekuestrimi i pasurive të fituara përmes veprimtarive kriminale jo vetëm që synon goditjen e kriminelëve, por shërben edhe si pengesë për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale në të ardhmen. Menaxhimi dhe përdorimi efektiv i pasurive të konfiskuara është një nga mënyrat kryesore për t'u siguruar se ajo që u është vjedhur shoqërive do t'u kthehet. Ripërdorimi social i pasurive u jep qytetarëve një sinjal të qartë për fuqinë dhe efektivitetin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve publike.

Për sa i përket bazës ligjore, Shqipëria ka miratuar ligjin 10192/2009, "Për parandalimin dhe goditjet e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër

pasurisë", zakonisht referuar si "ligji antimafia". Ky ligj përmban dispozita për ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara.

Fitimet nga shitja e pasurive të konfiskuara, vlerat monetare të konfiskuara dhe të ardhurat e tjera kontribuojnë në krijimin e "fondit të konfiskimit", një pjesë e të cilit përcaktohet si "fondi posaçëm". "Fondi i posaçëm" shërben për qëllime të ndryshme, përfshirë dhënien e ndihmës për viktimat e krimit të organizuar dhe trafikimit, si dhe promovimin e programeve sociale për këto kategori dhe kompensimin e viktimave sipas përcaktimeve në vendimet gjyqësore.

Përveç institucioneve qendrore, përfituesit e kualifikuar për financimin e projektit nga fondi i posaçëm mund të jenë edhe:

- Njësitë e qeverisjes vendore ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;
- Organizatat jofitimprurëse të dedikuara për rehabilitimin social, kulturor dhe shëndetësor, duke u fokusuar te grupet e cenueshme të prekura ose të rrezikuara nga krimi. Këtu përfshihen organizatat dhe qendrat terapeutike, ambientet e rehabilitimit për përdoruesit e drogës dhe qendrat e ndihmës dhe rehabilitimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Aplikimet për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm, si dhe verifikimi e përgatitja e dokumentacionit, i dorëzohen Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar. Ky komitet merr vendimet për financimin e projekteve dhe alokimin e fondeve për aplikantët. Pas miratimit, zbatimi i këtyre projekteve monitorohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Tabela 22: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 5.1.1. Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonale/ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional të vendit kundër krimeve financiare, duke siguruar që pasuritë që rrjedhin nga aktivitete të tilla të rikuperohen dhe të përdoren siç duhet.	Zyra e Rikuperimit të Aseteve është krijuar dhe është funksionale (**qershor 2025**). Paraqitja e aplikimit për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve ose në platformat rajonale/ndërkombëtare të rikuperimit **(dhjetor 2025).** Të paktën 50% e numrit dhe vlerës së pasurive të konfiskuara ripërdoren (përfshi ripërdorimin social) brenda 6 muajve nga konfiskimi **(dhjetor 2026**).	**5.1.1.** Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonale/ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet e përgjegjësisë
5.1.1. Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve, si Njësi Kombëtare Koordinuese dhe pikë kontakti rajonale/ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve			**Ministria e Punëve Brendshme (MPB)**
Hapi 1 - Zyra e Rikuperimit të Aseteve është krijuar dhe është funksionale (qershor 2025). - Miratimi i projektligjit për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve nga Këshilli i Ministrave pas konsultimeve me ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, publikun e gjerë, DBE-në etj. (dhjetor 2024) - Miratimi i projektligjit për ZRA-në nga Parlamenti (qershor 2025) - Hartimi i akteve nënligjore për ligjin e miratuar për ZRA-në përmes udhëzimeve të ekspertëve të KiE-së (qershor 2025) - Krijimi i strukturës së ZRA-së pranë Policisë së Shtetit Shqiptar (qershor 2025)	(qershor 2025)	Aktualisht nuk ka asnjë akt ligjor në fuqi	MPB
Hapi 2 - Paraqitja e aplikimit për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve ose në platformat rajonale/ndërkombëtare të rikuperimit (dhjetor 2025). - Vendosja e kontakteve me platformat rajonale dhe ndërkombëtare për rikuperimin e aseteve (dhjetor 2025) - Dorëzimi i aplikimit për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve (dhjetor 2025)	(dhjetor 2025)	Aktualisht nuk ka aplikime për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve ose në platformat rajonale/ndërkombëtare të rikuperimit	MPB
Hapi 3 - Të paktën 50% e numrit dhe vlerës së pasurive të konfiskuara ripërdoren (përfshi ripërdorimin social) brenda 6 muajve nga konfiskimi (dhjetor 2026). - Hartimi i një baze dhe i treguesve për numrin dhe/ose vlerën e pasurive të konfiskuara (dhjetor 2024) - Përmirësimi i procedurës së administrimit dhe ripërdorimit të aseteve të konfiskuara me qëllim ruajtjen e vlerës së pasurisë dhe/ose mundësimin e ripërdorimit të tij, brenda gjashtë muajve (qershor 2025) - Kryerja e procedurave efikase dhe në kohë për administrimin dhe/ose ripërdorimin (përfshirë ripërdorimin social), e asetit brenda gjashtë muajve nga konfiskimi (dhjetor 2026)	(dhjetor 2026)	Deri më 31 dhjetor 2023 janë konfiskuar 85 asete/pasuri të paluajtshme pa barrë ligjore e financiare.	MPB

R - 5.1.2 Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë

Qeveria shqiptare ka miratuar "Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025" dhe Planin e Veprimit 2023–2025, të ndryshuar. Vizioni i strategjisë dhe i planit të veprimit është zhvillimi i vendit dhe mbrojtja e qytetarëve nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar nëpërmjet rritjes së fuqisë parandaluese dhe pakësimit të risqeve. Strategjia shërben si udhërrëfyes për zbatimin praktik të qasjes gjithëpërfshirëse kundër veprimtarive të paligjshme dhe strukturave të krimit të organizuar, që përfshin ndërveprimin mes sektorit publik, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve.

Me qëllim monitorimin e nivelit të zbatimit dhe mbarëvajtjen e masave të planifikuara në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, Ministri i Punëve të Brendshme harton raporte monitorimi gjashtëmujore dhe vjetore për "Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025". Krahas raporteve të monitorimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit Shqiptar harton analiza risku, me qëllim përditësimin e informacionit për grupet kriminale, përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë. Më specifikisht, vlerësimi i riskut dhe kërcënimeve nga grupet kriminale kryhet çdo dy vjet dhe vlerësimi kombëtar i riskut dhe kërcënimeve kryhet çdo vit.

Një nga masat e parashikuara në kapitullin 24 të "Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës", është monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Krimin e Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2023–2025 dhe Planit të saj të Veprimit, rinovimi dhe ndjekja e saj për periudhën 2026–2030. Në këtë kontekst, në përputhje me Udhërrëfyesin, seksioni 5.1.2, parashikon përgatitjen e raporteve gjashtëmujore dhe vjetore të kësaj strategjie. Raportet e monitorimit ofrojnë një pasqyrë të statusit të zbatimit të masave për luftën kundër krimit të organizuar, duke përcaktuar edhe prioritetet e kërkesat për periudhën në vijim. Siç përshkruhet

në hapin e dytë të seksionit 5.1.2, krahas raporteve të monitorimit, Policia e Shtetit Shqiptar përgatit dhe analizat e saj teknike. Më specifikisht, PSH-ja kryen vlerësimin e riskut për krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe vlerësimin e grupeve kriminale.

Një hap tjetër i përshkruar në Udhërrëfyes është rritja e aksesit në bazat e të dhënave për autoritetet ligjzbatuese, Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, që parashikohet në hapin e tretë të këtij seksioni.

Standardet për aksesin dhe ndërveprimin në bazat e të dhënave[95]:

1. Sigurimi i aksesit të drejtpërdrejtë të PSH-së në të paktën 5 baza të dhënash (p.sh., të dhëna që lidhen me pronësinë, transaksionet financiare, sigurimet, domenet, transportin, gjyqësorin etj.) (qershor 2026).

2. Përmirësimi i ndërveprimit në platformat e informimit të siguruara nga agjencitë ligjvënëse:

- Zgjerimi i kanalit SIENA për personelin e policisë kufitare shqiptare në PKK-të e përbashkëta në kufirin me Greqinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi (qershor 2025), për personat e kontaktit të PSH-së në EMPACT (dhjetor 2025) dhe për Drejtorinë e Tatimeve (qershor 2026).

Për hapin: "Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimit në bazat e të dhënave dhe përdorimi i mjeteve të TI-së/metodave hetimore për luftën kundër krimit të organizuar", standardi është:

- Rritja e numrit të bazave të të dhënave publike të aksesuara nga agjencitë ligjzbatuese (p.sh. PSH-ja);
- Zgjerimi i aksesit në platformat e sigurta të shkëmbimit të informacionit (p.sh., SIENA) në strukturat/agjencitë ligjzbatuese për të siguruar ndërveprim të mëtejshëm.

Sigurimi i aksesit të drejtpërdrejtë dhe të shtuar në bazat e të dhënave në agjencitë ligjzbatuese, në veçanti strukturat e policisë, sjell përmirësimin e shkëmbimit të informacionit, hetime të thella dhe të plota, reduktimin e ekspozimit të paautorizuar (d.m.th. ndaj personelit administrativ) të hetimeve policore nëpërmjet korrespondencës me shkrim, ndërveprimin e zgjeruar të agjencive ligjzbatuese (p.sh., PSH-së me Doganat, Drejtorinë e Tatimeve, BKH-në, etj.) në bazat e të dhënave, si dhe nxitjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar. PSH-ja identifikon vazhdimisht regjistra publikë ekzistues dhe të rinj, aksesi i drejtpërdrejtë i të cilëve mund të jetë vendimtar për hetimet e policisë duke marrë parasysh të dhënat e tyre në lidhje me pronat, domenet, transaksionet financiare, të dhënat gjyqësore e të ngjashme. Informacione të tilla mundësojnë verifikime të shpejta nga policia, dhe shtrirje më të gjerë hetimi nga prokuroria. Bazat e të dhënave në internet sjellin konfidencialitet të shtuar përmes aksesit të autorizuar, monitorimit të rregullt dhe auditimeve reaktive, ndërkohë që u sigurojnë hetuesve akses të shpejtë dhe të lehtë në informacione të dobishme. Ndërsa, aksesi i zgjeruar në platformat e sigurta të shkëmbimit të informacionit (p.sh. SIENA) për strukturat përkatëse të policisë dhe agjencitë e tjera të kualifikuara në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi (marrëveshjen e ndryshuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROPOL-it), garanton rritje të shkëmbimit të informacionit me EUROPOL-in dhe shtetet anëtare.

Krimi i organizuar frenohet nëpërmjet hetimeve gjithnjë e më proaktive dhe efektive, të fokusuara në veçanti te aspektet financiare, përfshirë dyshimet për korrupsion dhe pastrim parash, duke ndikuar në mënyrë progresive dhe solide në historikun e ndjekjeve penale, dënimeve, sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive kriminale. Standardet janë si më poshtë (duke marrë vitin 2023 si bazë):

- Rritja progresive e përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit çdo vit (PSH-ja si burim informacioni).
- Përdorimi sistematik i hetimeve financiare paralelisht me hetimet penale deri në qershor të vitit 2026 (ZRA-ja dhe SPAK-u si burime informacioni, me rritje progresive në vitet 2024 dhe 2025).
- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe prokurorisë (të dhëna nga PSH-ja, EUROPOL-i, EUROJUST-i).

Në kuadër të zhvillimit institucional dhe progresit në luftën kundër krimit të organizuar, nevojitet mbështetje për modernizimin e sistemeve në përdorim nga strukturat e sigurisë publike, rritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, përmirësimin e infrastrukturës dhe logjistikës, për t'u përgjigjur ndaj nevojave për zhvillim teknologjik, formave të avancuara të kriminalitetit dhe natyrës së tij transnacionale, nevojës për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni. Më specifikisht:

[95] Burimi i verifikimit: Policia e Shtetit Shqiptar (PSH).

- Asistencë teknike për përmirësimin e kapaciteteve institucionale për kryerjen e hetimeve financiare të ndërlikuara, paralelisht me hetimet penale dhe veçanërisht përmirësimin e teknikave të hetimit financiar;

- Asistencë për sigurimin e aksesit në rrjetet e shkëmbimit të informacionit dhe garantimin e sigurisë kibernetike të këtyre rrjeteve;

- Financim për përditësimin e sistemeve të ndryshme në përdorim nga Policia e Shtetit (*Interpol Web Service for Data Management*, ISDM dhe WISDM, në sistemin TIMS të Policisë së Shtetit; sistemi FIND i INTERPOL-it, i inkorporuar në sistemin TIMS që nga viti 2009, në versionin FIND 0.4; ridizenjimi i sistemit TIMS etj.).

- Trajnim i strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit dhe veprimtarive kriminale (p.sh., kriptovalutat), krimin kibernetik (me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndaj fëmijëve të kryera nëpërmjet internetit, pornografinë, mbrojtjen dhe parandalimin), si dhe trajnime të përbashkëta ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve (krimet financiare, veprat penale të pastrimit të parave, veprat penale të trafikimit etj.);

- Trajnime për përdorimin e sistemeve dhe platformave përkatëse të shkëmbimit të informacionit kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda (platformat elektronike).

Në përpjekjet e vazhdueshme, lufta kundër korrupsionit shfaqet si shqetësim kryesor për qeverinë, duke vepruar njëkohësisht si shtytës vendimtar për avancimin së bashku me konsolidimin e reformës në drejtësi. Progresi në zbatimin e kësaj reforme ka dhënë rezultate premtuese. Angazhimi i Shqipërisë në kornizat ndërkombëtare kundër korrupsionit, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe konventat e Këshillit të Evropës, thekson detyrimin e saj për të parandaluar dhe dënuar praktikat e korrupsionit.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka ndjekur hetime penale dhe hetime financiare për disa çështje të profilit të lartë. Rritja e cilësisë së drejtësisë dhe dënimeve në këto raste mbetet prioritet kyç për të sfiduar kulturën mbizotëruese të mosndëshkimit. Procesi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve vijon të ketë rezultate pozitive për luftën kundër korrupsionit në gjyqësor.

Në vitin 2022 u sekuestruan pasuri prej 38 milionë eurosh në lidhje me veprat penale të korrupsionit, një rritje e dukshme nga 21 milionë euro një vit më parë. Gjithashtu, ka pasur rritje të numrit të kallëzimeve penale dhe administrative, së bashku me masat disiplinore të marra. Për të forcuar më tej përpjekjet kundër korrupsionit, është e domosdoshme që agjencitë përkatëse të miratojnë një qasje sistematike parandaluese të bazuar në analizën e të dhënave disiplinore dhe rasteve të tjera të sjelljes së papërshtatshme.

Shqipëria do të vijojë punën për cilësinë e proceseve të hetimit, dënimeve, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive për krime të lidhura me korrupsionin, në përputhje të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor. Ky angazhim është përfshirë si hap në Agjendën e Reformave, ndërsa baza për matjen e ndikimit të saj do të ishte performanca mesatare në tre vitet e mëparshme (vitet 2022–2023 & 2024 për qershorin e vitit 2026) (vitet 2023, 2024 dhe 2025 për qershorin e vitit 2027) sipas të dhënave për Shqipërinë në platformën e BE-së për historikun e krimit të organizuar dhe korrupsionit (OCCTR), ndërsa treguesi do të ishte performanca cilësore e sistemit të drejtësisë për trajtimin e korrupsionit, në përputhje të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, duke marrë parasysh raportet vjetore të Policisë së Shtetit dhe raportet vjetore publike të organeve përkatëse gjyqësore/të prokurorisë.

Tabela 23: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 5.1.2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Përmirësimi i infrastrukturës kombëtare dhe aftësive për trajtimin e krimeve të organizuara dhe të rënda, duke siguruar që agjencitë ligjzbatuese të jenë të pajisura me mjetet dhe informacionin e nevojshëm për të luftuar në mënyrë efektive kundër këtyre kërcënimeve	Përgatitja e vlerësimit të rreziqeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda dhe rishikimi respektivisht i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda (qershor 2026). Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimit të bazave të të dhënave dhe përdorimi i mjeteve të IT-së/metodave hetimore në luftën kundër krimit të organizuar (dhjetor 2026). Progres i vazhdueshëm me cilësinë e	**5.1.2.** Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë

	procedimeve, në pajtueshmëri të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, dhe përmirësimi i historikut të të dhënave (*track records*), që burojnë nga hetime, ndjekje penale, vendime të formës së prerë , sekuestrime dhe konfiskime përfundimtare efektive dhe efikase në rastet e korrupsionit, përfshirë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë (qershor 2026), përsëritje në (qershor 2027). Progres i vazhdueshëm me rezultatet në hetimet, ndjekjet penale, dënimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive në rastet e lidhura me krimin e organizuar (qershor 2027).	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet e përgjegjësisë
5.1.2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rastet e nivelit të lartë			**Ministria e Punëve Brendshme (MPB) & Ministria e Drejtësisë**
Hapi 1 - Përgatitja e vlerësimit të rreziqeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda dhe rishikimi respektivisht i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda (qershor 2026). - Hartimi i raporteve monitoruese gjashtëmujore dhe vjetore për Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025; - Hartimi i një raporti vlerësimi të Strategjisë aktuale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të rënda 2021-2025 (dhjetor 2025) - Kryerja e vlerësimit të riskut për krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe vlerësimit të grupeve kriminale (shtator 2026) - Hyrja në fuqi e strategjisë së re për krimet e organizuara dhe të rënda 2026-2030 (qershor 2026)	(qershor 2026)	Aktualisht nuk ka asnjë vlerësim kërcënimi dhe nuk është bërë asnjë rishikim për Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për krimet e organizuara dhe të rënda	MPB
- Hapi 2 - Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimit të bazave të të dhënave dhe përdorimi i mjeteve të IT-së/metodave hetimore në luftën kundër krimit të organizuar (dhjetor 2026). - Identifikimi i bazave të reja të të dhënave të aksesueshme nga autoritetet ligjzbatuese (qershor 2025) - Sigurimi i mjeteve të reja të TI-së/metodave hetimore për agjencitë ligjzbatuese/dhe ZPP-në me mbështetjen e BE-së dhe partnerëve të tjerë etj. (dhjetor 2026)	(dhjetor 2026)	Aktualisht nuk ka hartëzim të bazave të të dhënave të aksesuara nga PSH-ja/agjencive të tjera ligjzbatuese	MPB
Hapi 3 - Progres i vazhdueshëm me cilësinë e procedimeve, në pajtueshmëri të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, dhe përmirësimi i historikut te të dhënave (*track record*), që burojnë nga hetime, ndjekje penale, vendime të formës së prerë , sekuestrime dhe konfiskime përfundimtare efektive dhe efikase në rastet e korrupsionit, përfshirë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë (qershor 2026), përsëritje në (qershor 2027).	(qershor 2026, qershor 2027).	performanca mesatare në tre vitet e mëparshme (vitet 2022-2023 & 2024 për qershorin e vitit 2026) (vitet 2023, 2024 dhe 2025 për qershorin e vitit 2027) sipas të dhënave për Shqipërinë në platformën e BE-së për historikun e krimit të organizuar dhe korrupsionit (OCCTR)	Ministria e Drejtësisë
Hapi 4 - Progres i vazhdueshëm me rezultatet në hetimet, ndjekjet penale, dënimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive në rastet e lidhura me krimin e organizuar (qershor 2027).	(qershor 2027).	Performanca mesatare në tre vitet e mëparshme (të dhënat nga vitet 2023, 2024 dhe 2025) sipas të dhënave për Shqipërinë në platformën e BE-së për regjistrimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (OCCTR)	Ministria e Drejtësisë

5.2. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E DROGËS

Furnizimi global i drogave të paligjshme po rritet ndjeshëm, me kultivimin dhe prodhimin e kokainës që ka arritur nivele të larta si asnjëherë më parë. Gjithashtu, është rritur kërkesa për droga të paligjshme, veçanërisht nga të rinjtë. Sfidat rajonale mbi këtë temë përfshijnë ritmin alarmues të zhvillimit të drogave sintetike, shtimin e përdorimit të internetit për transaksionet e drogës dhe ndikimin negativ që tregu i drogave të paligjshme ka në mjedis.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Instituti i Shëndetit Publik janë organet drejtuese përkatësisht në luftën kundër trafikimit të drogës dhe pakësimin e kërkesës për drogë. Shqipëria nuk ka krijuar ende një Qendër Kombëtare Informimi për Drogën

(observatori kombëtar i drogës) dhe ky është një nga objektivat e agjendës për rritje. Instituti i Shëndetit Publik ka kompetenca për të mbledhur dhe raportuar të dhëna për drogat në vend, si dhe të dhëna të tjera, sipas tabelave standarde të Qendrës Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Drogat (EMCDDA). Strukturat kryesore në luftën kundër trafikimit të drogës janë Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Shqipëria duhet të ngrejë një observator operacional me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, gjë që është thelbësore për zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave mbi drogat, koordinimin e një sistemi informacioni për barnat dhe për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin Reitox të BE-së.

Është krijuar një koordinator i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm (SPH), që është emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Dhe ndonëse ekspertët shqiptarë kanë ndjekur kurse trajnimi, synohet të forcohet edhe Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm.

R – 5.2.1. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme

Lufta kundër trafikut të paligjshëm të drogës vijon të jetë fokusi kryesor i veprimtarisë së Policisë së Shtetit në veçanti dhe strukturave të specializuara në përgjithësi, duke u angazhuar në zbatimin e detyrave të planifikuara për parandalimin, zbulimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale.

Lufta kundër trafikut të lëndëve narkotike mbështetet në forcimin e koordinimit ndërinstitucional, si dhe në bashkëpunimin me strukturat homologe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, përmes rritjes së efikasitetit të hetimeve, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të metodave të posaçme të hetimit (veprimet simuluese, infiltrimi, dërgesat e kontrolluara), kryerjes së operacioneve policore, si dhe hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare, rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të strukturave ndaj luftës kundër trafikut të drogës, duke i pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme, si dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit dhe monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve në fushën e reduktimit të furnizimit të lëndëve narkotike.

Për sa i përket kuadrit strategjik, lufta kundër lëndëve narkotike dhe përdorimit të tyre trajtohet në "Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025" dhe në "Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030".

Në kuadër të luftës kundër lëndëve narkotike, Shqipëria është e angazhuar për ngritjen e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorit Kombëtar të Drogës. Pritet që deri në fund të vitit 2025 Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm të jetë vënë në funksion, ndërsa në vitin 2026 të vihet në funksion Observatori Kombëtar i Barnave.

Tabela 24: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 5.2.2. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme

Rezultati	Produktet e pritshme (rezultatet)	Reforma që kontribuon në arritjet
Përmirësimi i aftësive të vendit për të trajtuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive çështjet e lidhura me drogën, në mënyrë që vendi të jetë më i pajisur për të reduktuar dëmet e lidhura me drogën dhe për të përmirësuar rezultatet e shëndetit publik.	Vlerësimi i zbatimit të Planit të rishikuar të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e dëmtimeve të lidhura me drogën 2023–2026 (qershor 2027). Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm është funksional (dhjetor 2025). Observatori Kombëtar i Drogës është funksional (dhjetor 2026).	**5.2.2.** Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme.

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	Afati kohor	Baza	Institucionet e përgjegjësisë
5.2.2. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik me synimin për zvogëlimin e ofertës dhe kërkesës për droga të paligjshme.			**Ministria e Brendshme (MB)**
Hapi 1 - Vlerësimi i zbatimit të Planit të rishikuar të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e dëmtimeve të lidhura me drogën 2023-2026 (qershor 2027). - Miratimi i urdhrit të MSHMS-së për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit (dhjetor 2026). - Dorëzimi i raportit të vlerësimit (qershor 2027).	(qershor 2027)	Aktualisht nuk ka asnjë vlerësim të Planit të ri të Veprimit	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
Hapi 2 - Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm është funksional (dhjetor 2025). - Lëshimi i urdhrit/ave të Kryeministrit për ngritjen e një grupi pune ndërinstitucional për analizën e legjislacionit dhe praktikave më të mira për SPH-në dhe OKD-në dhe hartimi i raportit përfundimtar të GP-ve (dhjetor 2024). - Hartimi i bazës rregullatore dhe procedurave të funksionimit për SPH-në (qershor 2025). - Caktimi i pikave fokale/të koordinimit për SPH-në dhe pikave të kontaktit nga institucionet/agjencitë përkatëse. - Krijimi dhe vënia në funksion e SPH-së (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	SPH-ja nuk është funksionale	Ministria e Brendshme (MB)/MSHMS
Hapi 3 - Observatori Kombëtar i Drogës është funksional (dhjetor 2026). - Lëshimi i urdhrit/ave të Kryeministrit për ngritjen e një grupi pune ndërinstitucional për analizën e legjislacionit dhe praktikave më të mira për SPH-në dhe OKD-në dhe hartimi i raportit përfundimtar të GP-ve (dhjetor 2024). - Hartimi i bazës rregullatore për krijimin e OKD-së (dhjetor 2025). - Hartimi i procedurave operative (qershor 2026). - Sigurimi i stafit të OKD-së dhe funksionimi i OKD-së si organ koordinues ndërinstitucional ose njësi strukturore (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	OKD-ja nuk është funksionale	MB/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

5.3. Pastrimi i parave

Shqipëria merr pjesë aktivisht në punën e Eurojustit dhe që nga prilli i vitit 2022 deri në shkurt të vitit 2023 është përfshirë në 83 raste. Shumica e këtyre rasteve lidhen me veprimtaritë e pastrimit të parave, trafikimin e drogës dhe krimin e organizuar.

Sa i përket pastrimit të parave, janë të disponueshëm si regjistri qendror i llogarive bankare, ashtu edhe regjistri i pronarëve përfitues (PP). Tashmë, regjistri i pronarëve përfitues është pothuajse plotësisht i popullluar, përfshirë 99% të bizneseve dhe 94% të OJF-ve deri në prill të vitit 2023. Që nga korriku i vitit 2022, janë vendosur sanksione për subjektet që nuk përmbushin detyrimet e regjistrimit si PP. Regjistri elektronik (PRESTO), të cilin Prokuroria e Përgjithshme e prezantoi në korrik të vitit 2021 për të siguruar gjurmimin e të gjitha rasteve të pastrimit të parave, është në përdorim të plotë.

Më 27 tetor të vitit 2023, Task-Forca e Veprimit Financiar (TFVF) vendosi të hiqte Shqipërinë nga lista gri, njohur edhe si monitorimi i zgjeruar. Ky është rezultat i progresit që Shqipëria ka bërë në zbatimin e rekomandimeve. Ky vendim mbart një sërë ndikimesh pozitive, si në aspektin e reputacionit, ashtu edhe në uljen e kostove të transaksioneve financiare në sistemin bankar, brenda dhe jashtë vendit. Kjo arritje shërben si motivim për të vazhduar fuqizimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

R - 5.3.1. Sigurimi i një kornize të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave

Në dhjetor të vitit 2023, Autoritetet Shqiptare kanë finalizuar dhe miratuar Vlerësimin Kombëtar të Riskut (VKR) për PP-në/FT-në përmes një plani veprimi 3-vjeçar. VKR-ja është një dokument që ka si

objekt kryesor vlerësimin e nivelit të ekspozimit të një vendi ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Plani i veprimit ka 10 objektiva për të adresuar dhe për të zbutur risqet e PP-së/FT-së të identifikuara nga VKR-ja. Shqipëria është tashmë e angazhuar për të zbatuar Planin e veprimit në kohë dhe në mënyrë efektive. Kjo do të matet nga raportet vjetore për zbatimin e Planit të Veprimit, të cilat do të tregojnë nivelin e zbatimit (shih paragrafin e fundit në hapin e parë të tabelës për zbatimin dhe përgjegjësitë).

Për sa i përket Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2024–2030 (miratuar në dhjetor të vitit 2024), hartimi i kësaj strategjie vjen si rrjedhojë e nevojës për adresimin e rekomandimeve/standardeve ndërkombëtare, gjetjeve nga vlerësimit kombëtar i riskut, vizionit të vendit për arritjen e objektivave të Shqipërisë në këtë drejtim, adresimit të sfidave të sigurisë kombëtare dhe rolit të Shqipërisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Përmbushja e masave të këtyre dy dokumenteve do të sigurojë "një kornizë të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave", duke synuar parandalimin, shtrirjen, mbikëqyrjen, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, partneritetin publik-privat, hetimin dhe masat e përgjithshme të zbatimit.

Tabela 26: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 5.3.1. Sigurimi i një kornize të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Rritja e përputhshmërisë rregullatore, forcimi i mekanizmave të zbatimit, duke forcuar edhe mbrojtjen e vendit kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare.	Zbatimi efektiv dhe në kohë i Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA) kundër Pastrimit të Parave 2024–2027 (qershor 2027).	**5.3.1.** Sigurimi i një kornize të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave.
Fuqizimi i masave parandaluese, përforcimi i kornizave ligjore dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, duke rritur ndjeshëm kapacitetin e vendit për luftën kundër krimeve financiare dhe financimit të terrorizmit.	Miratimi i Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Kundër Financimit të Terrorizmit, dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2030 (dhjetor 2024).	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet përgjegjëse**
5.3.2. Sigurimi i një kornize të besueshme dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave			**Ministria e Financave/FIA**
Hapi 1 - Zbatimi efektiv dhe në kohë i Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA) kundër Pastrimit të Parave 2024–2027 (qershor 2027). - Zhvillimi i trajnimeve vjetore për sektorin privat dhe publik në fushën e PP-së/FT-së (2024–2026); - Përmirësimi i mbulimit duke ndarë tipologjitë e reja dhe në zhvillim të PP-së/TF-së sipas shënimeve vjetore për prirjet (2024–2026), ndërmjet institucioneve private dhe atyre publike. - Zhvillimi i takimeve të rregullta vjetore periodike ndërinstitucionale me sektorin privat dhe publik, me qëllim rritjen e bashkëpunimit, diskutimin e tipologjive aktuale dhe çështje të tjera me interes të ndërsjellë të palëve të përfshira (2024–2026). - Rivlerësimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i metodologjisë/procedurave/manualeve për deklaratat kontrollit kufitar mbi paratë (dhjetor 2024). - Lëshimi i raportit të zbatimit të Planit të Veprimit	(qershor 2027)	Statusi i zbatimit të Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (VKR) për Pastrimin e Parave 2024-2027 (Plani i veprimit është aktualisht në zbatim. Raporti gjashtëmujor i monitorimit për vitin 2024, i përgatitur nga FIA, diskutuar dhe miratuar nga Komiteti i Bashkërendimit për Luftën kundër Pastrimit të Parave në korrik të vitit 2024.)	MF/FIA

që tregon nivelin e zbatimit (qershor 2027).			
Hapi 2 - Miratimi i Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Kundër Financimit të Terrorizmit, dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2030 (dhjetor 2024). - Hartimi i draftit të konsoliduar dhe të konsultuar (qershor 2024). - Konsultimi për draftin e konsoliduar me institucionet përkatëse dhe palët e interesuara (shtator 2024). - Miratimi i strategjisë nga Komiteti i Bashkërendimit për Luftën kundër Pastrimit të Parave (CCFAML) (dhjetor 2024).	(dhjetor 2024)	Statusi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Financimit të Terrorizmit dhe i Planit përkatës të Veprimit Aktualisht, strategjia është duke u përgatitur, në proces konsultimi.	MF/FIA

5.4. GJYQËSORI

Reforma në Drejtësi konsiderohet si një prej reformave ligjore dhe institucionale më rrënjësore që ka përfshirë sistemin e drejtësisë në vend në dhjetëvjeçarët e fundit. Qëllimi i saj është krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, efektiv, të pavarur dhe profesional të bazuar në parimet e shtetit të së drejtës dhe në përputhje me standardet evropiane.

Reforma në Drejtësi solli ndryshime themelore pozitive, të cilat lidhen me përmirësime të rëndësishme ligjore, duke rikonceptuar dhe siguruar zbatimin e parimeve kushtetuese, si pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit.

Një nga objektivat themelorë të reformës në drejtësi është rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësinë dhe funksionimin e tij efektiv. Bazuar në këtë, si pjesë përbërëse e paketës së ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij ligji ishte vendosja e rregullave specifike për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, si një proces që do t'i shërbente garantimit të profesionalizmit, integritetit moral, verifikimit të pasurisë dhe zbulimit të çdo lidhjeje apo ndikimi të mundshëm korruptiv. Ky rivlerësim kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur edhe si "*vetting*", konsiderohet nga Komisioni i Venecias si një nga masat më të rëndësishme të reformës për sistemin e drejtësisë, i parë si masë e jashtëzakonshme, kalimtare dhe e nevojshme.

Kjo arkitekturë e re institucionale e sistemit të drejtësisë ka prodhuar rezultatet e saj fillestare të dukshme në disa drejtime, duke përfshirë, ndër të tjera: rezultate shumë pozitive në zbatimin e procesit të rivlerësimit kalimtar *("vetting");* në emërimet e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të dalluar; në funksionimin e plotë të të gjitha organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe në ngritjen dhe funksionimin e të gjitha strukturave të specializuara në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Njëkohësisht, Shkolla e Magjistraturës ka vazhduar të trajnojë gjyqtarë dhe prokurorë të sapokualifikuar dhe të ofrojë trajnime për ata në detyrë, falë programeve të rishikuara të trajnimit.

Kuadri legjislativ dhe institucional i Shqipërisë për gjyqësorin ka një nivel të lartë përafrimi me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane. Reforma Gjyqësore e vitit 2016 rezultoi në reformimin rrënjësor të kuadrit ligjor dhe institucional të gjyqësorit dhe prokurorisë dhe përcaktoi garanci ligjore për përforcimin e pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë, përfshirë: zhbllokimin e mekanizmave për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; instrumentet për shmangien e ndikimit politik në institucionet e drejtësisë, mekanizmat e llogaridhënies, si dhe vlerësimin kalimtar *("vetting")* të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Reforma në Drejtësi e vitit 2016 solli ristrukturim të plotë institucional të gjyqësorit dhe prokurorisë, në përputhje me standardet evropiane, përfshirë reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe ngritjen e organeve të reja për vetëqeverisjen e gjyqësorit.

Angazhimi politik i Shqipërisë për reformimin e gjyqësorit është i dukshëm nëpërmjet masave që synojnë konsolidimin e pavarësisë dhe llogaridhënies gjyqësore, nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përmirësimit të efikasitetit gjyqësor në të gjitha nivelet. Këto masa pasqyrojnë një synim strategjik për të forcuar integritetin dhe efektivitetin e gjyqësorit. Për më tepër, rritja e efikasitetit në të gjitha nivelet gjyqësore është projektuar për të përmirësuar proceset, për të zvogëluar vonesat dhe për të rritur reagimin

e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë. Kjo qasje e gjithanshme ndaj reformës tregon vullnetin e fortë kombëtar për t'u përafruar me standardet evropiane dhe praktikat më të mira në qeverisjen gjyqësore.

Për më tepër, Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm për sa i përket integrimit gjinor në sistemin gjyqësor. Sipas të dhënave të vitit 2023, gratë përfaqësojnë 53% të gjyqtarëve dhe 35% të prokurorëve në sistem.

Sa u përket prokurorive: Që prej dhjetorit të vitit 2023, nga 208 prokurorë, 135 janë meshkuj dhe 73 femra. Konkretisht, 67 prokurore femra janë pjesë e shkallës së parë, 3 janë pjesë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe 3 janë pjesë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë.

Të dhënat për gjyqtaret gra janë si më poshtë: Që nga dhjetori i vitit 2023, ka 243 gjyqtarë në detyrë, me 130 gra dhe 113 burra në të gjitha shkallët e gjykatave. Këtu përfshihen 86 gjyqtare femra në gjykatat e shkallës së parë, 15 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit dhe 5 në Gjykatën e Lartë. Me rëndësi të veçantë është Gjykata e Apelit Tiranë, e cila përbëhet nga 18 gjyqtare femra që përbëjnë 70% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që përbëhet nga 6 gjyqtare femra që përbëjnë 67% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Shqipëria do të vazhdojë finalizimin progresiv të reformës brenda vitit 2026, duke përfshirë ndryshimet ligjore, që sigurojnë pakthyeshmërinë e rezultateve pozitive të masave të procesit të rivlerësimit që sigurojnë efikasitet; zbatimin dhe forcimin e dispozitave, që rregullojnë zgjedhjen paraprake të anëtarëve jogjyqtarë të KLGJ-së dhe KLP-së dhe institucioneve të tjera të vetëqeverisjes që do të bashkërendohen. Këto përpjekje përqendrohen në sigurimin e zbatimit efikas të drejtësisë dhe respektimin e standardeve të verifikimit për emërimin e anëtarëve jogjyqtarë të Këshillave dhe zhvillimin e karrierës së magjistratëve dhe aktorëve të tjerë të drejtësisë. Ky angazhim përfshin kryerjen e analizave dhe ruajtjen e standardeve më të mira.

Procesi i rivlerësimit *("vetting")* është pjesë thelbësore e kësaj reforme, me fokus në vlerësimet cilësore dhe referimin e vazhdueshëm të rasteve të dyshimta në prokurori. Shërbimet e prokurorisë do të nisin në mënyrë proaktive procedimin penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i verifikimit të të cilëve zbuloi elemente kriminale.

Po bëhet progres në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve (ICMS), veçanërisht me detajimin e kuadrit të ndërveprimit, duke përcaktuar nivelin bazë për hapjen e sistemit dhe marrëveshjen me bazë të gjerë për koordinimin e financimit të sistemit.

Shqipëria është e angazhuar për të siguruar bashkëpunimin efektiv ndërmjet institucioneve të drejtësisë, duke alokuar burimet e duhura dhe duke siguruar funksionimin efikas sistemik të sektorit të drejtësisë, si elemente thelbësore për zbatimin e suksesshëm të reformës në drejtësi. Në angazhimin tonë të palëkundur për prioritizimin e objektivave të reformës në drejtësi të Qeverisë Shqiptare dhe në kuadër të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe për të adresuar sfidat e mësipërme, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me të gjithë aktorët, po finalizon Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030. Ky dokument strategjik është krijuar për të zbatuar masat e përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar në dhjetor të vitit 2023 me vendimin nr. 736, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, ku detajohen masat strategjike dhe kuadri institucional në përputhje me gjetjet e Komisionit Evropian në Raportin e Shqyrtimit Analitik.

Synimi ynë është përparimi i reformës në drejtësi dhe përafrimi me *acquis* përkatës. Republika e Shqipërisë është e përkushtuar për arritjen e rezultateve të prekshme, si konsolidimi i arritjeve të reformës, sigurimi i pavarësisë dhe paanshmërisë, forcimi i llogaridhënies, përmirësimi i cilësisë së drejtësisë dhe rritja e efikasitetit.

R - 5.4.1. Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës

Sistemi gjyqësor shqiptar funksionon nën qeverisjen e organeve të pavarura vetëqeverisëse, duke përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP). Këta këshilla janë thelbësorë për emërimin, transferimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke iu përmbajtur në mënyrë rigoroze kritereve transparente dhe të bazuara në merita, të përcaktuara me ligj. Këshillat janë përgjegjës edhe për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, në bazë të rasteve të paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD).

Për sa i përket llogaridhënies, ekziston një proces i plotë verifikimi/"*vetting*" për të gjithë gjyqtarët, duke garantuar integritet dhe standarde të larta etike. Procesi i rivlerësimit/"*vetting*-ut" është pjesë thelbësore e kësaj reforme, me fokus në vlerësimet cilësore dhe referimin e vazhdueshëm të rasteve të dyshimta në prokurori, që pritet të përfundojë deri në vitin 2026 në shkallë apeli.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik do të sigurojnë mbylljen e të gjitha çështjeve të rivlerësimit/*"vetting*-ut" në pritje deri në vitin 2024. Deri në janar të vitit 2025, institucionet shqiptare, përfshirë edhe ZPP-në, në përputhje me detyrimet ligjore, do të sigurojnë referimin sistematik të çështjeve në prokurori, ku ka dyshime për elemente kriminale. Shërbimet e prokurorisë do të nisin në mënyrë proaktive procedimin penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i verifikimit/"*vetting*-ut" të të cilëve zbuloi elemente kriminale.

Kuvendi është institucioni përgjegjës për emërimin e anëtarëve jomagjistratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi. Legjislacioni në Shqipëri përcakton plotësisht dhe qartë procedurat dhe rregullat që duhet të ndjekë autoriteti përkatës për emërimin e anëtarëve jomagjistratë.

Përbërja e këshillave pasqyron një ekuilibër midis anëtarëve të gjyqësorit dhe përfaqësuesve jomagjistratë të avokatëve, akademikëve dhe shoqërisë civile, të përzgjedhur nga Kuvendi. Kjo strukturë, veçanërisht duke përjashtuar Presidentin e Republikës dhe Ministrin e Drejtësisë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mëparshëm, shënon një hap të rëndësishëm drejt demarkacionit të pavarësisë së gjyqësorit nga ndikimi i ekzekutivit.

Kushtetuta parashikon parimet e përgjithshme të zbatueshme në fazën parazgjedhore për anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së dhe KLP-së. Rregullime të mëtejshme të legjislacionit janë parashikuar në përputhje me Kushtetutën, pasi nevojitet bashkërendimi i procedurave të përzgjedhjeve paraprake me standardet më të larta në lidhje me kontrollet e historikut dhe deklaratat e pasurisë. Procedura do të kryhet në një mënyrë më të unifikuar/rregulluar dhe ekziston nevoja për të lehtësuar kontrollet e shpejta të historikut, duke mbledhur informacion nga të gjitha institucionet përkatëse. Për më tepër, kontrollet e pasurive duhet të rregullohen për kategoritë e atyre që mund të kenë një pozitë zyrtare, duke qenë anëtarë të këtyre Këshillave, si avokatët apo shoqëria civile. Detajimi i standardeve të mëtejshme të përzgjedhjes paraprake në të gjitha nivelet, përpara përzgjedhjes përfundimtare të anëtarëve dhe zgjedhjes së mundshme nga Kuvendi, do të lehtësojë punën e vazhdueshme të Kuvendit, do të rrisë transparencën dhe më e rëndësishmja do të sigurojë një standard të barabartë të kontrollit të integritetit për të gjitha kategoritë e anëtarëve të Këshillit. Do të kërkohet diskutim i mëtejshëm me ekspertët dhe Komisionin për qëllimin e zbatimit të hapit të parashikuar.

Një hap tjetër i rëndësishëm për të siguruar konsolidimin gjyqësor është transparenca dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë synojnë të përmbushin të gjitha kushtet e kërkesave të transparencës duke ndarë publikisht të gjithë informacionin në lidhje me emërimet, ngritjet në detyrë, vlerësimet dhe transferimet, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Tabela 27: Rezultatet dhe produktet e pritshme – Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Sigurimi i një sistemi drejtësie më të përgjegjshëm, transparent dhe efektiv, duke forcuar shtetin e së drejtës dhe besimin e publikut në gjyqësor. Rritja e llogaridhënies dhe luftimi i korrupsionit në sektorin e drejtësisë. Rritja e besimit në sistemin e drejtësisë dhe nxitja e	Rastet e *vetting*-ut me dyshime për elementë kriminalë, të përfunduara në shkallë të parë (KPK) [me vendim pushimi] i referohen prokurorisë **(dhjetor 2024)** dhe ndjekja efektive gjyqësore për rastet e *vetting*-ut që rezultojnë me dyshime për elementë kriminalë, që vazhdojnë t'i referohen prokurorisë **(qershor 2025)**. Ndryshimi i dispozitave që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për t'iu përshtatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, të zbatueshme për magjistratët, dhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në merita për renditjen e pavarur **(dhjetor**	**5.4.1.** Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës

vendimmarrjes së drejtë dhe të paanshme. Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies, duke nxitur besimin e publikut në sektorin e drejtësisë.	**2027)**. Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë sigurojnë transparencë të lartë, ndajnë publikisht të gjithë informacionin në lidhje me emërimet [vlerësimet periodike të karrierës], ngritjet në detyrë dhe transferimet, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (**qershor 2025)**.	

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet e përgjegjësisë**
5.4.1. Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës			**Drejtues: Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e mëposhtme**
Hapi 1 - Rastet e *vetting*-ut me dyshime për elementë kriminalë, të përfunduara në shkallë të parë (KPK) [me vendim pushimi] i referohen prokurorisë (dhjetor 2024). dhe ndjekja efektive gjyqësore për rastet e *vetting*-ut që rezultojnë me dyshime për elementë kriminalë, që vazhdojnë t'i referohen prokurorisë (qershor 2025). - Përgatitja e një plani nga KPK-ja për të përfunduar referimet e çështjeve me elemente të dyshimta kriminale, që kanë marrë formë të prerë në shkallë të parë KPK (me vendime pushimi) në prokurori (qershor 2024). - Përfundimi i referimeve për çështjet me elemente të dyshimta kriminale, që kanë marrë formë të prerë në shkallë të parë KPK (me vendime pushimi) në prokurori (dhjetor 2024). - Përditësimi i rregullt në platformën elektronike, për mbledhjen e të dhënave lidhur me korrupsionin dhe krimet e tjera më të rënda, i të dhënave për ndjekjen efektive gjyqësore të referimeve të çështjeve me elemente të dyshimta kriminale që kanë marrë formë të prerë në shkallë të parë KPK (me vendime pushimi) (qershor 2025–çdo 3 muaj). - ZPP-ja raporton rregullisht për procedimin e rasteve të referuara me elemente të dyshimta kriminale që kanë marrë formë të prerë në shkallë të parë KPK (janar 2025–çdo 3 muaj).	dhjetor 2024 (qershor 2025)	Numri total i çështjeve me vendim pushimi evidentuar nga KPK-ja në janar të vitit 2024. 34 raste referimit nga KPK-ja në prokurori në vitin 2023 Statusi i ndjekjes aktuale gjyqësore për rastet e rivlerësimit/"*vetting*"	Ministria e Drejtësisë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Dhoma e Apelit (DHA)
Hapi 2 - Ndryshimi i dispozitave që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për t'iu përshtatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, të zbatueshme për magjistratët, dhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në merita për renditjen e pavarur (dhjetor 2027).	(dhjetor 2027)	Aktualisht, nuk ka asnjë vlerësim kërcënimi dhe deri tani nuk është bërë asnjë rishikim	Ministria e Drejtësisë Kuvendi, institucioni i Avokatit të Popullit
Hapi 3 - Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë sigurojnë transparencë të lartë, ndajnë publikisht të gjithë informacionin në lidhje me emërimet [vlerësimet periodike të karrierës], ngritjet në detyrë dhe transferimet, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga Inspektori i Lartë i	(qershor 2025)	Metodologjia aktuale e KLGJ-së dhe KLP-së për transparencën dhe publikimin e informacioneve për emërimet, promovimet dhe	Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

Drejtësisë (qershor 2025). - Kryerja e vlerësimeve dhe miratimi i metodologjive nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë për transparencën dhe publikimin e informacionit për emërimet, promovimet dhe transferimet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave[96] (dhjetor 2024) - Publikimi nga Këshillat e Lartë Gjyqësorë dhe të Prokurorisë i të dhënave të përgjithësuara për emërimet, gradimet dhe transferimet në gjyqësor (qershor 2025–çdo 3 muaj) - Publikimi nga Këshillat e Lartë Gjyqësorë dhe të Prokurorisë i të dhënave të përgjithësuara për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike nga ILD-ja (qershor 2025 – çdo vit brenda 3/6 muajve të vitit pasardhës).		transferimet	

R – 5.4.2. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet

Progresi i konsiderueshëm drejt një sistemi gjyqësor më efikas, transparent dhe më të përgjegjshëm, që forcon shtetin e së drejtës dhe besimin e publikut në gjyqësor, do të arrihet përmes zbatimit të një udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të pakësuar stokun e çështjeve të mbartura *(backlog),* bazuar në instrumentin CEPEJ për pakësimin e çështjeve të mbartura *(backlog),* duke sjellë reduktimin e numrit të përgjithshëm të çështjeve të mbartura dhe kohës së pritjes për çështjet civile dhe tregtare dhe përmirësimin e statistikave gjyqësore kombëtare.

Një analizë e plotë do të kryhet nga KLGJ-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme për të përmirësuar ligjet procedurale, me qëllim arritjen e përfitimeve të mëtejshme në drejtim të efikasitetit. KLGJ-ja/këshillat e gjykatave dhe Prokuroria e Përgjithshme do të hartojnë dhe miratojnë një strategji për pakësimin e stokut të çështjeve të mbartura *(backlog),* duke rregulluar shpërndarjen e barabartë të ngarkesës së punës, për gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet brenda vitit 2025 dhe duke zbatuar masat nga viti 2025 e në vazhdim.

KLGJ-ja dhe KLP-ja do të vazhdojnë me emërimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të gjitha nivelet. Ato do të përmirësojnë më tej procedurat e vlerësimit dhe ngritjes në detyrë të magjistratëve, bazuar në kritere cilësore dhe sasiore dhe do të rrisin transparencën e procesit.

Platforma Qeveritare – *e-Albania* – është baza e të dhënave shtetërore e cila siguron ndërveprimin midis të gjitha bazave të të dhënave shtetërore dhe është parakusht për aksesin në të dhënat e nevojshme (si p.sh., Zyra e Gjendjes Civile, Regjistri i Pasurive të Paluajtshme, Regjistri i Pasurive të Luajtshme, Dëshmitë e Penalitetit, Regjistri Noterial, Regjistri i Testamenteve dhe Trashëgimisë etj.), si dhe në të dhëna të tjera thelbësore për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe rritjen e efikasitetit duke reduktuar punën me shkresa, duke ulur/hequr tarifat administrative dhe duke rritur modernizimin e procesit digjital.

Shqipëria po ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar që buxheti të jetë i disponueshëm për sistemin e drejtësisë për të krijuar Sistemin modern të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve, duke siguruar shtrirjen e tij dhe duke mundësuar bashkëpunimin digjital mes gjykatave dhe dorëzimin elektronik të dokumenteve, në kuadër të një përshtatje graduale me procedurat ekzistuese dhe të ardhshme të bashkëpunimit digjital në fushën e gjyqësorit në BE.

Duhet theksuar se Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve do të jetë një sistem i administruar tërësisht nga KLGJ-ja si Autoriteti Rregullator Koordinues në kuptim të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore". Aktet nënligjore në fuqi kanë parashikuar masa specifike për të garantuar pavarësinë e këtij sistemi në menaxhimin, administrimin si dhe në garantimin e sigurisë kibernetike. QTI-ja, në KLGJ, është organi kolegjial, i cili sipas pikës 6 të VKM-së nr. 972, datë 2.12.2020, "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të QTI-së për sistemin e drejtësisë", parashikon që Qendra, në përmbushjen e veprimtarisë së saj, të bazohet në parimet e:

- garantimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe ndarjes së pushteteve;

[96] Institucionet shqiptare u nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe rekomandimeve të detyrueshme të Komisionerit të të Dhënave Personale.

- garantimit të sigurisë dhe integritetit të të dhënave në sistemet e teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë;

- mbrojtjes së të dhënave personale dhe garantimit të konfidencialitetit;

- ruajtjes së sekretit dhe ndalimit të publikimit të akteve hetimore;

- garantimit të ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave mes sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë;

- garantimit të prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë;

- garantimit të zbatimit të standardeve të Bashkimit Evropian për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Ekzistojnë një sërë aktesh që rregullojnë ndërveprimin midis ICMS dhe platformës *e-Albania,* si më poshtë:

- Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 92, 216.

- Vendimi nr. 971, datë 2.12.2020, "Për miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë".[97]

- Vendimi nr. 972, datë 2.12.2020, "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të QTI-së për sistemin e drejtësisë"[98]

Nga ana tjetër, Platforma *e-Albania* është baza e të dhënave shtetërore e cila siguron ndërveprimin midis të gjitha bazave të të dhënave shtetërore dhe siguron aksesin në të dhënat e nevojshme (si p.sh., Zyra e Gjendjes Civile, Regjistri i Pasurive të Paluajtshme, Regjistri i Pasurive të Luajtshme, Dëshmitë e Penalitetit, Regjistri Noterial, Regjistri i Testamenteve dhe Trashëgimisë etj.), si dhe në të dhëna të tjera thelbësore për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe rritjen e efikasitetit duke reduktuar punën me shkresa, duke ulur/hequr tarifat administrative dhe duke rritur modernizimin e procesit digjital.

Nga sa më sipër rezulton, se ndërveprimi mes sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve ICMS dhe platformës qeveritare *e-Albania* do të kryhet vetëm për qëllimin e shkëmbimit të të dhënave, në përputhje të plotë me garancitë ligjore, që lidhen me bazat e të dhënave shtetërore, për pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorive, ku përdoruesit e gjykatave dhe prokurorive që kanë akses në ICMS do të kenë akses edhe në dokumente që lehtësojnë hetimin dhe gjykimin dhe shkurtojnë afatet për hetimet/gjykimet si dhe shmangin kostot administrative të institucioneve shtetërore. Kështu, këta përdorues do të kenë akses në regjistrat noterialë me qëllim nxjerrjen e akteve të trashëgimisë ose akteve të tjera noteriale të nevojshme për hetim/gjykim pa të drejtë ndryshimi të përmbajtjes; si dhe akses në sistemin tatimor, regjistrin e gjendjes gjyqësore, regjistrin e gjendjes civile etj. Nga ana tjetër, qytetarët, përmes aksesit në *e-Albania* do të mund të shohin statusin e çështjes së tyre gjyqësore, pa ndikuar në përmbajtjen e të dhënave.

Tabela 28: Rezultatet dhe produktet e pritshme – 5.4.2. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet

Rezultati	**Produktet e pritshme (rezultatet)**	**Reforma që kontribuon në arritjet**
Progresi i rëndësishëm drejt një sistemi gjyqësor më efikas, transparent dhe më të përgjegjshëm, duke forcuar shtetin e së drejtës dhe besimin e publikut në gjyqësor.	Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) miraton dhe zbaton në mënyrë efektive një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar numrin e çështjeve të pashqyrtuara, bazuar në metodologjinë më të fundit, siç miratuar nga instrumenti CEPEJ[99] për reduktimin e çështjeve të pashqyrtuara, me synime të matshëm, statistika dhe një strukturë të konsoliduar monitorimi (**qershor 2025**). Reduktimi i përgjithshëm i çështjeve të pashqyrtuara dhe kohës së disponimit me të paktën 30% në çështjet civile dhe tregtare nga Gjykata e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm, Tiranë, me të paktën 25% nga Gjykata e Apelit dhe me të paktën 35% nga	**5.4.2.** Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet

[97] https://qti.al/wp-content/uploads/2022/01/vendim-2020-12-02-971.pdf
[98] https://qti.al/wp-content/uploads/2022/01/vendim-2020-12-02-972.pdf
[99] Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ – Commission européenne pour l'effcacité de la justice).

	Gjykata Administrative e Apelit (**dhjetor 2026**). Sigurimi i një zgjidhje për mjediset e punës së Gjykatës së Apelit, për t'u akomoduar sipas hartës gjyqësore të vitit 2022 (**dhj**		
Reforma dhe hapat	**Afati kohor**	**Baza**	**Institucionet e përgjegjësisë**
5.4.2. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet	Përmirësimi i statistikave kombëtare të sistemit të ri të ministrit të Drejtësisë për statistikat kombëtare të drejtësisë, bazuar në metodologjinë e CEPEJ dhe në konsultim me institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë **(qershor 2025)**. Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS)[100], i cili siguron ndërveprim ndërmjet gjykatave dhe prokurorive dhe Portalit ndërqeveritar *(Government Gateway)* – në respekt të plotë të garancive ligjore për bazat e të dhënave shtetërore, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorisë, si dhe gjenerimin automatik të statistikave bazuar në metodologjinë e CEPEJ dhe legjislacionin kombëtar, është gati për t'u përdorur **(dhjetor 2027)**. Të paktën 70% e vendeve vakante për magjistratë në Gjykatat e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të paktën 80% për Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 90% e personelit jomagjistrat në të gjitha nivelet e gjykatave, janë plotësuar (**dhjetor 2027**). Rritja e kapaciteteve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) duke siguruar që vendet vakante e inspektorëve pranë ILD-së të plotësohen gradualisht, me masa që synojnë të sigurojnë atraktivitetin e pozicionit. ILD miraton dhe zbaton planin vjetor të inspektimeve tematike për çështjet më problematike, në konsultim me Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës (**dhjetor 2026**).	dhe zbatuar një udhëzim	**Ministria e Drejtësisë(MD)**

Zbatimi dhe përgjegjësitë

[100] ICMS (Integrated Case Management System).

Hapi 1 – Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) miraton dhe zbaton në mënyrë efektive një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar numrin e çështjeve të pashqyrtuara, bazuar në metodologjinë më të fundit, siç miratuar nga instrumenti CEPEJ[101] për reduktimin e çështjeve të pashqyrtuara, me synime të matshëm, statistika dhe një strukturë të konsoliduar monitorimi (qershor 2025). - KLGJ-ja dhe PP/ZPP-ja bëjnë analiza dhe japin një sërë rekomandimesh për riorganizimin e ligjeve procedurale dhe opsioneve të tjera të efikasitetit dhe menaxhimit të gjykimeve, për përfitime të mëtejshme të efikasitetit nëpërmjet ndryshimeve në ligjin procedural (shtator 2024). - KLGJ/këshillat e gjykatave dhe PP-të miratojnë një strategji efikasiteti/reduktimi të stokut të çështjeve të mbartura *(backlog)* dhe akteve plotësuese/shpërndarjes së barabartë të ngarkesës në gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet (dhjetor 2024). - Strategjia për reduktimin e stokut të çështjeve të mbartura *(backlog)* filloi të zbatohet përmes krijimit të ekipeve për reduktimin e stokut të çështjeve të mbartura *(backlog)* (të përbërë nga gjyqtarë të mbështetur nga ndihmës ligjorë, sekretarë gjyqësorë dhe oficerë të tjerë për reduktimin e stokut të çështjeve të mbartura), së bashku me një numër shtesë asistentësh ligjorë dhe me stafin mbështetës të rekrutuar (qershor 2025).	(qershor 2025)	Nuk ka udhërrëfyes për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar çështjet e mbartura e KLGJ-së	Këshilli i Lartë Gjyqësor, PP, ZPS
Hapi 2 – Reduktimi i përgjithshëm i çështjeve të pashqyrtuara dhe kohës së disponimit me të paktën 30% në çështjet civile dhe tregtare nga Gjykata e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm, Tiranë, me të paktën 25% nga Gjykata e Apelit dhe me të paktën 35% nga Gjykata Administrative e Apelit (dhjetor 2026). - Miratimi i planit të punës për prioritizimin e çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, përkatësisht (shtator 2024, i cili përsëritet çdo janar dhe shtator). - MD-ja krijon një grup pune për përmirësimin e ligjit për gjykatat administrative lidhur me rritjen e mëtejshme të efikasitetit përmes ndryshimeve në procedurat gjyqësore administrative (dhjetor 2024). - Grupi i punës për përmirësimin e ligjit për gjykatat administrative përgatit dhe konsultohet me palët e interesuara lidhur me rritjen e mëtejshme të efikasitetit përmes ndryshimeve në procedurat gjyqësore administrative (qershor 2025). - Ndryshimet në ligjin për gjykatat administrative, për rritjen e mëtejshme të efikasitetit të ligjit, miratohen nga Qeveria (shtator 2025). - KLGJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë hartimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të zbatimit për strategjinë e stokut të çështjeve të mbartura dhe akteve plotësuese (dhjetor 2025). - Hartimi i bazës në dispozicion, lidhur me kohën e reduktimit të stokut të çështjeve të mbartura dhe me KLGJ-në dhe KLP/PP-në (dhjetor 2024).	(dhjetor 2026)	Çështjet e mbartura për vitin 2023: 19.275 raste në vitin 2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, 37.662 raste në vitin 2023 në Gjykatën e Apelit dhe 23.056 raste në vitin 2023 në Gjykatën Administrative të Apelit	Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjykatat (Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit)

[101][101] Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ – Commission européenne pour l'ecacité de la justice).

- Objektivi i arritur (dhjetor 2026).			
Hapi 3 - Sigurimi i një zgjidhje për mjediset e punës së Gjykatës së Apelit, për t'u akomoduar sipas hartës gjyqësore të vitit 2022 (dhjetor 2025). - Financimi është ndarë nga buxheti i shtetit për studimin e zgjidhjes së çështjes së objekteve adekuate për akomodimin e Gjykatës së Apelit sipas hartës gjyqësore 2022 (qershor 2024). - KLGJ-ja fillon procesin e tenderimit për marrjen me qira të objekteve të përshtatshme për akomodimin e Gjykatës së Apelit sipas hartës gjyqësore 2022 në periudhën ndërmjetëse (dhjetor 2024). - KLGJ prokuron studimin, i cili përcakton vendndodhjen dhe llojin e ndërhyrjes për objektet që akomodojnë në mënyrë adekuate Gjykatën e Apelit sipas hartës gjyqësore 2022 (qershor 2025). - KLGJ-ja nis zbatimin e gjetjeve të studimit për zgjidhjen e ambienteve adekuate për akomodimin e Gjykatës së Apelit sipas hartës gjyqësore 2022 (dhjetor 2025).	(dhjetor 2025)	Statusi i objekteve për Gjykatën e Apelit në qershor 2024	Këshilli i Lartë Gjyqësor
Hapi 4 - Përmirësimi i statistikave kombëtare të sistemit të drejtësisë duke miratuar dhe zbatuar një udhëzim të ri të ministrit të Drejtësisë për statistikat kombëtare të drejtësisë, bazuar në metodologjinë e CEPEJ dhe në konsultim me institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë (qershor 2025). - Kryerja e një analize që sjell përcaktimin e fushës së rregullimit të udhëzimit të ri të MD-së (dhjetor 2024) - Konsultimi i MD-së me Këshillin e Lartë Gjyqësor lidhur me udhëzimin e ri për statistikat gjyqësore kombëtare (shkurt 2025). - Tryezë e rrumbullakët me të gjitha institucionet e drejtësisë vetëqeverisëse dhe aktorët përkatës (KLGJ, PP, Avokati i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Shtetëror të Përmbarimit, INSTAT) për përmirësimin e mëtejshëm të projekt-udhëzimit (maj 2025). - Udhëzimi i ri i MD-së në koordinim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, miratohet nga MD-ja (qershor 2025).	(qershor 2025)	Udhëzimi aktual nr. 4, datë 15.4.2019, "Për Plotësimin e të Dhënave Statistikore"	Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor
Hapi 5 - Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS)[102], i cili siguron ndërveprim ndërmjet gjykatave dhe prokurorive dhe Portalit ndërqeveritar *(Government Gateway)* – në respekt të plotë të garancive ligjore për bazat e të dhënave shtetërore, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorisë, si dhe gjenerimin automatik të statistikave bazuar në metodologjinë e CEPEJ dhe legjislacionin kombëtar, është gati për t'u përdorur (dhjetor 2027). - Qeveria siguron një buxhet të mjaftueshëm për KLGJ-në dhe KLP-në. - Grupi i punës miraton termat/specifikimet, duke siguruar ndërveprimin midis gjykatave/prokurorëve dhe Portalit të Qeverisë, në respekt të plotë të garancive ligjore lidhur me bazat e të dhënave shtetërore, si dhe me pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorisë (qershor 2024). - Pilotimi i gjenerimit të të dhënave statistikore përmes	(dhjetor 2027)	Nuk ka ICMS të gatshme për t'u përdorur	Qendra e Teknologjisë së Informacionit në KLGJ dhe AKSHI

[102] ICMS (Integrated Case Management System).

përdorimit të sistemit ICMS (qershor 2027)[103]. - Zgjerimi i popullatës së sistemit me të dhëna për të siguruar shpërndarjen e ndërveprimit (dhjetor 2027).			
Hapi 6 – Të paktën 70% e vendeve vakante për magjistratë në Gjykatat e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të paktën 80% për Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 90% e personelit jomagjistrat në të gjitha nivelet e gjykatave, janë plotësuar (dhjetor 2027). - Rritja e ritmit të vlerësimeve të cilësisë nga KLGJ-ja dhe fillimi i vlerësimeve nga KLP-ja (dhjetor 2024). - Vlerësimi i nevojave në lidhje me kuotat e regjistrimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë, që do të pranohen në SHM (Shkollën e Magjistraturës) për atë vit akademik (janar 2025 - dhe çdo janar të çdo viti). - Përgatitja e zgjidhjeve për të rritur numrin e studentëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës (qershor 2025). - Këshillat rishikojnë metodologjinë e tyre për vlerësimin e performancës, për të arritur një balancë më të madhe midis kritereve cilësore dhe sasiore dhe për të rritur transparencën e procesit dhe për të zbatuar metodologjinë (dhjetor 2025). - Emërimi në kohë i studentëve të diplomuar nga SHM ne KLGJ dhe KLP (nëntor 2024 dhe çdo nëntor të çdo viti) (dhjetor 2027).	(dhjetor 2027)	Bazuar në të dhënat e qershorit të vitit 2024, Gjykata e Apelit Administrativ ka 6 gjyqtarë me kohë të plotë (+ 5 gjyqtarë të deleguar) nga 13 që është numri total. Numri i gjyqtarëve në funksion në vitin 2023 ishte 243 nga gjithsej 408 gjyqtarë sipas dekretit të Presidentit (59.55%).	Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës
Hapi 7 – Rritja e kapaciteteve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) duke siguruar që vendet vakante e inspektorëve pranë ILD-së të plotësohen gradualisht, me masa që synojnë të sigurojnë atraktivitetin e pozicionit. ILD miraton dhe zbaton planin vjetor të inspektimeve tematike për çështjet më problematike, në konsultim me Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës (dhjetor 2026). - Hartimi i zgjidhjeve për përmirësimin e kapaciteteve, nëpërmjet emërimit të inspektorëve të ILD-së, sipas ndryshime ligjore (qershor 2026). - Sigurimi i një promovimi më të mirë për palët e interesuara dhe publikun për mundësinë për të aplikuar për emërim në ILD nga KLGJ-ja dhe KLP-ja (shtator 2026). - Objektivi i arritur nëpërmjet thirrjeve publike, emërimeve, ndryshimeve ligjore dhe zbatimit (dhjetor 2026).	(dhjetor 2026)	Numri i inspektorëve në vitin 2023 ishte 4 inspektorë magjistratë dhe 5 inspektorë jomagjistratë, gjithsej 9 nga 20 që parashikon organigrama.	Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

5.5. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Shqipëria është aktualisht në procesin e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale për Antikorrupsionin 2024-2030, me Planin e parë të Veprimit të dedikuar për periudhën 2024-2026. Paketa strategjike do të miratohet në muajt në vijim.

Shqipëria ka legjislacion të gjerë në fushën e parandalimit të korrupsionit, që mbulon administratën publike, deklarimin e pasurisë, konfliktin e interesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Shqipëria është palë e instrumenteve ndërkombëtare kundër korrupsionit. Ligji për ratifikimin e Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC) hyri në fuqi në maj 2006. Shqipëria ratifikoi edhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Konventat e së Drejtës Civile dhe Penale mbi Korrupsionin e Këshillit të Evropës, të cilat janë tashmë pjesë e legjislacionit të saj të brendshëm. Legjislacioni është i përafruar pjesërisht me direktivën 2017/1371 (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit përmes legjislacionit penal. Kodi Penal parashikon kriminalizimin e korrupsionit si krim të rëndë, duke përfshirë edhe përmasat e tij ndërkufitare.

Legjislacioni shqiptar është përafruar gjerësisht me vendimin kuadër të Këshillit 2003/568/JHA për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat. Ligji "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" përafron pothuajse të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me personat juridikë, ndërsa dënimet e parashikuara në nenin 164/b të Kodit Penal janë në përputhje me përcaktimet e vendimit kuadër.

Shqipëria mori masa për të siguruar një digjitalizim më të madh të shërbimeve të saj për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Shqipëria krijoi një platformë prokurimi publik, një platformë ankesash prokurimi, një sistem elektronik të deklarimit tatimor dhe digjitalizoi 99% të të gjitha shërbimeve tatimore. Komisariati digjital është platforma kryesore e Policisë së Shtetit, i cili lejon denoncimin anonim të veprimeve të paligjshme dhe korrupsionit. Një sistem i menaxhimit të çështjeve është vendosur në Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK) për të trajtuar praktikat korruptuese.

Baza ligjore për hetimin e pasurisë përbëhet nga neni 36 i Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009 (ligji antimafia) dhe akti normativ nr. 1, datë 31.1.2020, "Për masat parandaluese në kuadër të fuqizimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda, dhe për konsolidimin e rendit të sigurisë publike". Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike rregullon edhe çështjen e lëvizjes së nëpunësve publikë drejt sektorit privat (e ashtuquajtura "dera rrotulluese"), me qëllim shmangien e konfliktit të interesit.

Shqipëria duhet të adresojë ende disa sfida lidhur me korrupsionin. Sfidat që duhet të adresohen janë si më poshtë:

- nevoja për më shumë transparencë në financat e qeverisë dhe akses publik në të dhënat e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publikë, me qëllim promovimin e llogaridhënies dhe uljen e korrupsionit.

- nevoja për parandalimin e rasteve të korrupsionit përmes mekanizmave të përforcuar të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, të cilat do të kontribuojnë në një sistem qeverisjeje më transparent dhe të përgjegjshëm.

- nevoja për forcimin e kuadrit ligjor në fuqi, në mënyrë që të rritet transparenca, llogaridhënia dhe integriteti në jetën politike dhe publike, duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe sjellje joetike.

R - 5.5.1. Parandalimi efektiv i korrupsionit, zvogëlimi i incidencës së korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit mbetet prioritet. Një ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është emëruar që nga fundi i vitit 2023, për të forcuar reformat për parandalimin e korrupsionit.

- Veprimet reformuese të parashikuara për parandalimin efektiv të korrupsionit dhe uljen e incidencës së korrupsionit në kuadër të Agjendës së Reformave 2024–2027, janë të orientuara drejt adresimit të sfidave kryesore, si më poshtë: Transparenca e Rritur: Krijimi i një platforme të hapur të të dhënave për buxhetin kombëtar dhe vendor dhe për shpenzimet publike, në partneritet me shoqërinë civile, do të sillte rritjen e transparencës në financat e qeverisë. Gjithashtu, publikimi i të gjitha deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) do t'i mundësonte publikut akses në informacionin për pasuritë financiare të zyrtarëve publikë, duke nxitur llogaridhënien dhe reduktuar e mundësitë për korrupsion.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj rreziqeve, si dhe mbajtjes së kostove sa më të ulëta në kushtet aktuale. Në këtë drejtim, viti 2023 shënoi përmirësim në të gjithë treguesit e rrezikut të borxhit, veçanërisht në rrezikun e rifinancimit të borxhit të brendshëm, si dhe në uljen e pjesës së borxhit në valutë. Për më tepër, marrëdhëniet me investitorët janë përmirësuar, komunikimi është intensifikuar dhe është shënuar një pjesëmarrje më e gjerë e investitorëve individualë gjatë viteve të fundit. Gjatë vitit 2023, menaxhimi i borxhit ka vazhduar me masat e marra për përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar. Masat e ndërmarra synuan krijimin e madhësive të standardeve dhe konsolidimin e kurbës së kthimeve financiare drejt letrave me vlerë afatmesme dhe afatgjata. Në këtë drejtim, ajo ka vazhduar zbatimin e projektit i bërjes së tregut për obligacionet referente 5-vjeçare dhe 3-vjeçare. Në periudhën afatmesme, menaxhimi i borxhit do të fokusohet në përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm) në drejtim të zbutjes së rrezikut. Struktura e financimit të brendshëm do të jetë fleksibël për sa i përket madhësisë së emetimeve, në varësi të kushteve të tregut (si niveli i kërkesës, norma e interesit etj.), duke synuar kështu optimizimin e kostos në përputhje me zhvillimin e objektivave të menaxhimit të rrezikut. Ndërkohë, financimi i jashtëm do të jetë gjithashtu një burim i rëndësishëm financimi, për të mbajtur presionin e huamarrjes së brendshme në përputhje me kapacitetet e kërkesës së brendshme, për të optimizuar kostot e borxhit dhe për të furnizuar valutën e nevojshme për menaxhimin e detyrimeve të borxhit të jashtëm, duke shmangur deformimin e tregun e valutës vendase. Gjatë vitit 2024 financimi është planifikuar të mbështetet gjerësisht në tregun e brendshëm, ku priten 50 miliardë lekë (rreth 480 milionë euro ekuivalenti) në terma neto. Financimi nga kreditorët e jashtëm konsiston në lëvrimin e kredive për projekte dhe mbështetje buxhetore. Në terma neto, huamarrja e jashtme pritet në nivel negativ rreth (minus) 14 miliardë lekë.

VII. Perspektiva afatmesme

Pas rimëkëmbjes në 2021-2022, ne presim që rritja ekonomike të ngadalësohet në 2.6 për qind në 2023 sipas skenarit bazë. Rritja ekonomike parashikohet të zgjerohet me 3.5 për qind në vitin 2023 dhe më tej në 3.7 për qind në vitin 2024, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, veçanërisht ecuria e jashtëzakonshme e sektorit të turizmit dhe aktivitetit të ndërtimit. Gjatë gjithë kufirit afatmesëm, rritja

parashikohet të qëndrojë afër 3.9 për qind. Kjo rritje e qëndrueshme i atribuohet kryesisht kërkesës së brendshme të fuqishme, që rrjedh si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet, me një efekt neto paksa pozitiv që pritet nga kërkesa e huaj neto.

Veçanërisht, eksportet e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht në sektorin e turizmit, parashikohet të shfaqin performancë të fortë. Megjithatë, rritja e parashikuar e importeve sugjeron një kontribut të lehtë neto pozitiv nga kërkesa e huaj në periudhën afatmesme.

Në kontekstin aktual makroekonomik global, i karakterizuar nga ndërprerjet e fundit të ofertës globale dhe pasiguritë në zhvillim, veçanërisht në fushën e kushteve të reja financiare globale shumë më të shtrënguara, ne e perceptojmë vazhdimin e konsolidimit fiskal si një rëndësi të madhe.

Ndërsa angazhimi ynë për konsolidimin fiskal mbetet i palëkundur, ne jemi po aq të përkushtuar për të zbutur ndikimin e krizës së fundit në segmentet më të cenueshme të shoqërisë, të gjitha brenda kufijve të kujdesit fiskal. Kjo qasje e balancuar siguron ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendeve tona duke adresuar sfidat mbizotëruese sociale dhe ekonomike.

Projeksionet për periudhën 2024–2026 tregojnë një rritje mesatare vjetore reale prej 5.2 për qind për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke kontribuar pozitivisht me një mesatare prej 1.9 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Nga ana tjetër, importet e mallrave dhe shërbimeve në këtë hark afatmesëm pritet të zgjerohen me 3.7 për qind, duke rezultuar në një kontribut mesatar negativ prej rreth -1.7 pikë përqindjeje në vit në rritjen e përgjithshme. Si rrjedhojë, kërkesa e huaj neto parashikohet të ketë një ndikim lehtësisht pozitiv në rritjen e përgjithshme, mesatarisht 0.2 pikë përqindjeje në vit.

Nga këndvështrimi i ofertës agregate, parashikohet që të gjithë sektorët kryesorë të performojnë në përputhje me normat e tyre mesatare historike të rritjes, ndërsa efektet e vazhdueshme të goditjeve të mëparshme do të zvogëlohen. Konkretisht, parashikimi tregon se shërbimet do të përjetojnë një rritje mesatare vjetore reale prej 4.5 për qind gjatë periudhës 2024-2026, me peshën e tyre më të madhe që do të kontribuojë dukshëm me një mesatare prej 2.2 pikë përqindjeje në vit. Industria pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 4.5 për qind, duke dhënë një kontribut mesatar prej 0.5 pikë përqindjeje në vit. Bujqësia parashikohet të arrijë një rritje mesatare vjetore prej 2.4 për qind në të njëjtën periudhë, me një kontribut mesatar prej 0.5 pikë përqindjeje në vit. Gjithashtu, ndërtimi vlerësohet të rritet me 2.8 për qind në vit, duke kontribuar mesatarisht me 0.3 pikë përqindjeje në vit.

Ndërsa rritja e investimeve pritet të reflektojë përdorimin tashmë më intensiv të kapaciteteve ekzistuese prodhuese, si dhe përshpejtimin e aktivitetit ekonomik në periudhën e parashikuar, dhe përmirësimin e përgjithshëm të perceptimit të investitorëve për stabilitetin makroekonomik të vendit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vazhdimi i përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të kreditimit pritet të jetë një faktor i rëndësishëm nxitës për investimet private, në periudhën afatmesme.

Indeksi i ndjenjës ekonomike pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2023, duke vijuar rritjen e fortë që pati në vitin 2022, ndaj duket se ka një tendencë të qartë rritëse të besimit dhe perceptimit të agjentëve ekonomikë për ecurinë e aktivitetit ekonomik së fundmi si dhe pritshmëritë e tyre në të ardhmen e afërt.

Konkretisht, për periudhën afatmesme (2024-2026), konsumi përfundimtar parashikohet të rritet në terma realë me një mesatare prej rreth 3.0 për qind në vit, duke kontribuar mesatarisht me 2.6 pikë përqindjeje në vit në rritjen e përgjithshme.

Njëkohësisht, investimet parashikohen të përjetojnë rritje reale me një normë mesatare prej 4.7 për qind në vit, duke kontribuar mesatarisht me 1.1 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së.

Janë vërejtur vazhdimisht zhvillime pozitive në tregun e punës, duke shënuar një rikuperim të vazhdueshëm nga rënia ekonomike e shkaktuar nga pandemia. Gjatë gjithë vitit 2023, tregu i punës ka mbajtur një prirje rënëse të shkallës së papunësisë, shoqëruar me një rritje të nivelit të përgjithshëm të punësimit. Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet mesatarisht me 0.3% në vit gjatë periudhës 2024–2026. Norma më e lartë e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore pritet të jetë nxitësi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë me ofertën agregate të aktivitetit ekonomik. Prandaj, shërbimet pritet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë se sa pjesa tjetër e sektorëve të ofertës ekonomike. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në periudhën afatmesme, sërish produktiviteti i

përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe. Papunësia pritet të vazhdojë një ulje graduale deri në 9.5% në vitin 2026.

VIII. Qeverisja fiskale dhe qëndrueshmëria e financave publike

Zbatimi i reformës së MFP-së shërben si udhërrëfyes për Shqipërinë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë së reformës së MFP-së është të arrijë një buxhet më të balancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të reduktuar të borxhit përmes menaxhimit financiar më të fortë dhe proceseve të kontrollit dhe auditimit dhe ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë.

Ky dokument strategjik në fushën e menaxhimit të financave publike shërben si një udhërrëfyes në:

- Reduktimi i borxhit publik;
- Shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve të prapambetura;
- Mobilizimi i vazhdueshëm i mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe doganore;
- Përmirësimi i projekteve të investimeve publike, përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe koncesionet;
- Sigurimi i një lidhjeje më të mirë ndërmjet politikave strategjike dhe Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Një angazhim më i strukturuar dhe në kohë me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit;
- Rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të KLSH-së.

MF i ka dhënë një fokus të veçantë reformës së MFP-së, duke filluar me formulimin e Strategjisë së MFP-së, zbatimin e reformës ndër vite, monitorimin dhe raportimin dhe vlerësimin. Që nga miratimi i strategjisë së MFP-së në vitin 2019, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash për të mundësuar një buxhet më të balancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të reduktuar të borxhit nëpërmjet kontrollit dhe menaxhimit më të fortë financiar, si dhe përmes proceseve të auditimit, ku zbatimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë. Gjatë kësaj periudhe, një numër i madh i këtyre reformave janë zbatuar dhe arritur. MF ka krijuar një dialog vjetor për politikat e MFP-së të udhëhequr nga qeveria me të gjithë aktorët përkatës, përfshirë BE-në, institucionet financiare ndërkombëtare (IFN-të) kryesore dhe vendet partnere, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

Raporti Vjetor i Progresit të MFP-së ofron një vlerësim të kritereve të pranueshmërisë së MFP-së për Bashkimin Evropian (BE) për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe përkatës për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Strategjia e re e MFP u miratua me VKM-në nr. 390, datë 12.6.2024, dhe është botuar në Fletoren Zyrtare më 26.6.2024[106]. Strategjia e miratuar është publikuar edhe në faqen e MF-së[107]. Ky dokument përcakton drejtimet dhe prioritetet për të garantuar një sistem të financave publike që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin dhe barazinë në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik, dhe që siguron një integrim të lehtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Plani i veprimit të MFP 2023–2026 mbulon edhe vitin 2023, për të cilin MF-ja po harton raportin e monitorimit për vitin 2023. Raporti i miratuar i monitorimit do të publikohet në faqen e internetit të MF-së.

Vazhdimi i reformave të MFP-së është thelbësor për të rritur efektivitetin e shpenzimeve buxhetore dhe për të krijuar një mjedis më produktiv për shpenzime në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Strategjia do të mbulojë periudhën 2023-2030, në koordinim dhe harmonizim në kohë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), e cila është e përafruar me Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Strategjia e MFP-së do të ketë planin e saj të veprimit, që mbulon një periudhë 3-vjeçare, duke përfshirë aktivitete afatshkurtra dhe produkte me afat kohor. Strategjia e re e MFP 2023–2030 do të marrë në konsideratë zhvillimet dhe progresin që rezulton nga zbatimi i strategjisë së MFP 2019–2022 dhe reformat përkatëse të kryera, por gjithashtu do të adresojë mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë, si dhe sfidat e hasura, të cilat kanë penguar

[106] https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/105/d896de92-1aea-4d73-991e-7a99cfeb934f
[107] https://financa.gov.al/en/menaxhimi-i-financave-publike/

zbatimin e masave të planit të veprimit të MFP-së. Gjithashtu, strategjia e re do të marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit në fushën e financave publike, si ato kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare, të vlerësuara për t'u adresuar në planin e veprimit të MFP. Tri fazat që udhëhoqën përgatitjen e strategjisë së re të MFP-së ishin: faza I - Hartimi, konsultimi dhe miratimi i dokumentit të "listës së sfidave"; faza II – Hartimi dhe kostimi i Strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike; Faza III – Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike.

B. TRANSPARENCA BUXHETORE

Shqipëria prodhon dhe publikon të 8 dokumentet kryesore buxhetore të klasifikuara si të domosdoshme në kuadrin e transparencës.

1. Dokumenti parabuxhetor[108]: Është miratuar dhe publikuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, i cili është organizuar në një mënyrë më miqësore për përdoruesit. Dokumenti i PBA-së prezantoi një përmbledhje të shkurtër të objektivit të politikës afatmesme për secilën ministri të linjës, për sa i përket kostos dhe rezultateve të parashikuara. Pjesë e dokumentit të PBA-së është edhe një aneks ku janë paraqitur pikëpamjet dhe opinionet e shoqërisë civile për buxhetin afatmesëm, gjatë konsultimit publik të tij.

2. Propozimi i Buxhetit të Ekzekutivit: Paketa e projektligjit të buxhetit 2024[109] përgatitet nga Ministria e Financave dhe përmban informacion të strukturuar mbi situatën ekonomike të vendit dhe krahasimin me vendet e rajonit; treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë për tre vjetët e ardhshëm buxhetore; të ardhurat e planifikuara sipas llojit dhe si do të ndikojnë në arritjen e objektivave të politikës qeveritare; shpenzimet tatimore të shpjeguara; shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit funksional, klasifikimit ekonomik, programit dhe klasifikimit të burimit të financimit; buxhetin vendor; analizën e nivelit të borxhit, përbërjes së tij sipas burimit të financimit dhe nivelit të garancive; detyrimet kontingjente dhe masat e mundshme; minimizon riskun buxhetor ekstra/informacionin e Partneritetit Publik Privat (PPP) mbi risqet aktuale dhe të planifikuara për t'u marrë, pagesat vjetore përkatëse nga buxheti i shtetit etj.

3. Buxheti i Qytetarit: Buxheti i Qytetarit për vitin 2024[110] është përgatitur nga Ministria e Financave dhe është publikuar në të njëjtën kohë kur paketa e projektligjit të buxhetit për vitin 2024 është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave. Për përgatitjen e këtij dokumenti, është siguruar mbështetje nga UN Women Albania.

4. Buxheti i miratuar: Ministria e Financave publikon projektpropozimin e buxhetit vjetor[111], si dhe versionin e miratuar i tij, që hyn në fuqi më pas. Gjatë vitit buxhetor, zakonisht në mes të vitit, por jo vetëm, si dhe lidhur ngushtë me dinamikën specifike të vitit fiskal, MF-ja vlerëson nevojën për një rishikimin përfundimtar të buxhetit. Këto vlerësime konsistojnë në analizimin e ecurisë së disa treguesve fiskalë për të garantuar qëndrueshmërinë e parametrave makroekonomikë.

Raportet që përgatiten dhe publikohen, në kuadër të transparencës buxhetore, konsistojnë në: raportet vjetore[112]; raportet mujore për pagesat e kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore[113]; raportet tremujore të performancës financiare dhe jofinanciare të NSH-ve kryesore[114]; Raportet tremujore mbi monitorimin e detyrimeve të prapambetura [115]; raportet e monitorimit të performancës

---

[108] Ky dokument dhe të gjitha anekset mund të shkarkohen në linkun e mëposhtëm: https://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2024-2026-faza-iii/

[109] Draftpaketa vjetore është publikuar në faqen e Ministrisë së Financave në linkun: https://financa.gov.al/projektbuxheti-2024/

[110] Dokumenti mund të aksesohet në linkun: https://www.financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit-2/

[111] Me miratimin e një ligji për rishikimin e buxhetit, MF e publikon paketën e plotë të tij në faqen zyrtare të internetit, e cila mund të gjendet në linkun e mëposhtëm: https://arkiva.financa.gov.al/buxheti-ne-vite/. Konkretisht, për vitin fiskal 2023, paketat përkatëse të ligjit origjinal për buxhetin dhe rishikimet e tij mund të gjenden në linkun e mëposhtëm: https://arkiva.financa.gov.al/per-buxhetin-e-vitit-2023/. Paketën e plotë të buxhetit të miratuar për vitin 2024 mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://financa.gov.al/buxheti-2024/

[112] https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/

[113] Raportet shpalosen/përfshihen në të gjitha dokumentet periodike buxhetore të MF-së, si Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Raporti i Mesvitit dhe Propozimi për Buxhetin Vjetor.

[114] Raportet shpalosen/përfshihen në të gjitha dokumentet periodike buxhetore të MF-së, si Raporti i Zbatimit të Buxhetit Vjetor, Raporti i Mesëm Vjetor dhe Propozimi i Buxhetit Vjetor.

[115] link: https://arkiva.financa.gov.al/shlyerja-e-detyrimeve-te-prapambetura/

buxhetore të bazuara në katër muaj[116]; raporti gjashtëmujor[117] , raporti mbi zbatimin e buxhetit vjetor[118] , raport auditimi[119].

C. PROGRESI KRYESOR NË REFORMAT E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE (MFP)

Për sa i përket "Programimit makroekonomik të matur dhe realist", për periudhën e kërkuar, shtator 2023–mars 2024, të gjitha pritshmëritë janë përmbushur, pasi ato janë materializuar në dy dokumentet më të rëndësishme, si "Kuadri makroekonomik dhe fiskal 2025-2027", miratuar në janar të vitit 2024 dhe "Programi i Reformës Ekonomike 2024-2026", miratuar gjithashtu në janar 2024.

Në përputhje të plotë me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Organik i Buxhetit (LOB) Nr. 9936/2008, i ndryshuar, kuadri fiskal për periudhën 2024–2026 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

Projeksione të matura makroekonomike: Vlera nominale e PBB-së në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin paraardhës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera përkatëse e parashikuar ose e vlerësuar në raportin e FMN-së: "Perspektiva Ekonomike Botërore", që publikohet në kohën kur ligji i buxhetit vjetor kalon për miratim në Kuvend. Kjo është e dokumentuar qartë në raportin shoqërues të ligjit të buxhetit vjetor.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, kuadri 2024–2026 mbështetet në projeksionet nominale të PBB-së në vijim, të cilat nuk janë më të larta se parashikimet e Raportit të Perspektivës Ekonomike Botërore të FMN-së, publikuar së fundmi në tetor 2023.

Është bërë progres në disa fusha, të cilat përfshijnë:

Në përgatitjen e Deklaratës së Riskut Fiskal (DRF) si një dokument më vete, Viti Fiskal 2023 (VF2023) ka qenë një vit pilot në këtë kontekst, duke shërbyer si një periudhë pune në kuadër të koordinimit dhe konsolidimit të informacionit të ofruar nga të gjitha njësitë raportuese. Departamenti për Çështjet Fiskale (DÇF) i asistencës teknike të FMN-së ofroi mbështetje të mëtejshme në një çështje më praktike; në përgatitjen e draftit të parë të dokumentit pilot të DRF-së. DRF-ja e parë si dokument zyrtar do të finalizohet në fund të majit 2024. Sipas udhëzimit nr. 35, i datës 29.12.2022, dokumenti do t'i paraqitet për informim Këshillit të Ministrave dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Për sa i përket menaxhimit të investimeve publike, ndryshimet e reja, të futura në procesin e menaxhimit të investimeve publike, me miratimin e VKM-së nr. 887, datë 27.12.2022, "Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike", synojnë të rrisin përputhshmërinë ndërmjet objektivave strategjikë të vendit dhe prioriteteve të qeverisë me procesi i PBA-së. Procesi i ri ka filluar të zbatohet nga muaji mars i vitit 2023 dhe pasohet nga miratimi i parë zyrtar i Listës Kombëtare Unike të Projekteve (NSPP[120]/LKUP) me VKM-në nr. 447, datë 26.7.2023 për "Dokumentin e politikave prioritare 2024–2026".

Administrata Tatimore ka ndjekur një qasje të re për riskun e pajtueshmërisë, duke u fokusuar në identifikimin mujor të risqeve dhe trajtimin e tyre bazuar në vendimmarrjen e Komitetit të Riskut. Qasja e Administratës Tatimore është ndërgjegjësimi i tatimpaguesve për respektimin vullnetar duke forcuar urat e bashkëpunimit me tatimpaguesit dhe duke minimizuar kontrollet vetëm për rastet e vlerësimit me rrezikshmëri të lartë. Gjatë vitit 2023 janë mbajtur 14 mbledhje të Komitetit të Riskut dhe janë trajtuar mesatarisht 8-9 dukuri. Shtyllat në të cilat është përqendruar puna janë gjithashtu shtyllat kryesore të draftit të SAA-së, si më poshtë:

Ulja e hendekut të përputhshmërisë në lidhje me TVSH-në. Komiteti i Riskut është krijuar për zbatimin me efikasitet maksimal të kësaj mase duke ekzaminuar çdo muaj dukuri të caktuara të riskut dhe duke identifikuar tatimpaguesit më të rrezikshëm përmes kombinimit të informacioneve dhe analizave të ndryshme. Fokusi ynë në të ardhmen do të mbetet te të ardhurat nga TVSH-ja, duke i dhënë prioritet sektorëve kyç si turizmi, si dhe rritjen e regjistrimit të TVSH-së.

---

[116] https://financa.gov.al/raporte-monitorimi/

[117] Raporti gjashtëmujor mund të gjendet në linkun e mëposhtëm: https://arkiva.financa.gov.al/buxheti-ne-vite/. Për VF2023, Raporti i Mesvitit mund të gjendet në linkun e mëposhtëm: https://financa.gov.al/raporti-i-mesvitit-2023/

[118] https://arkiva.financa.gov.al/buxheti-faktik-nder-vite/

[119] https://www.klsh.org.al/content_pdf/18

[120] Lista Kombëtare Unike e Projekteve (LKUP) – National Single Project Pipeline (NSPP).

Reduktimi i punës së padeklaruar, nëndeklarimi dhe reduktimi i pagesave me para në dorë në ekonomi; Administrata tatimore është fokusuar te informaliteti në tregun e punës nëpërmjet katër formave: mosregjistrimit të punonjësve, deklarimit të gabuar të pagave, deklarimit të gabuar të orarit të punës, deklarimit të gabuar të kategorisë dhe profesionit të punësimit.

Ulja e evazionit fiskal; Strukturat në terren janë angazhuar për verifikimin dhe identifikimin e tatimpaguesve në përputhje me Planet Operacionale që miratohen nga Komiteti Operativ dhe Komiteti i Riskut në DPT. Objektivi kryesor i punës së tyre është parandalimi, ndërgjegjësimi, identifikimi dhe lufta kundër paligjshmërisë në fushën tatimore dhe marrja e masave të duhura administrative kundër shkeljeve tatimore.

Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit në administratën tatimore; Nga marsi i vitit 2023 është bërë i mundur deklarimi automatik i librave të shitjes dhe blerjes nga Sistemi i Fiskalizimit në sistemin C@TS, duke ulur në zero kohën dhe duke maksimizuar cilësinë dhe saktësinë e deklarimit për tatimpaguesit. Ne po punojmë për të arritur paraplotësimin automatik të deklaratës së TVSH-së, duke automatizuar procesin e faturimit dhe deklarimit 100% të TVSH-së dhe parapërfundimin e deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale, duke përparuar me pajtueshmërinë e bazuar në sistem. Për sa i përket procesit të rimbursimit, koha mesatare e rimbursimit është reduktuar nga 45 ditë në vitin 2022 në 42 ditë aktualisht, me synim uljen më të madhe të saj.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore. Kjo nismë synon të shtojë më tej gatishmërinë, cilësinë, transparencën e shërbimit publik, reduktimin e kohës dhe kostove të proceseve administrative, mbrojtjen e të dhënave private bazuar në legjislacionin aktual. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ofron shërbime të shumta nëpërmjet portalit *e-Albania,* duke u mundësuar individëve dhe tatimpaguesve aksesin në mënyrë efikase në shërbimet e nevojshme, duke kursyer kohë, burime dhe shpenzime administrative. Kjo platformë *online* ofron 31 shërbime, duke përfshirë 14 për pagesat e taksave *online*. Kalimi në shërbimet *online* ka rritur ndjeshëm aplikimet e shërbimit në rreth 3.2 milionë.

Në kuadër të reformës për modernizimin dhe forcimin e sistemit të taksimit të pasurive të paluajtshme, Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe me mbështetjen e projektit "ProTax Albania", kanë hartuar projektligjin, "Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme". Ky projektligj do të vendosë taksën mbi pasurinë e paluajtshme në bazë të vlerës së tregut sipas një metodologjie të mbështetur në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe konceptet/elementet e vlerës së tregut.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) 2022–2026 është përgatitur, miratuar nga Këshilli i Ministrave në korrik të 2022 dhe publikuar në faqen e MF-së. Strategjia e re, e cila shtrihet në një afat kohor pesëvjeçar, përcakton objektiva të reja që duhet të arrihen në fund të harkut kohor të Strategjisë.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2023 është përgatitur Raporti i Monitorimit të Strategjisë për vitin 2022 dhe është publikuar në faqen e internetit të ministrisë. Gjithashtu, raporti për vitin 2023 është përmbyllur zyrtarisht dhe është publikuar në faqen e Ministrisë. Viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv për sigurimin e financimit, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Treguesit e riskut kanë treguar përmirësim në të gjitha kategoritë krahasuar me fundin e vitit 2022, si dhe janë përmirësuar në krahasim me vitin bazë të strategjisë, vitin 2021.

Një nga objektivat kryesorë të SAMB-së është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk pasi përbëhet nga instrumente me maturim të gjatë dhe profile amortizimi të zgjatura në kohë. Gjatë vitit 2023, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, Ministria e Financave ka rritur peshën e emetimeve afatmesme dhe afatgjata të instrumenteve në tregun vendas dhe si rrjedhojë, treguesit e riskut të rifinancimit kanë treguar një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me fundin e vitit 2022, si dhe kanë shfaqur përmirësim në krahasim me vitin bazë të Strategjisë (viti 2021). Konkretisht, periudha mesatare e maturimit të borxhit të brendshëm është rritur me 55 ditë, nga 780 ditë në fund të vitit 2022 në 835 ditë në fund të vitit 2023; ndërsa krahasuar me fundin e vitit 2021 ky tregues është rritur me 42 ditë (ATM në fund të vitit 2021: 793 ditë).

Gjithashtu, pjesa e borxhit që maturohet brenda një viti është ulur nga 47,9% në dhjetor të vitit 2022 në 44.7% në dhjetor të vitit 2023. Në të njëjtën kohë, ky tregues është përmirësuar në krahasim me vitin bazë të SAMB-së, që në fund të vitit 2021 ishte 46.6%.

Risku i normës së interesit është përmirësuar edhe gjatë vitit 2023, kjo në kushtet e rritjes së përdorimit të letrave me vlerë afatmesme dhe afatgjata si dhe rezultat i emetimeve vetëm me norma fikse interesi në tregun vendas. Konkretisht, pjesa e totalit të borxhit që fikson normën e interesit brenda një viti është ulur ndjeshëm nga 49.0% në fund të vitit 2022 në 45.4% në fund të vitit 2023. Edhe ky tregues ka shënuar përmirësim në krahasim me vitin bazë të SAMB-së, që u vlerësua në nivelin 48.0 %.

Për të dytin vit radhazi Ministria e Financave hartoi dhe publikoi në dhjetor të vitit 2023 planin vjetor të Huamarrjes për vitin e ardhshëm, konkretisht vitin 2024. Plani vjetor i Huamarrjes për vitin 2024 synon të mbështesë aktivitetin vjetor huamarrës të Ministrisë së Financave, si dhe të rrisë transparencën dhe parashikueshmërinë ndaj investitorëve dhe palëve të treta të interesuara.

Për sa i përket krijimit të kuadrit ligjor IPA III për periudhën 2021–2027, fondet IPA po mbështesin procesin e integrimit të Shqipërisë në BE në përputhje me Kuadrin e Programimit IPA III. Korniza e Programimit IPA III përbëhet nga pesë dritare dhe 17 prioritete tematike që rregullojnë alokimin e fondeve të BE-së në fusha specifike të politikave. IPA III, është ratifikuar me ligjin nr. 65/2022. Në bazë të këtij ligji, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të BE-së sipas Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit 2021–2027" (IPA III), ka përcaktuar funksionet dhe përgjegjësitë për menaxhimin indirekt të asistencës IPA III.

Vendimi, i cili përcakton strukturat dhe autoritetet dhe vendos marrëdhëniet e ndërsjella për menaxhimin indirekt të asistencës financiare në kuadër të programeve vjetore dhe shumëvjeçare, që Bashkimi Evropian i ka besuar Republikës së Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit (IPAIII) (2021–2027), u botua në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 22.9.2023, duke hyrë menjëherë në fuqi. Vendimi ka nenin 14, "Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së", ku parashikohet e gjithë dispozita.

- Marrëveshja Financiare IPA 2022, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni Evropian (KE), në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2022, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit. (IPA III), është miratuar brenda vendit me VKM nr.165, datë 24.3.2023.

- Marrëveshja financiare për Programin Kombëtar IPA 2023, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2023, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit (IPA III) është miratuar me VKM-në nr. 166, datë 24.3.2023, duke mundësuar fillimin e zbatimit të kësaj pakete financiare.

- Më 8 nëntor 2023 u konfirmuan nga KE 5 Dokumentet e Veprimit, që do të financohen nga programi kombëtar IPA 2024, në vlerën totale (67.35 milionë euro).

- Nëntor 2023. I kërkohet të Besuarit zbatimi i detyrave të buxhetit për IPA 2022, sipas nenit 13 të FFPA për Programin IPA III, të cilat dorëzohen në 15 nëntor 2023 nga NAO.

- Programet Operative 2024–2027.

Shqipëria ka aplikuar për herë të parë në IPA III për programet shumëvjeçare, të ashtuquajturat Programe Operacionale, një nga synimet kryesore të të cilave është përgatitja e vendit për programimin, zbatimin dhe menaxhimin e fondeve strukturore, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

D) Transparenca e Financave Publike Gjatë vitit 2023 është bërë progres i dukshëm me zhvillimin e kapaciteteve programore për përgatitjen e Programeve Operative shumëvjeçare. Në qershor të vitit 2023, tri programe operacionale shumëvjeçare iu dorëzuan Komisionit Evropian për t'u financuar nga Bashkimi Evropian për periudhën 2024–2027, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III). Tri programet operacionale janë, si më poshtë: a) Programi Operacional i BE-së për Punësimin e Rinisë 2024–2027; b) Programi Operacional për Energjinë 2024–2027; c) Programi Operacional për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale 2024–2027, të cilat do të bashkëfinancohen nga qeveria shqiptare.

Zbatimi i këtyre Programeve Operacionale do të kombinojë një sistem kontrollesh paraprake dhe të mëvonshme nga Delegacioni i BE-së. Kjo qasje synon të përshpejtojë konvergjencën e strukturave

aktuale të IPA-s me sistemet administrative të shteteve anëtare të BE-së, që marrin fonde nga fondet strukturore dhe Fondi i Kohezionit Evropian. Në këtë aspekt, ato mund të përfaqësojnë një hap të mëtejshëm në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Për sa i përket hartimit dhe zbatimit të rregulloreve, procedurave për menaxhimin e IPA III, rritjes së kapaciteteve të strukturave të IPA III, strukturat dhe autoritetet IPA do të mbështeten nga dy projekte: 1. Mbështetje për Menaxhimin e Asistencës Financiare të BE-së në Shqipëri; dhe 2. Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore në Shqipëri, për përgatitje dhe negociata efikase dhe të lehta me BE-në. Lista e trajnimeve të detyrueshme do të identifikohet duke organizuar një fokus grup me strukturat dhe autoritetet e IPA-s.

Në lidhje me përmirësimin e cilësisë së raporteve të auditimit, të përshtatura sipas kërkesave të lexuesve të tij dhe zgjerimin e përdorimit të të gjitha mjeteve të komunikimit për të promovuar në vazhdimësi rolin e KLSH-së, KLSH-ja hartoi dhe miratoi Udhëzuesin për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë, dhe ka përmirësuar dukshëm vizualizimin e Buletineve Statistikore dhe raporteve të tjerë të KLSH-së.

Në strategjinë e MFP-së 2014–2020 dhe në strategjinë e MFP 2019–2022 transparencës iu dedikua një seksion specifik. Objektivi specifik i "Transparencës së Financave Publike" kishte për qëllim përmirësimin e mbulimit, cilësisë dhe aksesit të informacionit mbi financat publike. Pasqyrë e përgjithshme e arritjeve dhe sfidave kryesore të transparencës së financave publike paraqitet si më poshtë:

Për sa u përket **Llogarive Financiare Kombëtare**, forcimi i sistemeve dhe kapaciteteve për përgatitjen e statistikave financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare ishte në fokusin kryesor që nga fillimi i Strategjisë. Gjatë vitit 2017, për herë të parë INSTAT-i përpiloi dhe transmetoi Statistikat e Financave të Qeverisë (SFQ) për llogaritë jofinanciare për sektorin e qeverisjes së përgjithshme në vijim të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). INSTAT publikon çdo vit Listën e Institucioneve Publike, të cilat klasifikohen brenda Sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme S.13. Kjo listë përditësohet dhe miratohet çdo vit nga tri institucionet e përfshira: INSTAT-i, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Lista përfshin të gjitha institucionet e sektorit publik që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore, gjithashtu Korporatat Financiare Publike dhe Korporatat Publike Jofinanciare që janë në pronësi të subjekteve publike. Gjatë muajit nëntor 2019, u publikua "Harmonizimi i Politikave Revizionuese për Statistikat Makroekonomike" nga INSTAT-i, që bazohet në Politikën e Harmonizuar të Rishikimit Evropian (HERP) dhe manuale të tjera të publikuara nga EUROSTAT-i, që përcaktojnë politikat që duhen ndjekur nga institutet statistikore të vendeve të ndryshme për të bërë statistika të krahasueshme me vendet e tjera. Që nga viti 2021, INSTAT-i ka përdorur sistemin IT të zhvilluar për përpilimin e statistikave GFS dhe EDP. Duke përdorur Sistemin e ri të Përpilimit të Integruar të GFS Shqiptare (AIGCS), 5 tabela GFS iu transmetuan EUROSTAT-it. Duke përdorur të njëjtin sistem, tabelat EDP përpilohen dhe i transmetohen Eurostatit dy herë në vit (fundi prill/fundi tetori).

Për sa i përket **Raportimit dhe Monitorimit të Performancës Financiare Publike**, sipas Anketës së Buxhetit të Hapur të vitit 2017, që nga viti 2015 Shqipëria ka rritur: a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor të dhënë në raportin e auditimit dhe në deklaratën parabuxhetore; dhe b) numrin e raporteve të publikuara të zbatimit të buxhetit. Gjithashtu, procedurat për zbatimin e buxhetit brenda vitit janë përmirësuar dhe në faqen e MF-së është publikuar raporti gjashtëmujor i Performancës Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore të qeverisë, për herë të parë në vitin 2017. Shqipëria u përmirësua pak më tej në Anketën e Buxhetit të Hapur të vitit 2019, pasi ajo ka publikuar edhe Rishikimin gjashtëmujor në internet. Modelet dhe përmbajtja e raporteve të zbatimit të buxhetit vjetor të qeverisë u rishikuan gjatë vitit 2019. Në vitin 2020, u zhvilluan sesione pune me menaxherin e programit dhe Departamentet e Financave të dy ML-ve me qëllim përmirësimin e modeleve të zbatimit të buxhetit vjetor brenda vitit. Për më tepër, AFMIS është në funksion në të gjitha ML-të dhe institucionet buxhetore dhe të dhënat përkatëse janë ngarkuar në sistem. Një format i ri për Raportin e Zbatimit të Buxhetit Vjetor është hartuar dhe zbatuar gjatë vitit 2021, duke përfshirë Indikatorët Kyç të Performancës (KPI), që janë në përputhje me AFMIS dhe informacionin financiar. Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit (DMB) ka ndjekur disa seanca testimi në vend, përkatësisht në disa ML, për të monitoruar performancën e Modulit BPPM[121]. Si rezultat, janë ngritur disa problematika, kështu që njësitë përgjegjëse

[121] BPPM – Budget Performance and Programing Module.

dhe kompania projektuese janë informuar për mospërputhje të raporteve të gjeneruara nga moduli BPPM i sistemit AFMIS.

Për sa i përket **Angazhimit të Qytetarëve**, vlerësimi për vitin 2019 nga Indeksi i Buxhetit të Hapur (IBH), lidhur me ofrimin e mundësive formale për publikun për t'u përfshirë në procesin buxhetor dhe pjesëmarrja e publikut, për Shqipërinë u vlerësua me 7/100 pikë. Në vitin 2021 pjesëmarrja e publikut për Shqipërinë u vlerësua me 6/100. Është përgatitur dhe zbatuar një kalendar i dëgjesave për proceset kryesore buxhetore. Gjithashtu, është zhvilluar dhe publikuar një udhëzues për buxhetin e qytetarit për vitet 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023. Gjithashtu gjatë viteve 2019-2021 janë ofruar trajnime për OSHC-të për të rritur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin buxhetor. Por gjatë vitit 2022 nuk janë ofruar trajnime për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve njerëzore.

Për sa i përket **kontabilitetit,** u finalizua analiza krahasuese (Analiza e mangësive) ndërmjet kuadrit ligjor aktual në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) dhe gjetjet u prezantuan në një seminar në maj të vitit 2017. Bazuar në analizën e mangësive, Qeveria miratoi një Plan Veprimi Strategjik të vendit për kalimin në SNKSP në tetor të vitit 2019. Gjithashtu, u krijua një funksion specifik në kuadër të DPPMFK-së dedikuar kontabilitetit për të qenë përgjegjës për përditësimin e metodologjisë së kontabilitetit të sektorit publik si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin privat. Gjatë viteve 2021-2022 është bërë njëfarë progresi në lidhje me lëvizjen me faza bazuar në kontabilitetin *"accrual"*. Objektivi përfundimtar strategjik është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP-të e përzgjedhura. Objektivat që synojnë të përmirësojnë kuadrin rregullator të kontabilitetit dhe të përmirësojnë AGFIS-in për të regjistruar të dhënat e kontabilitetit "*accrual*" nuk u arritën në vitin 2021. Edhe pse janë kryer disa aktivitete si analiza e mangësive të standardeve kombëtare të kontabilitetit në krahasim me SNKSP-në, raporti që vlerëson ndikimin sasior për zbatimin e secilit SNKSP individualisht është ofruar nga konsulenti. Gjithashtu, janë ofruar disa draftudhëzime kontabël në lidhje me elemente të ndryshme të pasqyrave financiare, që do të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në SNKSP.

Gjatë vitit 2022, konsulenti i përzgjedhur nga MFE-ja në bashkëpunim me stafin e MFE-së, ka mundësuar hartimin e akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit, bazuar në analizën e mangësive të kryera nga ky konsulent. Gjatë kësaj periudhe u finalizuan: 1. Udhëzime të detajuara kontabël në lidhje me: i. raportimin dhe paraqitjen; ii. Konsolidimin; iii. të ardhurat; iv. pronën dhe pajisjet; v. aktivet jomateriale; vi. Inventarin; vii. instrumentet financiare; viii. kontabiliteti "*accrual*" dhe shpenzimet; ix. Provizionet; x. përfitimet nga përdorimi. 2. Rishikimi i procesit të biznesit, i cili përfshin rishikimet e propozuara të proceseve të biznesit përmes një dizajni procesi në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare, që mundëson përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat në udhëzimet e reja të kontabilitetit. 3. Analiza e mangësive të grafikut kontabël dhe skema e llogarive të përshkruara për të përmbushur kërkesat e SNKSP-së. 4. Një analizë sesi procesi buxhetor në Shqipëri mund të përfitojë nga informacioni i nxjerrë nga pasqyrat e SNKSP-së. 5. Rekomandime për të përmirësuar funksionalitetet e AGFIS-it për të përmbushur nevojat shtesë të të dhënave të identifikuara për secilën nga dhjetë fushat e kontabilitetit; 6. Përfundimi i punës së madhe në terren për pilotimin e udhëzimeve të kontabilitetit në 7 institucione të përzgjedhura; 7. Rekomandime për raportimin financiar të shtetit dhe qeverisë. 8. Një pasqyrë e rolit të NJQH[122] dhe Thesarit në raportimin kontabël dhe financiar, strukturën, përshkrimet e punës dhe rekomandimet për përmirësim. 9. Pilotimi i këtij kuadri rregullator në 7 institucione të sektorit publik në përgatitjen e pasqyrave financiare. Gjatë vitit 2023 është hartuar koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO. Një objektiv kryesor i kësaj faze të dytë të projektit është miratimi i ligjit të kontabilitetit të sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP.

Sa i përket **Menaxhimit të Aseteve**, zhvillimi i metodologjisë për njohjen e aseteve nuk ishte finalizuar siç ishte planifikuar për periudhën 2020–2022. Tri institucione buxhetore (IB), konkretisht Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë futur inventarin e aseteve në modulin e aseteve gjatë vitit 2020 dhe kanë trajnuar 6 anëtarë të stafit të këtyre IB-ve, për vitin 2021 nuk është bërë asnjë progres, ndërsa gjatë vitit 2022 dy IB, konkretisht Bashkia e

[122] Njësia Qendrore e Harmonizimit (CHU – Central Harmonizing Unit).

Tiranës dhe Ministria e Drejtësisë kanë futur inventarin e aseteve në modulin e aseteve dhe kanë trajnuar 6 punonjës të këtyre IB-ve. Objektivi përfundimtar strategjik i reformës është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP-të e përzgjedhura. Pas finalizimit të fazës së parë të projektit të kontabilitetit të sektorit publik në dhjetor 2022, koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO, është hartuar gjatë vitit 2023. Një objektiv kryesor i kësaj faze të dytë të projektit është miratimi i ligjit të kontabilitetit të sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP-të sipas planit. Pjesë e këtij kuadri rregullator të përditësuar është edhe metodologjia në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të sektorit publik. Kjo fazë e dytë do të nisë gjatë vitit 2024.

Për sa i përket **Transparencës së Financave Publike**, sfidat kryesore lidhen me: Komponentin e menaxhimit të aseteve pasi Institucionet Buxhetore të lidhura *online* me AGFIS-in nuk kanë përgatitur inventarin e aseteve për t'u integruar në AGFIS; Zhvillimi i metodologjisë për njohjen e pasurisë nuk përparoi siç ishte planifikuar; përgatitjen e formateve të reja të Udhëzuesit për anekset e monitorimit të buxhetit, që përfshijnë KPI-të; përmirësimin e kuadrit rregullator të kontabilitetit dhe përmirësimin e AGFIS-it për të regjistruar të dhënat e kontabilitetit *"accrual";* Gjatë vitit 2022 për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve njerëzore nuk janë ofruar trajnime për ciklin buxhetor.

Fokusi në të ardhmen (strategjia e MFP-së 2023–2030). Në strategjinë e re të MFP-së, nuk ka një seksion të dedikuar për transparencë, por komponentët që kanë të bëjnë me financat publike janë ende pjesë e seksioneve të ndryshme të strategjisë. Në këtë drejtim, prioritetet kryesore për të ardhmen janë:

- Rritja e dokumentacionit buxhetor dhe në veçanti elementi i informacionit të performancës;
- Përmirësimi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit dhe prezantimi i raportit të zbatimit të buxhetit të qytetarit;
- Përmirësimi i mëtejshëm i statistikave GFS dhe EDP me standardet e BE-së;
- Rritja e aksesit dhe shfrytëzimit të AGFIS-it; Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për reformat në kontabilitetit;
- Përmirësimi i funksionaliteteve të AGFIS-it për të përvetësuar reformat e kontabilitetit;
- Përgatitja, ofrimi dhe institucionalizimi i zhvillimit të kapaciteteve të kontabilistëve për të përvetësuar reformat e kontabilitetit.

Deklarata e Riskut Fiskal, NSH, PPP, Strategjia Kundër Mashtrimit

Procesi i menaxhimit të rrezikut fiskal në Shqipëri është përmirësuar vazhdimisht që nga viti 2016, me krijimin e Njësisë së Riskut Fiskal (NJRF). NJRF-ja është e fokusuar në monitorimin e detyrimeve të prapambetura, monitorimin dhe raportimin e pagesave aktuale dhe të planifikuara për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, monitorimin e detyrimeve kontingjente për vendimet gjyqësore (të arbitrazhit dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), vlerësimin e risqeve që vijnë nga ndërmarrjet shtetërore. Gjatë viteve të fundit janë bërë disa përmirësime në drejtim të forcimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore (NSH), përmes zgjerimit të monitorimit të NSH-ve duke përfshirë, Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizimeve dhe ndërmarrjeve të tjera shtetërore që mund të kenë ndikim në buxhet. Më tej, me nënshkrimin e urdhrit të përbashkët të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe ministrit të Financave (MF), nr. 304 datë 17.12.2020, "Për miratimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike", si dhe urdhrit të përbashkët nr. 304 të MIE-s dhe MF-së, datë 30.9.2021, "Për zbatimin e planit të masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike", NjRF mbledh informacion rregullisht çdo muaj në lidhje me raportimin dhe qartësimin e detyrimeve reciproke që kanë ndërmarrjet shtetërore të sektorit të energjisë; me njëri-tjetrin dhe me subjektet e tjera shtetërore (Ujësjellësi, DPT etj.), modalitetet e të cilave përfshihen në udhëzimin buxhetor suplementar të ministrit të Financave. Shtrirja e risqeve fiskale që po monitorohen dhe raportohen është rritur gradualisht dhe përfshin aktualisht risqet që lidhen me borxhin, zhvillimet makroekonomike, NSH-të, PPP-të dhe kontratat koncesionare, detyrimet e prapambetura, të ardhurat, pushtetin vendor, procedurat ligjore dhe çështjet gjyqësore. Parashikohet përmirësimi i cilësisë dhe zgjerimi i fushës së menaxhimit të riskut fiskal, për shembull duke përfshirë gradualisht në kuadrin e monitorimit risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Në lidhje me zhvillimin, pilotimin dhe publikimin e Pasqyrës Vjetore të Riskut Fiskal çdo vit, në vitin 2023 është hartuar Pasqyra e parë e Risqeve Fiskal (për vitin 2022). Viti fiskal 2023 ishte një vit pilot në

këtë kontekst, duke shërbyer si periudhë pune në kuadër të koordinimit dhe konsolidimit të informacionit të ofruar nga të gjitha njësitë raportuese.

Sektori i energjisë ka qenë dhe mbetet nën vëzhgim nëpërmjet monitorimit nga Ministria e Financave, duke marrë parasysh ndikimin e rëndësishëm fiskal dhe efektin thelbësor që ka sektori në ekonominë e përgjithshme. Ky monitorim është në zbatim të ligjit organik të buxhetit, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili kryhet periodikisht çdo tremujor. Krahas sektorit të energjisë, Ministria e Financave monitoron periodikisht çdo tremujor ndërmarrjet e tjera shtetërore, bazuar në ndikimin e tyre të mundshëm buxhetor. Që nga viti 2022, monitorimi i NSH-ve është zgjeruar përmes subjekteve të sektorit të ujësjellësit. Për më tepër, me nënshkrimin e urdhrit të përbashkët nr. 304 të MIE-s dhe MF-së, datë 17.12.2020, "Për miratimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike", si dhe urdhrit të përbashkët nr. 379 të MIE-s dhe MF-së, datë 30.9.2021, "Për zbatimin e planit të masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike". Sektori i Riskut Buxhetor (SRB) pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit/Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave mbledh çdo muaj informacion në lidhje me raportimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që kanë me njëra-tjetrën ndërmarrjet shtetërore të sektorit të energjisë, dhe me subjektet e tjera shtetërore (UU, DPT etj.), modalitetet e të cilave përfshihen në udhëzimin buxhetor suplementar të ministrit të Financave. Ministria e Financave dorëzon dhe paraqet çdo tre muaj një raport monitorimi dhe statusin e planit të veprimit për detyrimet e ndërsjella pranë Komitetit Drejtues të Programit (KDP) të krijuar në kuadër të sektorit të energjisë.

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të NSH-ve, është ofruar asistencë teknike nga Departamenti i Çështjeve Fiskale (FAD) i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) (gjatë vitit 2023 dhe në vijim) për të mbështetur më tej monitorimin e NSH-ve, përmes zbatimit dhe përdorimit të Mjetit të Kontrollit të Shëndetit të NSH-ve (HCT), në mënyrë që të zgjerohet analiza e raportimit vjetor të NSH-ve.

HCT-ja e NSH-ve është nga tani pjesë integrale e analizës së përdorur në monitorimin e NSH-ve. Të dhënat dhe rezultatet e marra nga HTC-ja e NSH-ve do të jenë, gjithashtu, pjesë e seksionit të NSH-së në dokumentin zyrtar të Deklaratës së Riskut Fiskal për vitin fiskal 2023.

Për sa i përket përafrimit të ligjit për koncesionet dhe PPP-të me *acquis*-in *e* BE-së, vitet e fundit është bërë progres i dukshëm në përafrimin e legjislacionit të prokurimit publik me direktivat e BE-së. Një nga prioritetet për periudhën 2023–2026 është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për koncesionet dhe partneritetin publik-privat. Në këtë kuadër, në strategjinë e MFP-së të miratuar së fundmi, një nga aktivitetet është përditësimi i legjislacionit për PPP-të dhe akteve përkatëse nënligjore për të siguruar monitorim dhe raportim adekuat në nivel të kontratës dhe portofolit/programit. Për sa i përket forcimit/zhvillimit të kapaciteteve të institucioneve qeveritare për monitorimin e kontratave koncesionare/PPP, është duke u hartuar ndryshimi i udhëzimit nr. 35 datë 12.12.2019, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i cili do të përfshijë tregues të ndryshëm për zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve monitoruese. Gjithashtu, ndryshimi i udhëzimit do t'i shërbejë krijimit të mekanizmave efikase në monitorimin e kontratave koncesionare/PPP, në mënyrë që risqet e palëve kontraktuese, me fokus të shtuar tek autoritetet kontraktore, të jenë sa më të ulëta për të siguruar përfitim sa më të madh nga këto kontrata. Në lidhje me plotësimin e bazës së të dhënave të kontratave të monitoruara dhe ndjekjen e procesit të monitorimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat, në lidhje me monitorimin, puna ka vijuar nga Ministria e Financave, e cila ka kërkuar raporte periodike nga Autoritetet Kontraktuese, bazuar në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 12.12.2019. Po vijon puna për krijimin e një baze të dhënash unike për krijimin e një regjistri që do t'u shërbejë funksioneve të ATRAKO-s dhe Ministrisë së Financave për vlerësimin dhe monitorimin e kontratave aktuale dhe të reja.

Për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, po konsiderohen reforma të mëtejshme për të adresuar mangësitë në sistemin e Menaxhimit të Investimeve Publike, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, përpunimin e mëtejshëm të Listës Kombëtare Unike të Projekteve. Në këtë kuadër, në Strategjinë e MFP-së të miratuar së fundmi, një nga aktivitetet është rishikimi i procedurave dhe sistemeve për zhvillimin e një Liste Kombëtare Unike të Projekteve, gjithëpërfshirëse, duke përfshirë PPP/Koncesionet, duke përfshirë udhëzime të detajuara për përgatitjen dhe vlerësimin e studimeve të fizibilitetit për të mbuluar gjithashtu pajtueshmërinë me rregullat e ndihmës shtetërore.

Projekti EU4GG TA po ndihmon Ministrinë e Financave në përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të buxhetit në përputhje të plotë me strategjinë sektoriale të MFP-së dhe planin e veprimit të miratuar së fundmi, me synimin e përgjithshëm për të përmirësuar transparencën buxhetore. Projekti do të mbështesë veçanërisht ministrinë në përmirësimin e monitorimit dhe raportimit për Projektet e Investimeve Publike (në bashkëpunim me Bankën Botërore), për PPP-të dhe kontratat koncesionare (në partneritet me FMN-në) dhe për detyrimet e prapambetura. Periudha e planifikuar e zbatimit për këtë mbështetje është nga viti 2024 deri në vitin 2026.

Projekti EU4GG TA aktualisht po ndihmon rrjetin AFCOS me formulimin e Strategjisë së parë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiarë të BE (SKKM), për Shqipërinë. SKKM-ja po zhvillohet në bazë të rregulloreve përkatëse të BE-së dhe udhëzimeve të OLAF-it. Në këtë moment është krijuar një grup pune i SKKM-së, është hartuar një dokument koncepti dhe janë mbajtur disa takime/*workshop*-e të grupeve të punës. Një pjesë integrale e SKKM-së është Vlerësimi i Riskut të Mashtrimit dhe plani i veprimit që mbulon të gjitha fazat e ciklit kundër mashtrimit. (Draft) SKKM pritet të përfundojë në tetor të vitit 2024.

Mekanizmi raportues për mbështetjen buxhetore

Ministria e Financave e Shqipërisë ka përgjegjësi të rëndësishme në menaxhimin e aspekteve financuese që lidhen me Instrumentin e Mbështetjes Buxhetore në kuadër të Asistencës së Paraaderimit (IPA). Kjo përfshin mbikëqyrjen e shpërndarjes dhe alokimit të fondeve për të mbështetur synimet e zhvillimit të Shqipërisë dhe objektivat e integrimit në Bashkimin Evropian. Mbështetja buxhetore e sektorit u prezantua përmes IPA II si një instrument i ri për lidhjen e ndihmës financiare dhe dialogun e politikave në mbështetje të reformave të sektorit kombëtar dhe duke vënë theksin në çështjet ndërsektoriale si reforma e administratës publike (RAP) dhe menaxhimi i financave publike (MFP). Kontrata e parë e mbështetjes buxhetore në rajonin e Ballkanit Perëndimor u miratua në vitin 2014 për Shqipërinë. Për të siguruar raportimin dhe monitorimin e duhur të këtij instrumenti, Ministria e Financave krijoi në vitin 2016 Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike, e cila shërben si sekretariat teknik për komitetet teknike dhe drejtuese të menaxhimit të financave publike. Ndër të tjera, Komisionet e MFP-së janë përgjegjës për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, e cila është një nga katër kushtet e përgjithshme për marrjen e fondeve në kuadër të instrumentit të mbështetjes buxhetore. Në këtë kontekst, Drejtoria e MFP-së bashkërendon punën me të gjithë aktorët e përfshirë dhe paraqet raportin vjetor të monitorimit të MFP-së në komisionet përkatëse për diskutim dhe miratim.

Sa i përket instrumentit të mbështetjes buxhetore, Drejtoria e MFP-së koordinon dhe integron kontributet për përgatitjen e: 1. Raportit Vjetor për Ruajtjen e Stabilitetit Makroekonomik; dhe 2. Raportit Vjetor të Transparencës Buxhetore, që janë dy nga katër kushtet e përgjithshme.

Drejtoria e MFP-së ka monitoruar zbatimin e Kontratës së Reformës Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike, e cila ishte kontrata e parë e këtij instrumenti për Shqipërinë. Në lidhje me këtë kontratë, Drejtoria e MFP-së, në bashkëpunim me asistencën teknike të parashikuar nga kjo kontratë, përgatiti një formular raportimi dhe monitorimi për kërkesën e disbursimit, i cili më pas iu shpërnda institucioneve drejtuese të kontratave përkatëse të mbështetjes buxhetore.

Sa i përket kontratave të tjera të mbështetjes buxhetore, drejtoria e MFP-së shqyrton dhe kontrollon dëshmitë e dorëzuara nga institucionet drejtuese të kontratave, për t'u siguruar që të gjitha provat e nevojshme të sigurohen sipas specifikimeve në kontratat e mbështetjes buxhetore. Pas sigurimit të provave, drejtoria e MFP-së përgatit dhe dorëzon paketën e plotë të kërkesës për shpërndarje te delegacioni i BE-së.

Drejtoria e MFP-së komunikon dhe bashkëpunon me Delegacionin e BE-së për sigurimin e dëshmive të nevojshme shtesë, si dhe për konfirmimet e shumave të shpërndara nga Delegacioni i BE-së. Në të njëjtën kohë, Drejtoria e MFP-së bashkëpunon me Departamentin e Thesarit në MF për të konfirmuar shpërndarjen e fondeve në Llogarinë e Vetme të Thesarit.

Gjithashtu, Drejtoria e MFP-së ka krijuar dhe përditëson vazhdimisht bazën e të dhënave të mbështetjes buxhetore, si dhe ka informuar institucionet drejtuese dhe Delegacionin e BE-së për çdo disbursim të bërë në Llogarinë e Vetme të Thesarit sipas këtij instrumenti.

PJESA 3: KOMPLEMENTARITETI DHE ZBATIMI I AGJENDËS SË REFORMAVE

12. KOMPLEMENTARITETI ME IPA III

Për të krijuar sinergji ndërmjet asistencës së Agjendës së Reformave dhe aktiviteteve në vazhdim ose të planifikuara të IPA III dhe për të shmangur dublikimin, dokumentet e veprimit dhe programet përkatëse të IPA-s janë rishikuar tërësisht duke analizuar se si secili nga aktivitetet IPA III siguron sinergji dhe kontribuon indirekt në objektivat e Agjendës së Reformave.

Reforma 1.1.2. Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës

Veprimi IPA III i BE-së për të Drejtat e Pronësisë – Faza II (IPA 2021) do të kontribuojë në avancimin e kuadrit ligjor për krijimin e të drejtave të pronësisë në Shqipëri dhe do të sigurojë të dhëna gjeohapësinore dhe harta kadastrale plotësisht të digjitalizuara (të skanuara dhe gjeoreferencuara). Veprimi IPA i lartpërmendur kontribuon në mënyrë indirekte në Reformën 1.1.2 e cila synon të miratojë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për regjistrimin e plotë të pronave në kadastër deri në qershor 2025, mbështetur nga një plan integriteti deri në dhjetor 2025. Kjo e fundit do të përfshijë masa të forta kundër korrupsionit.

Reforma 2.1.1. Rishikim i sistemit të AFP-së për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të të tregut punës

Reforma 2.1.1 do të mbulojë ndër të tjera hartimin dhe miratimin e kurrikulave të reja të AFP-së në përputhje me Strategjinë e Specializimit Inteligjent të Shqipërisë (që do të miratohet në vitin 2024) dhe trajnimin e mësuesve mbi ato kurrikula. Tri veprime IPA aktualisht në zbatim dhe të planifikuara në kuadër të programeve vjetore IPA 2019 dhe 2024 dhe programeve shumëvjeçare 2024–2027 në rrjedhën e vendimit të miratimit nga Komisioni, janë plotësuese të objektivit të Agjendës së Reformave. Veprimi IPA 2024 "BE për Punësimin dhe Gjithëpërfshirjen Sociale në Shqipëri" nën mbështetjen buxhetore (28 milionë euro) synon të promovojë zhvillimin e aftësive dhe punësimin duke rritur trajnimin arsimor dhe integrimin në tregun e punës, veçanërisht për kategoritë e pafavorizuara (përfituesit e ndihmës sociale, njerëzit me aftësi të kufizuara, komuniteti Rom dhe Egjiptian dhe gratë), dhe përmirësimi i përshtatshmërisë së masave të mbrojtjes sociale, aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel lokal. IPA po mbështet gjithashtu Projektin e Mësimdhënies Gjithëpërfshirëse të BE-së në kuadër të IPA 2019. Programi operacional "Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale (2024–2027)" – Fusha e Mbështetjes 1.2 Arsimi Digjital, synon të përmirësojë rezultatet e të nxënit të nxënësve të arsimit parauniversitar duke përdorur mjete dhe sisteme digjitale. Mbështetja është horizontale dhe synon të forcojë kurrikulën e shkollave të mesme të orientuara nga TIK-u dhe kapacitetet e mësuesve për të ofruar kurrikulat e reja. Ky program i fundit do të kontribuojë gjithashtu në mënyrë indirekte në Reformën 2.1.4. Përparimi i aftësive dhe njohurive digjitale për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme të TIK-ut për shkollat dhe universitetet publike.

Reforma 3.1.2. Përditësimi i kuadrit për sigurinë kibernetike, duke përfshirë kërkesat e direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse

Programi Operacional Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale (IPA 2024–2027) përfshin një Nën-Zonë Mbështetëse të Sigurisë Kibernetike e cila do të mbështesë trajnimin mbi ndërgjegjësimin kibernetik, trajnimin e modelit të trajnerëve dhe investimin në infrastrukturën qendrore (serverët, magazinimi), rrjetet/siguria dhe platforma e inteligjencës kibernetike. Objektivi specifik i mbështetjes së BE-së në kuadër të programit operativ është të përmirësojë aftësinë e autoriteteve shqiptare për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike duke forcuar ndërgjegjësimin kibernetik, aftësinë e analizës parandaluese, si dhe qëndrueshmërinë dhe reagimin kibernetik të organizatave të sektorit publik që marrin pjesë në rrjetin e qeverisjes së sigurisë kibernetike. Zbatimi i Veprimit do të ecë paralelisht me zbatimin e reformës 3.1.2 në mënyrë komplementare.

Reforma 3.1.3. Përditësimi i kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme

Dy Veprime financohen nga IPA III që janë plotësisht plotësuese me Reformën 3.1.3: sipas IPA 2022 – Faciliteti i Integrimit në BE, përgatitja e akteve nënligjore dhe rregulloreve mbështetet për të harmonizuar ligjin e ri të komunikimit elektronik me direktivën 2018/1972/BE duke krijuar Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike; Programi Operacional Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale nën IPA 2024-2027 do të mbështesë në kuadër të Zonës së Mbështetjes 2 përmirësimin e mjedisit ligjor dhe

rregullator për infrastrukturën gigabit, rritjen e qëndrueshmërisë dhe besimit për lidhje më të mirë digjitale dhe promovimin e inovacionit dhe agjendës së gjelbër në ndërtimin digjital infrastrukturën dhe 5G duke përfshirë masat zbatuese të bazuara në kutinë e veglave 5G.

Reforma 3.2.1. Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë respektive të mbështetjes financiare

Dy Veprime të mëpasshme që mbështesin zhvillimin e mjedisit të biznesit dhe ekosistemit të inovacionit u financuan në kuadër të IPA 2017 (BE për Fazën I Inovative) dhe IPA 2021 (BE për Inovacionin – faza II). Këto Veprime janë komplementare me Reformën 3.2.1.

Reforma 4.2.1. Zhvillimi i një plani ankandi me bazë sasiore, transparent dhe konkurrues, për energjinë e rinovueshme

Programi Operacional i BE-së për Energjinë i financuar nga IPA (2024-2027) do të kontribuojë në mënyrë indirekte në Reformën 4.2.1 nëpërmjet veprimeve të planifikuara në Fushën e Mbështetjes 1: Mbështetje për energjinë e rinovueshme dhe eficiencën energjetike të ndërtesave, të cilat mund të mbështesin instalimin e kapaciteteve shtesë të energjisë së rinovueshme në ndërtesat që u nënshtrohen masave të eficiencës së energjisë.

Reforma 4.4.1. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave, dhe skemës së eficiencës së energjisë

Miratimi i një strategjie kombëtare rinovimi afatgjatë për të mbështetur rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale në përputhje me kërkesat e direktivës (BE) 2010/31/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (i ndryshuar) është gjithashtu një kusht tematik që mundëson përmbushjen e Rregullores së BE-së 2021/1060 (Rregullorja e Dispozitave të Përbashkëta) për aksesin në fondet e kohezionit për rinovimin e ndërtesave. Rregullorja e BE-së 2021/1060 – Neni 15 dhe shtojca III, kërkon që strategjia kombëtare e rinovimit afatgjatë për të mbështetur rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale: a) përfshin piketa treguese për 2030, 2040 dhe 2050; b) ofron një përmbledhje treguese të burimeve financiare për të mbështetur zbatimin e strategjisë; c) përcakton mekanizmat efektivë për nxitjen e investimeve në rinovimin e ndërtesave. Përveç kësaj, kushti tematik i lartpërmendur kërkon që të zbatohen masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë për të arritur ruajtjen e kërkuar të energjisë. Nën Zonën e Mbështetjes 1, Programi Operativ IPA i BE-së për Energjinë 2024-2027 do të mbështesë në mënyrë indirekte zbatimin e reformës 4.1.1 duke mbështetur masat e eficiencës së energjisë duke përfshirë auditimin e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike dhe investimet në eficiencën e energjisë. Mbështetja e tërthortë shtesë për Reformën në Shqipëri përfiton gjithashtu nga Programi Rajonal i Eficiencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor(REEP).

Reforma 5.4.1. Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit nëpërmjet transparencës

IPA ka financuar Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri në tri programe vjetore: 2016 (faza I), 2020 (faza 2) dhe 2022 (faza 3). Mbështetja e BE-së ka qenë instrumentale në garantimin e zhvillimit dhe transparencës së procesit të *vetting*-ut në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe ligjin e *vetting*-ut. Mbështetja e deritanishme e IPA-së është baza për plotësimin e reformës 5.4.1 dhe për këtë arsye ONM-ja kontribuon vazhdimisht në mënyrë indirekte për objektivin specifik të kësaj Reforme.

Reforma 5.5.1. Parandalimi efektiv i korrupsionit, zvogëlimi i incidencës së korrupsionit

IPA 2024 BE për Veprimin Kundër Korrupsionit (3.85 milionë euro) është komplementare me Reformën 5.5.1. Veprimi përkatës IPA 2024 do të mbështesë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve operacionale për të luftuar korrupsionin përmes parandalimit, represionit, kapaciteteve ndërgjegjësuese dhe qasjes proaktive të luftës së nivelit të lartë të korrupsionit.

Reforma 5.6.1. Forcimi i lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane

Veprimi IPA 2022 BE për Demokraci (IPA 2022) kontribuon në mënyrë indirekte në objektivat e reformës 5.6.1, duke mbështetur integrimin e përforcuar të shoqërisë civile dhe pjesëmarrjen e medias në mekanizmat e qeverisjes demokratike dhe në hartimin e politikave në Kuvend dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe kontributin efektiv të shoqërisë civile dhe medias në dialogun e politikave, monitorimin dhe proceset e raportimit.

13. INVESTIMET SIPAS KORNIZËS SË INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR (KIBP/WBIF)

Prioritetet kryesore të investimeve në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave lidhen me shtyllat e AKR-së, me qëllim sigurimin e instrumentit për investime dhe me synim rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe hedhjen e bazave për një rritje të qëndrueshme në rajon.

Prioritetet e investimeve në transport do të lidhen kryesisht me sa vijon:

- masat për rritjen e ndërlidhjes (konektivitetit) për të lehtësuar tregtinë, për të përmirësuar efikasitetin e korridoreve të transportit, me synimin për të reduktuar kohën e pritjes në vendkalimet kufitare, sigurinë dhe transportin e gjelbër.

- mbështetja e investimeve në zgjidhjet digjitale për të rritur efikasitetin e infrastrukturës fizike; mbështetja e investimeve në sistemet e TI-së për të përmirësuar sigurinë dhe efikasitetin, si dhe në zgjidhjet digjitale për lidhjen hekurudhore midis BP6 dhe BE-së.

Prioritetet e investimeve në energji do të lidhen kryesisht me linjat e transmetimit dhe zgjidhjet inteligjente në eficiencën e energjisë, në mënyrë që të sigurohet integrimi i tregut të sektorit të energjisë me Tregun Unik të BE-së dhe tregun rajonal BP6. Për sa i përket tranzicionit energjetik, prioriteti kryesor mbetet forcimi i lidhjes energjetike, duke u përkushtuar në lehtësimin e tregtisë së energjisë dhe për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës energjetike. Fokusi mbetet në përfundimin e investimeve të ndërlidhjes në linjat e transmetimit ndërmjet BP6 me të gjithë rrjetin evropian, për të hyrë në tregjet e energjisë BP6 dhe BE-së.

Infrastruktura e ndërlidhjes digjitale do të jetë një tjetër dimension i investimeve në infrastrukturë, me përfundimin e investimeve për lidhjen rajonale me rrjetet evropiane të brezit të gjerë, në kombinim me masat e reformave të politikave të ndërmarra në përputhje me angazhimet e integrimit digjital për ngritjen e Zyrës së Kompetencës me Brez të Gjerë dhe forcimin e aftësive institucionale për zhvillimin e shoqërisë gigabit dhe për të përmirësuar mjedisin e biznesit për të promovuar investimet në infrastrukturën digjitale bazuar në rrjete me kapacitet shumë të lartë.

Për sa u përket investimeve në kapitalin njerëzor, Smart Labs konsiderohen si prioritet, ndaj do të krijojë një bazë solide për brezin e ri për të përmirësuar aftësitë e TIK-ut, në mënyrë që të përputhet më mirë me kërkesat për aftësi të punës.

Shqipëria e paraqet projektin e infrastrukturës ekonomike si thelbësor për integrimin e Shqipërisë në tregun e përbashkët të BE-së. Duke përmirësuar efikasitetin ekonomik, konkurrencën, pajtueshmërinë me rregullat, investimet, ky projekt krijon një mjedis më të favorshëm për rritje ekonomike dhe integrim. Veçanërisht projektet që lidhen me Infrastrukturën e Cilësisë, aftësitë dhe Kërkim & Zhvillim, krijojnë premisa për nxitjen e eksporteve dhe për të siguruar rritje. Ato përafrojnë infrastrukturën dhe kuadrin rregullator të Shqipërisë me standardet e BE-së, duke lehtësuar ndërveprimet dhe partneritetet brenda Tregut të Vetëm dhe duke kontribuar në stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm të ekonomisë shqiptare.

Lista treguese e projekteve, që do të miratohen në një takim të nivelit të lartë, është si më poshtë:

Zona		Projektet prioritare	Kostoja treguese e projektit (mln Euro)	Informacion mbi projektin
	1	Shqipëri, OHTL/Linja ajrore e re e transmetimit 400 kV Rrashbull (Shqipëri) – Arachtos (Greqi)	64	Sipas Fizibilitetit dhe përgatitjes së VNMS-së me AT përmes KIBP. Investimi në TBC bazuar në AT
	2	Digjitalizimi i OST-së	46	Miratimi jozyrtar në KIBP për grantin e investimeve. Të miratohet brenda muajit dhjetor si pjesë e Listës së projekteve të Planit të Rritjes
	3	Nënstacioni i ri 400/220 kV Vau i Dejës dhe përmirësimi i 220 kV ekzistues.	70	Fizibiliteti dhe VNMS do të përditësohen me Connecta 2 AT. Gjithashtu në diskutim me IFI për AT
	4	Zbatimi i matësve inteligjentë në sistemin e shpërndarjes.	330	KIBP ka pranuar vetëm pjesën e vendosjes së matësve inteligjentë në nënstacione, jo për konsumatorin fundor. Një

				projekt zbatimi për instalimin e matësve inteligjentë në Tiranë është në përgatitje e sipër. Planifikohet të mos aplikojë në KIBP për shkak të kufizimeve
Energjia	5	Ndërtimi i stokut për eficiencën e energjisë	TBA	Fondet për eficiencën e energjisë shkojnë në kuadër të programit KIBP/REEP. Projektet do të caktohen përmes strategjisë për rinovimin e stokut të ndërtesave që do të përgatitet me ndihmën e BERZH-it.
	6	Depoja e hidropompës së Koman-Fierzës	210	Sipas Fizibilitetit, VNMS-së dhe projektimit paraprak përmes AT nga KIBP
	7	Rehabilitimi i HEC-it të Vaut të Dejës	110	Fizibiliteti dhe VNMS do të përditësohen me Connecta 2 AT. Si dhe diskutim për AT me KfW
	8	Shtrirja e nënstacionit 400/220 KV Fierzë dhe 400 kV OHTL Fierzë (Shqipëri) - Prizren2 (Kosovë)	65	Aplikuar për FS dhe VNMS nën AT nga Connecta 2
	9	Unaza e brendshme 400 kV Fier - Rrashbull – Tiranë 2	31	Në përgatitje e aplikimit për grant për AT me IFI (KfW)
	10	Modelimi digjital i kaskadës së Drinit dhe rjedhës së poshtme të lumit Drin	80	Në diskutim me IFI
	12	Hekurudha Kristalopigji/Greqi me Pogradecin	250	
Transport	13	Stacioni hekurudhor Vlorë - Aeroporti i Vlorës (12 km)	50	
	14	Projekti i Zhvillimit të ITS dhe Qendra e Kontrollit të Trafikut	100	
		TTFP 2.0	40.1	
Digjital		Infrastruktura e Konektivitetit/Ndërlidhjes Digjitale/Zhvillimi Rajonal i brezit të gjerë		Projekti KIBP/BP24-ALB-DII-01 për përditësimin e FS, CBA dhe TD është në vazhdim dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2024. Kostoja e investimit TBC bazuar në FS të rishikuar/përditësuar.
		QKB AKSHI dhe Qendra DRC	45	
Kapitali Njerëzor		Smart Labs	41	
Infrastruktura ekonomike		Projekti i Infrastrukturës Ekonomike (Aftësitë; Kërkimi për Zhvillim; Infrastruktura e Cilësisë)	30	

14. KONSULTIMI [123]

Zhvillimi i Agjendës së Reformave është koduar në një proces të gjerë dialogu me institucionet qeveritare, institucionet e pavarura, si dhe aktorët përkatës, të cilët kanë marrë pjesë në një proces intensiv.

Procesi ka përfshirë fillimisht ministritë e linjës në të gjitha nivelet, të cilat janë përgjegjëse për fushat e politikave që kanë të bëjnë me Agjendën e Reformave, nëpërmjet Strukturës Negociatore. I gjithë procesi është koordinuar nga Struktura e Negociatave të Integrimit Evropian, e përbërë nga Ministri i Shtetit dhe kryenegociatori dhe negociatorët që mbulojnë fushat përkatëse në ministritë e linjës, duke pasur drejtimin për koordinimin në nivel politik, ndërlidhjen dhe qartësimin e diskutimeve teknike me vendimmarrjen politike, si dhe Sekretariati Teknik i BE-së/Departamenti i Politikave dhe Integrimit në BE, dhe zyrat në ministritë e linjës, agjencitë e tjera, organet qeveritare dhe institucionet e pavarura, si Parlamenti, institucionet e sistemit të drejtësisë, AMA etj.

Në këtë këndvështrim, janë zhvilluar katër raunde takimesh (afërsisht 72 takime gjatë periudhës mars-qershor 2024, të udhëhequra nga Ministri i Shtetit dhe kryenegociatori dhe negociatorët (zëvendësministra në ministritë e linjës), të organizuara dhe të mbështetura nga Sekretariati Teknik i BE-së përmes Strukturës Negociatore. Takimet kanë shërbyer si platforma bisedash për të hartuar dhe diskutuar mbi politikat prioritare, kanë konsoliduar hapat/masat në lidhje me prioritetet e politikave, kanë kontribuar në drejtimin e punës në hapat përkatës për hapat e konfirmuar, si dhe objektivat dhe treguesit që lidhen me hapat, siç paraqiten nga departamentet teknike dhe ekipet teknike përkatëse. Raundet vijuese të takimeve të strukturave negociuese të BE-së janë organizuar për të diskutuar me detaje Agjendën e Reformave:

- Seksioni i parë i fushës së politikës "Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe lufta kundër ekonomisë informale", u diskutua në rreth 12 takime në 4 raunde në muajt mars–qershor 2024, të zhvilluara midis ministrit të Shtetit dhe kryenegociatorit dhe negociatorëve të Ministrisë së Financave, Ministrisë së

[123] Konsultimi publik përfundon më 12.7.2024. Nëse do të ketë komente të reja që duhet të trajtohen, ato do të shtohen në këtë seksion në përputhje me rrethanat.

Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

- Seksioni i dytë, për "Kapitalin Njerëzor" u diskutua në 12 takime në 4 raunde mars–qershor 2024 mes ministrit të Shtetit dhe kryenegociatorit dhe negociatorëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; drejtorëve të përgjithshëm të politikave sektoriale dhe drejtorëve të përgjithshëm të disa agjencive në varësi të këtyre ministrive.

- Seksioni i tretë, për "Digjitalizimin", gjatë të cilit u zhvilluan 12 takime në 4 raunde në mars–qershor 2024, mes ministrit të Shtetit dhe kryenegociatorit dhe negociatorëve të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-it dhe drejtorit të përgjithshëm të AKSK-së, si dhe drejtorëve të përgjithshëm të politikave sektoriale në ministritë e linjës etj.

-Seksioni i katërt, "Energjia/Tranzicioni i Gjelbër", u zhvilluan 16 takime në 4 raunde në mars–qershor 2024, mes ministrit të Shtetit dhe kryenegociatorit dhe negociatorëve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmi, si dhe drejtorëve të përgjithshëm të politikave sektoriale në ministritë e linjës etj.

- Në seksionin e pestë të fushës së politikës "Bazat/Shteti i së Drejtës", u zhvilluan 20 takime në 4 raunde në mars–qershor 2024, mes zëvendësministrit të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Këshilltarit të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si dhe drejtorëve të përgjithshëm të politikave sektoriale në ministritë e linjës etj.

Përveç takimeve të kryenegociatorit dhe negociatorëve me ekipet teknike përkatëse dhe Sekretariatin e BE-së, këto takime janë shoqëruar me takime të tjera teknike dhe komunikime të sekretariatit teknik të Strukturës së Integrimit Evropian, që është Departamenti i Politikave dhe Integrimit Evropian me ekipet teknike të ministrive të linjës dhe agjencive të zhvillimit, për të siguruar përgatitjen e hapave të Agjendës së Reformave, për të dhënë udhëzime, për të përgatitur dokumentin narrativ të Agjendës së Reformave, për të identifikuar kostot dhe investimet, si dhe për të punuar në përcaktimin e treguesve të performancës.

Grupi i negociatorëve është mbledhur në tri takime të organizuara në mars, prill dhe maj 2024, për të diskutuar rreth prioriteteve dhe takimi i qershorit është planifikuar të zhvillohet në javën e 3-të të qershorit. Diskutimi në këto takime u fokusua në hapat e ndërmarrë për Agjendën e Reformave, për çështje komplekse të politikave për reformat përkatëse dhe problematikat në diskutimet me KE-në. Diskutimet midis negociatorëve iu kushtuan zgjidhjes së detajeve të ndërlikuara dhe sigurimit të konsensusit mbi ndryshimet reformuese të propozuara dhe masat e tjera, duke rritur realizueshmërinë, fizibilitetin, ndikimin dhe efektivitetin e reformave.

Gjithashtu, ministri i Shtetit dhe kryenegociatori kanë zhvilluar katër raunde takimesh me ministrat përkatës në më shumë se 30 takime, për të diskutuar aspektet komplekse të reformave, të nevojshme për të ndërtuar një pozicion dhe perspektivë për zbatimin e saj, si dhe për të garantuar mbështetje dhe udhëheqje politike në zbatimin dhe arritjen e rezultateve.

Agjenda e Reformave dhe perspektiva e saj është diskutuar në 3 mbledhje të Komitetit Konsultativ të Qeverisë (Komiteti Ndërministror Ekonomik), të kryesuara nga zëvendëskryeministri me pjesëmarrjen e ministrave, zëvendësministrave dhe ministrit të Shtetit dhe kryenegociatorit nga fusha përkatëse e politikës. Gjithashtu është organizuar një takim i Komitetit Ndërministror të Mirëqenies Sociale i kryesuar nga ministri i Arsimit dhe një takim i Komitetit Ndërministror të Sundimit të Ligjit dhe Sigurisë i kryesuar nga ministri i Mbrojtjes, Seancat me ministrat dhe Komisionet Konsultative përfshinë prezantime të analizave të thella dhe rregullime për të mundësuar reformat e propozuara, buxhetin dhe planifikimin legjislativ, si dhe ndikimin dhe udhëheqjen kolektive.

Më tej, Agjenda e Reformave është diskutuar në mbledhjet e drejtuara nga Kryeministri. Takimi i parë i Komitetit të Planifikimit Strategjik u organizua në nëntor 2023 për të diskutuar rreth procesit dhe prioriteteve kryesore të Qeverisë në lidhje me AR-në. Takimi i dytë dhe i tretë i punës janë zhvilluar në janar 2024 dhe mars 2024, me fokus në formësimin e reformave kryesore, si dhe diskutimin politik dhe vendimmarrjen për AR-në. Ky proces ka zhvilluar një diskutim të thelluar mbi Agjendën Kombëtare të Reformave, duke u fokusuar në përafrimin e saj me synimet strategjike afatgjata. Qasja e projektimit të përbashkët ka qenë instrumentale në vlerësimin e reformave të propozuara, duke u siguruar që ato janë të bazuara në njohuritë e mbështetura nga të dhënat dhe janë të realizueshme brenda kornizave aktuale dhe të parashikuara të politikave ekonomike dhe sociale, dhe më shumë ndikim në rritje.

Konsultimi dhe projektimi i përbashkët me institucione të pavarura

Janë mundësuar diskutime të gjera dhe koordinim ndërinstitucional me institucionet e pavarura, si Parlamenti, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (KLGJ), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), PP, SPAK, ILDKP etj. Këto institucione kanë qenë pjesë e grupit të punës për Sundimin e ligjit/bazat e koordinuara nga negociatori i kapitullit 23 (zëvendësministri i Drejtësisë) dhe Ministria e Drejtësisë, si dhe në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Pastrimin e Parave të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Pastrimi i Parave dhe Grupi i Punës për Krimin e Organizuar i kryesuar nga negociatori i kapitullit 24 (zëvendësministri i Brendshëm). Kjo qasje bashkëpunuese dhe ndërveprimet kanë qenë në rritje në përfshirjen e institucioneve të pavarura në diskutimin dhe dhënien e mendimit të tyre për secilin hap dhe afat kohor të reformave përkatëse etj. Përfshirja e institucioneve të pavarura në procesin e bashkë-projektimit ka qenë shumë e dobishme për procesin e arritjes së konsensusit dhe cilësisë së planifikimit për politikat, hapat e Agjendës së Reformave etj. Takimet e organizuara nga Ministria e Drejtësisë, DPPP, si dhe Kabineti i Ministrit të Shtetit për Antikorrupsionin kanë shqyrtuar çdo aspekt të reformave në Shtyllën e Shtetit të së Drejtës, duke ofruar njohuri dhe rekomandime kritike për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e reformave. Kjo përpjekje bashkëpunuese shënoi një hap të rëndësishëm përpara në përsosjen e drejtimit strategjik të reformave, duke vendosur një rrugë të qartë për zbatimin dhe rezultatet e parashikuara.

Konsultimet me Parlamentin

Kuvendi është informuar për procesin dhe përmbajtjen e Agjendës së Reformave me dy raporte tremujore të paraqitura në Komisionin për Çështjet Evropiane. Më tej, Komisioni për Çështjet Evropiane i Parlamentit ka diskutuar Agjendën e Reformave në një takim të organizuar në muajin maj. Takimi shërbeu për të informuar deputetët e Kuvendit, si dhe për të marrë opinionet e tyre mbi prioritetet e përfshira në Agjendën e Reformave.

Konsultimet me OSHC-të dhe aktorët e jashtëm

Agjenda e Reformave dhe reformat e saj për Klimën e Biznesit (Shtylla 1) janë diskutuar në dy takime të organizuara nga KEK (Këshilli Ekonomik Kombëtar), në prill dhe maj, të kryesuar nga Kryeministri/Ministri i Shtetit për Ndërmarrjet dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të biznesit, të cilat dhanë një kontribut të çmuar në diskutimin mbi Agjendën e Reformave.

Konsultimet me grupet e interesit të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile janë organizuar edhe në muajt mars–prill 2024 për të diskutuar mbi Agjendën e Reformave. Janë organizuar pesë takime të Platformave të Partneritetit të Integrimit Evropian në mars–prill 2024, të fokusuara në konsultimin e reformave në shtyllat përkatëse prioritare të Agjendës së Reformave. Takimet u kryesuan nga negociatorët/zëvendësministrat e ministrive që udhëheqin reformat në fushat përkatëse, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partnerëve socialë, organizatave të shoqërisë civile, Think Tanks, OJQ-ve, akademisë etj. Këto sesione ishin pjesë përbërëse për diskutimin dhe përsosjen e gjithëpërfshirjes së Agjendës së Reformave, si dhe sigurimin e një terreni solid për mbështetjen e zbatimit të këtyre reformave dhe përcaktimin e anëtarësimit në BE për vendin.

Konsultimi publik përmes platformës *e-Konsultimet* e Draftagjendës së Reformave ka nisur në 12 qershor 2024 dhe mbyllet në 12 korrik 2024, sipas procedurave ligjore dhe ligjit për konsultimin publik. Këto platforma janë të aksesueshme nga OSHC-të, Think Tank, grupe interesi, ekspertë, qytetarë, media, akademikë etj.

15. MONITORIM, RAPORTIM, VLERËSIM

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të Agjendës së Reformave do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive zbatuese të Shqipërisë.

Për këtë qëllim, Shqipëria do të krijojë një sistem të përhershëm monitorimi të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin dhe do të përpunojë raporte të rregullta progresi dhe raporte përfundimtare. Çdo raport duhet të japë një përshkrim të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësitë e hasura, ndryshimet e paraqitura, si dhe shkallën e arritjes së rezultateve të tij (rezultatet dhe rezultatet e drejtpërdrejta) të matura nga treguesit përkatës, duke përdorur si referencë listën e treguesve të rezultateve. Raporti do të hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë monitorimin e çdo mase në Agjendën e Reformave. Për këtë qëllim, Shqipëria do të bëjë organizime të rregullta dhe sistematike monitorimi dhe raportimi për të informuar mbi progresin drejt arritjes së rezultateve të planifikuara, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme,

marrëveshjet për sigurimin e cilësisë në mbledhjen e të dhënave – duke përfshirë ndarjen e të dhënave (p.sh. sipas gjinisë, moshës, rurale/urbane etj.) – dhe shkallën në të cilën reformat dhe investimet përkatëse marrin parasysh gjithëpërfshirjen dhe kontribuojnë në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Raporti përfundimtar, narrativ dhe financiar, do të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të veprimit dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi mbi zbatimin e përgjithshëm të reformave/masave, rezultateve dhe treguesve të rezultateve do të kryhen nëpërmjet strukturave të mëposhtme:

1. Koordinatori Kombëtar

Koordinatori Kombëtar do të veprojë si ndërlidhës me Komisionin Evropian për zbatimin e përgjithshëm të instrumentit.

Koordinatori Kombëtar do të përfshijë përgjegjësitë e mëposhtme, si:

- të sigurojë koordinimin e përgjithshëm, zbatimin në kohë, raportimin, monitorimin e asistencës për përfituesin, duke përfshirë koordinimin brenda administratës dhe me donatorë të tjerë sipas nevojës në përputhje me objektivat e përcaktuar në Rregulloren e Instrumentit të Facilitimit për Reformat dhe Rritjen;
- të koordinojë një dialog të rregullt politik të nivelit të lartë me Komisionin;
- të sigurojë një lidhje të ngushtë ndërmjet përdorimit të fondeve të facilitetit dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit;
- të sigurojë që ndihma e marrë në kuadër të Instrumentit të jetë plotësuese me ndihmën e marrë në bazë të Instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit dhe me çdo ndihmë tjetër të jashtme të marrë nga Shqipëria;

të përgatisë dhe dorëzojë kërkesat për lëshimin e fondeve në kuadër të facilitetit dhe të sigurojë vërtetësinë e tyre dhe nënshkrimin e deklaratës së sigurimit;

- të sigurojë: i. kapacitetin administrativ për sa u përket burimeve njerëzore (numri dhe profilet e stafit), përvojën dhe ekspertizën institucionale; dhe ii. mandatin dhe autoritetin për të ushtruar të gjitha detyrat përkatëse, duke përfshirë përgjegjësitë e raportimit dhe monitorimit;
- të garantojë përmbushjen e kënaqshme të hapave përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar në lidhje me zbatimin e Agjendës së Reformave, se fondet janë menaxhuar në përputhje me të gjitha rregullat në fuqi, veçanërisht rregullat për shmangien e konfliktit të interesave, parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe financimit të dyfishtë;
- të sigurojë që fondet e instrumentit të përdoren në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit për qëllimin e tyre të synuar dhe të menaxhohen siç duhet, veçanërisht në përputhje me rregullat shqiptare të plotësuara nga standardet e auditimit të BE-së dhe OECD-së dhe rregullat për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit dhe çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm që prek interesat financiarë të BE-së, si dhe për konfliktet e interesave dhe parregullsitë;
- të sigurojë mbledhjen, aksesin dhe transferimin në një format elektronik të të dhënave për personat fizikë dhe juridikë që marrin fonde për zbatimin e masave në kuadër të Instrumentit, në përputhje me nenin 22 të Rregullores së Facilitetit të Reformave dhe Rritjes.
- të monitorojë ngritjen dhe funksionalitetin e sistemit të brendshëm.
- të mbajë procedurat e duhura për hartimin e deklaratës së sigurisë dhe përmbledhjes së auditimeve dhe kontrolleve të kryera në nivel kombëtar. Kjo përfshin: i. një procedurë efektive për hartimin e deklaratës së sigurisë që dokumenton përmbledhjen e auditimeve dhe kontrolleve dhe mbajtjen e informacionit bazë për gjurmët e auditimit; ii. procedurat efektive për të siguruar që të gjitha rastet e mashtrimit, korrupsionit dhe konfliktit të interesave raportohen dhe korrigjohen siç duhet nëpërmjet rikuperimeve.
- të sigurojë masat e duhura, duke përfshirë procedurat për kontrollin e përmbushjes së hapave përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar në lidhje me zbatimin e Planit dhe pajtueshmërinë me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. Kjo përfshin: i. masat e duhura nëpërmjet të cilave autoritetet të cilave u është besuar zbatimi i masave të Planit do të kontrollojnë përmbushjen e hapave përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar në lidhje me zbatimin e Planit (p.sh. verifikim në zyrë, kontrolle në vend); ii. masat e duhura nëpërmjet të cilave autoritetet të cilave u është besuar zbatimi i masave të Planit do të

kontrollojnë mungesën e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit, aktiviteteve të tjera të paligjshme, duke përfshirë konfliktin e interesave dhe financimin e dyfishtë (p.sh. verifikimi në zyrë, kontrolle në vend).

- të administrojë një sistem efektiv për të siguruar mbajtjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve të nevojshme për qëllimet e gjurmimit të auditimit të zbatimit të hapave cilësorë dhe sasiorë.

- drejtojë punën e Komitetit të Monitorimit dhe të veprojë si ndërlidhës me Komisionit Evropian, OLAF, Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO), duke vepruar brenda kompetencave të tyre përkatëse dhe autoriteteve përfituese për zbatimin e përgjithshëm të Facilitetit; Koordinatori do të garantojë që Komisioni, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), Gjykata e Audituesve, EPPO mund të ushtrojnë lirisht të drejtat e tyre dhe të kenë akses të plotë për të ushtruar kompetencat e tyre. Në rastin e OLAF-it, të drejta të tilla përfshijnë ndër të tjera të drejtën për të kryer hetime, kontrolle dhe inspektime në vend, brenda kufijve të mandatit të saj, dhe, në rastin e EPPO-së, të drejtat në përputhje me marrëveshjet për Ndihmën e ndërsjellë Juridike në çështjet penale.

- të ndihmohet dhe këshillohet nga auditori i brendshëm në rishikimin e përmbajtjes së raportit të rregullt të zbatimit të parashikuar dhe informacionit të dorëzuar, duke përfshirë kryerjen e kontrolleve në vend. Në kuadër të përgatitjes së raportit gjysmëvjetor, auditorët e brendshëm do të ndihmonin Koordinatorin në përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë duke konfirmuar se të dhënat në raport janë të sakta, të verifikuara, të besueshme dhe pasqyrojnë saktë nivelin e arritjes së hapave të listuar, dhe se sistemi i vendosur i kontrollit të brendshëm dhe masat e marra për përmirësimin e tij konfirmojnë përmbajtjen e tij.

2. Komiteti i Monitorimit të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes. Komiteti i Monitorimit të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes do të vlerësojë shkallën dhe cilësinë e zbatimit të të gjitha reformave dhe investimeve në drejtim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në Agjendën e Reformave dhe në Rregulloren e Lehtësimit dhe Zhvillimit të Reformave.

- Komiteti i Monitorimit të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes - do të mbikëqyrë monitorimin dhe raportimin e të gjitha ministrive të linjës përkatëse, duke siguruar kështu një raportim të saktë dhe gjithëpërfshirës në Komisionin.

- Komiteti i Monitorimit të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes do të ketë si anëtarë: përfaqësues të Komisionit, përfaqësues të zyrës së Koordinatorit Kombëtar, përfaqësues të Zyrës së kryenegociatorit, përfaqësues të ministrive/institucioneve të linjës përgjegjëse për zbatimin e Agjendës së Reformave dhe, sipas rastit, donatorë dypalësh, organizata ndërkombëtare, institucione financiare ndërkombëtare dhe palë të tjera të interesuara, si shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat.

- Komiteti monitorues mblidhet të paktën një herë në vit. Mund të thirren edhe takime *ad hoc* me iniciativën e Komisionit ose të Shqipërisë, veçanërisht mbi baza tematike.

- Për të siguruar një koordinim efektiv gjatë zbatimit të Instrumentit, përfaqësues nga Komisioni, zyra e Koordinatorit dhe nga institucione të tjera shqiptare, do të mbajnë takime të rregullta në nivel teknik për të diskutuar investimet dhe reformat në Agjendën e Reformave që mund të ngrenë sfida specifike zbatimi - ose ndonjë rrezik të rëndësishëm për afatin kohor për përfundimin e çdo hapi, veçanërisht kur kjo mund të ketë implikime për afatin kohor të kërkesës shoqëruese për lëshimin e fondeve.

3) Ministritë/institucionet e linjës- Organet zbatuese për Facilitetin e Reformave dhe Rritjes në Shqipëri do të përbëhen nga pesë ministri kryesore, secila përgjegjëse për koordinimin e realizimit të reformave brenda fushave e politikave përkatëse. Këto ministri do të zgjidhen në bazë të numrit më të madh të masave për të mbikëqyrur secilën fushë të politikave. Ato do të sigurojnë zbatimin efektiv, monitorimin dhe përshtatjen e reformave për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e vendosur.

Ministritë e linjës do të:

- përgatisin të gjitha dokumentet për përmbushjen e masave të përfshira në Agjendën e Reformave.

- sigurojnë të gjitha provat për të demonstruar përmbushjen e masave të përfshira në agjendën e reformave

- përgatisin raporte gjashtëmujore dhe vjetore për masat përkatëse të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes.

- dorëzojnë Koordinatorit Kombëtar të gjithë informacionin mbi raportet e monitorimit, statistikat zyrtare, ditarin zyrtar etj. dhe orarin e brendshëm të disponueshmërisë së këtij informacioni (p.sh. orari i rregullt, datat specifike të publikimit etj.) Koordinatorit Kombëtar.

- zhvillojnë takime teknike periodike me institucionet drejtuese për çdo fushë, duke u fokusuar në statusin e reformave, identifikimin e pengesave të mundshme, diskutimin e nevojës për asistencë teknike shtesë dhe shtimin e koordinimit ndërmjet ministrive të ndryshme.

- ndërveprojnë në mënyrë të shpeshtë me Koordinatorin Kombëtar për të ndihmuar në ruajtjen e vrullit, adresimin e menjëhershëm të çështjeve në zhvillim dhe përpjekjeve kohezive drejt zbatimit të suksesshëm të Instrumentit të Facilitimit për Reformat dhe Rritjen.

16. KONTROLLI DHE AUDITIMI

Kontrolli i Brendshëm dhe Përgjegjësia Menaxheriale

Kontrolli i Brendshëm:

